



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**

**Raporti përfundimtar i auditimit të ushtruar në Universitetin “Luigj Gurakuqi”  
Shkodër**

**RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT**

**“AUDITIM FINANCIAR DHE I PËRPUTHSHMËRISË”  
NË UNIVERSITETIN “LUIGJ GURAKUQI” SHKODËR**

**TIRANË, maj 2025**

<b>Nr.</b>	<b>Përmbajtja</b>	<b>Faqe</b>
<b>I</b>	<b>PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE</b>	<b>3 – 10</b>
1	<i>Përshkrimi i shkurtër i Projekt të Auditimit</i>	3
2	<i>Përshkrimi i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve</i>	4-8
3	<i>Konkluzioni i përgjithshëm dhe opinioni i auditimit</i>	8-10
<b>II</b>	<b>HYRJA</b>	<b>10-14</b>
1	<i>Objektivat dhe qëllimi</i>	10
2	<i>Identifikimi i çështjes</i>	10-11
3	<i>Përgjegjësitë e strukturave drejtuese</i>	11
4	<i>Përgjegjësitë e audituesve</i>	11
5	<i>Kriteret e vlerësimit</i>	11-12
6	<i>Standardet e auditimit</i>	12
7	<i>Metodat e auditimit</i>	12-13
8	<i>Dokumentimi i auditimit</i>	13-14
<b>III</b>	<b>PËRSHKRIMI I AUDITIMIT</b>	<b>14-128</b>
1	<i>Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim.</i>	14
2	<i>Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit.</i>	14-128
2.1	<i>Hartimi dhe zbatimi i buxhetit të shtetit.</i>	14-20
2.2	<i>Zbatimi i dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës dhe pagave.</i>	20-32
2.3	<i>Zbatimi i dispozitave ligjore mbi administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare.</i>	32-41
2.3.1	<i>Zbatimi i Projekteve Shkencoret.</i>	41-47
2.4	<i>Auditimi i llogarive vjetore.</i>	47-69
2.5	<i>Prokurimet publike.</i>	69-109
2.5.1	<i>Zbatimi i kontratave të punëve publike.</i>	109-116
2.6	<i>Vlerësimi i funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit financiar dhe vlerësimi i të Auditit të Brendshëm.</i>	116-125
2.7	<i>Probleme të ndryshme që mund të dalin gjatë auditimit.</i>	125-128
<b>IV</b>	<b>REKOMANDIME</b>	<b>128-154</b>

## **I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.**

### **a. Përshkrim i shkurtër i institucionit:**

Mbështetur në Ligjin 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e KLSH”, në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 1101/1, datë 19.09.2024 (i ndryshuar), i miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, nga data 19.09.2024 deri në datën 10.01.2025, në subjektin “Universiteti Luigj Gurakuqi Shkodër”, (në vijim USHLG), për periudhën nga 01.01.2022 deri në datën 30.06.2024, u krye auditimi Financiar dhe i Përputhshmërisë, me qëllim vlerësimin e përputhshmërisë së veprimtarisë dhe rregullshmërinë e operacioneve financiare të kryera nga ana e këtij institucioni, duke i kushtuar vëmendje të veçantë çështjeve që lidhen me llogaridhënien vjetore, administrimin e fondeve buxhetore dhe zbatimin e procedurave të emërimit dhe largimit nga puna të arsimtarëve, aspektet e menaxhimit financiar dhe të vlerësimit të sistemeve të kontrollit, etj.

Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër është person juridik publik, i njohur me ligj si i tillë. Ai organizohet dhe funksionon në përputhje me legjislacionin për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor si edhe me rregullat e parashikuara në Statutin dhe në rregulloret e tij.

Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër është një universitet publik që ofron programe të nivelit bachelor, master dhe studime doktorale. Universiteti kontribuon në zhvillimin e shoqërisë, përmes tre shtyllave të misionit të arsimit të lartë publik: kërkim shkencor, edukim, si dhe shërbim ndaj publikut. Duke ofruar edukim me në qendër studentin, nxit rritjen personale dhe intelektuale, për të përgatitur studentë për karriere produktive dhe qytetare, të përgjegjshëm në një shoqëri globale. Organi më i lartë drejtues akademik i Universitetit është Senati Akademik. Organe të tjera akademike janë Asambleja e personelit akademik dhe komisionet e përhershme. Autoritetet drejtuese akademike janë: Rektori, drejtuesi i njësisë kryesore, drejtuesi i njësisë bazë. Rektori është autoriteti më i lartë akademik i institucionit të arsimit të lartë, si dhe përfaqësuesi ligjor i tij për çështjet akademike dhe protokollare. Dekani i fakultetit/drejtori i institutit është autoriteti më i lartë akademik i njësisë kryesore dhe përfaqësuesi i saj.

### **b. Rëndësia e institucionit dhe e auditimit të tij.**

Rëndësia e auditimit financiar dhe të përputhshmërisë të USHLG për periudhën e aktivitetit 2022-30.06.2024, krahas detyrimit kushtetues dhe ligjor që konsiston në kontrollin e përdorimit dhe mbrojtjes së fondeve shtetërore, sipas legjislacionit në fuqi, qëndron në të bërit sa më transparente të veprimtarisë menaxhuese dhe administruese, për të rritur përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien, në funksion të rritjes së performancës së mësimdhënies.

### **c. Qëllimi i auditimit ku përcaktohet dhe periudha nën auditim, paraqitja e objektivave të cilat janë të njëjta me drejtimit e auditimit të tij:**

Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve është paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe atë të shpenzimeve. Qëllimi i auditimit të pasqyrave financiare është që ti bëhet e njohur nivelit drejtues, si dhe rritja e shkallës së besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, nëpërmjet shprehjes së një opinioni nga ana jonë nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar, si një mekanizëm kontrolli për të siguruar përgjegjshmërinë në menaxhimin financiar.

Në përmbushje të qëllimit të auditimit, janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme:

- Hartimi dhe zbatimi i buxhetit.
- Zbatimi i dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës dhe pagave.
- Zbatimi i dispozitave ligjore mbi administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare.

- Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2023,
- Prokurimi i fondeve publike.
- Vlerësimi i funksionit të sistemit të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimi financiar dhe vlerësimi i auditit të brendshëm.
- Ankesës së ardhur në KLSH protokolluar me Nr.1494 prot, datë 13.12.2024.

**d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave.**

Metodologjia e përdorur për kryerjen e këtij auditimi është mikse, sasiore dhe cilësore. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efikasitet dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Nën gjykimin profesional të Audituesve të pavarur, bëhet përzgjedhja e kampioneve për ekzaminim në zërat e shpenzimeve.

Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetit. Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar.

Për arritjen e konkluzionit vlerësues, janë përdorur teknikat e auditimit si: Kontrolli aritmetik. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese, Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese, Kontrolli i vlerësimit. Kontrolli sipas një treguesi, Verifikimi i transaksioneve Intervistimi, Raporte dhe informacione, Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm.

**e. Nr. i gjetjeve dhe rekomandimeve.** Në raportin përfundimtar janë formuluar 30 gjetje dhe 32 rekomandime për masa organizative, 5 gjetje dhe 6 rekomandime për shpërblim dëmi, 8 gjetje dhe 8 rekomandime për përdorim të fondeve publike pa efektivitet si dhe 2 gjetje dhe 3 rekomandime për të ardhura të munguara.

**f. Paraqitja e gjetjeve kryesore.**

- Në rastin e pagesave të stafit me detyrë përgjegjës në Rektorat, paga e tyre është realizuar në kundërshtim me parashikimet ligjore të VKM nr.187 datë 08.03.2017.
- 36 anëtarë të personelit ndihmës akademik me karakter administrativ pranë Rektoratit ishin punësuar pa iu nënshtruar më parë procesit të rekrutimit, në kundërshtim me VKM nr.176 datë 29.03.2006 “Për botimin e buletinit e njoftimeve publike”.
- Me vendimin nr. 16 datë 13.01.2023 “Për pagesën për sekretaren e Bordit të Administrimit të USH-së”, është vendosur miratimi i pagesës shtesë mbi pagën normale për detyrën si sekretare e BA me një vlerë prej 15,000 lekë në muaj. Veprim ky në kundërshtim me ligjin nr. 8480 datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” neni 2, pika 1.
- Nga auditimi i dokumentacionit për shpenzimet mbi pagesat për orët jashtë orarit zyrtar për periudhën objekt auditimi, u konstatua se në janar të vitit 2024 janë paguar 13 punonjës ndërsa në muajin prill 12 punonjës. Grupi i auditimit konstaton se nuk ka kërkesë të eprorit të drejtpërdrejtë dhe miratimin e titullarit të institucionit për punonjësit që kanë punuar orë shtesë, por urdhri administratorit për pagesën për orët jashtë orarit zyrtar është mbas faktit, pasi dhe në shkresën me nr, 4005/1 datë 12.12.2023 nuk është cituar se grupi i punës do të punoj jashtë orarit zyrtar te punës.
- Për muaj mars të vitin 2024 janë paguar 5 punonjës me orë jashtë orarit zyrtarë. Grupi i auditimit konstaton se tek shkresa me nr, 715 prot datë 27.02.2024 për ngritjen e grupit te punës nuk është specifikuar se kur do të punoj jashtë orarit zyrtar grupi i punës. Ndërkohë tek liste prezenca e muajt mars me nr, 1106/8 prot, datë 02.04.2024 rezulton se punonjësit e sipërcituar nuk kanë punuar jashtë orarit zyrtar te punës pasi ne ditët pushim zyrtar siç është e shtuna dhe e diela prezenca është shënuar me (P) pushim.

- Në 3 procedura prokurimi, me vlerë totale të fondit limit 10,708,327 lekë pa TVSh, parregullsi në hartimin e fondit limit, në hartimin e specifikimeve teknike dhe vendosjen e kritereve jo në përputhje me e objektit që prokurohet.
- Në 4 procedura prokurimi, me fond limit 22,731,163 lekë pa TVSh, OE të shpallur fitues në dokumentacionin e paraqitur prej tyre kishin mangësi në plotësimin e kritereve të vendosura në DT.
- Në 4 procedura prokurimi, me fond limit 28,582,588 lekë pa TVSh, janë nënshkruar 2 kontrata me të njëjtën OE të shpallur fitues dhe të njëjtën objekt prokurimi, zbatimimi i kontratës është bërë referuar kontratës së dytë.
- Në 1 (një) procedurë prokurimi, kontrata me OE është nënshkruar me datë 06.10.2022 dhe përfundon brenda 60 ditëve nga nënshkrimi i saj ose me datë 05.12.2022. Ndërkohe që shtesa e kontratës është lidhur me datë 06.12.2022 kur ka përfunduar kontrata e pare, por çdo ndryshim kontrate mund të bëhet vetëm gjatë kohëzgjatjes së tyre. Veprime në kundërshtim me LPP nr. 162 dt. 23.12.2020 neni 127 Modifikimi i kontratave gjatë afatit të tyre si dhe VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 i ndryshuar Neni 23 Njoftimi i modifikimit të kontratës gjatë kohëzgjatjes së saj.
- Në 1 (një) procedurë prokurimi, me urdhrin nr, 2984/20 datë 26.12.2023 është ngritur komisioni për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës. Komisioni i zbatimit të kontratës ka mbajtur proces verbale me date 27-28.12.2023 mbi kryerjen e aktiviteteve, por aktivitet janë kryer përpara proces verbaleve të mbajtura nga komisioni si dhe përpara ngritjes së urdhrin për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës.
- Në 1 procedurë prokurimi, vendimi i KPP nuk është zbatuar brenda 5 ditëve por është zbatuar 122 ditë me vonesë nga AK.
- Në 5 procedura prokurimi të vitit 2022 me fond limit 27,080,671 lekë pa TVSh, dokumentet e dorëzuara nga operatorët ekonomik fitues në përmbushje të kërkesave të vendosura në DT nuk protokollohen në zyrën e arkiv protokollit nga OE. Dokumentacioni merret në dorëzim nga komisioni i vlerësimit të oferta të cilin mban dhe një procesverbal me dokumentet e marra në dorëzim dhe me pas protokollin pranë AK .
- Nga auditimi i 16 urdhër shpenzimeve grupi i auditimit konstatoi se blerja e biletave të transport ajror ndërkombëtare me vlerë 811,058 lekë nuk është zhvilluar me procedurën e prokurimit publik,
- Nga auditimi i kartelave të karburanti për periudhën objekt auditimit konstatohet se me autorizim të administratorit tërhiqnin karburant punonjës të USHLG për arsye pune si dhe lëviznin me makinat e tyre personale në vlerën 221,113 lekë. Gjithashtu dhe tek dietat brenda vendit është paguar shpenzime karburanti në vlerën 34,600 lekë por pa dokument justifikues për shpenzimin e kryen (kuponët tatimor).
- Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për zbatimin e kontratës me objekt: “Rikonstruksion çatia FSHE”, me nr.1030/2 prot., datë 25.03.2024, lidhur midis Universitetit Luigj Gurakuqi, Shkodër dhe Operatorit Ekonomik OE “L” Shpk. Vlera e kontratës është 11,418,326 lekë me TVSh, rezulton se punimet nuk kanë përfunduar sipas kushteve të kontratës, duke evidentuar një dem ekonomik në vlerën 866,056 lekë pa TVSh.
- Sipas të dhënave të paraqitura, vërehet se nga planifikimi në PBA për vitin 2022, investimet e realizuara përbëjnë vetëm 7%, ndërsa nga plani vjetor i buxhetit, realizimi i investimeve arrin në 14%. Kjo tregon qartë një mungesë të theksuar në analizimin dhe planifikimin e investimeve nga strukturat përgjegjëse në USHLG.
- Nga auditimi i aktiveve afatshkurtra materiale rezulton se për llogarinë 520 “Disponibilitete në thesar” konstatohet një diferencë prej 827,113 e cila nuk është rakorduar bazuar në përcaktimet ligjore dhe nënligjore në fuqi
- Nga auditimi i aktiveve afatshkurtra (qarkulluese) u konstatua se në llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm” e cila përfaqëson detyrimet që kanë të tretët ndaj universitetit për periudhën e auditimit është mbyllur me teprice zero. Nga të dhënat e platformës së sekretarisë online "Pitagora" te

administruara nga grupi i auditimit ne format elektronik konstatohen se janë 614 studente debitorë të regjistruar në Universitetin e Shkodrës me vlerë totale 14,386,000 leke. Nga këta studentë të cilët janë debitor, 167 studente janë me status “Diplomuar” që në vlerë kapin shifrën 4,330,000 lekë, të cilat nuk janë arkëtuar nga ana e Universitetit. Në librat e kontabilitetit të Universitetit këto të dhëna nuk janë të konstatuara apo të kontabilizuara.

- Nga auditimi i llogarisë 210 “*Toka troje terrene*” konstatohet se, nga përlllogaritjet e grupit të auditimit mbi sipërfaqen e tokës truall ku Universiteti ushtron aktivitetin, sipas shkresës nr 922/1 prot, datë 13.03.2024 rezulton një sipërfaqe toke truall prej 13,536.64 metër katror. Vlera e tokës truall sipas shkresës së mësipërme në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 89, datë 3.2.2016 “Për Miratimin e Hartës së Vlerës së Tokës në Republikën e Shqipërisë rezulton në vlerën 120,992,154.24 lekë, nga e cila vetëm 888,000 lekë është e kontabilizuar në llogaritë kontabël të pasqyrave financiare të Universitetit. Diferenca prej 120,104,154,24 lekë nuk është pasqyruar dhe kontabilizuar në llogaritë kontabël të pasqyrave financiare të Universitetit duke sjelle një paraqitje jo te drejte dhe te sakte te pozicionit financiar ne datën e mbylljes se pasqyrave financiare për vitin 2022 dhe 2023.
- Nga auditimi i të ardhurave konstatohet se për laboratorin e Diagnostifikimit Mikrobiologjik i cili është pjese e strukturës së Rektoratit, sipas nenit 91 te “*Rregullores së administratës të Rektoratit të USH-se*” si funksion të saj ka kryerjen e analizave mikrobiologjike për individët dhe realizimin e te ardhurave në buxhetin e USH-se, operohet me performance negative. Nga auditimi i të ardhurave konstatohet se të ardhurat e Universitetit kontabilizohen në momentin e arkëtimit dhe jo të konstatimit, duke operuar me kontabilitetin me baze likuiditetin.
- Nga auditimi i inventarizimit të pronës shtetërore për vitin 2023 konstatohet se për procesin e inventarizimit ka dale vetëm urdhri për “Krijimi i komisionit te inventarizimit dhe vlerësimit fizik te aktiveve”, por procesi i inventarizimit nuk është zhvilluar.

#### **g. Paraqitja e rekomandimeve kryesore:**

- Nga Rektori i Universitetit “Luigj Gurakuqi” Shkodër, të merren masa për rishikimin e kontratave të punës për personelin akademik me kohë të plotë, i cili nuk ka mbaruar studimet e doktoratës brenda afatit ligjor.
- Nga ana e Rektorit dhe Administratorit të Universitetit “Luigj Gurakuqi” Shkodër, të merren masat për rishqyrtimin e 36 procedurave të emërimeve/komandimeve, që janë kryer pa iu nënshtuar me parë procedurave të konkursit me qëllim zbatimin e akte ligjore dhe nënligjore.
- Titullari i Autoritetit Kontraktor (Administratori) në bashkëpunim me grupin e punës ose komisionin përkatës, të marrë masat e nevojshme për hartimin e fondit limit, përgatitjen e specifikimeve teknike dhe përcaktimin e kriterëve të vlerësimit, në përputhje me objektin që prokurohet. Gjithashtu, gjatë vlerësimit të ofertave për procedurat që do të zhvillohen në vijimësi, duhet të sigurojë që veprimet të jenë në përputhje të plotë me aktet ligjore dhe nënligjore, si dhe me parimet e transparencës, barazisë dhe efektivitetit.
- Nga ana e Universitetit “Luigj Gurakuqi” Shkodër, të merren masat e nevojshme për të siguruar miratimin e planit buxhetor brenda afateve të përcaktuara ligjore, duke përmirësuar koordinimin ndërmjet Administratorit, Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit, me qëllim shmangien e vonesave që kanë ndikuar negativisht në ekzekutimin e investimeve.
- Administratori dhe Sektori i Financës të marrin masa të menjëhershme për evidentimin dhe kontabilizimin e detyrimeve në vlerën 14,386,000 lekë që studentet e regjistruar prej vitit 2013 e në vijim, kanë ndaj Universitetit të Shkodrës në pasqyrat financiare të vitit 2024.
- Administratori dhe Sektori i Financës të marrë masa dhe veprime të menjëhershme që studentët me status “Diplomuar” të mbyllin detyrimet në vlerën 4,330,000 lekë, ndaj Universitetit.
- Titullari i Universitetit “Luigj Gurakuqi” Shkodër, të marrë masa për ngritjen e një grupi pune për të evidentuar shkaqet dhe personat përgjegjës, që kanë sjellë humbje në aktivitetin financiar të

Laboratorit të Diagnostifikimit Mikrobiologjik në vlerën 1,341,980 lekë, të ardhura këto të munguara në buxhetin e Universitetit “Luigj Gurakuqi” Shkodër.

- Administratori i Universitetit “Luigj Gurakuqi” Shkodrës të ngrëjë një grup pune për vlerësimin financiar të truallit nën administrim të Universitetit. Për vlerësimin financiar të nxjerrë nga grupi i punës, sektori i financës të marrë masa të menjëhershme për kontabilizimin e vlerës së tokës truall nën administrim nga Universiteti duke bërë që llogaritë e aktiveve afatgjata materiale të paraqiten në vlerë të drejtë sipas kërkesave të teknikave kontabël.
- Universitetit “Luigj Gurakuqi”, Shkodër/Sektori i financës të marrë masa të menjëhershme për tu pajisur me pajisje fiskale për lëshimin e faturave të fiskalizuara për të gjitha shërbimet e ofruara me qëllim konstatimin dhe pasqyrimin saktë të të ardhurave.
- Universiteti i Shkodrës të marrë masa të menjëhershme që të bëhet procesi i inventarizimit dhe rezultati të pasqyrohet në pasqyrat financiare të vitit 2024.
- Nga Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër, të kërkohej në rrugë ligjore arkëtimi i vlerës prej 1,186,389 lekë i përfituar padrejtësisht, për pagesat e orëve jashtë orarit zyrtar të punës, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit.
- Autoriteti Kontraktor Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës 449,947 lekë nga OE “I” shpk si kamatëvonesa për tejkalim të afatit të dorëzimit të pajisjeve.
- Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës 118,512 lekë nga Administratori z. A. U për lidhjen e kontratës me ditë pune dhe jo kalendarike duke shkaktuar kamatëvonesa për tejkalim të afatit të dorëzimit të pajisjeve.
- Autoriteti Kontraktor Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër, të marrë masa që në likuidimin e situacionit përfundimtarë të paraqitur nga OE “N” sh.p.k të zbres vlerën 1,736,533 lekë që përbën dëm, për punime të pa realizuara dhe të kryera me defekt.
- Autoriteti Kontraktor Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, masa për arkëtimin e vlerës prej 866,056 lekë pa TVSh nga Kontraktori OE “L” sh.p.k, për punime të likuiduara por të pa realizuara.
- Administratori i Universitetit “Luigj Gurakuqi” Shkodër në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse, të marrë masë:
- Ngritjen e një grupi pune për të evidentuar vlerën e përdorimit pa efikasitet të buxhetit të shtetit për pagesën e likuiduar për RASH me urdhër shpenzimet në masën totale 3,119,760 lekë, duke nxjerrë përgjegjësinë për personat përgjegjës.
- Administratori i Universitetit “Luigj Gurakuqi” Shkodër të marrë masa për ngritjen e një grupi pune për të evidentuar shkaqet dhe personat përgjegjës, që kanë sjellë përdorimin pa efikasitet të buxhetit të shtetit në vlerë totale 811,058 mbi pagesën e transport ajror ndërkombëtare të zhvilluar pa procedurë prokurimi.
- Administratori i Universitetit “Luigj Gurakuqi” Shkodër, të marrë masa për ngritjen e një grupi pune për të evidentuar shkaqet dhe personat përgjegjës, që kanë sjellë përdorimin pa efikasitetin të buxhetit të USHLG në vlerën 1,442,651 në trajtimin me pagë për kategorinë “Përgjegjës Sektori në Rektorat”.
- Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër, të marrë masa për ngritjen e një grupi pune për të evidentuar shkaqet dhe personat përgjegjës, që kanë sjellë përdorimin pa efikasitetin në buxhetin e institucionit , në vlerën 1,350,000 lekë, për pagesat e përfituar nga sekretarja e Bordit të Administrimit, komisioni i etikës dhe komisioni i përhershëm për garantimin e standardeve dhe cilësisë, në kundërshtim me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

- Administratori i Universitetit “Luigj Gurakuqi” Shkodër, të marrë masa për ngritjen e një grupi pune për të evidentuar shkaqet dhe personat përgjegjës, që kanë sjellë përdorimin pa efikasitet të buxhetit të USHLG në vlerën 741,262 lekë, për ngritjen e komisionit të zbatimit të kontratës si dhe mbajtjen e proces verbaleve nga komisioni mbas zhvillimit të aktiviteteve.
- Titullari i Autoritetit Kontraktor Universitetit “Luigj Gurakuqi” Shkodër, të marrë masa për ngritjen e një grupi pune për të evidentuar shkaqet dhe personat përgjegjës, që kanë sjellë përdorimin pa efikasitet të buxhetit të Autoritetit Kontraktor në vlerën 564,000 lekë pa TVSh mbi pagesat e kryera për punime të mbivendosura në objektin “Investim për ndriçim të objekteve dhe tabelave emërtuese të ndërtesave”.
- Titullari i Autoritetit Kontraktor Universitetit “Luigj Gurakuqi” Shkodër, të marrë masa për ngritjen e një grupi pune për të evidentuar shkaqet dhe personat përgjegjës, që kanë sjellë përdorimin pa efikasitet të buxhetit të Autoritetit Kontraktor në vlerën 1,159,535 lekë pa TVSh mbi pagesat e kryera për punime të mbivendosura në objektin e mësipërm.

### **I.1.Opinion i Auditimit.**

#### **Opinion mbi pasqyrat financiare:**

Ne kemi audituar hartimin dhe paraqitjen e pasqyrave financiare të Universitetit “Luigj Gurakuqi” Shkodër, për periudhën 01.01.2023-31.12.2023, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar, pasqyrën e performancës, pasqyrën e ndryshimeve në kapital, pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare dhe shënimet shpjeguese që shoqërojnë këto pasqyra. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe paraqitjen në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i zbatimit të parimeve kontabël, si dhe i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare përmbajnë gabime materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një **Opinionit të Kualifikuar mbi pasqyrat financiare.**

#### **Baza për opinionin:**

Ne e kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI-t. Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare. Ne jemi të pavarur nga subjekti dhe në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare, kemi përmbushur përgjegjësitë etike në përputhje me këto kërkesa. Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë vlerën e materialitetit prej 15,065 mijë lekë, që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur, justifikojnë dhënien e një “Opinionit të Kualifikuar” të auditimit. Nga auditimi i kryer nga ana e KLSH-së, mbi vlerësimin integral të sistemit të mbajtjes së kontabilitetit dhe raportimit financiar në Universitetin e Shkodrës, sipas kërkesave të legjislacionit mbi buxhetin dhe kontabilitetin, kanë rezultuar disa mangësi dhe parregullsi, të identifikuar si më poshtë:

-Nga auditimi i aktiveve afatshkurtra materiale rezulton se për llogarinë 520 “Disponibilitete në thesar” konstatohet një diferencë prej 827,113 lekë e cila nuk është rakorduar bazuar në përcaktimet ligjore në fuqi.

-Nga auditimi i llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” konstatohen se janë 614 studentë debitorë të regjistruar në Universitetin e Shkodrës, me vlerë totale 14,386,000 lekë të panjohura dhe kontabilizuar sipas përcaktimeve ligjore në fuqi, nga të cilët detyrimet nga 167 studentë me status “Diplomuar” janë në vlerën 4,330,000 lekë.

-Nga auditimi i llogarisë 210 “Toka troje terrene”, në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën neto 888,000 lekë, konstatohet vlerë trualli prej 120,104,154.24 nën administrimin e Universitetit e pakontabilizuar në asetet e Universitetit bazuar në përcaktimet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

-Nga auditimi i llogarive 230 “Për aktive afatgjata jomateriale” 231 “Për aktive afatgjata materiale” respektivisht 22,254,065 lekë dhe 65,971,837 lekë nuk janë bërë vlerësimet dhe klasifikimet e duhura kontabël bazuar në përcaktimet ligjore dhe nënligjore në fuqi

-Nga auditimi i shpenzimeve, konstatohet se janë klasifikuar si shpenzime rikonstruksione të godinave në shumën 21,025,252 lekë në kundërshtim me përcaktimet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

-Nga auditimi i detyrimeve të prapambetura konstatohen në total 2,890,800 lekë të pakontabilizuara dhe konstatuara në pasqyrat financiare

### **Opinionit mbi përputhshmërinë:**

Mbështetur në, ISSAI 4000 “Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Përputhshmërisë”, Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH dhe Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë në audituam përputhshmërinë e veprimtarisë së subjektit Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër, për periudhën 01.01.2022 deri më 30.06.2024, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë nga subjekti, të ligjeve, vendimeve rregullave dhe rregulloreve, udhëzimeve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord, nëpërmjet: a) auditimit të sistemeve financiare dhe transaksioneve, duke përfshirë edhe vlerësimin e përputhshmërisë me ligjet dhe rregulloret; b) auditimit të sistemit të kontrollit të brendshëm financiar publik; c) auditimit të integritetit dhe përputhshmërisë së vendimeve administrative të marra nga subjekti i audituar, d) raportimin e të gjitha çështjeve të tjera që dalin nga apo që lidhen me auditimin, të cilat Kontrolli i Lartë i Shtetit i konsideron të rëndësishme për t’u bërë publike.

Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e kërkuar dhe të vënë në dispozicion, kemi konstatuar se në veprimtarinë e subjektit Universiteti “Luigj Gurakuqi”, Shkodër janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur, janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinionit të **kualifikuar**, e shprehur kjo në bazën për opinion. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për dhënien e **opinionit të kualifikuar të përputhshmërisë**.

### **Baza për opinion:**

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Auditimi ynë përfshin kryerjen e procedurave me qëllim marrjen e evidencave të auditimit, mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e veprimtarisë të ushtruar nga subjekti i audituar. Procedurat janë përzgjedhur mbështetur mbi gjykimin profesional të audituesit, duke marrë në konsideratë vlerësimin e riskut dhe materialitetit për subjektin e audituar. Nga evidencat e marra për veprimtarinë e Universitetit “Luigj Gurakuqi” Shkodër rezultuan:

- Në rastin e pagesave të stafit me pozicion pune Përgjegjës në Rektorat, paga e tyre është realizuar në kundërshtim me parashikimet ligjore të VKM nr.187 datë 08.03.2017 “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e presidentit, kuvendit, komisionit qendror të zgjedhjeve, gjykatën e lartë, prokurorinë e përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e prefektit”.

- 36 anëtarë të personelit ndihmës akademik me karakter administrativ pranë USHLG ishin punësuar pa iu nënshtruar më parë procesit të rekrutimit, në kundërshtim me VKM nr.176 datë 29.03.2006 “Për botimin e buletinit e njoftimeve publike”.

- Në 2 procedura prokurimi, u konstatua dëm ekonomik në buxhetit e USHLG në vlerën 568,459 lekë.
- Në 1 procedurë prokurimi, u konstatua përdorimi i fondeve pa eficiencë në vlerën 741,262 lekë.
- Në 4 procedura prokurimi, me fond limit 28,582,588 lekë pa TVSh, janë nënshkruar 2 kontrata me të njëjtin OE të shpallur fitues me të njëjtin objekt prokurimi dhe zbatimi i kontratës është bërë referuar kontratës së dytë.
- Në auditimin e 3 kontratave të zbatimit të punëve publike, punimet nuk janë kryer sipas kushteve të kontratës dhe zërave të preventivit, duke evidentuar një dëm në vlerën 2,696,045 lekë.
- Në auditimin e 2 kontrate të zbatimit të punëve publike, u konstatua përdorimi i fondeve pa eficiencë në vlerën 1,723,535 lekë.
- Nga auditimi i 16 urdhër shpenzimeve, grupi i auditimit konstatoi se blerja e biletave të transportit ajror ndërkombëtar me vlerë 811,058 lekë nuk është zhvilluar me procedurën e prokurimit publik.

## II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e KLSH-së”, në zbatim të programit të auditimit nr.1101/1, datë 19.09.2024, miratuar nga Kryetari i KLSH-së, nga data 19.09.2024 deri më 10.01.2025 në Universitetin “Luigj Gurakuqi” Shkodër u krye auditimi financiar për periudhën 01.01.2022- 30.06.2024 nga grupi i auditimit me përbërje:

1. A. Z, përgjegjës i grupit të auditimit;
2. A. C, audituese;
3. S. Z, auditues;
4. M. H, auditues;
5. A. S, auditues;

## OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA

**1. Objektivat dhe qëllimi i auditimit.** Objekt i këtij auditimi është auditimi përputhshmërie dhe financiar, ku do të përcaktohet niveli i zbatimit të kriterëve të vlerësimit, referuar kuadrit rregullator të cilësuar në paragrafin nr. 5 “*Kriteret e vlerësimit*”. Ky auditim ka si qëllim:

Dhënien e një vlerësimi objektiv e të pavarur, nëse aktivitetet, transaksionet dhe informacioni përputhen, në të gjitha aspektet materiale, me kriteret e aplikuara si: rregullat, ligjet, politikat, kodet e vendosura apo termat dhe kushtet, mbi të cilat është rënë dakord, ku mund të përmendim si burim të këtyre kriterëve: standarde, ligje, vendime të Këshillit të Ministrave, rregullore, kontrata, marrëveshje, instrumente të tjerë që përmbajnë rregulla se si duhet të menaxhohen transaksionet dhe zbatohen buxhetet, etj.

Promovimin e qeverisjes së mirë, duke identifikuar dhe raportuar devijimet nga kriteret, në mënyrë që të merren veprime korigjuese si dhe të identifikohen personat përgjegjës për veprimet e tyre.

Dhënien e vlerësimeve të pavarura mbi funksionimin e sistemeve dhe nënsistemeve të kontrollit të brendshëm dhe komponentëve të menaxhimit financiar të subjektit, nëpërmjet përcaktimit nga ana e audituesve, nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar të sektorit publik dhe të sjelljes me integritet të zyrtarëve të sektorit publik.

**2. Identifikimi i çështjes.** Referuar programit të auditimit, u identifikuan çështjet si më poshtë:

- Hartimi dhe zbatimi i buxhetit.
- Zbatimi i dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës dhe pagave.
- Zbatimi i dispozitave ligjore mbi administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare.

- Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2023,
- Prokurimi i fondeve publike.
- Vlerësimi i funksionit të sistemit të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimi financiar dhe vlerësimi i auditit të brendshëm.
- Ankesës së ardhur në KLSH protokolluar me Nr.1494 prot, datë 13.12.2024.

**3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.** Strukturat drejtuese të USHLG, janë përgjegjëse për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, për përdorimin e burimeve financiare me ekonomicitet, eficientë dhe efektivitet, në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara (kriteret e vlerësimit), për fushat e veprimtarisë së USHLG-së, në drejtim të mirë administrimit të fondeve.

**4. Përgjegjësitë e audituesve.** Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme, nëse veprimtaria e subjektit të audituar është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një konkluzion dhe/ose opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin e tij profesional në punën audituese.

Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e veprimtarisë së subjektit, në raport me kriteret e paracaktuara të auditimit, të nxjerra nga aktet ligjore, nënligjore, si dhe ato rregullative mbi të cilat subjekti i audituar mbështetet në ushtrimin e veprimtarisë së tij;

Audituesit në të gjithë llojet e auditimit, kanë përgjegjësi që të zbatojnë parimet që lidhen me procesin e auditimit, të sanksionuara në ISSAI/IFPP-100 "*Parimet themelore të auditimit të sektorit publik*", paragrafi 44-51.

**5. Kriteret e vlerësimit.** Auditimi është bazuar në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.14 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", Manualin e Auditimit Financiar, Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, si dhe në referenca të tjera ligjore sa më poshtë:

- *Në fushën e zbatimit të buxhetit:* Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; Ligji nr. 137/2020, datë 16.11.2020 "Për buxhetin e vitit 2021" ; Ligji nr. 115/2021, datë 25.11.2021 "Për buxhetin e vitit 2022" ; Ligji nr. 84/2022, datë 24.11.2022 "Për buxhetin e vitit 2023"; Udhëzimet e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm"; Udhëzimi i MFE nr. 9, datë 20.07.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit"; i ndryshuar.

- *Në fushën e zbatimit të pagave:* Ligjin Nr.80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"; Statuti i Universitetit Luigj Gurakuqi Shkodër miratuar me urdhrin e Ministrit të Arsimit nr.366 datë 05.07.2018; VKM-së nr.656 datë 31.10.20218 "Për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave, bordeve ose komisioneve të përhershme të njëjësive të qeverisjes qendrore" i ndryshuar, (me VKM nr. 559 datë 31.07.2019 e VKM nr.612 datë 29.07.2020).

- *Në fushën e mbajtjes Kontabilitetit dhe Hartimit të Pasqyrave Financiare:* Ligji nr. 25/2018, datë 10.05.2018 "Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare"; VKM nr. 248, date 10.4.1998 "Për miratimin e planit kontabël publik, për organet e pushtetit lokal, institucionet shtetërore, qendrore dhe lokale, si dhe te njëjësive që varen prej tyre" i ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001; VKM nr. 783, datë 22.11.2006 "Për përcaktimi i standardeve dhe të rregullave kontabël"; VKM nr. 510, datë 10.06.2015 "Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe

detyrimeve, personelit, aktiviteteve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”; Udhëzimi i MF nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njërive të Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar .

- *Në fushën e prokurimeve publike*; Ligji nr. 162/202, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar; VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe akteve të tjera nënligjore të prokurimit publik”, i ndryshuar; Udhëzim i Agjencisë Prokurimit Publik nr. 5, datë 25.06.2021 “Mbi Përdorimin e procedurës me vlera të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, i ndryshuar; Urdhri i MF nr. 33, datë 11.07.2013 “Për gjurmët standarde të auditimit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë”.

**6. Standardet e auditimit të aplikuara në kryerjen e punës.** Auditimi është kryer në përputhje me ISSAI 100 “*Parimet themelore të auditimit të sektorit publik*”, i cili përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi; ISSAI 2000-2899 “*Udhëzues të Auditimit Financiar*”; ISSAI 2300 “*Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare*”; INTOSAI GOV 9100 “*Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik*” si dhe INTOSAI GOV 9110 “*Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontroleve të brendshëm*”; ISSAI 400 “*Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë*”, i cili përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë; ISSAI 4000 “*Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë*”; si dhe ISSAI 4200 “*Udhëzime për auditimin e përputhshmërisë*”; INTOSAI “*Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë*” etj.; Standardet Kombëtare të Kontabilitetit; Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilistëve IFAC; Manuali i Auditimit Financiar dhe i Përputhshmërisë të KLSH-së; Manuali i Auditimit të Brendshëm etj. Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC); Praktika të mira të fushës, si manualët e Gjykatës Evropiane të Audituesve, Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t etj.; Kodit Etik dhe Rregullorja e Procedurave të Auditimit të KLSH.

**7. Metodatat e auditimit.** Është përdorur metoda me auditim të njëpasnjëshëm dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efikasitet dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, bëhet përzgjedhja e kampioneve për ekzaminim në zërat e shpenzimeve.

Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetin<sup>1</sup>. Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t’u audituar.

Për arritjen e konkluzionit vlerësues, janë përdorur teknikat e auditimit:

- *Kontrolli aritmetik.* Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve

---

<sup>1</sup> *ISSAI 1320 (ISA 320) trajtojnë përgjegjësinë e audituesit për të zbatuar konceptin e materialitetit në planifikimin dhe kryerjen e një auditimi të pasqyrave financiare, në funksion të zbulimit dhe korigjimit të anomalive. Një trajtim i tillë i ngjashëm mund të përdoret edhe në rastet e auditimit të përputhshmërisë, ku natyrisht një rol të rëndësishëm ka gjykimi profesional i audituesit.*

në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim. (Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve)

- *Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese*. Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë asnjë gabim aritmetik, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (Urdhër shpenzimeve) konstatoi nëse shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar. Udhëzimi i MF nr. 30, datë 27.12.2011 “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

- *Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese*. Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminon përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, duke u siguruar edhe për ekzistencën reale të aktiveve në subjekt.

- *Kontrolli i vlerësimit*. Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

- *Konfirmim nga të tretët*. Nëse subjekti që auditohet ka të konfirmuara (Rakorduar) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepricave ose të çdo regjistrimi tjetër.

- *Kontrolli sipas një treguesi*. Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “jashtë normales”, që përbëjnë tregues të parregullsisë kontabël. Mund të përmendim: mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, të emrave, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave etj.

- *Verifikimi i transaksioneve* - është marrë informacioni për një rrethanë ose transaksion nga dy burime duke kryer krahasueshmërinë e tyre.

- *Intervistimi* - është përdorur gjatë marrjes verbale të informacionit nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit që auditohet.

- *Raporte dhe informacione* - janë shfrytëzuar raporte, analiza dhe informacione të cilat lidhen me objektivat e auditimit dhe çështjet për trajtim.

- *Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm* – grupi i auditimit ka përdorur pyetësorin e vetëvlerësimit të subjektit duke verifikuar çdo raportim të tij në lidhje me 5 komponentët e funksionimit të sistemit së kontrollit të brendshëm të subjektit.

**8. Dokumentimi i auditimit.** Është mbështetur në kërkesat e Manualeve të Auditimit Financiar dhe atij të përputhshmërisë, si edhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit: ISSAI 1230 “Dokumentimi i Auditimit”, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore.

Nga audituesit është përgatitur dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat ligjore dhe rregullatorë të zbatueshme. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra gjatë auditimit, si dhe çështje të tjera të rëndësishme që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre sipas gjykimit dhe skepticizmit profesional që audituesit kanë shfrytëzuar në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e Audituesve dhe ka shërbyer si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

Në përfundim të auditimit në terren (Akt-Konstatimeve), të mbajtura mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, nga grupi i auditimit janë mbajtur akt-konstatimet të cilat u dorëzuar në zyrën e protokollit të USHLG në datë 10.01.2025, e cila korrespondon me datën e mbylljes së punës në terren sipas programit të auditimit.

Nga subjekti i audituar janë paraqitur kundërshtitë të cilat pasi u analizuan me kujdes dhe profesionalizim nga grupi i auditimit, duke marrë në konsideratë ato kundërshti të cilat kishin mbështetje ligjore dhe me dokumentacion, u përgatit dhe u dërgua në subjekt Projektraporti i Auditimit për njohje dhe paraqitjen e kundërshtive rreth gjetjeve të tij.

Në përfundim të afatit 30 ditorë, nga subjekti i audituar Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër, janë paraqitur kundërshtitë mbi Projekt raport Auditmin, të cilat pasi u analizuan me kujdes, profesionalizëm dhe paanshmëri nga grupi i auditimit, u përgatit ky Raport Përfundimtar Auditimi.

### **III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT**

#### **1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim.**

Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër është person juridik publik, i njohur me ligj si i tillë. Ai organizohet dhe funksionon në përputhje me legjislacionin për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor, si edhe me rregullat e parashikuara në Statutin dhe në rregulloret e tij.

Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër është një universitet publik që ofron programe të nivelit bachelor, master dhe studime doktorale. Universiteti kontribuon në zhvillimin e shoqërisë, përmes tri shtyllave të misionit të arsimit të lartë publik: kërkim shkencor, edukim, si dhe shërbim ndaj publikut. Ofron edukim me në qendër studentin, si dhe nxit rritjen personale dhe intelektuale, për të përgatitur studentë për karriere produktive dhe qytetare, të përgjegjshëm në një shoqëri globale. Organi më i lartë drejtues akademik i Universitetit është Senati Akademik. Organe të tjera kolegjiale janë, Asambleja e personelit akademik, Senati Akademik, Komisionet e përhershme, Rektorati, Dekanati, Bordi i Administrimit, Këshilli i Etikës. Autoritetet drejtuese akademike janë: Rektori, drejtuesi i njësisë kryesore, drejtuesi i njësisë bazë. Rektori është autoriteti më i lartë akademik i institucionit të arsimit të lartë, si dhe përfaqësuesi ligjor i tij për çështjet akademike dhe protokollare. Dekani i fakultetit/drejtori i institutit është autoriteti më i lartë akademik i njësisë kryesore dhe përfaqësuesi i saj.

#### **2.1 HARTIMI DHE ZBATIMI I BUXHETIT TË SHETIT**

Në zbatim të programit të auditimit u shqyrtua dokumentacioni, si më poshtë:

- 1) Programet Buxhetore Afatmesëm;
- 2) Projektbuxheti për vitin 2022, 2023 dhe vitin 2024, si dhe shkresat e ndryshimit të buxhetit gjatë vitit ushtrimor;
- 3) Raportet e monitorimit të realizimit të buxhetit;
- 4) Parashikimi dhe realizimi i të ardhurave dytësore.

Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi” kryen aktivitetin duke u bazuar në Ligjin 80/2015 “Për Arsimin e Lartë”, në Statutin e USHLG miratuar me Urdhër të MASR me nr.366 datë 05.07.2018, në Rregulloren e miratuar me Vendim të Senatit Akademik nr. 132, datë 27.04.2023 si dhe në strategjinë e zhvillimit të institucionit. Autoritetet dhe Organet Drejtuese të USHLG përfshijnë Rektoren, Senatin Akademik, Rektoratin, Dekanatin, Këshillin e Etikës, Komisionet, Administratorin dhe Bordin e Administrimit.

Burimet e financimit të Universitetit të Shkodrës janë:

- a. Buxheti i Shtetit;
- b. Pagesat e studentëve për arsimim;
- c. Të ardhurat për shërbimet e kryera;
- d. Të ardhurat e krijuara nga marrëdhëniet me palët e treta
- e. Donacione dhe burime të tjera të ligjshme financimi.

Fondet e buxhetit të shtetit shpërndahen në formën e grantit që mund të jetë granti i politikave të zhvillimit për institucionet publike të arsimit të lartë, granti i mësimdhënies, granti i punës kërkimore-shkencore dhe veprimtarive krijuese.

▪ **Programi Buxhetor Afatmesëm**

Sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në RSH”, IAL harton një plan buxhetor afatmesëm, i cili është pjesë e planit strategjik të zhvillimit të institucionit, plan i cili përditësohet çdo vit.

Në IAL publike, hartohet një plan buxhetor afatmesëm, i cili është pjesë e planit strategjik të zhvillimit të institucionit dhe përditësohet çdo vit. Nga auditimi u konstatua se USHLG ka hartuar dokumentin e PBA 2023-2025, PBA 2024-2026 dhe PBA 2025-2027 për fazën teknike, ndërsa sa i takon fazën strategjike, nga ana e USHLG, nuk rezulton të jetë hartuar dokumenti i PBA-së.

Mos hartimi i dokumentit të PBA-së për fazën strategjike ka kufizuar përcaktimin e prioriteteve afatgjata të institucionit, ka ndikuar negativisht në shpërndarjen e burimeve financiare, ka penguar vlerësimin e ndikimit të aktiviteteve në arritjen e objektivave strategjike dhe rrezikon qëndrueshmërinë financiare dhe përmbushjen e misionit të tij.

▪ **Grupi i Menaxhimit Strategjik**

Titullarët e njësive publike në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit kanë si kompetencë kryesore ngritjen e grupit të menaxhimit strategjik të njësisë publike. Nga auditimi u konstatua se nga titullari i Universitetit “Luigj Gurakuqi” nuk ka urdhër për ngritjen e grupit të menaxhimit strategjik. Rrjedhimisht, nuk ka takime të dokumentuara të veprimtarisë së GMS-së, i cili duhet të mbledhet të paktën 4 herë në vit. Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, neni 27, pika 1 dhe Udhëzimin nr. 16 të MFE, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”, paragrafi 2.2.4, pika 3.

**Observacion i subjektit mbi Projektin e Raportit të Auditimit, vënë në dispozicion grupit të auditimit në datë 27.03.2025 me nr.1101/11 prot.**

**Pretendimi i subjektit:** Urdhri për GMS është ngritur me datë 11.08.2017 por meqenëse kërkesa me emali ka ardhur me datë 31 dhjetor, duke qenë edhe periudhë jo shumë e vonshme dhe ditët pasardhëse ditë pushimi zyrtar është arritur të gjendet këto ditë në arkiv Urdhri nr. 2575 Prot., datë 11.08.2017 “Për ristrukturimin e GMS ndryshuar e urdhrin 2575/2 Prot., datë 07.09.2017 Për një ndryshim në urdhrin nr. 244 dt 11.08.2017”. Konfirmojmë që gjatë periudhës së auditimit grupi nuk ka zhvilluar mbledhje. Në vijimësi do të merren masa konkrete që grupi të mbledhet dhe funksionojë sipas parashikimeve të ligjit të MFK.

**Qëndrimi i Grupit të Auditimit:** Referuar observacioneve të ardhura me prot 1101/14 datë 27.03.2025, nuk u sollën arsytetime apo dokumenta shtesë vërtetues për pasojë **observacioni nuk merret në konsideratë.**

**Viti 2022**

▪ **Projektbuxheti 2022**

Me shkresën nr. 1014 prot., datë 16.03.2022, të Administratorit drejtuar Rektoratit, Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit të USHLG, me lëndë “Relacion mbi realizimin e buxhetit vjetor 2021 dhe planin buxhetor vjetor 2022”, është dërguar plani i Buxhetit Vjetor, i hartuar në bazë të kërkesave të fakulteteve. Më pas, nga ana e Senatit Akademik nuk është vijuar me miratimin e buxhetit brenda afateve të përcaktuara, por rezulton se plani i buxhetit vjetor është miratuar me anë të Vendimit nr. 158 datë 29.07.2022, dhe nga Bordi i Administrimit është miratuar me anë të Vendimit e BA nr. 159 datë 01.08.2022 “Për miratimin e buxhetit për vitin 2022”, jashtë të gjitha afateve të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore, duke shkelur disiplinën buxhetore.

Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; ligjit nr. 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, si dhe të Udhëzimit nr. 9, datë 20.3.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar.

Në Projektbuxhetin e vitit 2022, është parashikuar se USHLG do të financohej si vijon:

1. Financimi nga Buxheti i Shtetit në shumën 707,536 mijë lekë, i ndarë në disa kategori si Granti për mësimdhënie: 647,463 mijë lekë, Bursat për studentët: 58,411 mijë lekë dhe Granti i kërkimit shkencor: 1,662 mijë lekë

2. Disbursimet nga Projekte me Financim të Huaj paraqiten në shumën prej 41,125 mijë lekë (39,317 mijë lekë shpenzime korrente dhe 1,808 mijë lekë investime);

3. Të Ardhurat e Institucionit, të parashikuara për tu mbartur nga viti 2021 paraqiten në shumën 332,735 mijë lekë, të ardhurat e parashikuara për tu arkëtuar në vitin 2022 në shumën 112,269 mijë lekë, pra në total të ardhurat e parashikuara gjithsej janë në vlerën 445,003 mijë lekë.

▪ **Realizimi i plan buxhetit të vitit 2022**

Për vitin 2022 buxheti i akorduar i çelur është në vlerën 729,526 mijë lekë, (170,794 mijë lekë janë mbartur nga viti 2021 dhe 558,732 mijë lekë është financimi i vitit 2022) i cili vjen nga akordimet e fondeve në fillim të vitit nga MAS si dhe të ardhurat e disponueshme janë realizuar në vlerën 100,525 mijë lekë.

Plan buxheti i çelur për përdorim ka vlerën 888,153 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën **567,941 mijë lekë**, ose 63.9%, sipas tabelës më poshtë:

Realizimi viti 2022 000/lekë										
Ilog	Pershkrimi	Granti			Të ardhura			USH		
		Plan	Realizimi	%	Plan	Realizimi	%	Plan	Realizimi	%
600	Paga	482,411	375,324	78%	2,355	2,355	100%	484,766	377,679	77.9%
601	Sigurime	78,878	60,030	76%	415	415	100%	79,293	60,445	76.2%
602	Shpenzime operative	98,929	59,189	60%	37,222	6,798	18%	136,151	65,987	48.5%
604	Transferta tek te tretet (shoqata sportive)				200	200	100%	200	200	100.0%
606	Bursa Studentëve dhe transferta	59,308	42,202	71%	3,540	3,540	100%	62,848	45,742	72.8%
231	Investime	10,000	10,000	100%	114,895	7,889	7%	124,895	17,889	14.3%
<b>TOTALI</b>		<b>729,526</b>	<b>546,745</b>	<b>75%</b>	<b>158,627</b>	<b>21,197</b>	<b>13%</b>	<b>888,153</b>	<b>567,941</b>	<b>63.9%</b>

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të USHLG

Llogaria 600 “Shpenzime për paga” dhe 601 “Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore” për vitin 2022 është mbuluar me fondet nga Granti për shpenzime korrente dhe të ardhurat e Institucionit. Plani vjetor i pagave dhe sigurimeve është përkatësisht 484,766 mijë lekë dhe 79,293 mijë lekë, ndërsa realizimi paraqitet për pagat në shumën 377,679, mijë lekë ose 77.9% dhe për sigurimet në shumën 60,445 mijë lekë ose 76.2%.

Llogaria 602 “Shpenzime operative” është parashikuar të përballohet nga granti për shpenzime korrente dhe nga të ardhurat. Shpenzimet operative për vitin 2023, të cilat janë planifikuar në shumën 136,151 mijë lekë dhe realizuar në shumën 65,987 mijë lekë ose 48.5%, të cilat kanë të bëjnë me ruajtjen e godinave, elektricitet, taksa e tarifa të institucionit etj.

Llogaria 606 “Bursa studentëve dhe transferta” është parashikuar 62,848 mijë lekë dhe është realizuar në shumën 45,742 mijë lekë, ose 72.8%.

**Planifikimi i investimeve në PBA 2022-2024, plani vjetor buxhetor dhe realizimi për 2022**

Referuar planit të investimeve të miratuar në projekt buxhet për vitin 2022, grupi i auditimit krahasoi planifikimin e tyre në PBA, plan buxheti vjetor në raport me realizimin. Më hollësisht, në Aneksin nr.1, tabela 1 paraqiten ndryshimet mes fondit të planifikuar në PBA 2022-2024, planit të buxhetit vjetor dhe realizimit për vitin 2022 për projektet e investimit, të cilat janë financuar nga

të ardhurat.

Nga analiza dhe kryqëzimi i të dhënave midis PBA 2022-2024 me plan buxhetin e vitit 2022, konstatohet se në planin vjetor të buxhetit janë shtuar 18 projekte investimi të reja, në shumën 36,676 mijë lekë.

Sa i përket projekteve të investimeve të realizuara gjatë vitit 2022 në raport me projektet e planifikuara në PBA 2022-2024, u konstatua se 47 projekte investimi në shumën 250,079 mijë lekë, janë planifikuar në PBA 2022-2024, por janë realizuar vetëm 7 projekte investimi në vlerën 17,220 mijë lekë, duke krijuar një diferencë të ndjeshme prej 232,858 mijë lekë.

Nga ana tjetër, nga planifikimi në planin e buxhetit vjetor në krahasim me realizimin për vitin 2022, konstatohet se janë planifikuar 34 projekte investimi në shumën 124,085 mijë lekë, dhe janë realizuar vetëm 7 projekte investimi, në shumën 17,089 mijë lekë.

Sipas të dhënave të paraqitura, vërehet se nga planifikimi në PBA për vitin 2022, investimet e realizuara përbëjnë vetëm 7%, ndërsa nga plani vjetor i buxhetit, realizimi i investimeve arrin në 14%. Kjo tregon qartë një mungesë të theksuar në analizimin dhe planifikimin e investimeve nga strukturat përgjegjëse në USHLG.

Sa më sipër, për secilin nga projektet të cilat janë në bashkëpunim me donatorët e huaj, konstatohet se për vlerën e TVSH-së, e cila nga ana e USHLG-së, janë të planifikuara dhe kanë kode të veçanta buxhetore në planin e buxhetit të MAS. Nga auditimi dhe kryqëzimi i të dhënave të projekteve të investimit për TVSH-të të planifikuara me ato të likuiduara nëpërmjet bankës, konstatohet se gjatë vitit 2022 janë shlyer me financim të brendshëm nga granti i akorduar nga MAS dy projekte investimi për TVSH-në, përkatësisht *“TVSH Entral blerje pajisje elektronike dhe elektrike”* në shumën 330,615 lekë dhe *“TVSH IDEA blerje pajisje elektronike dhe elektrike”* në shumën 641,074 mijë lekë (kapitulli 4), si dhe me të ardhurat e USHLG-së nëpërmjet kapitullit 6 janë shlyer *“TVSH USIA”* në shumën 909,047 lekë dhe *“TVSH SUCCESS blerje pajisje”* në shumën 669,000 lekë. Nga ana tjetër, në raportet e monitorimit të MAS, konstatohet se vlera e këtyre TVSH-ve paraqitet me realizim zero lekë, ndërkohë që projektet janë shlyer nga USHLG me fondet nga të ardhurat e institucionit.

Situata e mësipërme shkakton disa probleme të rëndësishme në aspektin e menaxhimit financiar dhe buxhetor të projekteve me donatorët e huaj. Së pari, shlyerja e TVSH-së për projektet e bashkëpunimit ndërkombëtar me financim nga të ardhurat e brendshme të USHLG, në vend që të përdoren fondet e dedikuara nga MAS, tregon një devijim nga planifikimi buxhetor fillestar dhe një përdorim joefikas të burimeve financiare. Kjo shkelje e disiplinës buxhetore krijon një mungesë transparence në mënyrën si janë menaxhuar fondet dhe si janë raportuar në dokumentet financiare.

Së dyti, përderisa MAS e raporton vlerën e TVSH-ve të projekteve me realizim zero, pavarësisht faktit që shpenzimet janë kryer nga USHLG, kjo krijon një mungesë koherence të të dhënave midis institucioneve, për realizimin e projekteve dhe përdorimin e fondeve, duke rrezikuar besueshmërinë e raportimeve financiare.

Së treti, përdorimi i fondeve të të ardhurave të institucionit për të shlyer detyrimet e TVSH-së që duhet të ishin mbuluar nga grantet, mund të shkaktojë një mungesë likuiditeti në të ardhurat e brendshme, duke vënë në rrezik aftësinë e institucionit për të mbuluar shpenzime të tjera operationale dhe investime të planifikuara. Në fund, kjo situatë rrezikon që institucionet ndërkombëtare dhe donatorët të humbasin besimin në menaxhimin financiar të USHLG-së, çka mund të ndikojë negativisht në projektet e ardhshme të bashkëpunimit. Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me Ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 *“Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”* i ndryshuar.

**Konkluzion:** Nga analiza e kryer, konstatohet se vonesat e shkaktuara nga procesi i miratimit të

planit buxhetor në Senatin Akademik dhe Bordin e Administrimit kanë ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në zbatimin e investimeve gjatë vitit 2022. Miratimi i buxhetit jashtë afateve ligjore ka shkaktuar vonesa të konsiderueshme në fillimin e projekteve të planifikuara, duke rezultuar në një realizim të ulët të investimeve, edhe pse nga ana e Administratorit është dërguar brenda afateve ligjore, nuk është shqyrtuar dhe miratuar brenda afateve ligjore, duke u vonuar deri në muajin gusht. Kjo vonesë ka rezultuar në dështimin për të filluar zbatimin e projekteve të planifikuara në kohë, duke ndikuar negativisht në përqindjen e realizimit të investimeve. Sipas të dhënave, nga 40 projekte të planifikuara, janë realizuar vetëm 2(dy), çka tregon një realizim të pamjaftueshëm prej 12% të investimeve të buxhetit vjetor. Këto vonesa kanë shkelur disiplinën buxhetore të përcaktuar në aktet ligjore dhe kanë ndikuar negativisht në përmbushjen e objektivave të investimeve, mangësi të cilat nxjerrin në pah dobësitë në menaxhimin dhe koordinimin e procesit të planifikimit financiar nga organet vendimmarrëse.

## Viti 2023

### ▪ Projektbuxheti 2023

Me shkresën nr. 692 prot., datë 27.02.2023, të Administratorit drejtuar Rektoratit, Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit të USHLG, me lëndë “*Relacion mbi realizimin e buxhetit vjetor 2022 dhe planin buxhetor vjetor 2023*”, është dërguar plani i Buxhetit Vjetor, i hartuar në bazë të kërkesave të fakulteteve. Më pas, nga ana e Senatit Akademik është vijuar me miratimin e buxhetit brenda afateve të përcaktuara, të Vendimit nr. 67 datë 02.03.2023, dhe nga Bordi i Administrimit është miratuar me anë të Vendimit e BA nr. 83 datë 28.03.2023 “*Për miratimin e buxhetit për vitin 2023*”.

Në Projektbuxhetin e vitit 2023, është parashikuar se USHLG do të financohej si vijon:

1. Financimi nga Buxheti i Shtetit në shumën 781,928 mijë lekë, i cili parashikohet të mbartet nga viti 2022 në shumën 182,781 mijë lekë, plani i financimit për vitin 2023 në shumën 599,147 mijë lekë.
2. Disbursimet nga Projekte me Financim të Huaj paraqiten në shumën prej 41,125 mijë lekë (39,317 mijë lekë shpenzime korente dhe 1,808 mijë lekë investime);
3. Të Ardhurat e Institucionit, të parashikuara për tu mbartur nga viti 2022 paraqiten në shumën 413,034 mijë lekë, të ardhurat e parashikuara për tu arkëtuar në vitin 2022 në shumën 100,000 mijë lekë, pra në total të ardhurat e parashikuara gjithsej janë në vlerën 513,034 mijë lekë.

### ▪ Realizimi i plan buxhetit të vitit 2023

Për vitin 2023 buxheti i akorduar i çelur është në vlerën **729,526** mijë lekë, (182,781 mijë lekë janë mbartur nga viti 2022 dhe 599,147 mijë lekë është financimi i vitit 2023) i cili vjen nga akordimet e fondeve në fillim të vitit nga MAS si dhe të ardhurat e disponueshme janë realizuar në vlerën 95,625 mijë lekë.

Plan buxheti i çelur për përdorim ka vlerën 771,867 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën **671,690** mijë lekë, ose 71.6% sipas tabelës më poshtë:

Realizimi viti 2023 000/lekë										
Ilog	Pershkrimi	Granti			Të ardhura			USH		
		Plan	Realizimi	%	Plan	Realizimi	%	Plan	Realizimi	%
600	Paga	484,316	464,322	95.9	52,000	45,568	87.6	536,316	509,890	95.1
601	Sigurime	73,591	73,051	99.3	8,400	6,734	80.2	81,991	79,785	97.3
602	Shpenzime operative	139,505	83,881	60.1	28,017	12,623	45.1	167,522	96,504	57.6
606	Bursa Studentëve	74,455	50,436	67.7	0	0	0.0	74,455	50,436	67.7
230/231	Investime	0	0	0.0	161,874	18,639	11.5	161,874	18,639	11.5
<b>TOTALI</b>		<b>771,867</b>	<b>671,691</b>	<b>87.0</b>	<b>250,291</b>	<b>83,564</b>	<b>33.4</b>	<b>1,022,158</b>	<b>755,254</b>	<b>73.9</b>

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të USHLG

Llogaria 600 “Shpenzime për paga” dhe 601 “Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore” për vitin 2023 është mbuluar me fondet nga Granti për shpenzime korrente dhe të ardhurat e Institucionit. Plani vjetor i pagave dhe sigurimeve është përkatësisht 536,316 mijë lekë dhe 81,991 mijë lekë, ndërsa realizimi paraqitet për pagat në shumën 509,890 mije lekë ose 95.1% dhe për sigurimet në shumën 79,785 mije lekë ose 97.3%.

Llogaria 602 “Shpenzime operative” është parashikuar të përballohet nga granti për shpenzime korrente dhe nga të ardhurat. Shpenzimet operative janë planifikuar në shumën 167,522 mijë lekë dhe realizuar në shumën 96,504 mijë lekë ose 57.6%, të cilat kanë të bëjnë me ruajtjen e godinave, elektricitet, taksa e tarifa te institucionit etj.

Llogaria 606 “Bursa studentëve dhe transferta” është parashikuar 74,455 mijë lekë dhe është realizuar në shumën 50,436 mijë lekë, ose 67.7%.

### **Planifikimi i investimeve në PBA 2023-2025, plani vjetor buxhetor dhe realizimi për 2023**

Referuar **planit të investimeve** të miratuar në projekt buxhet për vitin 2023, grupi i auditimit krahasoi planifikimin e tyre në PBA, plan buxheti vjetor në raport me realizimin. Më hollësisht, në Aneksin nr.1, tabela 2 paraqiten ndryshimet mes fondit të planifikuar në PBA 2023-2025, planit të buxhetit vjetor dhe realizimit për vitin 2023 për projektet e investimit, të cilat janë financuar nga të ardhurat.

Nga analiza dhe kryqëzimi i të dhënave midis PBA 2023-2025 me plan buxhetin e vitit 2023, konstatohet se në planin vjetor të buxhetit janë shtuar 46 projekte investimi të reja, në shumën 121,571 mijë lekë.

Sa i përket projekteve të investimeve të realizuara gjatë vitit 2023 në raport me projektet e planifikuara në PBA 2023-2025, u konstatua se 28 projekte investimi në shumën 268,613 mijë lekë, janë planifikuar në PBA 2023-2025, por rezulton se realizimi i tyre paraqitet në vlerën 0(zero) lekë. Nga ana tjetër, nga planifikimi në planin e buxhetit vjetor në krahasim me realizimin për vitin 2023, konstatohet se janë planifikuar 55 projekte investimi në shumën 195,224 mijë lekë, dhe janë realizuar vetëm 9 projekte investimi, në shumën 18,639 mijë lekë.

Sipas të dhënave të paraqitura, vërehet se nga planifikimi në PBA, investimet e realizuara në vitin 2023 rezultojnë 0%, ndërsa nga plani vjetor i buxhetit, realizimi i investimeve arrin në 10%. Kjo tregon qartë një mungesë të theksuar në analizimin dhe planifikimin e investimeve nga strukturat përkatëse në USHLG.

Gjithashtu, në kontratat e lidhura për bashkëfinancimin e projekteve të investimit të huaj, vlера e TVSH-së së projekteve ka kode buxhetore të caktuara për tu shlyer me financim të brendshëm, por nga ana e USHLG-së rezulton të jetë paguar me fonde nga të ardhurat.

Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me Ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

**Konkluzion:** Nga analiza e kryer, konstatohet një mospërputhje e dukshme midis planifikimit në PBA, plan vjetor buxheti dhe realizimeve faktike. Sipas të dhënave, nga 28 projekte të planifikuara në PBA 2023-2025, realizimi i tyre ka qenë zero lekë. Për më tepër, nga 55 projekte të planifikuara në buxhetin vjetor me vlerë 195,224 mijë lekë, janë realizuar vetëm 9 projekte, me një vlerë prej 18,639 mijë lekësh, që përfaqëson një realizim prej 10%. Këto rezultate tregojnë mungesë të efektivitetit në planifikimin dhe menaxhimin e investimeve nga strukturat përgjegjëse. Është e nevojshme përmirësimi i proceseve të analizimit dhe vlerësimit të projekteve për të shmangur mosrealizime të tilla në të ardhmen.

#### ▪ **Raportet e monitorimit**

Nga auditimi u konstatua se nga ana Universitetit “Luigj Gurakuqi” Shkodër, si njësi shpenzuese, nuk janë hartuar raportet e monitorimit si dhe relacionet shpjeguese 4-8-12 mujore për të ndjekur

realizimin e produkteve të buxhetit, për të garantuar përmirësimin e procesit të planifikimit dhe menaxhimit të buxhetit, ndjekjen dhe arritjen e qëllimit dhe objektivave të synuara, sipas deklaratës së politikës së programit, si dhe krahasimin e treguesve të planifikuar të performancës me treguesit faktik, veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr.22, datë 17.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të Buxhetit në NJQQ” dhe Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar të nenit 65.

**Observacion i subjektit mbi Projektin e Raportit të Auditimit, vënë në dispozicion grupit të auditimit në datë 27.03.2025 me nr.1101/11 prot.**

**Pretendimi i subjektit:** Vlerat e TVSH të projekteve me financim të huaj janë shlyer duke përdorur të ardhurat e institucionit dhe në vijim i është dërguar MF kërkesa për rimbursim TVSH. Në të ardhmen do të shfrytëzohen fondet e kapitullit 4 nëse do të ofrohen nga Institucioni përkatës. Vlera relativisht e ulët e këtyre zërave nuk ka ndikuar ë stabilitetin financiar të institucionit. Realizimet e ulëta të investimeve për 2022 janë rezultat kryesisht i miratimit të buxhetit në periudhe kur kishte ngelur fare pak kohë për procedurat e investimeve. Në lidhje me vitin 2023 ka pasur raste kur megjithëse procedurat e realizuara nga ana jonë, për arsye objektive nuk janë finalizuar kontratat në thesar. Në lidhje me raportet e monitorimit në vijim do të përgatiten bazuar Udhëzimit nr. 22 datë 17.11.2016.

**Qëndrimi i Grupit të Auditimit:** Referuar observacioneve të ardhura me prot 1101/14 datë 27.03.2025, nuk u sollën arsyetime apo dokumenta shtesë vërtetues për pasojë **observacioni nuk merret në konsideratë.**

## **2.2 ZBATIMI I DISPOZITAVE LIGJORE PËR MARRËDHËNIET E PUNËS DHE PAGAVE. BORDI I ADMINISTRIMIT.**

Në Universitetin “Luigj Gurakuqi” Shkodër, marrëdhëniet e punës për periudhën 01.01.2022 deri më 31.06.2024, janë rregulluar sipas dispozitave të Ligjit nr. 80/2015, datë 17.09.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, Kreu VI “Personeli i institucioneve të arsimit të lartë”, neni 57 pika 1, ku përcaktohet se “Personeli i institucionit të arsimit të lartë përbëhet nga personeli akademik, personeli ndihmës akademik dhe personeli administrative”.

Personeli i Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi” përbëhet nga:

1. Personeli akademik në përbërje të cilit janë, profesorët, docentët, lektorët dhe asistent lektorë. Kriteret e ndarjes në kategori dhe nivele përcaktohen në Ligjin Nr. 80/2015, “Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.
2. Personeli ndihmës mësimor-shkencor në përbërje të të cilit janë laborantët.
3. Personeli administrativ, pjesë e së cilit janë të gjithë punonjësit e administratës dhe që kryejnë detyra që shërbejnë në realizimin e misionit të arsimit të lartë pranë USHLG-së.

Nga auditimi i kryer mbi strukturën organizative për periudhën objekt auditimi rezultoi se Universiteti ka funksionuar me strukturën organike të miratuar nga Bordi i Administrimit, përkatësisht si më poshtë:

- Vendimi i Bordit të Administrimit nr. 95 datë 26.04.2022 “Për miratimin e strukturës organizative të USH-së për vitin 2022” nr. 1507 prot., datë 26.04.2022, ku në total janë miratuar 344 punonjës me kohë të plotë dhe 295 me kohë të pjesshme;

-Vendimi i BA nr. 73 datë 10.03.2023 “Për miratimin e strukturës të USH-së për vitin 2023” nr. 879 prot., datë 10.03.2023, ku në total janë miratuar 354 punonjës me kohë të plotë dhe 295 me kohë të pjesshme;

- Vendimi i BA nr. 96 datë 04.04.2024 “Për miratimin e strukturës të USH-së për vitin 2024” nr. 1202 prot., datë 04.04.2024, ku në total janë miratuar 355 punonjës me kohë të plotë dhe 295 me kohë të pjesshme

### **Konkluzion:**

Sektori i Burimeve Njerëzore nuk ka një Plan vjetor të njësisë dhe vlerësimin e performancës për sektorin dhe çdo punonjës të institucionit. Në kundërshtim me Ligji nr. 10 296, datë 08.07.2010, i ndryshuar dhe manualin e MFK-së Kapitulli III “Komponentët e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit”; 3.1 “Mjedisi i kontrollit të brendshëm”,.

### **Emërimet**

Nga auditimi i *procedurave të emërimit* të punonjësve rezultoi se në vitin 2022 janë emëruar 26 punonjës, në vitin 2023 janë emëruar 33 punonjës dhe deri më 30.06.2024 janë emëruar 13 punonjës, si vijon:

	<b>Viti 2022</b>	<b>Viti 2023</b>	<b>6 mujori i parë 2024</b>
<i>Personel akademik</i>	10	10	9
<i>Personel ndihmës akademik dhe administrativ</i>	16	23	4
<b>Totali</b>	<b>26</b>	<b>33</b>	<b>13</b>

Burimi: Universiteti “Luigj Gurakuqi”, Shkodër

**Grupi i auditimit konstatoi** se për periudhën objekt auditimi 36 anëtarë (*aneks 1*) të personelit akademik dhe ndihmës akademik me karakter administrativ ishin punësuar pa iu nënshtruar më parë procesit të rekrutimit dhe kohë zgjatja e kontratave është deri në shpalljen e procedurës së konkurimit Në kundërshtim me VKM nr. 176 datë 29.03.2006 ‘Për botimin e buletinit e njoftimeve publike’ pika 3 germa V...ku botohen të gjitha njoftimet publike të shkollave të larta publike, përfshi dhe shprehjet e interesit për rekrutim stafi akademik a personeli punonjës në këto institucione dhe vendim e BA nr, 146, datë 14.07.2022 “Për miratimin e disa ndryshimeve ne rregulloren e punësimit në USH” neni 4

Gjithashtu dhe ngritjet në detyrë e 12 (*aneks 2*) punonjësve të personelit ndihmës akademik dhe administrativ janë kryer pa procedurë dhe janë të pa bazuar në një vlerësim performance të stafit, pasi siç e kemi cituar dhe me sipër në USHLG për periudhën objekt auditimi nuk është bërë asnjë vlerësim performance për stafin. Tabela e detajuar si më poshtë:

Veprime në kundërshtim me Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar me Ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, dhe manualin e MFK-së Kapitulli III “Komponentët e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit”; 3.1 “Mjedisi i kontrollit të brendshëm” ku përcakton qartë se:

*Politikat e burimeve njerëzore duhet të garantojnë:*

- Një procedurë transparente për rekrutimin dhe emërimin e punonjësve;
- Kriteria dhe kërkesa të përshtatshme në drejtim të kualifikimit dhe përvojës profesionale në procesin e rekrutimit dhe të emërimit të stafit, që synojnë të fuqizojnë kapacitetin administrativ të njësisë dhe të krijojnë një ekip pune të besueshëm dhe kompetent;
- Një sistem për vlerësimin e performancës që të inkurajojë zhvillimin profesional të punonjësve dhe të ofrojë mundësi për ngritje të merituar në detyrë dhe të ndëshkojë në rast të kundërt;

- Zhvillimin dhe miratimin e politikave, rregullave dhe procedurave të zbatueshme, që janë në harmoni me dispozitat ligjore të vlefshme për rekrutimin, emërimin, vlerësimin, trajnimin, shpërblimin dhe motivimin e stafit.

Përgjegjësia e menaxhimit në garantimin e profesionalizmit të punonjësve të tij fillon me miratimin e politikave dhe praktikave të duhura që lidhen me burimet njerëzore dhe që reflektojnë angazhimin për:

- Caktimin e nivelit të njohurive dhe aftësive që kërkohen për çdo pozicion pune;

- Verifikimin e kualifikimeve të kandidatëve për vendet e punës;

- Marrjen në punë dhe ngritjen në detyrë vetëm të atyre personave që kanë njohuritë dhe aftësitë në nivelet më të larta etj.

Mbajnë përgjegjësi për veprimet dhe mosveprimet e tyre: ish rektori znj, S. G, ish rektori i komanduar znj, R. K, dhe administratori z, A. U.

**Observacion i subjektit mbi Projektin Raportin e Auditimit, vënë në dispozicion grupit të auditimit në datë 27.03.2025 me nr.1101/11 prot.**

**Pretendimi i subjektit:** Në kushtet e një emërimi të komanduar të papritur, kam punuar për të siguruar një funksionim normal të institucionit dhe kam respektuar strukturën organike të miratuar nga Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit. Në respektim të organikës dhe duke u bazuar në kërkesën e arsyetuar të strukturave të varesise, janë kryer punësime për të siguruar vijimin e procesit mesimor dhe funksionit të institucionit, si pasojë e të cilave, në vlerësimin tone, në asnjë rast nuk është shkaktuar dëm ekonomik për institucionin.

Në periudhën 22.06.2023 deri më 30.06.2024, me kërkesë të drejtuesve të njësisë kryesore, bazuar në nevojën e ngutshme të njësisë për staf janë punësuar dy punonjës ndihmës akademik për të zëvendësuar një punonjës me paaftësi të perkohshme në punë dhe një punonjës me leje lindje. Me lirim të këtyre dy pozicioneve, punonjësve iu është nënshkruar kontrate me afat të caktuar deri në hapjen e procedurave të konkursit, bazuar në nenin 142 të Ligjit Nr. 7961, datë 12.7.1995, i cili konsideron si kohë prove 3 muajt e parë të punës. Në periudhën 22.06.2023 deri me 30.06.2024, janë ngritur në detyrë dy punonjëse, të cilat ose kano qenë të aktivizuara me parë ose janë aktivizuar në detyra të asaj kategorie në të cilën janë ngritur. Për këtë arsye, bazuar në eksperiencën e tyre në institucion, njëra si specialiste e sigurimit të cilesise në USH dhe tjetra e aktivizuar në komisione të ndryshme të ngritura pranë Drejtorisë së Finances, në konsultim me drejtuesit e zyrave përkatëse, në përputhje me kualifikimin e tyre dhe në vlerësim të performancës së tyre, janë ngritur në detyrë në vende vakante, njëra pranë zyrës së SBNJ dhe tjetra si financiere pranë zyrës së komunikimit. Dy specialisteve ju është nënshkruar kontrate me afat të caktuar deri në hapjen e procedurave të konkursit. Në Statutin e USH apo në rregulloret e USH mungojnë parashikimet për levizjet brenda institucionit. Shtoj këtu së praktikave precedente të tilla ka patur ndër vite. Duke shprehur velesimin tim për punën e grupit të auditimit, do t'ju lutem që të saktësohen disa data që nuk i perkasin periudhës 22.06.2023 deri me 30.06.2024.

**Qëndrimi i Grupit të Auditimit:** Referuar observacioneve të ardhura me prot 1101/14 datë 27.03.2025, nuk u sollën arsye apo dokumenta shtesë vërtetues për pasojë **observacioni nuk merret në konsideratë.**

- **Largimet**

Për periudhën 01.01.2022-30.06.2024, në USHLG i janë ndërprerë marrëdhëniet e punës 29 punonjësve, për arsye të mëposhtme trajtuar në aneksi 1/1 bashkelidhur Raportit Përfundimtar.

- **Marrëdhëniet e pagave**

Për periudhën objekt auditimi në USHLG janë zbatuar përgjithësisht aktet ligjore dhe nënligjore në fushën e pagave, mangësi janë konstatuar vetëm në rastet si me poshtë vijon:

1. Duke filluar nga janari i vitit 2022 deri në mars të vitit 2023 pagesave e stafit me detyrë përgjegjës në rektorat, është realizuar në kundërshtim me parashikimet ligjore të VKM nr. 187 datë 08.03.2017 *“Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në Kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e Presidentit, Kuvendit, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Gjykatën e Lartë, Prokurorinë e Përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të Kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e Prefektit”*, i ndryshuar, lidhja nr.7 e cila kategorinë IV a ‘përgjegjës sektori në rektorat’ ndërsa vendimmarrja e Bordit ka përcaktuar kategorinë III b me vendimin e BA-së nr.59 datë 12.01.2021. Vendimmarrje në tejkallim të kompetencave pasi kategoria ishte shprehimisht e përcaktuar në VKM.

Efekti financiar nga ndryshimi i kategorisë është 1,442,651 lekë.

**Mbajnë përgjegjësi për veprimet dhe mos veprimet e tyre:** Bordi i Administrimit.

2. VKM nr. 187 datë 08.03.2017 *“Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në Kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e Presidentit, Kuvendit, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Gjykatën e Lartë, Prokurorinë e Përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të Kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e Prefektit”*, është ndryshuar me VKM 621, datë 28.09.2022 ku kanë ndryshuar pagat e nëpunësve.

Nga auditimi u konstatuar se USHLG ka zbatuar VKM e sipërcituar pa një miratim të BA në kundërshtim me *Ligjin Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në republikën e Shqipërisë” neni 38 gërma h, Statuti i USHLG neni 28 pika 2 germa c dhe me ligji Nr.8480, date 27.5.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale te administratës shtetërore dhe enteve publike” neni 8 dhe neni 16 pika 1. Ne çdo mbledhje mbahet një procesverbal, ku behet një përmbledhje e gjithçka je u tha ne mbledhje, data dhe vendi i mbledhjes, anëtarët qe morën pjese, çështjet qe u diskutuan, vendimet qe u morën, si dhe forma dhe rezultati i votimeve.*

2. *Procesverbali mbahet nga sekretari dhe duhet t'u paraqitet për miratim te gjithë anëtareve ne fund te mbledhjes ose ne fillim te mbledhjes pasardhëse. Pas miratimit procesverbali nënshkruhet se bashku nga kryetari dhe sekretari.*

3. *Ne rastet kur vete organi e shikon te arsyeshme dhe mbledhja është e ndare ne seanca, procesverbali miratohet menjëherë pas përfundimit te seancës përkatëse.*

4. *Vendimet jo normative te organeve kolegjiale hyjnë ne fuqi vetëm pasi te jete miratuar procesverbali përkatës.*

**Mban përgjegjësi për veprimet dhe mos veprimet :** ish Administratori i deleguar i USH, znj, S. A dhe nëpunësi zbatues z, I. B.

**Observacion i subjektit mbi Projekt Raportin e Auditimit, vënë në dispozicion grupit të auditimit në datë 27.03.2025 me nr.1101/11 prot.**

**Pretendimi i subjektit:** Në lidhje me VKM nr 621 dt 28.09.2022, ky vendim është një ndryshim

ne VKM nr 187 dt 08.03.2017 ku janë të përfshira edhe Universitete. VKM nr, 621 i dates 28.09.2022, nuk perjashton IAL-të nga institucionet që preken nga kjo VKM por ndryshon nivelet e pagave për kategori te caktuara. Bordi i administrimit ka marre njoftim për këtë VKM me ane te emailit nga ana e Administratores së komanduar, për periudhën në fjalë, Sehada Abdija, ku i është kerkuar edhe aprovimi. Bordi i administrimit, pasi ka marre sqarimin nga Nepunesi zbatues, kane shprehur aprovimin e tyre nepermiet emai-it zyrtar, per zbatimin e VKM-se. (bashkelidhur komunikimi ne email).

**Qëndrimi i Grupit të Auditimit:** Referuar observacioneve të ardhura me prot 1101/14 datë 27.03.2025, nuk u sollën arsyetime apo dokumenta shtesë vërtetues për pasojë **observacioni nuk merret në konsideratë.**

Nga auditimi i listë pagesave konstatohet se nuk ka një sistem elektronik të automatizuar të sistemit të pagave, duke përfshirë të gjithë elementët e saj, do të sjellë lehtësi në kontrollin e procesit të punës, si dhe në përlllogaritjen e pagës.

Ndërkohë për te gjithë muajt e periudhës së auditimit elementet e tabelës së listë pagesave nuk janë plotësuar sipas formatit te caktuar.

Konstatohet se për orët shtesë paguar për stafin akademik është përdorur kolona nr, 17 “Shtesë page për orët jashtë kohës normale të punës” në kundërshtim me udhëzimin nr, 1 date 21/05/2021 “Për formën, elementet dhe plotësimin e liste pagesës mujore të pagave dhe të urdhër shpenzimit për pagat në njësitë e qeverisjes se përgjithshme” i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Kjo parregullsi nuk na jep një pasqyre të qartë të elementeve përbërës të pagave si dhe efektin/peshën specifike të tyre në strukturën e pagave.

Gjithashtu konstatohet se për stafin akademik me kohe të pjesshme pagesat për shërbimin e ofruar nga ana e pedagoqeve për periudhën e vitit akademik 2023-2024 për semestrin e parë janë ekzekutuar në fund të semestrit për të gjithë ngarkesën mësimore dhe jo sipas planit mësimor bashkëlidhur kontratës së punës mes pedagoqeve dhe Rektoratit. Në referim të ligjit Nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore dhe Shëndetësorë në Republikën e Shqipërisë” neni 6 Mbrojtja e detyrueshme thekson “Sigurimet shoqërore, gjithashtu, i japin mbrojtje të detyrueshme të gjithë personave të punësuar, në rastin e pakësimit të të ardhurave, si pasojë e paaftësisë së përkohshme të shkaktuar nga sëmundja, aksidenti në punë, sëmundja profesionale dhe papunësia.” Neni 8 Periudha e mbrojtjes nga sigurimet shoqërore thekson “Periudha e mbrojtjes nga sigurimet shoqërore nis ditën kur personi e ka filluar ligjërisht veprimtarinë ekonomike dhe mbaron ditën kur përfundon ligjërisht kjo veprimtari”. Subjekti duhet ti kishte regjistruar në skemën e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësorë sipas planit mësimor bashkëlidhur kontratës pasi këta punonjës e kane ofruar shërbimin e tyre sipas muajve respektiv dhe ti paguante po sipas këtyre muajve. Ky veprim i ka privuar nga e drejta për të qenë përfitues sipas ligjit te mësipërm për periudhën për të cilën ata kane ofruar shërbimin.

### **Pagesa për orët jashtë orarit zyrtar të punës.**

**1** - Nga auditimi i dokumentacionit për shpenzimet mbi pagesat për orët jashtë orarit zyrtar për periudhën objekt auditimi, u konstatua se në vitin **2024** janë paguar 13 punonjës për periudhën e Dhjetorit te vitit 2023 me orë shtesë. Me shkresë 4005/1 datë 12.12.2023 është urdhëruar ngritja e grupit të punës për hartimin e buxhetit te vitit 2024. Me shkrese nr, 21 prot datë 09.01.2024 Administratori ka urdhëruar pagese e orëve shtesë për datën 03, 09, 10, 16, 17 , 23 dhe 30 dhjetor 2023 nga 8 ore shtesë si dhe për datat 24, dhe 31 dhjetor nga 4 orë shtesë . (Tabela në aneks nr, 1/3 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar).

**Nga auditimi** për pagesat e orëve jashtë orarit zyrtar të kryera për vitin 2024 konstatohet nuk ka kërkesë të eprorit të drejtpërdrejtë dhe miratimin e titullarit të institucionit për punonjësit që kanë punuar orë shtesë, por urdhri administratorit për pagesën për orët jashtë orarit zyrtar është mbas faktit, pasi dhe në shkresën me nr, 4005/1 datë 12.12.2023 nuk është cituar se grupi i punës do të punoj jashtë orarit zyrtar te punës.

Gjithashtu dhe tek listë prezenca e Dhjetorit me nr, 9/5 prot datë 10.01.2024 rezulton se punonjësit e sipërcituar nuk kanë punuar jashtë orarit zyrtarë te punës pasi ne datën 03, 09, 10, 16, 17 , 23 , 24 dhe 31 dite te cilat janë te shtuna dhe te diela dhe prezenca është (P) pushim,

*Vkm Nr. 568, datë 6.10.2021 “Për miratimin e rregullave për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit, orët shtesë dhe kompensimin e tyre në institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore” pika 7 : Me kërkesë të eprorit direkt dhe me miratimin e titullarit të institucionit, të punësuarit mund t’i kërkohet të kryejë orë shtesë, brenda kufijve të përcaktuar në Kodin e Punës. Pika 8: Të punësuarit, që kryen veprimtari administrative, orët shtesë në punë i kompensohen vetëm me pushim, pika 11: Në kuptim të këtij vendimi, veprimtari operacionale, si rregull, konsiderohen ato veprimtari që kanë kohëzgjatje të pandërprerë (sistem 24-orësh/gatishmëri). Për raste të tjera specifike merret mendimi i detyrueshëm nga ministria përgjegjëse për financat dhe Departamenti i Administratës Publike. Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” nenin 4/26 -pikën 17 “Kontrolle para faktit” të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”. Në këtë rast nuk është marrë miratimi para faktit nga titullari me qëllim që të garantohet ligjshmëria dhe rregullshmëria e vendimeve financiare. Ato duhet të kryhen në mënyrë të vazhdueshme në të gjitha fazat e procesit para marrjes së vendimit për përdorimin e fondeve publike, pra para se të ndodhë një transaksion i caktuar dhe pikën 36 “Dokumentimi i lëvizjes së aktiveve” të Udhëzimit nr. 30, dt. 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”.*

Për sa më sipër kemi të bëjmë me **dëm ekonomik** në vlerën **830,299 lekë**.

**Mbajnë përgjegjësi për veprimet dhe mosveprimet e tyre** Administratori z, A. U dhe Nëpunësi zbatues z, I. B.

**2 - Nga auditimi i dokumentacionit për shpenzimet mbi pagesat për orët jashtë orarit zyrtar për periudhën objekt auditimi, u konstatua në Mars të vitin 2024 janë paguar 5 punonjës me orë shtesë. Me shkresë me nr, 715 datë 27.02.2024 është urdhëruar ngritja e grupit të punës hedhjen e pagesave të studentëve në sistemin e pitagorës. Me shkresë nr. 1205/11 prot, datë 04.04.2024 Administratori ka urdhëruar pagese e orëve shtesë. (Tabela në aneks nr, 1/3 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar).**

Pagesa për orët jashtë orarit zyrtar mars viti 2024		
Nr	Emri i punonjësve	Paga e përfituar ne Total
1	S. C	66,128
2	E. I	44,617
3	X. Z	45,988

4	S. A	47,204
5	I. S	46,393
<b>Totali</b>		<b>250,330</b>

**Nga auditimi** i pagesave të orëve jashtë orarit zyrtar të kryera për muajin Mars te vitit 2024 konstatohet se tek shkresa me nr, 715 prot datë 27.02.2024 për ngritjen e grupit te punës nuk është specifikuar se kur do te punoj jashtë orarit zyrtar grupi i punës, por tek pika 3 e urdhrin citohet: *Ky grup do të funksionoj përgjatë kohës se nevojshme deri ne përfundim të procesit mësimor apo provimeve duke punuar dhe jashtë orarit zyrtare të punës.*

Ndërkohë tek liste prezenca e muajt mars me nr, 1106/8 prot, datë 02.04.2024 rezulton se punonjësit e sipërcituar nuk kanë punuar jashtë orarit zyrtare te punës pasi ne ditët pushim zyrtar siç është e shtuna dhe e diela prezenca është shënuat me (P) pushim.

Gjithashtu nuk ka një relacion ku te specifikohet numri i orëve dhe data ne të cilën kanë punuar jashtë orarit zyrtarë, por është vetëm urdhri për pagës e orëve jashtë orarit dhe shumat totale pa i cilësuar sa ore ka punuar gjithsecili.

*Vkm Nr. 568, datë 6.10.2021 “Për miratimin e rregullave për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit, orët shtesë dhe kompensimin e tyre në institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore” pika 7 : Me kërkesë të eprorit direkt dhe me miratimin e titullarit të institucionit, të punësuarit mund t’i kërkohe të kryejë orë shtesë, brenda kufijve të përcaktuar në Kodin e Punës. Pika 8: Të punësuarit, që kryen veprimtari administrative, orët shtesë në punë i kompensohen vetëm me pushim, pika 11: Në kuptim të këtij vendimi, veprimtari operacionale, si rregull, konsiderohen ato veprimtari që kanë kohëzgjatje të pandërprerë (sistem 24-orësh/gatishmëri). Për raste të tjera specifike merret mendimi i detyrueshëm nga ministria përgjegjëse për financat dhe Departamenti i Administratës Publike. Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” nenin 4/26 -pikën 17 “Kontrolle para faktit” të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”. Në këtë rast nuk është marrë miratimi para faktit nga titullari me qëllim që të garantohet ligjshmëria dhe rregullshmëria e vendimeve financiare. Ato duhet të kryhen në mënyrë të vazhdueshme në të gjitha fazat e procesit para marrjes së vendimit për përdorimin e fondeve publike, pra para se të ndodhë një transaksion i caktuar dhe pikën 36 “Dokumentimi i lëvizjes së aktiveve” të Udhëzimit nr. 30, dt. 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”. Për sa më sipër kemi të bëjmë me **dëm ekonomik** në vlerën **250,330 lekë.***

**Mbajnë përgjegjësi për veprimet dhe mosveprimet e tyre** Administratori z, A. U dhe Nëpunësi zbatues z, I. B.

**3** - Nga auditimi i dokumentacionit për shpenzimet mbi pagesat për orët jashtë orarit zyrtar për periudhën objekt auditimi, u konstatua se në muajin prill të vitin **2024** janë paguar 12 punonjës për orët e punuar jashtë orarit zyrtar të punës. Me shkresë nr, 1445 prot datë 29.04.2024 është urdhëruar të kryet pagesa për punonjës për datat 06 dhe 10.04.2024. Me shkresë nr. 1539 prot datë 07.05.2024 Administratori ka urdhëruar pagese e orëve shtesë për punonjësit si me poshtë vijon. (Tabela në aneks nr, 1/3 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar).

**Nga auditimi** për pagesat e orëve jashtë orarit zyrtar të kryera për muaj prill 2024 konstatohet nuk ka kërkesë të eprorit të drejtpërdrejtë dhe miratimin e titullarit të institucionit për punonjësit që kanë punuar orë shtesë, por urdhri i administratorit për pagesën për orët jashtë orarit zyrtar është mbas faktit.

*Vkm Nr. 568, datë 6.10.2021 “Për miratimin e rregullave për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit, orët shtesë dhe kompensimin e tyre në institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore” pika 7 : Me kërkesë të eprorit direkt dhe me miratimin e titullarit të institucionit, të punësuarit mund t’i kërkohet të kryejë orë shtesë, brenda kufijve të përcaktuar në Kodin e Punës. Pika 8: Të punësuarit, që kryen veprimtari administrative, orët shtesë në punë i kompensohen vetëm me pushim, pika 11: Në kuptim të këtij vendimi, veprimtari operacionale, si rregull, konsiderohen ato veprimtari që kanë kohëzgjatje të pandërprerë (sistem 24-orësh/gatishmëri). Për raste të tjera specifike merret mendimi i detyrueshëm nga ministria përgjegjëse për financat dhe Departamenti i Administratës Publike. Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” nenin 4/26 -pikën 17 “Kontrolle para faktit” të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”. Në këtë rast nuk është marrë miratimi para faktit nga titullari me qëllim që të garantohet ligjshmëria dhe rregullshmëria e vendimeve financiare. Ato duhet të kryhen në mënyrë të vazhdueshme në të gjitha fazat e procesit para marrjes së vendimit për përdorimin e fondeve publike, pra para se të ndodhë një transaksion i caktuar dhe pikën 36 “Dokumentimi i lëvizjes së aktiveve” të Udhëzimit nr. 30, dt. 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”. Për sa më sipër kemi të bëjmë me **dëm ekonomik** në vlerën **105,760 lekë**.*

**Mbajnë përgjegjësi për veprimet dhe mosveprimet e tyre:** Administratori z, A. U dhe Nëpunësi zbatues z, I. B.

**Observacion i subjektit mbi Projekt Raportin e Auditimit, vënë në dispozicion grupit të auditimit në datë 27.03.2025 me nr.1101/11 prot.**

**Pretendimi i subjektit:** Per pagesen e oreve jashte orarit per dhjetorin 2023, eshte leshuar urdheri ku krijon grupin e punes per pergatitjen e buxhetit te vitit 2024 dhe i ngarkon ketij grupi detyren e pergatitjes se buxhetit duke mos anashkaluar asnje nga detyrat tjera funksionale te secilit prej anetareve. Oret jashte orarit jane realizuar edhe duke qendruar pas orarit zyrtar gjate diteve te punes dhe ne kushtet e Universitetit eshte i veshtire kompensimi me dite pushimi pasi pushimet e stafit kane lidhje direkte me prezencen ose jo te studenteve ne Universitet. Ne rastet kur studentet nuk jane pushim, atehere edhe stafi detyrohet te jete i teri ne pune per shkak te permbushjes sa me te plotegdetyrave ndaj studenteve.

2. E njejta vlen edhe per oret jashte orarit te paguara ne mars eshte marre me hedhjen e mandateve te pagesave te studenteve ne sistemin pitagora.

3. Për pagesat jashtë orarit të muajit Prill 2024 situata ka qenë tërësisht e paparashikuar pasi në ditën se Bajramit të Madh si pasoje e rreshjeve të shumta të shiut, uji kishte hyrë në ndertesa duke bërë të pamundur zhvillimin normal të aktiviteti mesimor. Në këto kushte ka qenë emergjente kontaktimi i stafit të pastrimit dhe thirrja e tyre në punë. Urdheri ka qenë vetem verbal.

**Qëndrimi i Grupit të Auditimit:** Referuar observacioneve të ardhura me prot 1101/14 datë 27.03.2025, nuk u sollën arsyetime apo dokumenta shtesë vërtetues për pasojë **observacioni nuk merret në konsideratë**.

**Përmbushja e detyrimit për kohën vjetore të punës prej 1536 orë.**

Nga auditimi i evidencave të orëve të personelit akademik pranë Fakultetit të Drejtësisë, Fakultetit të Shkencave të Edukimit dhe Fakultetit të Shkencave të Natyrës, rezultoi se në formularin e

planifikimit pasqyroheshin të dhënat e personelit akademik, programet e studimit, lëndët mësimore që parashikoheshin të zhvilloheshin sipas planeve të miratuara dhe orët e specifikuar. Por në formularin e planifikimit pasqyrohej vetëm "veprimtaria mësimdhënëse" referuar kreut I, pika 3, germa a e udhëzimit nr.29 date 10.09.2018 "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore te personelit akademik ne Institucionet e Arsimit te Lartë" i ndryshuar, ndërsa veprimtaria tjetër, konkretisht "kërkimi shkencor" (pika 3/b), "kontributi institucional" (pika 3/c). "kontributi profesional" (pika 3/d) evidentohet në total por jo të detajuara sipas përcaktimeve të udhëzimit nr. 29 datë 10.09.2018 "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore te personelit akademik ne Institucionet e Arsimit te Lartë" i ndryshuar, kreu III, pika 1 ku citohet "Çdo anëtar i personelit akademik i punësuar me kohe te plote ne IAL duhet te përmbushë detyrimet për kohën vjetore te punës prej 1536 ore.

### **Studimet e doktoraturës.**

Sipas Ligjit 85/2015 nenit 126 pika 4 përcaktohet se *“Personeli akademik, i punësuar në institucionet e arsimit të lartë, si personel me kohë të plotë, brenda pesë viteve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, duhet të përfundojë studimet e doktoratës. Kur, brenda këtij afati, personeli akademik nuk përfundon studimet e doktoratës, rektori kryen procedurat për zgjidhjen e kontratës së punës”* dhe Statuti i USHLG neni 42 pika 3 citon *“Asistent-lektorit që brenda pesë vjetëve nuk ka fituar gradën shkencore “Doktor” në fushën ku zhvillon veprimtarinë mësimore- kërkimore nuk i rinovohet kontrata.. Nga auditimi konstatohet se ana e USHLG-së nuk janë kryer procedurat e parashikuara në Ligjin dhe Statutin për zgjidhjen e kontratës se punës. (tabela në aneks 7)*

### **Observacion i subjektit mbi Projektin Raportin e Auditimit, vënë në dispozicion grupit të auditimit në datë 27.03.2025 me nr.1101/11 prot.**

**Pretendimi i subjektit:** Personelit akademik nuk i është ndërprerë kontrata pasi kanë pas shumë vite të punësuar në USH. Ka patur një pezullim të procesit të kuotave dhe regjistrimeve për doktoratë prej disa vitesh nga ana e ministrisë duke e vendosur stafin në pamundësi për përmbushjen e detyrimit pesëvjeçar. Prej dy vitesh, MAS ka rihapur kuota dhe vijon procesi e doktoratës. Thuajse i gjithë stafit me detyrimin për afat kohor është regjistruar në doktoratë në Universitetin e Shkodrës apo të Tiranës.....

**Qëndrimi i Grupit të Auditimit:** Referuar observacioneve të ardhura me prot 1101/14 datë 27.03.2025, nuk u sollën arsytet apo dokumenta shtesë vërtetues për pasojë **observacioni nuk merret në konsideratë.**

### **Dalja në pension.**

Grupi i auditimit konstatoi se nga ana e rektorit të Universitetit, për periudhën objekt auditimi, ka realizuar zgjatjet e marrëdhënies së punës shtyrjen e pensionit anëtarë të personelit akademik *“për vitin akademik 2021-2022 një rast, për vitin akademik 2022-2023 një rast dhe për vitin akademik 2023-2024 pesë raste”* (lista në aneks 3 me shtyrjet e afatit të daljes në pensionit për periudhën objekt auditimi), Në kundërshtim me kategoritë e përcaktuara në Ligjin e arsimit të lartë neni 65, *Personeli akademik, që mban titullin “Profesor”, shërben në detyrë deri në moshën 68 vjeç, me përjashtim të rastit kur, me kërkesën e tij, largohet nga detyra. Mbështetur mbi nevojat e institucionit të arsimit të lartë dhe me pëlqimin e tij, ai mund të shërbejë në detyrë edhe pas moshës së lartpërmendur, përmes kontratave me kohëzgjatje deri në një vit, të përsëritshme, sipas përcaktimeve në statutin e institucionit të arsimit të lartë.* 2. Personeli akademik, që mban titullin *“Profesor i asociuar”, shërben në detyrë deri në moshën 65 vjeç. Mbështetur mbi nevojat e institucionit të arsimit të lartë dhe me pëlqimin e tij, ai mund të shërbejë në detyrë edhe pas moshës së lartpërmendur, përmes kontratave me kohëzgjatje deri në një vit, të përsëritshme, sipas*

përcaktimeve në statutin e institucionit të arsimit të lartë. pasi zgjatja mund të bëhet vetëm për kategorinë me titullin “Profesor” dhe “Profesor i asociuar”.

Sipas përcaktimeve edhe të statutit neni 41 pika 3 Personeli akademik që mban titullin “Profesor”, shërben në detyrë deri në moshën 68 vjeç. Kjo kategori e personelit akademik, pasi mbush moshën për pension, mund të punësohet pa konkurs publik, me kontratë me kohëzgjatje të caktuar vetëm për një vit, me të drejtë rinovimi edhe një vit, nëse vendi mbetet vakant.

**Mbajnë përgjegjësi për veprimet dhe mosveprimet e tyre:** znj, S. G dhe znj, R. K.

**Observacion i subjektit mbi Projektin Raportin e Auditimit, vënë në dispozicion grupit të auditimit në datë 27.03.2025 me nr.1101/11 prot.**

**Pretendimi i subjektit:** Risjell në vëmendje se zgjatja e marrëdhënieve të punës për anëtarë të personelit akademik është kryer me kërkesë të arsyetuar nga drejtuesit e fakulteteve dhe të departamenteve për të zgjidhur problematikat e njëjësive që ata drejtojnë, qoftë për personel të kualifikuar në fushën perkatëse, qoftë për nevoja specifike të projekteve kerkimore. Ligji për Arsimin e Lartë nuk vendos kufizim për afatet dhe se sa here mund të rinovohet kontrata e personelit akademik që ka mbushur moshën. Për më tepër, *neni 33 i Ligjit Nr.7703/1993 "Për sigurimet shogerore ne Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar*, i cili nuk parashikon kufizim kohor për shtyrjen e daljes në pension. Sipas nenit 92 të këtij ligji, *"I siguruari, i cili ka plotësuar kushtet për pension pleqërie, merr shtese në masën 0,5 per qind të pensionit për çdo muaj që shtyn datën e daljes në pension dhe vazhdon të paguaje kontribute"*. Ky ligj parashikon se shtyrja e daljes në pension kryhet në rast se institucioni ka kryer kërkesë për atë pozicion pune, nuk ka patur kandidate për pune, dhe është e nevojshme kryerja e punës perkatëse, atehere mbështetur në kërkesën e palës së interesuar mund të vazhdojë të qëndrojë në pozicionin e punës deri në plotësimin e vakancës për atë pozicion pune. Gjithashtu nga institucioni përkates, për nevoja të veçanta të cilat lidhen drejtpërdrejtë me punonjesin që kryente punën respektive, mund të kërkojë vijimi i punës. Meqenese Ligji i mësipërm, Kodi i Punës dhe Ligji i arsimit të lartë nuk e pengojnë punësimin e kategorise profesor dhe punonjes përtej moshes se parashikuar për të dale në pension, nisur nga nevojat e institucionit per staf të kualifikuar dhe mungesën e tyre në fusha të veçanta, (matematike, fizik), për të mos ulur kriteret e punësimit lidhur me kualifikimin e stafit, kam propozuar që në Statutin e USH-së, si e vetmja pengesë në këtë drejtim, të bëhen rregullime ne perputhje me ligjin per të cilën Senati Akademik ka rënë dakord. (Mbledhja e Senatit, 25.08.2023, Nr. prot. 252). Bazuar në parimin e hierarkise së normave juridike, aplikuar për rastet konkrete të analizuara nga grupi i auditit, sqarojm se në marrëdhëniet e punës, kur ka mosperputhje normash juridike, prevalon norma juridike që është në favor të punemarrësit.

**Qëndrimi i Grupit të Auditimit:** Referuar observacioneve të ardhura me prot 1101/14 datë 27.03.2025, nuk u sollën arsyetime apo dokumenta shtesë vërtetues për pasojë ***observacioni nuk merret në konsideratë.***

**Laboratorit i diagnostifikimit mikrobiologjik.**

Për periudhën objekt auditimi në strukturën e USH konstatohet se ne varësi të administratorit është Laboratori i diagnostifikimit mikrobiologjik i cili ka në përbërje 3 punonjës, Përgjegjës laboratorit (mjek mikrobiolog) si dhe 2 laborante. Qëllimi i laboratorit është kryerja e analizave mikrobiologjik për individë dhe realizimin e të ardhurave ne buxhetin e USH.

Lista e çmimeve për kryerjen e analizave dhe shërbimeve të laboratorit është miratuar nga Senati Akademik në vendim nr, 96 date 22.06.2011.

Për vitin 2022 laboratori ka realizuar 1,177,100 lekë të ardhura, për vitin 2023 ka realizuar 945,900 lekë të ardhura dhe deri ne 30.06.2024 ka realizuar 583,500 lekë.

Nga auditimi konstatohet se Përgjegjës laboratorit pranë Laboratorit të diagnostifikimit mikrobiologjik është vakant si dhe laboratorit (për vitet 2022, 2023 deri ne 30.06.2024) nuk e ka përmbushur qëllimin e tij i cili është të krijojë të ardhura për buxhetin e USH.

Pasi duke analizuar të ardhurat dhe shpenzimet e laboratorit (pagat e 2 laboranteve trajtuar ne piken 4 Pasqyrat financiare) konstatohet se laboratorit në fund të çdo viti ka dalur me humbje tabela me poshtë:

Gjithashtu dhe lista e çmimeve nuk është përditësuar dhe është miratuar përpara 14 vitesh.

	Viti 2022	Viti 2023	Janar - Qershor 2024
Te ardhurat e laboratorit	1,177,100	945,900	583,500
Shpenzime për paga 2 punonjës	1,300,120	1,782,840	965,520
Rezultati	-123,020	-836,940	-382,020

#### **a) Akreditimi i laboratorit dhe mirëmbajtja e tij**

Besueshmëria e analizave të laboratorit të diagnostikimit mikrobiologjik pranë USH varet nga disa faktorë, ku ndër më kryesorët janë: **akreditimi/certifikimi i laboratorit dhe mirëmbajtja e tij vazhdimisht**; Gjithashtu, për mirëmbajtjen e aparaturave laboratorike si dhe për të rritur saktësinë e rezultateve që ato gjenerojnë, **duhet që në mënyrë periodike (1 herë në vit) të bëhet kalibrimi i tyre**.

Akreditimi për laboratorët e testimit mjekësor kryhet nga Agjencia e Akreditimit (EAF). EAF ofron një program akreditimi të njohur ndërkombëtarisht për laboratorët e testimit mjekësor. Kërkesat për Programin e Akreditimit të EAF për laboratorët e testimit mjekësor përcaktohen në ISO 15189: 2022 Laboratorët mjekësorë - Kërkesat për cilësi dhe kompetencë. Akreditimi EAF dëshmon aftësinë e një laboratorit të testimit mjekësor për të menaxhuar dhe kryer aktivitete të përcaktuara nga programi i tij specifik i akreditimit. Procesi i akreditimit të EAF siguron dëshmi objektive që një organizatë funksionon në një nivel të lartë të standardeve organizative, ligjore dhe teknike nga ku nëse një organ vlerësues i konformitetit plotëson standardet e specifikuar, ai lëshohet me një shenjë akreditimi.

#### **Masat e marra nga institucioni për vlerësimin dhe kalibrimin e pajisjeve të laboratorit të kontrollit.**

Në lidhje me mirëmbajtjen e aparaturave laboratorike, e cila çon në saktësinë e rezultateve të cilat ato gjenerojnë, nga ku duhet që në mënyrë periodike (1 herë në vit) të bëhet kalibrimi i tyre. Kalibrimi është një komponent i **domosdoshëm** për të siguruar legjitimitetin e kualifikimit dhe verifikimit, duke përfshirë vërtetimin e sistemit kompjuterik. Aktivitetet e kalibrimit duhet të kryhen me instrumente të kualifikuara nga një laborator i akredituar, ku një ndër to është dhe Drejtorja e Përgjithshme e Meteorologjisë (organ shtetëror i akredituar). ”

Nga grupi i auditimit për periudhën objekt auditimit (2022,2023 deri 30.06.2024), nga USH nuk u paraqit asnjë dokument, i cili të dëshmonte kërkesën që USH duhet ti bënte Agjencisë së Akreditimit, se cilat janë kushtet për të plotësuar të gjitha standardet e akreditimit të laboratorit, ku më pas të krijohej një strategji e qartë që do të duhej të ndiqej për akreditimin e Laboratorit, për të paraprirë nga ana e USH një metodologji të mirë përcaktuar mbi hapa konkret që institucioni duhet të marrë, për të siguruar saktësinë dhe cilësinë e këtyre analizave, si një hap fillestar nga USH për tu njohur në lidhje me kushtet dhe kriteret të cilat duhet të plotësoj ky laborator për tu akredituar”.

Gjithashtu konstatohet se aparaturave laboratorike nuk janë kalibruar.

### **BORDI ADMINISTRIMIT.**

Bordi i Administrimit është organi më i lartë kolegjal administrativ, i cili garanton përmbushjen e misionit të Universitetit, mbarëvajtjen financiare dhe administrative të tij.

Bordi i Administrimit në Universitetin e Shkodrës përbëhet nga shtatë anëtarë, nga të cilët përkatësisht 3 anëtarë janë përfaqësues nga USH sipas vendimit të Senatit Akademik nr.299 datë 04.10.2021''Për zgjedhjen e anëtarëve përfaqësues të USH-së në Bordin e Administrimit'. Me urdhrin nr.432 datë 04.11.2021 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit ''Për emërimin në detyrë t anëtarëve të BA-së të Universitetit të Shkodrës përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin. Me vendimin nr. 335 Prot., datë 16.11.2021 të BA-së ''Për zgjedhjen e Kryetarit'' është zgjedhur kryetari i Bordit të Administrimit të Universitetit të Shkodrës z. A. L dhe anëtarët z. A. B, znj. B. L, znj. B. D, znj. E. R, znj. E. K, z. G. S.

Nga auditimi konstatohet se sekretare e bordit është znj. S. B, veprim ky në kundërshtim me ligjin nr. 8480 datë 27.05.1999 ''Për funksionimin e organeve kolegiale të administratës shtetërore dhe enteve publike'' neni 2, pika 1'' Çdo organ kolegjal ka një kryetar dhe një sekretar, të cilët zgjidhen nga anëtarët e këtij organi, me përjashtim të rasteve kur me ligj parashikohet ndryshe''. Me vendimin nr. 16 datë 13.01.2023 ''Për pagesën për sekretaren e Bordit të Administrimit të USH-së'', është vendosur miratimi i pagesës shtesë mbi pagën normale për detyrën si sekretare e BA me një vlerë prej 15,000 lekë në muaj. Në vendim shprehet se ky vendim i shtrin efektet financiarë që nga data e konsolidimit të BA data 16.11.2021 edhe pse në këtë vendim nuk shprehet që sekretare për BA do të jetë znj. S. B. Në bazë të këtij vendimi nga ana USH është kryer pagesa për sekretaren e BA për çdo mbledhje që ka qenë e pranishme. Kjo pagesë nuk duhej të ishte kryer për shkak se znj. S. B nuk është anëtare e BA siç edhe ligji e parashikon dhe ky veprim ka sjell një efekt financiar negativ për buxhetin e USH në masën 480,000 lekë.

Bordi i Administrimit të Universitetit të Shkodrës me vendim nr.75 datë 10.03.2023 ''Për miratimin e trajtimit të veçantë financiar të komisioneve të veçanta të USH-së'' ka miratuar shpërblime për anëtarët e këshillit të etikës me 10,000 lekë për çdo mbledhje deri në 6 mbledhje në vit dhe për anëtarët e komisionit të përhershëm për garantimin e standardeve dhe cilësisë së USH-së me 10,000 lekë për çdo mbledhje deri në 4 mbledhje në vit.

Këshilli i etikës miratuar me vendim senati nr.52 datë 22.02.2021 ''Për zgjedhjen e këshillit të etikës në USH'', janë paguar me honorarë si më poshtë:

Nr	Emër mbiemër	Fakulteti	Nr mbledhjeve paguar	Shuma bruto/mbledhje	Shuma Bruto	Vendimi Bordit Administrativ	
						Nr	Datë
1	B. L	Shkencat e Natyrës	Pagese për mbledhje Këshilli i Etikes		130,000	75	10.03.2023
2	E. A	Shkencat Shoqërore	Pagese për mbledhje Këshilli i Etikes		130,000	75	10.03.2023
3	N. D	Shkencat e Edukimit	Pagese për mbledhje Këshilli i Etikes		130,000	75	10.03.2023
4	K. L	Gjuhët e Huaja	Pagese për mbledhje Këshilli i Etikes		130,000	75	10.03.2023
5	R. D	Drejtësi	Pagese për mbledhje Këshilli i Etikes		130,000	75	10.03.2023

Komisioni i përhershëm për garantimin e standardeve dhe cilësisë së USH miratuar me Vendim Senatit Akademik nr.181 datë 31.05.2021 ''Për krijimin e komisionit të përhershëm për garantimin

e standardeve dhe cilësisë në USH” si dhe janë paguar me honorarë, trajtuar në aneks nr, 1/4 bashkëlidhur Raporti Përfundimtar.

Nga grupi i auditimit është konstatuar se ka një mospërputhje ligjore me përcaktimet e VKM-së nr.656 datë 31.10.20218 “Për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave, bordeve ose komisioneve të përhershme të njësisë të qeverisjes qendrore” i ndryshuar, (me VKM nr. 559 datë 31.07.2019 e VKM nr.612 datë 29.07.2020), pika 5 ku specifikohet vetëm pagesa e Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit “Kufiri maksimal i shpërblimit të anëtarëve në Senatit Akademik dhe Bordin e Administrimit në IAL është 25,000 (njëzet e pesë mijë)lekë në muaj”.

Nga auditimi u konstatua se me anë të një shkrese nga ana e anëtarëve të komisionit të etikës me nr. 123 Prot., datë 12.04.2023 drejtuar administratorit dhe drejtorisë së financës, me anë të një relacioni të përgatitur prej tyre, ju kërkohet që të marrin pagesën edhe për mbledhjet që janë zhvilluar më përpara se të merrej vendimi i BA, kur në vendimin e BA nuk shprehet se ky vendim ka dhe fuqi prapavepruese. Ky veprim ka sjellë një efekt financiar negativ për buxhetin e USH në vlerën 650,000 lekë.

Nga auditimi konstatohet sipas të dhënave të ardhura nga financa e USH se komisioni i përhershëm për garantimin e standardeve dhe cilësisë në USH është paguar në kundërshtim me VKM, veprim ky që ka sjellë një efekt financiar negativ për buxhetin e USH në vlerën 220,000 lekë.

Me vendimin e Bordit të Administrimit nr.239 datë 22.11.2022 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të klinikës së fizioterapisë”, është miratuar rregullorja për funksionimin e kësaj klinike e cila ka për synim praktikën e studentëve dhe shërbim për të tjerë. Në këtë rregullore janë shprehur funksione të stafeve të ndryshme që do të shërbejnë në këtë klinik si dhe një financier i cili do të jetë përgjegjës për të gjitha shpenzimet dhe të ardhurat që mund të ketë kjo klinik. Nga auditimi i pasqyrave financiare të USH nuk ka të dhëna mbi të ardhurat që kjo klinik sipas rregullores duhet të kishte sjellë për buxhetin e USH. Për sa trajtuar rezulton se kjo klinik nuk e përmbush plotësisht vendimin e bordit mbi rregulloren e funksionimit të kësaj klinike për shkak se deri tani kjo klinik nuk ka sjellë të ardhura për USH.

### **2.3 Zbatimi i dispozitave ligjore mbi administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare.**

Për auditimin e rregullshmërisë dhe ligjshmërisë së veprimeve të kryera me arkë e bankë në valutë dhe lekë, nga grupi i auditimit u përzgjedhën për auditim veprimet e kryera në 3-mujori i 1 dhe 3-mujori i fundit i vitit 2022, 9-mujori i parë i vitit 2023 si dhe 3-mujori i parë i vitit 2024.

#### **Rrjetit Akademik Shqiptar**

Me vendimin e Bordit të Administrimit për miratimin e buxhetit 2023 me vendim nr. 83 datë 28.03.2023 “Për miratimin e buxhetit për vitin 2023” është miratuar zëri buxhetor "shërbime rrjeti RASH". Është realizuar pagesa nga Administratori dhe nëpunësi zbatues me urdhër-shpenzimet nr. 16 datë 26.01.2024 në vlerën 3,119,760 lekë për shërbimin e rrjetit në kundërshtim me parashikimet ligjore konkretisht, pa një vendimmarrje të organit kompetent në kundërshtim *Me vendimin nr.88 datë 14.02.2018 “Për krijimin e qendrës ndërinstitucionale të rrjetit akademik shqiptar” u krijua RASH me kompetencat e tij.*

Bordi Drejtues i RASH me Vendimin nr. 49, datë 03.07.2020, "Për nivelin e tarifës së shërbimeve", ka miratuar në tejkallim të kompetencës të tij tarifë shërbimi.

Vendimi i Bordit Drejtues të RASH bie ndesh me Akt-marrëveshjen "Për krijimin e qendrës ndërinstitucionale të rrjetit akademik shqiptar", neni 8, pika 2, germa d ku parashikohet që

**Asambleja e Anëtarësisë** " miraton tarifat e përdorimit të shërbimeve të përbashkëta dhe kontributin vjetor të anëtarësisë" e po kjo Akt-marrëveshje, në nenin 10, pika I germa "h" i njeh Bordit drejtues të RASH vetëm kompetencën e "propozimit të tarifave përkatëse të përdorimit të shërbimit dhe kontributin vjetor të anëtarësisë".

**Observacion i subjektit mbi Projektin e Raportit të Auditimit, vënë në dispozicion grupit të auditimit në datë 27.03.2025 me nr.1101/11 prot.**

**Pretendimi i subjektit** Pagesa e tarifës së shërbimit të RASH është bërë në vijim të marrëveshjes mes RASH dhe Universiteti dhe në kushtet kur shërbimi i ofruar nga ana e RASH ka qenë në parametrat e kerkuara. Mospagesa e Faturave të RASH do të conte në ndërprerjen e sistemit pitagora duke cenuar kështu pamundësinë monitorimin e pagesës së tarifave të shkollimit nga ana e tyre.

**Qëndrimi i Grupit të Auditimit:** Referuar observacioneve të ardhura me prot 1101/14 datë 27.03.2025, nuk u sollën arsye të apo dokumenta shtesë vërtetues për pasojë **observacioni nuk merret në konsideratë.**

**Biletat e transportit ajror ndërkombëtare**

Nga auditimi i urdhër shpenzimit nr, 390 datë 30.09.2022 janë paguar shpenzimet e udhëtimit në vlerën **36,979** lekë.

Me datë 20.09.2022 është bërë kërkesë për rimbursim e udhëtimit për aktiviteti i cili është zhvilluar në Universitetin e Gyor Hungari nga datat 11-18.09.2022.

Miratimi i rektorit është me nr, 2786 datë 19.09.2022, ndërsa me shkresë 2786/1 datë 30.09.2022 Administratori urdhëron kryerjen e pagesës.

**Grupi i auditimit** konstatoi se blerja e biletave të transportit ajror ndërkombëtare me vlerë **36,979** lekë nuk është zhvilluar me procedurën e prokurimit publik *Ne kundërshtim me Ligjin nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik" neni 54 pika 1, VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit Publik" neni 68 pika 9 dhe me udhëzimin nr, 03 datë 18.06.2021 "Mbi përdorimin e sistemit dinamik për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtare dhe zhvillimin me mjete elektronike"*.

Nga auditimi i urdhër shpenzimit nr, 415 datë 24.10.2022 dhe nr, 416 datë 21.10.2022 janë paguar shpenzimet e udhëtimit në vlerën 216,643 lekë.

Me shkresë nr, 1444 prot, datë 19.04.2022 dhe shkresë nr, 1493 prot, 26.04.2022 është bërë kërkesë për blerje biletave të transportit për udhëtimin që do të kryhet në Valencia Spanjë me datë 02-03.05.2022 për konferencën e shoqatës Europiane të grave rektore.

Me shkresë nr, 1444/2 prot, datë 21.10.2022 është urdhëruar kryerja e pagesës për udhëtimin.

**Grupi i auditimit** konstatoi se blerja e biletave të transportit ajror ndërkombëtare me vlerë **128,609** leke nuk është zhvilluar me procedurën e prokurimit publik *Ne kundërshtim me Ligjin nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik" neni 54 pika 1, VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit Publik" neni 68 pika 9 dhe me udhëzimin nr, 03 datë 18.06.2021 "Mbi përdorimin e sistemit dinamik për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtare dhe zhvillimin me mjete elektronike"*.

Nga auditimi i urdhër shpenzimit nr, 447 datë 12.12.2022 dhe nr, 448 datë 12.12.2022 janë paguar shpenzimet e udhëtimit në vlerën 75,180 lekë.

Me shkresë nr, 2687 prot, datë 09.09.2022 është bërë kërkesë për blerje biletave të transportit për udhëtimin që do të kryhet në Podgorice-Lubjane me datë 19-21.09.2022 për vizite në Universitetin e Mariborit në kuadër të festimeve të 47 vjetorit të themelimit të tij si dhe emërimin

Rektorit të këtij Universitetit.

Me shkresë nr, 2687/2 prot, datë 12.12.2022 është urdhëruar kryerja e pagesës për udhëtimin.

**Grupi i auditimit** konstatoi se blerja e biletat të transport ajror ndërkombëtare me vlerë **51,874** lekë nuk është zhvilluar me procedurën e prokurimit publik *Ne kundërshtim me Ligjin nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” neni 54 pika 1, VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit Publik” neni 68 pika 9 dhe me udhëzimin nr, 03 datë 18.06.2021 “Mbi përdorimin e sistemit dinamik për blerjen e biletave të transport ajror ndërkombëtare dhe zhvillimin me mjete elektronike”.*

Nga auditimi i urdhër shpenzimit nr,47 dhe 48 datë 14.02.2023 janë paguar shpenzimet e udhëtimit në vlerën 151,092 lekë.

Me shkresë nr, 516 prot, datë 13.02.2023 është urdhëruar kryerja e pagesës për udhëtimin e kryer me datat 11-14.09.2022.

**Grupi i auditimit** konstatoi se blerja e biletat të transport ajror ndërkombëtare me vlerë **55,930** lekë nuk është zhvilluar me procedurën e prokurimit publik, *Në kundërshtim me Ligjin nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” neni 54 pika 1, VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit Publik” neni 68 pika 9 dhe me udhëzimin nr, 03 datë 18.06.2021 “Mbi përdorimin e sistemit dinamik për blerjen e biletave të transport ajror ndërkombëtare dhe zhvillimin me mjete elektronike”.*

Nga auditimi i urdhër shpenzimit nr, 91 datë 07.03.2023 janë paguar shpenzimet e udhëtimit në vlerën 31,434 lekë.

Me shkresë nr, 697 prot, datë 28.02.2023 është urdhëruar kryerja e pagesës për udhëtimin e organizuar me datat 29 nëntor deri me 1 dhjetor 2022 *“Konferenca ndërkombëtare des femes libres a travers l histoire de l humanite”.*

**Grupi i auditimit** konstatoi se blerja e biletat të transport ajror ndërkombëtare me vlerë **31,434** lekë nuk është zhvilluar me procedurën e prokurimit publik, *Në kundërshtim me Ligjin nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” neni 54 pika 1, VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit Publik” neni 68 pika 9 dhe me udhëzimin nr, 03 datë 18.06.2021 “Mbi përdorimin e sistemit dinamik për blerjen e biletave të transport ajror ndërkombëtare dhe zhvillimin me mjete elektronike”.*

Nga auditimi i urdhër shpenzimit nr, 176 datë 27.04.2023 janë paguar shpenzimet e udhëtimit në vlerën 22,000 lekë.

Me shkresë nr, 530/1 prot datë 30.01.2023 është bërë kërkesë për blerje bileta transporti për udhëtimin që do të kryhet në Bratislave - Sllovakia me datë 20-24.02.2023 për aktivitetin e programit Ceepus III.

Me shkresë nr, 1360 prot, datë 20.04.2023 është urdhëruar kryerja e pagesës.

**Grupi i auditimit konstatoi** se blerja e biletat të transport ajror ndërkombëtare me vlerë **22,000** lekë nuk është zhvilluar me procedurën e prokurimit publik, *Në kundërshtim me Ligjin nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” neni 54 pika 1, VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit Publik” neni 68 pika 9 dhe me udhëzimin nr, 03 datë 18.06.2021 “Mbi përdorimin e sistemit dinamik për blerjen e biletave të transport ajror ndërkombëtare dhe zhvillimin me mjete elektronike”.*

Nga auditimi i urdhër shpenzimit nr, 228, 229 dhe 230 datë 24.05.2023 janë paguar shpenzimet e udhëtimit në vlerën 350,030 lekë për aktivitetin e zhvilluar ne Salsburg Austri.

Me shkresë nr, 1343 prot datë 19.04.2023 është bërë kërkesë për shpenzime udhëtimi, qëndrimi dhe akomodimi.

Me shkresë nr, 1343/2 prot, datë 17.05.2023 është urdhëruar kryerja e pagesës.

**Grupi i auditimit** konstatoi se blerja e biletat të transport ajror ndërkombëtare me vlerë **93,891** lekë nuk është zhvilluar me procedurën e prokurimit publik *Në kundërshtim me Ligjin nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” neni 54 pika 1, VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit Publik” neni 68 pika 9 dhe me udhëzimin nr, 03 datë 18.06.2021 “Mbi përdorimin e sistemit dinamik për blerjen e biletave të transport ajror ndërkombëtare dhe zhvillimin me mjete elektronike”.*

Nga auditimi i urdhër shpenzimit nr, 237 dhe 238 datë 02.06.2023 janë paguar shpenzimet e udhëtimit në vlerën 152,978 lekë për aktivitetin e zhvilluar ne Zenic Sarajev.

Me shkresë nr, 1343/2 prot, datë 17.05.2023 është urdhëruar kryerja e pagesës.

**Grupi i auditimit** konstatoi se blerja e biletat të transport ajror ndërkombëtare me vlerë **108,771** lekë nuk është zhvilluar me procedurën e prokurimit publik, *Në kundërshtim me Ligjin nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” neni 54 pika 1, VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit Publik” neni 68 pika 9 dhe me udhëzimin nr, 03 datë 18.06.2021 “Mbi përdorimin e sistemit dinamik për blerjen e biletave të transport ajror ndërkombëtare dhe zhvillimin me mjete elektronike”.*

Nga auditimi i urdhër shpenzimit nr, 261 datë 15.06.2023 janë paguar shpenzimet e udhëtimit në vlerën 31,678 lekë.

Me shkresë nr, 1654/1 prot, datë 15.06.2023 është urdhëruar kryerja e pagesës për udhëtimin.

**Grupi i auditimit** konstatoi se blerja e biletat të transport ajror ndërkombëtare me vlerë **16,000** leke nuk është zhvilluar me procedurën e prokurimit publik *Ne kundërshtim me Ligjin nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” neni 54 pika 1, VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit Publik” neni 68 pika 9 dhe me udhëzimin nr, 03 datë 18.06.2021 “Mbi përdorimin e sistemit dinamik për blerjen e biletave të transport ajror ndërkombëtare dhe zhvillimin me mjete elektronike”.*

Nga auditimi i urdhër shpenzimit nr, 274 datë 16.06.2023 janë paguar shpenzimet e udhëtimit në vlerën 44,318 lekë.

Me shkresë nr, 1654/1 prot, datë 16.06.2023 është urdhëruar kryerja e pagesës për udhëtimin.

**Grupi i auditimit** konstatoi se blerja e biletat të transport ajror ndërkombëtare me vlerë **44,318** leke nuk është zhvilluar me procedurën e prokurimit publik *Ne kundërshtim me Ligjin nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” neni 54 pika 1, VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit Publik” neni 68 pika 9 dhe me udhëzimin nr, 03 datë 18.06.2021 “Mbi përdorimin e sistemit dinamik për blerjen e biletave të transport ajror ndërkombëtare dhe zhvillimin me mjete elektronike”.*

Nga auditimi i urdhër shpenzimit nr, 374 datë 19.07.2023 janë paguar shpenzimet e udhëtimit në vlerën 26,126 lekë.

Me shkresë nr, 1747/1 prot, datë 18.07.2023 është urdhëruar kryerja e pagesës për udhëtimin e kryer për programin CEEPUS III Bratislava.

**Grupi i auditimit** konstatoi se blerja e biletat të transport ajror ndërkombëtare me vlerë **26,126** leke nuk është zhvilluar me procedurën e prokurimit publik *Ne kundërshtim me Ligjin nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” neni 54 pika 1, VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit Publik” neni 68 pika 9 dhe me udhëzimin nr, 03 datë 18.06.2021 “Mbi përdorimin e sistemit dinamik për blerjen e biletave të transport ajror ndërkombëtare dhe zhvillimin me mjete elektronike”.*

Nga auditimi i urdhër shpenzimit nr, 382 datë 27.07.2023 janë paguar shpenzimet e udhëtimit në vlerën 42,877 lekë.

Me shkresë nr, 1218/2 prot, datë 26.07.2023 është urdhëruar kryerja e pagesës për udhëtimin e kryer për programin CEEPUS III Hungari.

**Grupi i auditimit** konstatoi se blerja e biletat të transport ajror ndërkombëtare me vlerë **42,877** leke nuk është zhvilluar me procedurën e prokurimit publik *Në kundërshtim me Ligjin nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” neni 54 pika 1, VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit Publik” neni 68 pika 9 dhe me udhëzimin nr, 03 datë 18.06.2021 “Mbi përdorimin e sistemit dinamik për blerjen e biletave të transport ajror ndërkombëtare dhe zhvillimin me mjete elektronike”.*

Nga auditimi i urdhër shpenzimit nr, 390 datë 02.08.2023 janë paguar shpenzimet e udhëtimit në vlerën 16,108 lekë.

Me shkresë nr, 1746/1 prot, datë 01.08.2023 është urdhëruar kryerja e pagesës për udhëtimin e kryer për programin CEEPUS III Budapest.

**Grupi i auditimit** konstatoi se blerja e biletat të transport ajror ndërkombëtare me vlerë **11,108** leke nuk është zhvilluar me procedurën e prokurimit publik. Ndërsa fatura tatimore e mbushjes se mjetit me karburant ne vlerën **5,000** lekë është ne kundërshtim me *VKM nr. 977, datë 10.12.2010, “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit” i ndryshuar, në të cilën përcaktohet mënyra e rimbursimit të shpenzimeve të transportit sipas dokumentacionit tatimor (biletës së udhëtimit) sipas tarifave përkatëse dhe distancës kilometrike të linjave të miratuara me Vendimin nr. 146, datë 26.02.1998, “Për tarifat e transportit të udhëtarëve” i ndryshuar dhe me Ligjin nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” neni 54 pika 1, VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit Publik” neni 68 pika 9 dhe me udhëzimin nr, 03 datë 18.06.2021 “Mbi përdorimin e sistemit dinamik për blerjen e biletave të transport ajror ndërkombëtare dhe zhvillimin me mjete elektronike”.*

Nga auditimi i urdhër shpenzimit nr, 406 datë 10.08.2023 janë paguar shpenzimet e udhëtimit në vlerën 42,200 lekë.

Me shkresë nr, 2327/1 prot, datë 10.08.2023 është urdhëruar kryerja e pagesës për udhëtimin e kryer për projektin Mediver.

**Grupi i auditimit** konstatoi se tek dietat brenda vendit është paguar shpenzime karburanti në vlerën **29,600** lekë por pa dokument justifikues për shpenzimin e kryen (kuponët tatimor). Shpenzimet e karburantit janë kundërshtim më *VKM nr. 977, datë 10.12.2010, “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit” i ndryshuar, në të cilën përcaktohet mënyra e rimbursimit të shpenzimeve të transportit sipas dokumentacionit tatimor (biletës së udhëtimit) sipas tarifave përkatëse dhe distancës kilometrike të linjave të miratuara me Vendimin nr. 146, datë 26.02.1998, “Për tarifat e transportit të udhëtarëve”.*

Nga auditimi i urdhër shpenzimit nr, 44 dhe 45 datë 12.02.2024 janë paguar shpenzimet e udhëtimit në vlerën 172,393 lekë.

Me shkresë nr, 4174 prot, datë 21.12.2023 është urdhëruar kryerja e pagesës për udhëtimin e kryer për Universitetin e Bergamos.

**Grupi i auditimit** konstatoi se blerja e biletat të transport ajror ndërkombëtare me vlerë **61,419** leke nuk është zhvilluar me procedurën e prokurimit publik *Në kundërshtim me Ligjin nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” neni 54 pika 1, VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit Publik” neni 68 pika 9 dhe me udhëzimin nr, 03 datë 18.06.2021 “Mbi përdorimin e sistemit dinamik për blerjen e biletave të transport ajror ndërkombëtare dhe*

*zhvillimin me mjete elektronike”.*

Nga auditimi i urdhër shpenzimit nr, 48, 49 dhe 50 datë 13.03.2024 janë paguar shpenzimet e udhëtimit në vlerën 194,464 lekë.

Me shkresë nr, 886 prot, datë 05.03.2024 është urdhëruar kryerja e pagesës për udhëtimin e kryer në Paris Francë.

**Grupi i auditimit** konstatoi se blerja e biletat të transport ajror ndërkombëtare me vlerë **79,722 leke** nuk është zhvilluar me procedurën e prokurimit publik, *Në kundërshtim me Ligjin nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” neni 54 pika 1, VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit Publik” neni 68 pika 9 dhe me udhëzimin nr, 03 datë 18.06.2021 “Mbi përdorimin e sistemit dinamik për blerjen e biletave të transport ajror ndërkombëtare dhe zhvillimin me mjete elektronike”.*

**Nga auditimi** i 16 urdhër shpenzimeve të sipër cituara konstatohet se blerja e biletat të transport ajror ndërkombëtare me vlerë **811,058 lekë** nuk është zhvilluar me procedurën e prokurimit publik, *Në kundërshtim me Ligjin nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” neni 54 pika 1, VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit Publik” neni 68 pika 9 dhe me udhëzimin nr, 03 datë 18.06.2021 “Mbi përdorimin e sistemit dinamik për blerjen e biletave të transport ajror ndërkombëtare dhe zhvillimin me mjete elektronike”.*

Gjithashtu dhe tek dietat brenda vendit është paguar shpenzime karburanti në vlerën **34,600 lekë** por pa dokument justifikues për shpenzimin e kryer (kuponët tatimor). Shpenzimet e karburantit janë kundërshtim me VKM nr. 977, datë 10.12.2010, *“Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit” i ndryshuar, në të cilën përcaktohet mënyra e rimbursimit të shpenzimeve të transportit sipas dokumentacionit tatimor (biletës së udhëtimit) sipas tarifave përkatëse dhe distancës kilometrike të linjave të miratuara me Vendimin nr. 146, datë 26.02.1998, “Për tarifën e transportit të udhëtarëve”.*

**Mbanë përgjegjësi për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme:** Administratori z. A. U dhe Nëpunësi zbatues z. I. B.

**Observacion i subjektit mbi Projekt Raportin e Auditimit, vënë në dispozicion grupit të auditimit në datë 27.03.2025 me nr.1101/11 prot.**

**Pretendimi i subjektit** Në lidhje me biletat e transportit ndërkombëtar ajror, në vazhdimësi të praktikës së ndjekur para periudhës së auditimit, nuk është bërë pagesa direkt e biletës agjencise turistike apo kompanisë së fluturimit, por rimbursimi i saj anëtarëve të stafit që kanë bërë udhëtimin, të cilët e kishin prerë nga ana e vet paraprakisht biletën. Përveç këtyre, jemi ndodhur në rrethanat kur nga ana e stafit akademik që ka udhëtuar nuk na është ofruar informacioni i nevojshëm në lidhje me precizimin e datës së vajtjes dhe të kthimit detaj ky i domosdoshëm për prerjen e biletës në menyrë të rregullt. Në vijim, blerja e këtyre biletave do të realizohet me sistemin dinamik në përputhje me Ligjin 162/2020 "Për prokurimin publik" Neni 54 pika 1, VKM nr 285 dt 19.05.2021 miratimin e rregullave të prokurimit publik neni 68 pika 9 dhe me udhëzimin nr 3 dt 18.06.2021 përdorimin e sistemit dinamik për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar dhe zhvillimin me mjete elektronike. Kjo do të realizohet edhe duke ju vënë në dukje paraprakisht gjithë stafit që precizimi i datave të udhëtimit. Është përfshirë në regjistrin e prokurimeve edhe blerja e biletave të transportit ajror me sistem dinamik.

**Qëndrimi i Grupit të Auditimit:** Referuar observacioneve të ardhura me prot 1101/14 datë 27.03.2025, nuk u sollën arsyetime apo dokumenta shtesë vërtetues për pasojë **observacioni nuk merret në konsideratë.**

### **Kërkimi Shkencor dhe fee e konferencave.**

Për periudhën objekt auditimi janë rimbursuar pagesa për Fee Konferenca dhe kërkimi shkencor. Për vitin 2022 janë 3 përfituese personel akademik ne vlerën totale prej 55,774 lekë, për vitin 2023 janë 79 përfitues personel akademik me vlerë totale 5,079,658 lekë dhe deri ne 30.06.2024 janë 14 përfitues personel akademik me vlerë totale 856,833 lekë. Në total janë 96 përfitues personel akademik me vlerë totale prej 5,992,235 lekë. (Tabela në ankes 4).

**Grupi i auditimit konstatoi** se për vitin 2022 dhe vitin 2023 nuk ka një relacion shpjegues dhe verifikues nga ana e strukturave përkatëse akademike. Ndërkohë për vitin 2024 relacioni i hartuar nga struktura përkatëse është një përmbledhje narrative dhe nuk citohet mbështetja në objektivat strategjik të institucionit apo të prioriteteve të njësisve baze kryesorë të USHLG. *Në kundërshtim me Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.*

### **Observacion i subjektit mbi Projekt Raportin e Auditimit, vënë në dispozicion grupit të auditimit në datë 27.03.2025 me nr.1101/11 prot.**

**Pretendimi i subjektit :** Në lidhje me fees të konferencave është duke u përgatitur rregullorja e re. Grupi i punes, në përbërje të të cilit edhe NZ, ka dorezuar propozimin e tij për këtë subjekt ku mes tjerash detajohen Shpallja e thirrjes per shprehje interesi, Dokumentacioni i shprehjes se interesit, Afati i dorezimit te shprehjes se interesit, Shqyrtimi i aplikimeve dhe perzgjedhja e fituesve dhe njoftimi i aplikanteve. Draft rregullorja nuk eshte miratuar akoma.

**Qëndrimi i Grupit të Auditimit:** Referuar observacioneve të ardhura me prot 1101/14 datë 27.03.2025, nuk u sollën arsyetime apo dokumenta shtesë vërtetues për pasojë **observacioni nuk merret në konsideratë.**

### **Tejkalimi i afatit 30 ditor të likuidimit të faturave.**

Grupi i auditimit kreu me zgjedhje testime për të identifikuar pagesat e kryera për periudhën objekt auditimi me datën e urdhër shpenzimit mbi 30 ditë, nga data e lëshimit të faturës së furnitorit. *Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar, neni 52 dhe Në ligjin Nr.48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare” neni 7.* Nga kryerja e testimeve mbi urdhër shpenzimet, rezultuan shkelje të disiplinës buxhetore sa i takon likuidimit të faturave duke tejkaluar afatin ligjor. Konkretisht, janë likuiduar fatura mbi afatin e parashikuar 30 ditor duke shkelur disiplinën buxhetore që dikton ligji për “*Menaxhimin e Sistemit Buxhetor*”. Trajtuar në aneks 1/5 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar.

a. Tejkalim të afateve që parashikon ligji nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar, neni 52 ku citohet: “*specifikohet se Nëpunësi zbatues i njësisve shpenzuese të qeverisjes së përgjithshme paraqesin në strukturën e thesarit dokumentacionin justifikues të shpenzimeve për rastet e pagesave ndaj operatorëve ekonomikë, Brenda 30 ditëve nga data e faturës origjinale të OE-së”, dhe si pasojë*

b. Duke implikuar risqe për krijimin e detyrimeve të reja (prapambetura).

**Mbajnë përgjegjësi për veprimet dhe mosveprimet e tyre:** Administratori z. A. U dhe Nëpunësi zbatues z. I. B.

### **Observacion i subjektit mbi Projekt Raportin e Auditimit, vënë në dispozicion grupit të auditimit në datë 27.03.2025 me nr.1101/11 prot.**

**Pretendimi i subjektit :** Fatura ne nr rendor 1, sipas raportit paraprak, ka datë urdhër shpenzimi

11.02.2024, datë 30.01.2023 me vlerë 2,497,494. Nga sistemi afmis vërejmë që me urdhër shpenzim nr, 42, datë 12.02.2024 është likuaduar fatura nr, 165/2024 datë 31.01.2024 në vlerën 2,497,494, kjo faturë është likuaduar 12 ditë pas datës së faturimit.

**Qëndrimi i Grupit të Auditimit:** Referuar observacioneve të ardhura me prot 1101/14 datë 27.03.2025, nuk u sollën arsyetime apo dokumenta shtesë vërtetues për pasojë **observacioni nuk merret në konsideratë.**

**Nga auditimi me zgjedhje mbi rregullshmërinë e kryerjes së Shpenzimeve për karburant për automjetet e USHLG, u konstatua se:**

**1- Karta elektronik me targe e automjetit te USHLG AA**

Nga Drejtorja e fondit të investimeve dhe e shërbimeve, për automjetin me targe AA mbahet si dokument vërtetues për konsumin e karburantit kartela, në të cilat pasqyrohen të gjitha shpenzimet të shoqëruara me flete udhëtimet e tyre përkatëse.

Për automjetin që administron institucioni, në fillim dhe në fund të vitit nuk është evidentuar kilometrazhi i tij, për të bërë ndjekjen e shpenzimeve periodike, të cilat nuk mund të përlllogariten pa pasqyruar elementin bazë (kilometrazhin), si dhe për përlllogaritjen dhe planifikimin e shpenzimeve për mirëmbajtje dhe shfrytëzimin e automjeteve.

Nga auditimi me përzgjedhje i kartelave të automjeteve i cili është dokumenti vërtetues për lëvizjet, kilometrazhin dhe shpenzimet e karburantit të automjeteve, rezultoi se të gjithë fletë udhëtimet të drejtuesve të mjeteve janë të përshkruara lëvizjes me intenerarinin e tyre përkatëse por nuk janë të firmosura me firmat e nëpunësve udhëtues të kryerjes së shërbimit.

*Veprimet në këndshmit me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësite e sektorit publik”, i ndryshuar.*

Vitet	Gjendja në Litra ne fillim te çdo vitit	Hyrjet	total litra	dalje	Gjendja ne litra ne fund te periudhës 31.12.2023
2022	9511.5	0	9511.5	<b>7516</b>	1995.5
2023	1995.5	4458	6453,5	<b>3175,5</b>	3278
30.06.2024	3278	4249	7527	<b>2070</b>	5457

Vitet / Konsumi ne litra	AA 230 VH	Karta gold furnizuar punonjës e USHLG	Total litra konsumuar
2022	2130	5000 litra funizuar kaldaja + 386 makina te tjera= <b>5386</b>	<b>7516</b>
2023	2065.5	1110	<b>3175,5</b>
30.06.2024	350	1720	<b>2070</b>

## **2 – Karta elektronike gold**

Nga auditimi i kartelave të karburantit për periudhën objekt auditimit konstatohet se me autorizim të administratorit tërhiqnin karburant punonjës të USHLG për arsye pune si dhe lëviznin me makinat e tyre personale.

Për vitin 2022 janë tërhequr 386 litra \* 134.1195 litri = 51,770 lekë.

Për vitin 2023 janë tërhequr 795.5 litra \* 134.1195 litri = 106,692 lekë.

Për vitin 2024 janë tërhequr 350 litra \* 179.00 litri = 62,651 lekë.

Por pasja e kartave elektronike gold pa targë mjete si dhe pa përdoruesin e saj është në kundërshtim me *Vendimin nr.561 datë 27.06.2016, Për standardizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njësitë e qeverisjes së përgjithshme. Pika 1 citon: njësitë e qeverisjes së përgjithshme të sigurojnë që shërbimi i furnizimit me karburant për mjetet efektive të transportit të kryhet vetëm nëpërmjet kartës elektronike me të cilën mundësohen identifikimi i mjetit dhe përdoruesi i saj.*

Gjithashtu dhe autorizimet e administratorit për furnizimin me karburant të punonjësve për arsye pune është në kundërshtim me *VKM nr. 977, datë 10.12.2010, “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit” i ndryshuar, në të cilën përcaktohet mënyra e rimbursimit të shpenzimeve të transportit sipas dokumentacionit tatimor (biletës së udhëtimit) sipas tarifave përkatëse dhe distancës kilometrike të linjave të miratuara me Vendimin nr. 146, datë 26.02.1998, “Për tarifën e transportit të udhëtarëve” i ndryshuar.*

Vlera prej 1531.5 litra ose **221,113** lekë është përdorur pa efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet.

**Mbajne përgjegjësi për veprimet dhe mosveprimet e tyre:** Administratori z. A. U.

Në lidhje me konsumin e karburantit për kaldajat dhe gjeneratorët, konstatohet se USHLG përdor 6 kaldaja për ngrohje, përkatësisht tek godina e Rektoratit, Fakultetit i Gjuhëve të Huaja, Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Fakulteti Ekonomik, Biblioteka, Fakulteti Shkencave Edukimit dhe Fakulteti i shkencave Shoqërore.

Me urdhër nr, 4046 prot, datë 23.11.2021 është përcaktuar grafiku i ndezjes së kaldajave i cili është nga datë 23.11.2021 deri me datë 15.03.2022.

Me urdhër nr 3637 prot, datë 17.11.2023 është përcaktuar grafiku i ndezjes së kaldajave i cili është nga datë 20.11.2023 deri me datë 15.03.2023. trajtuar në aneksin nr. 1/6 bashkëlidhur Raporti Përfundimtar.

**Grupi i auditimit** konstatoi se për vitin akademik 2022-2023 (nga nëntori deri në mars) nuk ka një urdhër për ndezjen e kaldajave si dhe nuk është konstatuar dhe verifikuar gjendja e Karburantit në cisternat e kaldajave në fund të çdo sezoni të ngrohjes për secilën nga kaldajat e USHLG dhe nuk është pasqyruar niveli i naftës në depozitat e kaldajave.

Grupi i auditimit nuk mund të bëjë verifikimin e rregullshmërinë e kryerjes së shpenzimit për përdorimin e karburantit në kaldaja pasi pavarësisht se janë mbajtur proces verbalë me orarin e punës së kaldajës për secilin muaj, nuk ka gjurmë auditimi se sa ka qenë gjendja në cisternat e karburantit të kaldajave në çdo fillim viti ose në përfundim të sezonit.

*Veprimet në këndshmit me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar. Pika 74 dhe 122.*

**Mbajne përgjegjësi për veprimet dhe mosveprimet e tyre:** Administratori z. A. U.

**Observacion i subjektit mbi Projektin Raportin e Auditimit, vënë në dispozicion grupit të auditimit në datë 27.03.2025 me nr.1101/11 prot.**

**Pretendimi i subjektit:** Në lidhje me naftën bejme me dije se në mungesë të një automjeti tjetër

pervec automjetit te Institucionit, jemi gjetur ne situata te atilla kur me kerkese ne menyre verbale edhe te Senatit Akademik dhe te drejtuesve akademik te USH por te justifikuara me emailt perkatese te personave udhetues eshte kerkuar qe per disa aktivitete apo levizje (per arsye pune si panairi ëork&study apo procese gjyqesore ne periudhen kur gjykata eshte vendosur ne kryeqytet) te furnizohen me karburant automjete te stafit qe ka levizur.

**Qëndrimi i Grupit të Auditimit:** Referuar observacioneve të ardhura me prot 1101/14 datë 27.03.2025, nuk u sollën arsyetime apo dokumenta shtesë vërtetues për pasojë **observacioni nuk merret në konsideratë.**

### **Auditimi i projekteve me financim të huaj dhe të brendshëm.**

***Mbi auditimin e ushtruar në Universitetin e Shkodrës Luigj Gurakuqi (këtu e më poshtë USHLG) në bazë të programit të auditimit Nr.1101/1, datë 19.09.2024, (i ndryshuar) mbajtur në datë 10.01.2025 për periudhën 01.01.2022 deri në 30.06.2024.***

Në zbatim të pikës 3 të programit të auditimit Nr. 1036/2, datë 14.12.2023 “*Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve të kryera nëpërmjet bankës dhe arkës*”, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Dosjet e projekteve me financim nga AKKSHI
- Dosjet e projekteve me financim nga BE (programi “Erasmus +”) dhe donatorë të huaj
- Urdhër Shpenzimet me dokumentacionin justifikues.

Auditimi i këtij drejtimi u bazua në:

- Ligji Nr.80/2015 “*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*”.
- Ligji nr. 117/2014 datë 11.9.2014 “*Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Europian për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programin “Erasmus +”, Programi i BE-së për arsimin, trajnimin, rininë dhe sportin ...*”.
- VKM Nr. 607, datë 31.08.2016 “*Për krijimin, përbërjen, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI)*”,
- Udhëzimi i MF Nr.8, datë 17.02.2003 “*Për evidentimin, regjistrimin, përdorimin dhe raportimin e financimeve të huaja në kuadrin e projekteve dhe marrëveshjeve me donatorë dhe kreditorë të huaj*”,
- Rregullore e Brendshme e administratës së Rektoratit të USHLG, miratuar me Vendimin e Senatit Nr. 132, datë 27.04.2023.

Bazuar në Rregulloren e Brendshme të administratës së Rektoratit të USHLG, neni 30, Drejtoria e Komunikimit, Kërkimit Shkencor, Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë, ka për detyrë të mbulojë aspektet lidhur me kërkimin shkencor, projektet etj.

***Konstatim:*** Në Rregulloren aktuale, nuk parashikohet përshkrimi i proceseve të punës që duhet të kryhen nga kjo drejtori në lidhje me përgatitjen e dokumentacionit për shfaqje interesi ndaj thirrjeve për aplikim të projekteve të publikuara nga AKKSHI, menaxhimin e projekteve, si dhe administrimin e dokumentacionit në rastin e projekteve me financim nga BE. Mos përfshirja në rregullore e përshkrimit të këtyre proceseve të punës, sjell riskun e menaxhimit administrativ jo efektiv të dokumentacionit të projekteve, pasi nuk ka procedura të standardizuara për planifikim, zbatim dhe monitorim.

Ligji Nr. 80/2015 “*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar, Neni 12, përcakton se Agjencia Kombëtare e Kërkimit

Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI) si institucion publik në varësi të ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe shkencën, ka për detyrë kryesore shpërndarjen e fondeve për programet e kërkimit shkencor, mbi bazën e projekteve të paraqitura prej institucioneve të arsimit të lartë. AKKSHI identifikon fushat prioritare të kërkimit shkencor, teknologjisë dhe inovacionit, si dhe vlerësojnë nivel kombëtar programet e projektet në fushat e shkencave natyrore, inxhinierike dhe teknologjike, mjekësore, bujqësore, sociale dhe humane.

Në zbatim të këtij detyrimi ligjor për periudhën objekt auditimi janë shpallur thirrje për aplikim dhe janë financuar nga AKKSHI 6 projekte për USHLG, ndërsa me fondet e BE janë financuar 14 projekte. (të listuara në tabelë ankes 5)

## **I-Auditimi i projekteve me financim nga AKKSHI**

Auditimi i këtyre projekteve u krye mbi bazë risku duke marrë si kampion për auditim dosjet e projekteve me vlerë financimi më të lartë trajtuar si më poshtë:

### **1.Projekti “Vlerësimi i ndikimeve të ndërsjellta ndërmjet ndryshimeve klimaterike dhe ndotjes së ajrit mbi territorin e Shqipërisë”.**

Me vendimin Nr.1, datë 21.07.2021 të AKKSHI-it, Bordi i Administrimit ka miratuar për USHLG, në kuadër të Programit Kombëtar të Kërkimit dhe Zhvillimit (PKKZH) projektin “Vlerësimi i ndikimeve të ndërsjellta ndërmjet ndryshimeve klimaterike dhe ndotjes së ajrit mbi territorin e Shqipërisë”, në vlerën 1,830,899 lekë, për të cilin është lidhur Kontrata Nr. 818/1 datë 13.10.2021, me kohëzgjatje 24 muaj nga nënshkrimi i saj. Ministria e Financave dhe Ekonomisë me shkresën Nr. 180571/1, datë 27.10.2021 ka dërguar detajimin e grantit për vitin 2021, në vlerën 1,830,899 lekë.

Pas përfundimit të çdo aktiviteti sipas kalendarit të aktiviteteve të miratuar në Formularin e Projekt Propozimit, bazuar në relacionin e bërë nga drejtuesi i projektit është likujduar grupi i punës së projektit.

**Konstatim: 1.1** Sipas Relacionit datë 24.03.2023 nga Drejtuesi i Projektit, në lidhje me likuidimin e stafit për periudhën Janar-Mars 2023, është përfshirë si staf i projektit z. A.U., në cilësinë e Administratorit të USHLG i cili nuk ka qënë i përfshirë në Projekt propozimin e miratuar më parë, duke u paguar në vlerën 5,182 lekë si dhe për periudhën Prill-Gusht 2023, është në vlerën 10,364 lekë, në total 15,546 lekë. Në dosje nuk ka asnjë miratim nga AKKSHI për ndryshimin e stafit të projektit, në kundërshtim me nenin 12, pika 4 të Kontratës Nr. 818/1 datë 13.10.2021 ku është përcaktuar në mënyrë eksplicite se “Në rast të ndryshimit të drejtuesit ose i pjesës më të madhe të ekipit kryesor të projektit, përfituesi njofton me shkrim AKKSHI, ku argumenton ndryshimin dhe përcjell edhe të dhënat e personit/personave zëvendësues. Ndryshimi ndodh vetëm me miratimin nga AKKSHI.”

Vlera prej **15,546** lekë përbën shpenzim jo efektiv për buxhetin.

**1.2.** Rezulton se, shumata e mbetur pa u shpenzuar nga financimi i projektit nuk është kthyer pas përfundimit të tij, jo në përputhje me nenin 5, pika 3 të Kontratës, e cila parashikon që “Përfituesi i grantit të financimit të projektit ka detyrimin që t’i kthejë të gjitha fondet e pa shpenzuara brenda 15 ditësh pas përfundimit të projektit...”. Me shkresën Nr.3750, datë 30.11.2023 të Rektorit të USHLG është dërguar te AKKSHI raporti përfundimtar i projektit. AKKSHI me shkresën Nr.520, datë 27.03.2024 ka dërguar konstatimet në lidhje me monitorimin e projektit si dhe ka dhënë rekomandimet përkatëse. USHLG me shkresën nr. 520 prot datë 27.03.2024 ka kthyer përgjigje rekomandimeve të AKKSHI.

Deri në momentin e auditimit, nuk administrohet konfirmimi zyrtar i përfundimit të projektit nga AKKSHI.

Totali i shpenzimeve për projektin dhe i likuiduar rezulton në vlerën **1,737,899** lekë.

## 2. Projekti “*Shtypi në Shkodër nga fillimet e tij deri në vitin 1920, në kohë digjitale*”.

AKKSHI me datë 18 Janar 2024, ka shpallur thirrje për projekt propozim në kuadër të programit kombëtar të kërkimit shkencor për vitin 2024. USHLG i është përgjigjur kësaj thirrjeje duke paraqitur projekt propozimin “Shtypi në Shkodër nga fillimet e tij deri në vitin 1920, në kohë digjitale”, projekt afatmesëm pasi kohëzgjatja e tij është 9 deri 18 muaj. Sipas Thirrjes për projekt propozime, kap. III, pika 2, germa “b”, për projektet me kohëzgjatje deri në 18 muaj, vlera maksimale e financimit do jetë deri në 5,000,000 lekë. Buxheti në total i projektit është në vlerën 3,354,056.14 lekë dhe vlera e kërkuar nga AKKSHI është 2,649,056.14 lekë.

AKKSHI me Vendimin Nr.6, datë 12.06.2024 ka miratuar financimin e projekt propozimit nga USHLG Shkodër, në vlerën 2,541,476 lekë. Ministria e Financave me shkresën Nr.9484/1, datë 12.07.2024 ka dërguar detajimin e grantit në vlerën **2,541,476 lekë**. Me USHLG është lidhur Kontrata Nr.1006/1, datë 05.07.2024 me AKKSHI me afat deri në realizimin e të gjithë aktiviteteve të Projektit parashikuar në kalendarin e projektit pjesë integrale e kontratës. Zbatimi i kontratës është në proces.

## 3. Projekti “*Laboratori i Analizave Ushqimore*”.

AKKSHI me thirrjen Nr. 565/3, datë 18.06.2021 ka njoftuar thirrjen për aplikim të projekteve të infrastrukturës së kërkimit shkencor (PIKSH) në përgjigje të së cilës USHLG ka dërguar për miratim projekt propozimin me shkresën Nr. 2388/1, datë 30.07.2021. Vlera e kërkuar nga AKKSHI është 27,349,898.64 lekë dhe buxhetit i kërkuar nga burime të tjera parashikohet në vlerën 1,334,145.16 lekë, gjithsej në vlerën 28,684,043 lekë, kohëzgjatja e projektit parashikohet 2 muaj (tetor 2021- Dhjetor 2021) vetëm për kryerjen e procedurave të prokurimit për blerjen e pajisjeve. Me vendimin e Senatit Nr.263, datë 10.09.2021 është miratuar financimi i projektit propozimit në vlerën 1 334 145.16 lekë.

AKKSHI me Vendimin Nr. 1, datë 01.10.2021 ka miratuar financimin e projekt propozimit nga USHLG Shkodër, në vlerën 10,000,000lekë.

Me Vendimin e BA të AKKSHI nr. 3 datë 06.04.2022, është vendosur miratimi i financimit të projekteve të infrastrukturës së kërkimit shkencor, të cilat janë fituar në vitin 2021 dhe nuk kanë arritur t’i përfundojnë procedurat e prokurimit gjatë vitit 2021, në të cilën është përfshirë dhe projekti “Laboratori i Analizave Ushqimore” me vlerë 10,000,000 lekë. Me shkresën Nr.7638/1, datë 10.05.2022 nga MFE është bërë transferimi i fondeve për shpenzime kapitale për këtë vit buxhetor.

Me USHLG është lidhur Kontrata Nr.868/1, datë 11.10.2021 me AKKSHI me afat deri në realizimin e të gjithë aktiviteteve të Projektit. Kontrata përfundon me dorëzimin e raportit përfundimtar të projektit dhe pranimin e tij nga financuesi (AKKSHI) referuar nenit 3 të kontratës. Në zbatim të këtij detyrimi ligjor me shkresën Nr.2675/1, datë 17.10.2024 është përcjellë tek AKKSHI Raporti Final dhe Financiar i projektit.

***Konstatim: 3.1*** Raporti Final është përcjellë me vonesë (Tetor 2024) ndërkohë që, procedura e prokurimit për blerje pajisje për laboratorin për të cilët AKKSHI ka financuar vlerën 10,000,000 lekë, ka përfunduar në 31 Dhjetor 2022, sipas Kontratës shtesë Nr.2526/21, datë 06.12.2022 ”Blerje për Laboratorin e Analizave Ushqimore” duke u bërë dhe likuidimi i OE “I” SHPK.

Nga USHLG me e-mail datë 30.01.2023 është dërguar informacioni në lidhje me realizimin e pagesës totale dhe përdorimin e grantit në masën 100%. Gjithashtu AKKSHI me shkresën Nr.1229, datë 06.09.2024 rikujton USHLG për dorëzimin e Raportit përfundimtar.

**3.2** Në përfundim të Projektit, nuk administrohet si pjesë e dosjes relacioni përmbledhës për pranimin e projektit nga financuesi (AKKSHI) referuar nenit 3 të kontratës të lidhur.

Për realizimin e këtij projekti është kryer procedurë prokurimi, e cila është trajtuar në drejtimin e auditimit “Për prokurimet publike”.

#### **4. Projekti “Edukimi është çelësi i zhvillimit”.**

Me Urdhrin e ministrit të MAS Nr.287, datë 07.6.2023 është shpallur thirrja për financimin e projekteve në kuadër të ndërkombëtarizimit të programeve të studimit për IAL-publike, nga fondet e miratuara për vitin 2023, në programin e “Arsimit të Lartë”. Me vendimin e BA të USHLG Nr.164, datë 19.06.2023 është miratuar financimi i projektit “Edukimi është çelësi i zhvillimit”, ku totale e projektit është 22,761,031 lekë nga të cilat, vlera e kërkuar nga MAS është 15,335,199 lekë dhe financimi i ofruar nga USHLG/USHLG është 7,425,832 lekë, ku projekt propozimi është përcjellë në MAS me shkresën Nr.1973/2, datë 19.06.2023.

Konstatim: Projekt propozimi nuk ka bashkëlidhur kërkesën nga struktura përkatëse e cila ka hartuar projekt propozimin.

Me shkresën nr. 4398/1 prot datë 25.07.2023 të MFE është miratuar financimi i projektit për vitin 2023, në vlerën 15,335,199 lekë nga MAS dhe në vlerën 7,667,600 lekë nga IAL, si dhe me shkresën nr.15538/1, datë 7.8.2023 është miratuar transferimi i fondeve për shpenzime kapitale në vitin 2023 në shumën 7 667 600 lekë, si dhe për vitin 2024, në shumën 7,667,600 lekë.

Konstatim: Në dosje nuk administrohet kontrata e lidhur mes MAS-it dhe USHLG për vlerën e financuar nga ajo për projektin e shpallur fitues, në kundërshtim me VKM Nr. 607, datë 31.08.2016 “Për krijimin, përbërjen, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI)”, pika 1, germa” c” në të cilën në mënyrë eksplicite shprehet se “Drejtori i përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit është titullari i institucionit dhe përfaqëson agjencinë në marrëdhënie me të tretë. Drejtori i Përgjithshëm ka këto kompetenca: ...Nënshkruan kontratat e financimit me aplikantët fitues, në kuadër të thirrjeve të hapura që realizohen nga agjencia”.

Për realizimin e këtij projekti është kryer procedura e prokurimit e cila është trajtuar në drejtimin e auditimit “për prokurimet publike”.

#### **5. Projekti “Master Profesional në Zhvillime të Avancuara Software”.**

Projekti “Master Profesional në Zhvillime të Avancuara Softëare” është paraqitur për financim nga Sesioni i Informatikës pranë Departamentit të Matematikës (FSHN-USH) në kuadër të Urdhrit të Ministrisë të Arsimit dhe Sportit Nr 360 prot, datë 28.06.2022 me objekt “Për shpalljen e thirrjes për financimin e IAL-ve publike, për projekte të përbashkëta në kuadër të ndërkombëtarizimit të programeve të studimit për vitin akademik 2022-2023”.

Projekti u shpall fitues për këtë thirrje me një vlerë prej 6,846,000.00 lekë të financuar nga MAS dhe 614,150.00 lekë nga USH.

Nga Universiteti Politeknik i Marche-s i cili është në marrëdhënie bashkëpunimi me USHLG nuk u mundësua në kohë procedura e gjenerimit të dokumentacionit dhe lejeve të nevojshme nga Ministria e Arsimit në Itali, për njohjen e një programi të tillë, studimi, si diplomë e përbashkët, nga ana e USHLG nuk u ndërmor asnjë likuidim financiar për këtë projekt. Ndodhur në këto kushte Drejtoria e Financës dhe Buxhetit (USH) ka ndërmarrë veprimet me financuesin për kthimin në buxhetin e shtetit, të fondit të akorduar për këtë projekt.

Nga Njësia e Auditit të Brendshëm të USHLG, është ushtruar auditim në Sektorin e Kërkimit Shkencor dhe Projekteve në zbatim të Programit të angazhimit Nr. 2554/1 prot datë 29.08.2024, për periudhën nga janari 2020 deri në dhjetor 2023, me objekt “*Auditimi i menaxhimit të fondeve të akorduara nga Bashkimi Europian dhe donatorë të tjerë, përfshirë fondet IPA*”. Në zbatim të Programit u audituan projektet me financim të brendshëm: “Vlerësimi i ndikimeve të ndërsjellta ndërmjet ndryshimeve klimaterike dhe ndotjes së ajrit, mbi territorin e Shqipërisë (Mjedisi)”

“Laboratori i Analizave Ushqimore”

“Për një menaxhim dhe digjitalizim mbi baza shkencore te biodiversitetit në Qarkun e Shkodrës (Mediver)”

“Laboratori Klinik – Biokimik”

“Edukimi është çelësi i zhvillimit (Çelësi)”

Në përfundim të auditimit kjo Njësi ka dhënë rekomandimet përkatëse (3) për përmirësimin e punës së këtij sektori.

## **II-Auditimi i projekteve me fonde të akorduara nga BE.**

Në kuadër të Ligjit 117/2014 datë 11.9.2014 “*Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Europian për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programin “Erasmus +”, Programi i BE-së për arsimin, trajnimin, rininë dhe sportin*”, nga BE janë akorduar fonde për 14 projekte të cilat kanë filluar në periudhën nën auditim ose që janë në proces zbatimi për veprime financiare në këtë periudhë.

Nga auditimi i projekteve “*Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi" Entrepreneurial skills for a Modern Education in Albania, EntrAL; 617886-EPP-1-2020-1-FIEPPKA2-CBHE-SP*” me vlerë financimi 59,525,00 Euro dhe “*Improving REsearch capacities of Albanian higher education institutions in conservation and restoration of Cultural Heritage 610390-EPP-1-2019-1-ALEPPKA2-CBHE-SP – REACH*” me vlerë financimi 116,340,00 Euro rezultoi:

Projektet e sipërme pjesë e Programit Erasmus+Capacity Building, me financim nga EACEA, pas nënshkrimit të “partnership agreement”, janë dërguar kërkesat për hapjen e llogarive speciale pranë BSH-së. Pas konfirmimit nga Banka e Shqipërisë, janë dërguar kërkesat nga USH si institucion zbatues, për hapjen e llogarive speciale në Bankën e Nivelit të Dytë (*konkretisht BKT*). Me hapjen e llogarive respektive, USHLG ka kërkuar nga “Lead partner” (*përgjegjës për monitorim/zbatim dhe raportim në EACEA*) të bëjë transfertat përkatëse bazuar në “partnership agreement” tek llogaria e BSH-së për projektin. Pas marrjes së njoftimit nga BSH për mbërritjen e fondit, Universiteti ka dërguar kërkesë për transferimin e fondit nga llogaria e BSH-së për projektet tek llogaria e BKT-së.

Për çdo shpenzim që kryhet në kuadër të projektit, raportohet tek Lead Partner i cili monitoron ecurinë e projektit. Lead partner është përgjegjës për grumbullimin e gjithë materialeve dhe raportimin që i dërgohen për kontroll EACEA.

Ne fund të çdo projekti kryhet një auditim nga EACEA për projektin duke dhënë vlerësimin përkatës si në aspektin financiar ashtu edhe objektivat e projektit.

Pagesat e kryera janë raportuar në Ministrinë e Financave dhe MAS, brënda datës 5 të çdo muaji sipas Udhëzimit Nr.8, datë 17.02.2003 “*Për evidentimin, regjistrimin, përdorimin dhe raportimin e financimeve të huaja në kuadrin e projekteve dhe marrëveshjeve me donatorë dhe kreditorë të huaj*”, për projektet respektive që USH mbulon.

Gjatë auditimit të dokumentacionit rezultoi të janë ngritur grupet e punës që do të angazhohen për zbatimin e projektit.

Në urdhërat përkatës janë specifikuar ditët e punës si dhe kategoritë përkatëse të profilit të secilit prej anëtarëve, me qëllim rakordimin me buxhetin.

Lidhur me zbatimin e projekteve në përputhje me marrëveshjen, Drejtoria Ekonomike në bazë të dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Sektori i Projekteve me financim të huaj, ka bërë regjistrimin e ditarit të bankës dhe raportimin e zbatimit të tyre në MF, sipas formatit të raportimit në Udhëzimin nr.8, datë 17.02.2003.

Për projektin “*Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi" Entrepreneurial skills for a Modern Education in Albania, EntrAL; 617886-EPP-1-2020-1-FIEPPKA2-CBHE-SP*”, ftesa për pjesëmarrje në aplikimin për projektin është bërë me datë 11.12.2019 konfirmuar nga Rektori me nënshkrimin e “Mandatit”(për përfshirjen në projekt) dhe aplikimi është bërë në Shkurt 2020”.

Projekti ka filluar zbatimin me nënshkrimin e Grant Agreement me datë 26.11.2020 mes Lead Partner dhe EACEA dhe periudha e zbatimit të projektit bazuar në Grant agreement është 15.01.2021 – 14.01.2024. Partnership agreement mes USH-se dhe Lead Partner është firmosur me date 16.12.2020. Në mbarim të projektit, pas raportimit nga Lead partner është bërë auditimi nga përgjegjësi i grupit të auditimit për vlerësimin e këtij projekti. Rezultati i auditimit është njoftuar me e-mail me date 06.06.2024 (Final report 617886-EPP-1-2020-1-FI-EPPKA2-CBHE-SP) i cili ka qënë pozitiv nga auditimi.

Për Projektin “*Improving REsearch capacities of Albanian higher education institutions in conservation and restoration of Cultural Heritage 610390-EPP-1-2019-1-ALEPPKA2-CBHE-SP – REACH*” i cili ka përfunduar me datë 14.01.2024, auditimi nga EACEA është në proces.

#### **Sa më sipër arrihet në konkluzion:**

*Nga auditimi i projekteve me financim nga AKKSHI, rezultoi se:*

-Rregullore e Brendshme e administratës së Rektoratit të USHLG, miratuar me Vendimin e Senatit Nr. 132, datë 27.04.2023 nuk ka parashikuar përshkrimin e proceseve të punës që duhet të kryej Drejtoria e Komunikimit, Kërkimit Shkencor, Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë në lidhje me përgatitjen e dokumentacionit për shfaqje interesi ndaj thirrjeve për aplikim të projekteve të publikuara nga AKKSHI, e cila sjell riskun e menaxhimit administrativ jo efektiv të dokumentacionit të projekteve.

-Në 1 rast në dosjen e projektit nuk ka asnjë miratim nga AKKSHI për ndryshimin e stafit të projektit, në kundërshtim me nenin 12, pika 4 të Kontratës Nr. 818/1 datë 13.10.2021.

-Në 1 rast, shuma e mbetur pa u shpenzuar nga financimi i projektit nuk është kthyer pas përfundimit të tij, jo në përputhje me nenin 5, pika 3 të Kontratës.

-Në 1 rast, Raporti Final është përcjellë me vonesë (Tetor 2024) ndërkohë që, procedura e prokurimit për blerje pajisje për laboratorin për të cilët AKKSHI ka financuar vlerën 10,000,000 lekë, ka përfunduar në 31 Dhjetor 2022, sipas Kontratës shtesë Nr.2526/21, datë 06.12.2022 “*Blerje për Laboratorin e Analizave Ushqimore*” duke u bërë dhe likuidimi i OE.

-Në dosjet e audituara ku projektet rezultojnë të përfunduara, nuk administrohet si pjesë e dosjes relacioni përmbledhës për pranimin e projektit nga financuesi (AKKSHI) referuar nenit 3 të kontratës të lidhur.

- Në 1 rast, në dosje nuk administrohet kontrata e lidhur mes MAS-it dhe USHLG për vlerën e financuar nga, në kundërshtim me VKM Nr. 607, datë 31.08.2016 “*Për krijimin, përbërjen, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI)*”, pika 1, germa”c”.

*Për sa sipër në dijëni dhe kompetencë të z. V. P, në cilësinë e P/Sektorit për projektet me financim të brendshëm në Drejtoria e Komunikimit, Kërkimit Shkencor, Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtëm z. E. Ç, në cilësinë e P/Sektorit për projektet me financim të huaj.*

## **2.4 AUDITIM I LLOGARIVE VJETORE.**

Në zbatim të programit të auditimit u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- 1- Formati 1 - Pasqyra e pozicionit financiar për vitin 2023;
- 2- Formati 2 - Pasqyra e performancës financiare, ose pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin 2023;
- 3- Formati 3- Pasqyra e flukseve monetare për vitin 2023;
- 4- Formati 4- Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/ fondet neto për vitin 2023;
- 5- Formati 5- Shënimet shpjeguese për hartimin dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore për vitin 2023;
- 6- Formati 6- Pasqyra e investimeve dhe burimeve të financimit të tyre për vitin 2023;
- 7- Formati 7- Pasqyra mbi gjendjen dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me koston historike dhe me vlerën neto për vitin 2023;
- 8- Formati 8- Pasqyra e numrit të punonjësve dhe fondi i pagave për vitin 2023.

### **a. Mbi organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit.**

Struktura e llogarive është hartuar mbi bazën e Udhëzimit të MF me nr. 8, datë 09.03.2018 “*Për Proçedurat në përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*”, i ndryshuar me Udhëzimin e MF nr.5, datë 21.02.2022 “*Për disa ndryshime në Udhëzimin nr.8, datë 09.03.2018.*”

Auditimi në drejtim të mbajtjes së kontabilitetit dhe hartimit të pasqyrave financiare u përqendrua në vlerësimin e saktësisë dhe përputhshmërisë ligjore të veprimeve ekonomiko-financiare dhe të dokumentimit të transaksioneve financiare të realizuara gjatë periudhës objekt auditimi, si dhe në lidhje me zbatimin e parimeve të përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit. Dokumentet justifikuese për kryerjen e veprimeve ekonomike, janë plotësuar konform dispozitave ligjore në fuqi, përjashtuar disa mangësi të trajtuara në vijimësi.

Auditimi u krye në lidhje me dy drejtimet e mëposhtme: mbi afatin ligjor të përcaktuar për përgatitjen e pasqyrave financiare dhe në vlerësimin e rregullshmërisë dhe saktësisë së llogarive dhe të pozicioneve të bilancit për çdo vit, si dhe kryerjen dhe dokumentimin e veprimeve në ditarin e përgjithshëm (ku janë regjistruar dhe veprimet e bankës), konform udhëzimeve të Ministrisë së Financave.

Për çdo vit të veçantë të periudhës objekt auditimi, në zbatim të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*” i ndryshuar, dhe kërkesave të Udhëzimit të MF me nr. 8, datë 09.03.2018 “*Për Proçedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*” i ndryshuar, me Udhëzimin e MF me nr. 5, datë 21.02.2022, pasqyrat financiare janë përpiluar dhe dërguar në afat për miratim në Degën e Thesarit Shkodër.

Konstatohet se, veprimet kontabël janë azhornuar periodikisht, janë kontabilizuar në ditarët, ku llogaritë në përgjithësi janë në pozicionin e duhur dhe në përputhje me kërkesat e dispozitave në fuqi. Llogaritë vjetore, si dhe pasqyrat financiare janë të shoqëruara me situacionin e shpenzimeve të programit dhe ato të realizuara nga Universiteti i Shkodrës, situacione këto të rakorduara me degën e Thesarit.

PF është shoqëruar me relacionin shpjegues, sipas udhëzimit të miratuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MF), me situacionin përfundimtar të shpenzimeve si dhe llogaridhënien vjetore.

Në bazë të të dhënave kontabël përkatëse janë përpiluar Pasqyrat Financiare vjetore mbi llogaritë e vitit ushtrimor që janë raportuar.

- Për vitin 2023 janë dorëzuar Pasqyrat Financiare të Universitetit të Shkodrës pranë Degës së Thesarit Shkodër, Ministrisë Arsimit dhe Sportit, Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar Tiranë me shkresën nr. 1108/8 Prot., datë 06.09.2024 “Dërgohen listat e llogarive vjetore për vitin 2023”.

Nga ana e grupit të auditimit u konstatua se Pasqyrat Financiare të Universitetit të Shkodrës pranë Degës së Thesarit Shkodër, Ministrisë Arsimit dhe Sportit, Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar Tiranë me shkresën nr. 1108/8 Prot., datë 06.09.2024 “Dërgohen listat e llogarive vjetore për vitin 2023” ne tejkalim të afatit të përcaktuar. Veprimet e mësipërme nuk janë kryer në përputhje me Udhëzimin e MF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Proçedurat në përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar.

Gjithashtu, situacionet progresive vjetore janë rakorduar dhe kundër-firmuar rregullisht nga përfaqësuesi i Degës së Thesarit. Realizimi i buxhetit i është raportuar rregullisht Degës së Thesarit.

**b. Vlerësimi nëse aktivi dhe pasivi janë llogaritur saktë dhe në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse, si edhe rakordimi me pasqyrat e tjera financiare.**

### **Pasqyrat Financiare viti 2023**

Paraqitja dhe raportimi i tyre është kryer në përputhje me Udhëzimin nr. 8, datë 03.09.2018, Kapitulli V “Proçedurat e paraqitjes dhe raportimit të Pasqyrave Financiare vjetore”, i ndryshuar.

**Nga auditimi i pasqyrave financiare individuale të Rektoratit konstatohet se:**

#### **1. Pasqyra e pozicionit financiar (F1)**

Nga auditimi i pasqyrës së pozicionit financiar tre pjesët përbërëse të saj paraqiten si më poshtë:

a- Të drejtat (Aktivet)	1,469,882 mijë lekë
b- Detyrimet (Pasivet)	48,699 mijë lekë
c- Fondet Neto (Aktivet neto)	1,421,636 mijë lekë

**Aktivet neto plotësojnë rregullin Aktive – Pasive = Aktivet Neto (1,421,636 mijë lekë).**

#### **1.1. Të Drejtat (Aktivet)**

Aktivet më datë 31.12.2023 paraqiten në vlerën **1,469,882,311 lekë** ndërsa në datën 31.12.2022 paraqiten në vlerën **1,553,007,158 lekë** dhe përbëhen nga:

*Në lekë*

Emërtimi	Ushtrimi i mbyllur 2023	Ushtrimi i mbyllur 2022	Pesha % per 2023	Pesha % per 2022	Ndryshimi
I. Aktivet Afatshkurtra	623,779,144.75	664,092,847.04	42%	43%	(40,313,702.29)
II. Aktivet Afatgjata	846,103,166.50	888,914,311.72	58%	57%	(42,811,145.22)
<b>Totali</b>	<b>1,469,882,311.25</b>	<b>1,553,007,158.76</b>	<b>1.00</b>	<b>1.00</b>	<b>(83,124,847.51)</b>

*Burimi: Pasqyra Financiare Universiteti i Shkodrës/Përpunuar nga Grupi i Auditimit*

Nga auditimi u konstatua se në vitin 2022 Aktivet e afatshkurtra kanë zënë 43% të totalit të Drejtave në vlerë 664,092 mijë lekë ndërsa Aktivet afatgjata kanë zënë 57% të totalit në vlerë 888,914 mijë lekë.

Gjatë vitit 2023 ky raport ka ndryshuar me trend zbritës dhe më konkretisht aktivet e afatshkurtra kanë zënë 42% të totalit të aktiveve në vlerë 623,779 (mijë lekë) ndërsa aktivet afatgjata kanë zënë 58% të totalit të aktiveve në vlerë 846,103 (mijë lekë).

Konkretisht ndryshimi në aktivet e afatshkurtra mes dy viteve është në rënie në vlerën (40,313) mijë lekë si rezultat i rënies së mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, ndryshimit të gjendjes së inventarit dhe të drejtave nga operacionet me shtetin. Ndërsa për aktivet afatgjata gjatë vitit ndryshimi në vlerë është në rënie në vlerën (42,811) mijë lekë i cili ka ardhur kryesisht nga amortizimi i aseteve.

#### 1.1.a Aktivet afatshkurtra (qarkulluese)

Ne kuptim të UMF nr 5 dt. 21.02.2022 aktivet qarkulluese përkufizohen si tërësia e aktiveve që i shërbejnë funksionimit të njësisë të qeverisjes së përgjithshme, për një kohë relativisht të shkurtër, kryesisht për një vit ushtrimor. Këto aktive, për shkak të destinacionit të tyre dhe për shkak të natyrës së tyre, nuk kanë prirjen që të qëndrojnë gjatë në formën që kanë.

AASH paraqiten në vlerën 623,779,145 lekë dhe përbëhen nga shumatat e rubrikave që përfaqësojnë:

- Llogaritë e Klasës 5 “Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre” në shumën 557,363,442 lekë;
- Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues” në shumën 18,543,142 lekë;
- Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” në shumën 47,872,562 lekë.

#### **Klasa 5 “Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre”, përbëhet nga:**

Gjendja e llogarisë nr.512 “Mjete monetare në bankë” dhe gjendja e llogarisë nr.520 “Disponibilitete në Thesar”, në total sipas pasqyrës së pozicionit financiar F1 të vitit 2023 në mbyllje paraqitet në shumën prej 557,363,442 lekë, e cila rakordon me rubrikën V “Teprica në fillim të vitit ushtrimor” dhe rubrikën VI “Teprica e Likuiditeteve në fund të vitit ushtrimor” në shumën 557,363,442 lekë të formatit F3 “Pasqyra e flukseve monetare”

Gjendja e llogarisë nr.512 “Mjete monetare në bankë” në datën e mbylljes së pasqyrave sipas viteve respektive pasqyrohen në vlerat 19,132,280 lekë dhe 10,798,043 lekë të cilat përmbledhin tepricat e projekteve në proces aneksi 1 tabela 1. Teprica e llogarisë 512 e raportuar në datën e mbylljes së pasqyrave financiare është e rakorduar me lëvizjen e llogarisë analitike të bankës së nivelit të dytë.

*Llogaria nr.520 “Disponibilitete në Thesar”, në pasqyrat financiare të vitit 2023 paraqitet në vlerën prej 538,231,162 lekë ndërsa në teprica pasqyrat financiare të vitit 2022 paraqitet në vlerën prej 597,960,1119 lekë. Këto teprica në mbyllje të periudhave përfaqësojnë gjendjet aneksi 1 tabela 2:*

Nga auditimi i kësaj llogarie konstatohet se gjendja në datën e mbylljes së pasqyrave financiare duhet të ishte 539,058,275 leke dhe jo 538,233,185 lekë, pra kemi një diferencë prej 827,113 lekë midis gjendjes së raportuar në datën 31 dhjetor 2023 dhe përlllogaritjeve analitike mes granteve dhe të ardhurave dytësore të trashëguara nga viti 2022 shtuar me grantin buxhetor dhe të ardhurat dytësore të vitit 2023 pakësuar me shpenzimet e periudhës shtuar me tepricën e mjeteve në ruajtje. Gjithashtu mungon akt-rakordimi me thesarin lidhur me llogarinë 520 “Disponibilitete në thesar” në kundërshtin me Udhëzimin të MF me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Proçedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar pika 50. Pika 50 e udhëzimit thekson se: “Tepricat e llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar” dhe llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” duhet të vërtetohen me akt rakordimin me thesarin, një kopje e të cilit i bashkëlidhet llogarisë vjetore. Në akt rakordim tepricat duhet të paraqiten të strukturuar sipas natyrës së të ardhurave të trashëguara (të ardhurat e papërdorura, si të çelura ashtu edhe ato të pa çelura, mjetet në ruajtje, sponsorizimet dhe pjesën e grandit që trashëgohet).

**Observacion i subjektit mbi Projekt Raportin e Auditimit, vënë në dispozicion grupit të auditimit në datë 27.03.2025 me nr.1101/11 prot.**

**Pretendimi i subjektit:** Diferenca prej 827,113 lekë vjen nga Mjetet në ruajtje teprica e të cilave verifikohet në vecanti nga Dega e thesarit Shkodër. Pasqyrat janë aprovuar pasi balanca e mjeteve në ruajtje është sjellë në vleren e dorezuar. Do të verifikohet dhe do të sistemohet.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Përsa i përket observimeve të paraqitura lidhur me diferencën e konstatuar, sic është cituar më sipër janë në kundërshtim me udhëzimin e MF nr. 8 datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”.

**Përsa më sipër observacioni juaj nuk merret në konsideratë.**

**Klasa 3 “Gjendje inventari qarkullues”, përbëhet nga:**

*Në lekë*

Referenca e llogarive	Emërtimi	Ushtrimi i mbyllur 2023	Ushtrimi i mbyllur 2022
	<b>2.Gjendje inventari qarkullues</b>	18,543,142	16,729,119
31	Materiale	8,767,151	6,953,128
32	Inventar i imët	9,775,991	9,775,991

*Burimi: Pasqyra Financiare Universiteti i Shkodrës/Përpunuar nga Grupi i Auditimit*

Llogaritë e Klasës 3, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar në 31.12.2023 pasqyrohet në shumën 18,543,142 lekë dhe përbëhet nga llogaria kontabël 31 “Materiale” në vlerën 8,767,151 lekë dhe llogaria 32 “Inventar i imët” në vlerën 9,775,991 lekë.

Diferenca me vitin e mëparshëm përfaqëson lëvizjen e inventarit në shumën 1,814,022 lekë e cila kuadron me llogarinë 63 “Ndryshimi gjendjes së inventarit” në shumën 1,814,022 lekë.

Nga auditimi i kësaj llogarie konstatohet se për vitin 2023 dhe 2022 është kryer procesi i inventarizimi të aktiveve të kësaj klase sipas Udhëzimit Nr. 30 datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”

Llogaritë e klasës 3 kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llog. 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit” dhe duke u kredituar për daljet e inventarit në debi të llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit”.

**Llogaritë Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme”&“Të tjera aktive afatshkurtra” përbëhet nga:**

*Në lekë*

Referenca e llogarive	Emërtimi	Ushtrimi i mbyllur 2023	Ushtrimi i mbyllur 2022
	<b>3.Llogari të arkëtueshme</b>	<b>47,872,562</b>	<b>38,605,567</b>
4342	Operacione me shtetin (të drejta)	47,872,562	38,605,567

*Burimi: Pasqyra Financiare Universiteti i Shkodrës/Përpunuar nga Grupi i Auditimit*

- Llogaria 4342 “Operacione me shtetin(Të drejta)” në shumën 47,872,562 lekë përfaqëson detyrimet për pagat, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, detyrimet e TAP si dhe detyrime të tjera të muajit dhjetor 2023. Kjo llogari ka si kundërparti llogaritë e pasivit 401,421, 431, 435, 436, 437 dhe 467. Llogaria analitike 4342 “Operacione me shtetin (Të drejta)” paraqitet si më poshtë:

*Në lekë*

Referenca e llogarive	Emërtimi	Ushtrimi i mbyllur 2023	Ushtrimi i mbyllur 2022
42	Detyrime ndaj personelit	32,214,485	30,224,031
431	Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa	4,185,293	3,195,266
435	Sigurime Shoqërore	10,068,516	4,617,670
436	Sigurime Shëndetësore	1,404,268	568,600
	Totali	47,872,562	38,605,567

Burimi: Pasqyra Financiare Universiteti i Shkodrës/Përpunuar nga Grupi i Auditimit

- Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm” përfaqëson detyrimet qe kane te tretet ndaj universitetit e cila per periudhën e auditimit është mbyllur me teprice zero. Nga të dhënat e platformës së sekretarisë online "Pitagora" të administruara nga grupi i auditimit në format elektronik **konstatohen** se janë 614 studente debitorë të regjistruar në Universitetin e Shkodrës me vlere totale 14,386,000 leke. Në librat e kontabilitetit të Universitetit këto të dhëna nuk janë të konstatuara apo të kontabilizuara në zbatim te Udhëzimit të MF me nr. 5, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e Ministrit të Financave nr 8, datë 09/03/2028 “Për Procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 3 “Ndërkohë, në lidhje me njohjen e të ardhurave në librat e tyre të brendshëm kontabel, të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme, gjatë raportimit të tyre financiar do të përdorin metodën mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, në kuadër të rritjes së transparences dhe besueshmërisë së informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare”. Nga këta studente të cilët janë debitor, 167 studente janë me status “Diplomuar” që në vlerë kapin shifrën 4,330,000 leke, te cilat nuk janë arkëtuar nga ana e universitetit.

**Observacion i subjektit mbi Projekt Raportin e Auditimit, vënë në dispozicion grupit të auditimit në datë 27.03.2025 me nr.1101/11 prot.**

**Pretendimi i subjektit:** Në lidhje me studentet debitore nga verifikimet e deritanishme, në mungesë edhe të një liste me emrat që figurojnë si të tillë, rezulton që për ata me status të diplomuar, dalin të tillë si rezultat i një problemi të sistemit Pitagora. Verifikimet do të vazhdojnë intensivisht deri në finalizimin e shlyerjes së detyrimeve nëse rezultojnë

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Përsa i përket observimeve të paraqitura lidhur me të drejtat e konstatuara, sic është cituar më sipër janë në kundërshtim me udhëzimin e MF nr. 8 datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar.

**Përsa më sipër observacioni juaj nuk merret në konsideratë.**

- Llogaria 486 “Shpenzime te periudhave te ardhshme” përfaqëson detyrimet qe institucioni ka ndaj të tretëve e cila per periudhën e auditimit është mbyllur me teprice zero.

1.1.b Aktivët Afatgjatë

AAGJ përbehen nga aktivët afatgjatë jomateriale dhe aktivët afatgjatë materiale si dhe investime sipas tabelës së mëposhtme:

Emërtimi	Ushtrimi i mbyllur 2023	Ushtrimi i mbyllur 2022
<b>II.Aktivët Afatgjatë</b>	<b>846,103,166</b>	<b>888,914,310</b>
Aktive afatgjatë jomateriale	8,574,711	9,380,110
Aktive afatgjatë materiale	749,302,553	791,308,299

Në lekë

Burimi: Pasqyra Financiare Universiteti i Shkodrës/Përpunuar nga Grupi i Auditimit

Ato paraqiten në vlerën 846,103,166 lekë dhe përbëhen nga shumatat e rubrikave që përfaqësojnë llogaritë e grupit 202, 210, 212, 213, 214, 215 dhe 218.

Aktivitet afatgjatë jo materiale përbëhen nga Llogaria 202 “*Studime dhe kërkime*” në shumën 8,574,711 lekë

Aktivitet afatgjatë materiale përbëhen nga:

- a- Llogaria 210 “*Toka, troje, terrene*” në shumën 888,000 lekë;
- b- Llogaria 212 “*Ndërtesa e konstruksione*” në shumën 625,665,281 lekë;
- c- Llogaria 213 “*Rrugë, rrjete, vepra ujore*” në shumën 291,910 lekë;
- d- Llogaria 214 “*Instalime teknike, makineri e pajisje*” në shumën 51,727,015 lekë;
- e- Llogaria 215 “*Mjete transporti*” në shumën 1,011,574 lekë;
- f- Llogaria 218 “*Inventar ekonomik*” në shumën 69,718,773 lekë.

Investimet përbëhen nga llogaria 230 “*Për aktive afatgjatë jo materiale*” në shumën 22,254.065 lekë dhe llogaria 231 “*Për aktive afatgjatë materiale*” në shumën 65,971,837 lekë.

Llogaritë e Klasës 20 “*Aktivitet Afatgjatë Jo materiale*”, paraqitet në vlerë kontabël neto në shumën 8,574,711 lekë dhe përbëhen nga llogaria 202 “*Studime dhe kërkime*” e cila përfaqëson sipas regjistrimit analitik të mbajtur nga departamenti i financës së Universitetit, zërat sipas tabelës 3 aneksi 1 me poshtë, për transaksionet e tjera të cilat përfaqësojnë diferencën konstatohet se nuk gjendet origjina.

Në vitin 2022 në datën e mbylljes së pasqyrave vlera kontabël neto e AAJM-ve paraqitet në shumën 9,380,110 lekë e pakësuar me amortizimin vjetor. Ndërsa në vitin 2023 ndryshimi i AAJM-ve në shumën 805,399 lekë neto vjen si rezultat i shtesës me anë të blerjeve në shumën 621,589 lekë dhe pakësimeve si rezultat i amortizimit vjetor. Në vijim u verifikua pasqyrat statistikore formati nr 7/a “*Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjatë (kosto historike)*” dhe formati 7/b “*Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjatë (vlera neto)*” sipas së cilave përlllogaritjet në këto pasqyra rakordojnë me tepricat e pasqyruara në formatin nr 1 “*Pozicioni financiar*”

Nga auditimi i kësaj llogarie konstatohet se përlllogaritja e amortizimit të grupit është bërë me normë 15% si dhe me metodë amortizimit me “*Vlerë të mbetur*”. Metoda e përdorur për amortizimin e asetëve të kësaj klase është në kundërshtim me Udhëzimin të MF me nr. 8, datë 09.03.2018 “*Për Proçedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*” i ndryshuar pika 36, dhe Klasa 2 “*Aktivitet Afatgjatë*” (Përbërja dhe trajtimi kontabël). Trajtimi Kontabël për AAGJ Jomateriale (Aktivitet e patrupëzuara) pika f “*Amortizimi i tyre duhet të bëhet me metodën lineare. AAGJ jomateriale të amortizueshme nuk do të kenë vlerë të mbetur.*” Në pikën 36 në të cilën sanksionohet se “*Në lidhje me amortizimin e aktiveve afatgjatë, deri në daljen e dispozitave ligjore të veçanta për sektorin publik, amortizimi vjetor i këtyre aktiveve duhet të llogaritet sipas normave të përcaktuara në legjislacionin fiskal përkatës, si më poshtë vijon:*

- *Për aktivitet afatgjatë materiale si ndërtesat, konstruksionet, linjat teknologjike e të prodhimit, dhe makineritë e pajisjet me afat të gjatë shërbimi, duhet të zbatohet norma 5%, duke i llogaritur veçmas me vlerën e mbetur;*
- *Kompjuterat, pajisjet e ruajtjes së të dhënave, softë e sisteme informacioni të amortizohen mbi bazë grupimi me normën 25%;*
- *Për të gjitha aktivitet e tjera afatgjatë materiale duhet të zbatohet norma vjetore e amortizimit 20% mbi bazë grupimi; dhe*

- *Për aktivet afatgjata jo materiale, amortizimi të llogaritet me metodën lineare me normë amortizimi 15%.”*

Mosaplikimi i sakte i metodës për përlllogaritjen e amortizimit të kësaj klase sjell per pasoje një pasqyrim jo te drejte dhe jo të sakte të vlerës që këto aktive mbartin. Mos pasqyrimi i sakte i vlerës së tyre ndikon drejtpërsëdrejti në rezultatin e vitit ushtrimor i cili ndikon në pozicionin financiar ne datën e mbylljes se pasqyrave financiare duke ndikuar drejtpërsëdrejti ne vendimet e organeve drejtuese.

Nga analiza e kësaj llogarie konstatohet keq klasifikim në zërin “Likuidim TVSH pajisje elektronike projekti MARDS” në shumën 700,217 leke. Ky zë nuk duhet te ishte kontabilizuar ne këtë llogari por ne llogarite e klases 2 “Aktivet Afatgjata Materiale” si pjese e pajisjeve te financuara nga projekti. Kontabilizimi ne këtë llogari është në kundërshtim me Udhëzimit të MF me nr. 8, datë 09.03.2018 “*Për Proçedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*”, i ndryshuar.

Llogaritë e Klasës 21 “*Aktivet Afatgjata Materiale*”, AAM sipas të dhënave të pasqyruara për vitin ushtrimor 2023, vlera kontabël neto paraqitet në shumën 749,302,553 lekë. Në vitin paraardhës 2022, vlera kontabël neto e AAM-ve paraqitet në shumën 791,308,299 lekë, me një renie të AAM-ve në shumën 42,005,746 lekë.

Llogaritë përbërëse te AAM analizohen si më poshtë:

- Llogaria 210 “*Toka troje terrene*”, në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën neto 888,000 lekë e njëjtë me tepricën e pasqyruara në datën e mbylljes së pasqyrave financiare të vitit 2022.

Nga analizimi i asetëve të kontabilizuara në llogarinë 212 “*Ndërtesa dhe Konstruksione*” dhe raportimit që Universiteti ka bërë në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit me shkresën nr 922/1 prot dt. 13.03.2024 me lëndë “Informacion mbi pronat e Universitetit te Shkodrës Luigj Gurakuqi” jepet informacion lidhur inventarizimin dhe regjistrimin e pronave të cilat janë në përdorim nga Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”. Konstatohet se veprimtaria ushtrohet në 8 godina të cilat janë të regjistruara në llogarinë 212 “*Ndërtesa dhe Konstruksione*”. Gjithashtu në shkresën e dërguar ne Ministrinë e Arsimit dhe Sportit nga Universiteti jepet informacion lidhur me detajet e pronave në të cilat pozicionohen godinat ku ushtrohet veprimtaria e universitetit, ku përveç ndërtesave jepet informacion edhe për token “Truall” sipas zonave kadastrale.

Nga përlllogaritjet e grupit të auditimit mbi sipërfaqen e tokës truall ku Universiteti ushtron aktivitetin, sipas shkresës nr 922/1 prot dt. 13.03.2024 rezulton një sipërfaqe toke truall prej 13,536.64 metër katror. Vlera e tokës truall sipas shkresës së mësipërme në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 89, datë 3.2.2016 “Për Miratimin e Hartës së Vlerës së Tokës në Republikën e Shqipërisë rezulton në vlerën 120,992,154.24 lekë, nga e cila vetëm 888,000 lekë është e kontabilizuar në llogaritë kontabël të pasqyrave financiare të Universitetit.

Konstatohet se diferenca prej 120,104,154,24 lekë nuk është pasqyruar dhe kontabilizuar në llogaritë kontabël të pasqyrave financiare të Universitetit duke sjelle një paraqitje jo te drejte dhe te sakte te pozicionit financiar ne datën e mbylljes se pasqyrave financiare per vitin 2022 dhe 2023. Veprimi i mësipërm është në kundërshtim me Udhëzimin të MF me nr. 8, datë 09.03.2018 “*Për Proçedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*” i ndryshuar, “Parimet e kontabilitetit ne sektorin publik” pika 5 “*Pasqyrat financiare sigurojnë transparencën përmes të dhënave të plota dhe paraqesin, me vërtetësi, të dhënat e nevojshme për vendimmarrje. Ato përgatiten bazuar në një kontabilitet ushtrimor dhe në vijueshmërinë e veprimtarisë së njësisë së qeverisjes së përgjithshme, për një të ardhme të parashikueshme...*”

**Observacion i subjektit mbi Projektin Raportin e Auditimit, vënë në dispozicion grupit të auditimit në datë 27.03.2025 me nr.1101/11 prot.**

**Pretendimi i subjektit:** Trojet nuk janë regjistruar në bilanc pasi akoma nuk janë në posedim të Universitetit me VKM.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Përsa i përket observimeve të paraqitura lidhur me moskontabilizimin e tokës truall nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore në fuqi mbi përfshirjen e vlerës së plotë të aseteve në pasqyrat financiare, pasi në llogarinë 212 për një objekt është kontabilizuar vlera e truallit, duhet të ishte kontabilizuar vlera e tokës në administrim të Universitetit, sic është cituar më sipër janë në kundërshtim me udhëzimin e MF nr. 8 datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar.

**Përsa më sipër observacioni juaj nuk merret në konsideratë.**

- Llogaria 212 “Ndërtesa dhe Konstruksione”, në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën neto 625,665,281 lekë dhe në fund të vitit ushtrimor 2022 paraqitet në vlerën prej 658,595,033 lekë. Metoda e llogaritjes së amortizimit është me “Vlerë të mbetur”. Norma e amortizimit e përdorur për të llogaritur amortizimin është 5%. Amortizimi në vlerë konstatohet në shumën 32,929,752 lekë ose 5% mbi vlerën kontabël neto në çelje të vitit ushtrimor.

Nga analiza e llogarisë 212 “Ndërtesa dhe Konstruksione” konstatohet se ajo përbëhet nga disa ndërtesa të ndryshme në të cilat ushtrinë aktivitetin e tyre disa fakultete dhe ndryshimi mes dy viteve në vlerë ka ardhur si rezultat i amortizimit vjetor. Konstatohet se vlera totale e këtyre aseteve në regjistrin analitik të kësaj llogarie nuk rakordon me tepicën e pasqyruar në datën e mbylljes së pasqyrave financiare për vitet 2022 dhe 2023, kjo diferencë është 10,395,397 lekë tabela 4 aneksi 1. Gjithashtu konstatohen se në këtë llogari ka të kontabilizuar artikuj të cilët i përkasin llogarisë 218 veprime në kundërshtim me Udhëzimin të MF me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

-Llogaria 213 “Rruge, rrjete, vepra ujore”, pasqyrohet me vlerën neto 291,970 lekë e cila ka ardhur në rënie në vlerën 291,910 lekë nga viti 2022 si rezultat i amortizimit vjetor

-Llogaria 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune”, pasqyrohet me vlerën neto 52,727,015 lekë dhe përfaqëson pajisje të ndryshme. Në vitin paraardhës 2022, vlera kontabël neto e AAM-ve pasqyrohet në shumën 43,533,147 lekë e cila ka ardhur me një shtim të tyre në shumën neto prej 8,193,868 lekë gjatë vitit 2023. Shtesa është rezultat i blerjeve gjatë vitit 2023 në shumën 17,628,678 lekë dhe pakësimeve si rezultat i amortizimit vjetor në shumën 8,706,629 lekë.

Nga auditimi i llogarisë analitike dhe regjistrit të aseteve që i përkasin kësaj llogarie u konstatua se amortizimi është përlllogaritur me normën 20% për vlerën totale të kësaj llogarie dhe jo për secilin artikull me vete. Gjithashtu konstatohen artikuj që nuk i përkasin këtij grupi të cilët duhet të ishin kontabilizuar në llogarinë 218 veprime në kundërshtim me Udhëzimit të MF me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar

-Llogaria 215 “Mjete transporti” pasqyrohet me vlerën neto 1,011,574 lekë dhe përfaqëson mjetet e transportit në pronësi dhe funksion të institucionit. Institucioni posedon 3 automjete. Në vitin paraardhës 2022, vlera kontabël neto e AAM-ve pasqyrohet në shumën 1,264,467 lekë, me një pakësim në shumën 252,893 lekë vlerë e amortizuar gjatë vitit. Nga auditimi i llogarisë analitike u konstatua se amortizimi është përlllogaritur me normën 20% ndërsa totali i llogarisë nuk rakordon me vlerën e kësaj llogarie e pasqyruar në datën e mbylljes së pasqyrave financiare të vitit 2023 veprim në kundërshtim me Udhëzimit të MF me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Procedurat e

*përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*”, i ndryshuar.

-Llogaria 218 “*Inventar ekonomik*” paraqitet me vlerën neto 69,718,773 lekë. Ky zë ka pësuar ndryshime gjatë vitit në vlerën absolute 16,943,992 lekë në renie nga viti 2022. Gjatë vitit 2023 ka pasur shtesa në asete në vlerë 388,561 lekë. Shtesat në asete për këtë llogari janë rezultat i blerjeve. Kjo llogari është pakësuar në vlerën 17,332,553 lekë e cila përfaqësojnë efektin e amortizimit vjetor.

Nga auditimi i llogarisë analitike 218 u konstatua se një pjesë e këtyre asetëve të kontabilizuara në këtë llogari duhet të ishin kontabilizuar në llogarinë 214 “*Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune*”. Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me udhëzimin e MF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Proçedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar

-Llogaria 230 “Për aktive afatgjata jo materiale” pasqyrohet në vlerën 22,254,065 lekë dhe përfaqëson investime në proces tabela 5 aneksi 1:

Nga auditimi i kësaj llogarie konstatohen se janë kontabilizuar investime të cilat kanë mbetur në proces në periudha të hershme të cilat datojnë që nga viti 2011 dhe për të cilat institucioni nuk ka marrë asnjë masë për sistemimin e tyre sipas llogarive përkatëse. Sipas “NOMENKLATURA E LLOGARIVE TE PLANIT KONTABEL PUBLIK” nënlllogaritë e klasës 230 përfshijnë:

- a- shpenzime dhe prime të emisionit ose rimbursimit të huave,
- b- shpenzime për studime ose kërkime,
- c- shpenzime, koncesione, patenta, licenca, marka, të drejta e tjera.

Sipas kriterëve të mësipërme “Projekt ide fasada dhe shtese godina e rektoratit” në vlerën 400,000 leke, “Leje ndërtimi godina shtesë Fakulteti Shkencave të Natyrës” në shumën 7,100,000 lekë, “Oponence teknike” në shumën 335,645 lekë, “Projektim shtesë I rikonstruksionit godina të universitetit” në shumën 8,219,520 lekë duhet të kapitalizoheshin në vlerat e objekteve respektive. Në total këto zëra kapin shifrën prej 16,055,165 lekë të cilat duhet tu bashkoheshin vlerave të objekteve respektive për të cilat do të kontabilizoheshin edhe amortizimet përkatëse sipas periudhave. Në vijim të studimit analitik të llogarisë 230 konstatohet se vlera prej 2,348,420 lekë “AKTI Pajisje” përfaqëson mjete monetare për pajisje, të disbursuara nga Agjencia Kombëtare e Teknologjisë së Informacionit (AKTI) të cilat duhet të ishin kontabilizuar në llogarinë 231 për periudhën e investimeve në proces më pas do të duhej të kontabilizoheshin në llogaritë e klasës 2 për të cilat sipas periudhave do të llogaritej dhe kontabilizoheshin edhe amortizimi përkatës.

Për transaksionet “Studim kabine elektrike”, “Studim salla e konferencave Fakulteti I Gjuhëve të Huaja” dhe “Studim projektim pmnz” të cilat kapin vlerën e 570,880 lekë subjekti ka akt-marrje në dorëzim të realizimit të këtyre punimeve të cilat do të duhej të sistemoheshin në llogaritë përkatëse kontabël. Me akt-marrjen në dorëzim të punimeve do të duhej që vlerat respektive në llogarinë 230 do të duhej që të kapitalizoheshin në llogaritë e klasës 2 së bashku me vlerat e aktiveve afatgjata materiale

Paraqitja e këtyre transaksioneve në llogarinë 230 Investime në proces “Për aktive afatgjata jo materiale” është keqklasifikim me pasoje paraqitje jo të drejta të pozicionit financiar në datën e mbylljes së pasqyrave financiare. Mosparaqitja e tyre në llogaritë e duhura kontabel sjell një pasqyrim jo të sakte të vlerave të asetëve të cilave u përkasin. Mosparaqitja e tyre në llogaritë e klasës 2 i ka përjashtuar nga trajtimi kontabel lidhur me amortizimin i cili ka si efekt kryesor uljen e vlerës së tyre. Mosmarrja në konsideratë e amortizimit ndikon drejtpërsëdrejti në rezultatin e periudhës, në përcaktimin e jetës së aktivitetit dhe në vendimmarrjen e organeve drejtuese.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me udhëzimin e MF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Proçedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e

Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar “Trajtimi kontabël dhe funksionimi i llogarive të klasës 2”.

-Llogaria 231 “Për aktive afatgjata materiale” pasqyrohet në vlerën 65,971,837 lekë dhe përfaqëson investime në proces tabela 6 aneksi 1:

Nga auditimi i kësaj llogarie konstatohen se janë kontabilizuar investime të cilat kanë mbetur në proces në periudha të hershme për të cilat institucioni nuk ka marrë asnjë masë për sistemimin e tyre sipas llogarive përkatëse.

Konkretisht konstatohen në llogarinë 231 “Për aktive afatgjata materiale” keqklasifikime transaksionesh në shumën 2,777,742 leke si “Supervizim Fakulteti Ekonomik”, “Kolaudim Fakulteti Ekonomik”, “Supervizim Fakulteti Shkencave të Natyrës”, “Supervizim Fakulteti Shkencave të Natyrës paguar në 2018”, “Mbikqyrje rikonstruksion Fakulteti Gjuhëve të Huaja” të cilat duhet të klasifikoheshin në llogarinë 230 “Për aktive afatgjata jo materiale”. Ndërsa transaksionet “Fakulteti Shkencave të Natyrës paguar në 2018”, “Rikonstruksion salla konf Fakulteti Gjuhëve të Huaja”, “Mobilim Fakulteti Ekonomik likuiduar në 2019”, “Sistem monitorimi me kamera likuiduar 2019” dhe “Shtesa viti 2019” janë kontabilizuar jo në llogaritë e duhura, transaksione të cilat në total janë 63,194,095 leke. Këto transaksione duhet të ishin sistemuar në llogaritë e klases 2 pas procesit të marrjes në dorëzim të punimeve me qëllim kapitalizimin e tyre dhe në vijim amortizimin sipas periudhave. Veprimet e mësipërme të konstatuara janë në kundërshtim me udhëzimin e MF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Proçedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar “Trajtimi kontabël dhe funksionimi i llogarive të klasës 2”. Mos sistemimi i këtyre transaksioneve pas akteve të marrjes në dorëzim në llogaritë e klases 21, na jep një paraqitje jo të drejtë dhe të sakte të këtyre aktiveve pasi në përcaktimin e vlerës së drejtë të tyre ndikon amortizimi i cili nuk është marrë në konsideratë që nga momenti i marrjes në dorëzim të punimeve duke ndikuar në rezultatet e periudhave dhe pasqyrat financiare lidhur me saktësinë dhe rregullshmërinë e tyre.

## 1.2. Detyrimet (Pasivet)

Detyrimet në datën 31.12.2023 janë pasqyruar në shumën 48,699,675 lekë dhe përbehen vetëm nga detyrimet afatshkurtra.

1.2.a- Detyrimet afatshkurtra në datën e mbylljes së pasqyrave financiare paraqiten të përbëra vetëm nga llogaritë afatshkurtra të paraqitura në aneksin nr.1, tabelën 4.

Në lekë

Referenca e llogarive	Emërtimi	Ushtrimi i mbyllur 2023	Ushtrimi i mbyllur 2022
	I. Detyrimet Afatshkurtra	48,699,675	40,749,672
42	Detyrime ndaj personelit	32,214,485	30,224,031
431	Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa	4,185,293	3,195,266
435	Sigurime Shoqërore	10,068,516	4,617,670
436	Sigurime Shëndetësore	1,404,268	568,600
466	Kreditorë për mjete në ruajtje	827,113	2,144,105

Burimi: Pasqyra Financiare Universiteti i Shkodrës/Përpunuar nga Grupi i Auditimit

Llogaritë e klases 4, në pjesën e detyrimeve të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, janë llogari të pagueshme. Ato paraqesin detyrimet e institucionit në datën 31.12.2023 kundrejt të tretëve, punonjësve për pagat e muajit dhjetor 2023, tatimeve për tatimin mbi pagat, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të muajit dhjetor 2023, kreditorë për mjete në ruajtje të cilat kryesisht kanë të

bëjnë me garancitë e përkohshme të operatoreve ekonomike lidhur me kontratat e lidhura me Universitetin e Shkodrës të analizuar si më poshtë:

- Llogaria 42, “Detyrime ndaj personelit” në shumën 32,214,485 lekë përfaqëson shumën e pagave neto të muajit dhjetor, e cila rakordon me listë pagesën e muajit dhjetor 2023 deklaruar në tatime në sistemin E-filing
- Llogaria 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa” në shumën 4,185,293 lekë përfaqëson tatimin mbi të ardhurat nga punësimi për muajin dhjetor 2023 e cila rakordon me deklaratimet e subjektit në sistemin e tatimeve E-filing.
- Llogaria 435, “Sigurime shoqërore” dhe llogaria 436 “Sigurime shëndetësore” përfaqëson vlerën kontributeve për sigurime shoqërore e shëndetësore për pagat e muajit dhjetor 2023 përkatësisht në vlerat 10,068,516 lekë dhe 1,404,268 lekë të cilat rakordojnë me listëpagesën e deklaruar në muajin dhjetor 2023 në sistemin E-filing të tatimeve.
- Llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”, nga pasqyra e pozicionit financiar për vitin 2023 paraqitet në vlerën kontabël prej 827,113 lekë, vlerë kjo e cila është e rakorduar me degën e thesarit. Konstatohet që për këtë vlerë në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare nuk jepen sqarimeve se nga se përbëhet kjo vlerë
- Llogaria 401 - 408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”, 467 “Kreditorë të ndryshëm” në pasqyrat financiare të vitit 2022 dhe 2023 janë mbyllur me tepricë zero.

### 1.3. Fondet Neto

Nga auditimi konstatohet se Aktivet neto plotësojnë rregullin Aktive – Pasive = Aktivet Neto (1,421,182 mijë lekë).

Nga te cilat llogari 101 “Fondi i akumuluar” është 612,894,982 lekë. Llogaria 85 “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore” në shumën 533,442,000 lekë përfaqëson rezultatin e vitit ushtrimor 2023. Llogaria 105 “Teprica e granteve kapitale të brendshme” në shumën 37,814,582 lekë përfaqëson investimet nga buxheti për vitin 2023 i cili nuk ka ndryshuar nga viti 2022.

Llogaria 115 “Nga fondet e veta të investimeve” në shumën 237,031,072 lekë përfaqëson investimet nga fondet e veta për vitin 2023 i cili nuk ka ndryshuar nga viti 2022.

Llogaria 106 “Teprica e granteve kapitale të huaja” për vitin 2023 është mbyllur me tepricë zero ndërkohë që nga analizimi i llogarisë nr.512 “Mjete monetare në bankë” në datën e mbylljes së pasqyrave sipas viteve respektive pasqyrohen në vlerat 19,132,280 lekë dhe 10,798,043 lekë të cilat përmbledhin tepricat e projekteve në proces. Teprica e llogarisë 512 e raportuar në datën e mbylljes së pasqyrave financiare është e rakorduar me lëvizjen e llogarisë analitike të bankës së nivelit të dytë. Kjo tepricë duhet të ishte respektivisht e lidhur me **llogaritë 106** e cila mbetet me tepricë në fund të periudhave ushtrimore vetëm në rastet kur këto grante janë burim për investimet në proces për institucionin (të papërfunduara ose të pamarrë në dorëzim). Në aktiv të bilancit këto janë investime në proces në grupin e llogarive 23. Këto mbyllen (kapitalizohen) me fondet bazë në kohën kur investimi është përfunduar dhe marrë në dorëzim.

Nga auditimi i seksionit të trete të pasqyrave financiare “Fondet Neto” tepricat e llogarive kontabel pasqyrohen si më poshtë:

Në lekë

Referenca e llogarive	Emërtimi	Ushtrimi i mbyllur 2023	Ushtrimi i mbyllur 2022
C	AKTIVET NETO/ FONDET NETO (A-B)	1,421,182,636	1,512,257,486
101	Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar	612,894,982	673,517,842
85	Rezultati i veprimtarisë ushtrimore	533,442,000	563,893,990

115	Nga Fondet e veta te investimeve	237,031,072	237,031,072
105	Teprica e granteve kapitale të brendshme	37,814,582	37,814,582

Burimi: Pasqyra Financiare Universiteti i Shkodrës/Përpunuar nga Grupi i Auditimit

Nga auditimi pasqyrës se ndryshimeve ne aktivet neto/fondet neto formati nr 4 tepricat e llogarive kontabel pasqyrohen si me poshtë:

Në lekë

Nr. Reshti	Referençe	EMERTIMI	Fonde baze dhe Grante Kapitale	Rezultatet e Ushtrimit Tepricoe/Deficit	GJITHESEJ Aktive/neto Fonde/ Neto
a	b	c	1	5	6
1	101	<b>I.AKTIVET NETO/FONDET NETO</b>	<b>1,512,257,486</b>	-61,449,974	<b>1,421,182,639</b>
2		<b>II.NDRYSHIMET NE AKTIVET/ FONDET NETO(1+2)</b>	<b>18,638,828</b>	<b>619,681,532</b>	<b>638,320,360</b>
3		<b>1.NGA BURIME TE BRENDSHME</b>	18,638,828	619,681,532	638,320,360
8	85	Nga Rezultatet e vitit ushtrimor(+,-)		558,231,558	558,231,558
10	115	Nga Fondet e veta te investimeve (+,-)	18,638,828	0	18,638,828
13	1013	Nga konsumi i AAGJ(-)	0	61,449,974	61,449,974
20		<b>TOTALI I FONDEVE TE VETA(I+II)</b>	<b>1,512,257,486</b>	<b>558,231,558</b>	<b>1,421,182,636</b>

Burimi: Pasqyra Financiare Universiteti i Shkodrës/Përpunuar nga Grupi i Auditimit

Konstatohet se këto dy tabela nuk rakordojnë me njëra tjetrën sipas tepricave te llogarive te pasqyruara. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me udhëzimin e MF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Proçedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar pika 60, pika 64 *Rubrika C e pasqyrës së pozicionit financiar evidenton aktivet neto ose fondet neto. Fondet neto përbëjnë diferencën midis totalit të aktiveve me totalin e pasiveve. Fondet neto përfshijnë zëra si: teprica apo deficitin e akumuluar, rezultatet e mbartura, rezultati i veprimtarisë ushtrimore, rezerva nga rivlerësimi i aktiveve afatgjata, etj. Pika 82 “Sipas rreshtave, në këtë pasqyrë financiare evidentohen: Në rubrikën I, evidentohen shumat përkatëse për gjendjen e fondeve/aktiveve neto në fillim të periudhës ushtrimore, për çdo zë të pasqyruar në kolonat nga 1 deri në 5. Në rubrikën II, evidentohen për çdo zë të pasqyruar në kolonat nga 1 deri në 5, ndryshimet në aktivet/fondet neto, që rrjedhin nga: burime të brendshme (nga grantet e brendshme kapitale, transfertat e brendshme të AAGJ, dhurata në natyrë, nga shitjet e AAGJ, nga rezultate e mbartura, nga rezervat, etj) si dhe nga burime të jashtme (nga grantet e jashtme kapitale dhe transfertat e brendshme të AAGJ, dhurata në natyrë). Në fund të pasqyrës, pasqyrohet totali i fondeve të veta (si shumë e rubrikës I dhe rubrikës II), për çdo zë të pasqyruar në kolonat nga 1 deri në 5. Totali i fondeve të vet të kësaj pasqyre duhet të jetë i barabartë me totalin e aktiveve/fondeve neto të evidentuar në rubrikën C të pasqyrës financiare individuale të pozicionit financiar.”* Në zbatim të UMF nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisve të Qeverisjes së Përgjithshme” aneksi 1, pika 1.1.2.c respektive citon se: “... **Llogaritë 105** mbeten me tepricë në fund të periudhave ushtrimore vetëm në rastet kur këto grante janë burim për investimet në proces të institucioneve (të papërfunduara ose të pamarrë në dorëzim). Në aktiv të bilancit këto janë investime në proces në grupin e llogarive 23. Këto mbyllen (kapitalizohen) me fondet bazë në kohën kur investimi është përfunduar dhe marrë në dorëzim.”

Sa më sipër, teprica e llogarisë 105 duhet të kapitalizohet brenda periudhës ushtrimore dhe jo të mbyllet me tepricë. Konstatohet se mbyllja me tepricë e llogarisë 105 është kryer në kundërshtim

me UMF nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njëjësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar

Llogaria 101 “Teprica/Deficiti i akumuluar”, mbyllur me vlerën 612,894,982 lekë i përgjigjen tepricës ne mbyllje te vitit 2022 pakësuar me amortizimin e vitit 2023 ne shumën 61,449,974 lekë. Nga përlllogaritja e vlerave te mësipërme teprica ne mbyllje per vitin 2023 duhet te ishte 612,067,868 leke ndërkohë qe ne pasqyrën e pozicionit financiar ajo paraqitet në vlerën 612,894,982 leke. Konstatohet një diference prej 827,113 leke duke sjelle per pasoje një mbivlerësim të pozicionit financiar në datën e mbylljes se pasqyrave dhe një paraqitje jo të drejtë të pozicionit financiar.

Aktiviteti neto rakordojnë me fondet neto ne totalin e tyre, por për disa zëra nuk ka informacion sesi sektori i financës ka arritur në rezultatet e pasqyruara.

Në pasqyrën e ndryshimeve të aktiveve neto nuk janë plotësuar të gjithë zërat që përfaqësojnë ndryshimet e ndodhura në burimet e brendshme.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me Udhëzimi i MF nr.5, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në Udhëzimin e MF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”.

## **2. Pasqyra e Performancës F2**

Nga auditimi i gjendjes së llogarive ne pasqyrën e performancës rezultoi se, kontabilizimi dhe dokumentimi i tyre është kryer konform rregullave ndërsa konstatimi i tyre nuk është realizuar sipas parimeve dhe rregullave te kontabilitetit. Rakordimi dhe kuadrimi është bërë si për llogaritë sintetike ashtu edhe për ato analitike.

Totali i te “Ardhurave” në Pasqyrën e Performancës F2 është i barabartë me totalin e shpenzimeve vjetore plus rezultatin e ushtrimit. Për vitin 2023 pasqyra paraqiten si me poshtë:

- a- Të ardhurat (grupi A) = 1,284,923,484 lekë
- b- Shpenzimet (grupi B) = 751,481,484 lekë
- c- Rezultati i ushtrimit (llog.85) = 533,442,000 lekë

Llogaria 85 “Rezultati i Veprimtarisë Ushtrimore” në Pasqyrën e Pozicionit Financiar (F1) rakordon me vlerën e kësaj llogarie të shënuar në kolonën nr. 132 të Formatit nr. 2 “Pasqyra e Performancës”.

Ndryshimi i gjendjes se llogarive te klasës 2 ne Pasqyrën e pozicionit financiar në formatin F1 (diferenca midis tepricës më 31.12.2022 me 31.12.2023, përkatësisht 16,729,119 minus 18,543,142 konstatohet (1,814,023) lekë). Kjo vlerë konstatohet e barabartë me tepricën e llogarisë 63 “Ndryshim i gjendjeve të inventarit” në Pasqyrën nr. 2, “Pasqyra performancës financiare”.

### **2.1 Të ardhurat**

Në lekë

TË ARDHURAT	1,284,923,484
Te Ardhura Jotatimore	94,418,686
Grante Korrente	626,610,808
Te Ardhura te Tjera	563,893,990

Burimi: Pasqyra Financiare Universiteti i Shkodrës/Përpunuar nga Grupi i Auditimit

Nga auditimi i pasqyrës se performancës konstatohet se te ardhurat e realizuara tabela 7 aneksi 1, gjate vitit 2023 ne vlerën 1,284,923,484 lekë janë rezultat i:

- a- Te ardhurave jotatimore
- b- Grantet korrente
- c- Te ardhura te tjera

Te ardhurat jotatimore janë rezultat i të ardhurave të krijuara nga ana e Universitetit të kontabilizuar në llogarinë:

- Llogaria 7109 “*Të tjera nga ndërmarrjet dhe pronësia*” përfaqëson te ardhurat e krijuara si rezultat i dhënies me qira te ambienteve per aktivitete te ndryshme në shumën 127,600 lekë.
- Llogaria 7110 “*Tarifa administrative dhe rregullatore*” përfaqësojnë te ardhura nga regjistrimet në shumën 1,769,600 lekë.
- Llogaria 7111 “*Të ardhura sekondare e pagesa shërbimesh*” përfaqësojnë te ardhurat nga regjistrimet dhe shërbimet në shumën 92,521,486 lekë.

Grantet korrente përbehen nga financimet nga buxheti dhe nga financimet nga sponsorizimet nga të tretet.

- Llogaria 7200 “*Nga buxheti për NJQP (Qendrore)*” përfaqëson financimin me grante nga buxheti i shtetit për funksionimin e institucionit ne shumën 600,361,242 lekë.

- Llogaria 7206 “*Financim i pritshëm nga buxheti*” përfaqëson shumën që institucioni u detyrohet punonjësve për pagat e muajit dhjetor, detyrimet ndaj shtetit për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, tatimin e mbajtur për tatimin mbi pagat si dhe detyrime të konstatuara ndaj të tretëve të muajit dhjetor 2023 për shërbime ndaj Universitetit, shpenzime të cilat do të ekzekutohen në janar 2024 per efekt te vitit 2023. Konstatohet se financimi i pritshëm nga buxheti mbyllet me teprice zero, duke mos pritur fonde per likuidimin e shpenzimeve te mësipërme. Efekti financiar do te duhej te përfshihej në pasqyrën e performances per vitin 2023. Veprimi i mësipërm është ne kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 8, datë 09.03.2018 “*Për Proçedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme*” i ndryshuar, pika 59 “Njësitë e qeverisjes së përgjithshme, në rastet kur është e nevojshme, duhet të

regjistrojnë në kontabilitetin e vitit ushtrimor edhe marrëdhëniet e tyre me shtetin, për të drejta të konstatuara sipas rrethanave të ndryshme.

a) Në rastin e një të drejte të njësisë ndaj shtetit, regjistrimi në kontabilitet bëhet me artikullin kontabël si më poshtë:

- Debitohet llogaria 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)”; dhe
- Kreditohet llogaria 7206 “Financimi i pritshëm nga buxheti”.

Grantet korrente llogaria 721 “*Nga organizata ndërkombëtare*” përfaqëson shumën e fondeve në formën e granteve të akorduara nga organizata të huaja për institucionin.

Nga grupi i auditimit konstatohet se grantet e huaja në Universitetin e Shkodrës, janë njohur në pasqyrat financiare vetëm ne pasqyrën e performances. Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me UMF nr.5, datë 21.02.2022 “*Për disa ndryshime ne udhëzimin e ministrit te financave dhe ekonomisë nr. 8 date 09.03.2018*” “*Për Proçedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësite e Qeverisjes së Përgjithshme*”.

Sipas ekstraktit te nxjerre nga dega e thesarit per vitin 2023 struktura e te ardhurave te Universitetit pasqyrohet në aneksi 8 tabela nr. 8 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar.

Totali i te ardhurave rakordon me te ardhurat e pasqyrurara në pasqyrat financiare te Universitetit. Nga struktura e mësipërme konstatohet se “Te ardhurat nga analizat kimike e biologjike” janë ne shumen 945,900 leke për gjithë vitin 2023. Këto të ardhura janë gjeneruar nga shërbimet e ofruara nga Laboratori i Diagnostifikimit Mikrobiologjik i cili është pjese e strukturës se Rektoratit. Sipas nenit 91 te “Rregullores së administratës të Rektoratit te USH-se” laboratorit ka si funksion te saj ka kryerjen e analizave mikrobiologjike per individët dhe realizimin e te ardhurave ne buxhetin e USH-se. Nga analiza e performances se aktivitetit te këtij laboratorit konstatohet se operohet me

performance negative sipas te dhënave te pasqyruara ne aneksi 8 tabela nr. 9 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar.

Te ardhurat qe realizohen nga kjo njësi arkëtohen pranë qendrës ku ofrohet shërbimi. Arkëtimi i të ardhurave realizohet vetëm me ane të mandat arkëtimeve të cilat përpilohen nga punonjësit e laboratorit për shërbimin që kryejnë por që nuk kontabilizohen nga departamenti i financës. Totali i arkëtimeve ditore depozitohet nga bankat e nivelit të dytë në llogari të thesarit, dokument i cili kontabilizohet nga sektori i financës. Nga ana e sektorit te financës nuk behet asnjë kontroll i mandat arkëtimeve te lëshuara nga kjo njësi. Veprimet e mësipërme janë ne kundërshtim me ligjin nr 87/2019 “Për faturën dhe sistemin e monitorimit te qarkullimit” neni 2 pika b) “Ky ligj zbatohet per: ... organet publike...” neni 4 pika c “Tatimpaguesit, që duhet të lëshojnë faturë, pavarësisht nga qarkullimi vjetor i realizuar në vitin paraardhës ose në atë aktual, janë personat juridikë dhe fizikë:... të cilët janë tatimpagues që ushtrojnë veprimtarinë ekonomike, në përputhje me legjislacionin në fuqi për tatimin mbi vlerën e shtuar, pavarësisht nga forma e organizimit, përfshirë organizatat jofitimprurëse, njësitë e zbatimit të projekteve, organet publike qendrore e vendore, organizatat politike dhe institucione të tjera të ngjashme;” neni 6 pika 1 “Tatimpaguesit e përcaktuar në nenin 4, të këtij ligji, janë të detyruar të lëshojnë faturë ....”, neni 8 pika 1 “Fatura duhet të lëshohet në momentin e furnizimit të mallrave ose shërbimeve, ...”

Konstatohet se per te gjitha te ardhurat dytësore të arkëtuara dhe të kontabilizuara në sistemin e kontabilitetit te universitetit nuk kane gjetur zbatim dispozitat e mësipërme.

Gjithashtu me vendimin nr 142 date 14.07.2022 te Senatit Akademik “Per miratimin e Rregullores se Funksionimit te Klinikes se Fizioterapise” është miratuar rregullorja e funksionimit të kësaj klinike. Ne nenin 3 Detyrat e klinikes pika b. “Klinika përveç funksionit didaktik per përgatitjen e studenteve, shërben edhe si njësi shërbimi ndaj te tjereve”. Në reference të nenit të mësipërm konstatohet se për periudhën e auditimit nuk janë gjeneruara të ardhura nga shërbimet që ofrohen në këtë njësi. Kjo e konstatuar nga ekstrakti i strukturës se te ardhurave gjeneruar nga dega e thesarit si dhe pasqyrat financiare te Universitetit.

## 2.2 Shpenzimet

- I. Llogaria 600 “Pagat dhe përfitimet e punonjësve” në shumën prej 509,890,060 lekë përfaqëson pagat e personelit të përhershëm në shumën 475,745,157 lekë dhe te punonjësve te përkohshëm ne shumen 34,144,903 leke sipas detyrimeve të konstatuara dhe listë-pagesave të deklaruara nga subjekti në sistemin e Tatimeve C@ts.
- II. Llogaria 601 “Kontribute të Sigurimeve” në shumën prej 79,785,115 lekë, përfaqëson shpenzimet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, pjesa e kontributeve e paguar nga punëdhënësi sipas detyrimeve të konstatuara dhe listë-pagesave të deklaruara nga subjekti në sistemin e Tatimeve C@ts.
- III. Llogaria 602 “Blerje mallra e shërbime” në shumën prej 113,183,902 lekë, përfaqëson shpenzimet operative të kryera nga institucioni në funksion të aktiviteteve e cila përbëhet nga:
  - a) Llogaria 6020 “Materiale zyre dhe te përgjithshme” për 4,331,166 lekë cila paraqet shpenzimet që institucionet ka kryer për blerje materiale të tjera zyre dhe kancelari gjatë vitit 2023. Nga auditimi konstatohet se në këtë llogari gjejmë të kontabilizuara shpenzime të cilat nuk i përkasin kësaj klase siç janë “Likujdim shërbime te tjera per aktivitetin e 7 Marsit” te cilat duhet te regjistroheshin në llogarinë 6029 “Shpenzime te tjera operative”
  - b) Llogaria 6021 “Materiale dhe shërbime speciale” për 1,789,628 leke përbëhet nga shpenzime të kryera nga institucioni për “Shpenzime dokumentacioni specifik” në shumën 768,000 lekë, “Blerje uniforma dhe veshje te tjera speciale” në shumën 254,240 lekë, “Shpenzim per prodhim dokument specifik” në shumën 530,064 lekë. Nga auditimi konstatohet se në këtë llogari

shpenzimet për “Likujdim Koktej per 7 Marsin” janë keqklasifikuar si shpenzime “Materiale dhe shërbime speciale”. Ato duhet të kontabilizoheshin si “Shpenzime të tjera operative” në llogarinë 6029 “Shpenzime te tjera operative”

- c) Llogaria 6022 “Shërbime nga të tretë” për 49,343,184 lekë përbëhet nga shpenzime për shërbime utilitare si energji elektrike, ujë, shërbim telefoni/internet, shërbime postare, shërbim ruajtje objekti, blerja gazoil per ngrohje. Nga auditimi konstatohet se në këtë llogari janë kontabilizuar edhe shpenzime për “Pagesa per komisionet zgjedhore”, “Pagese tarife per doktorature” te cilat janë keqklasifikuar ne këtë llogari.
- d) Llogaria 6023 “Shpenzime transporti” në shumën 989,477 lekë përbëhet nga shpenzime për karburant, pjesë këmbimi, dhe policat e sigurimit të detyrueshëm për automjetet në pronësi të subjektit
- e) Llogaria 6024 “Shpenzime udhëtimi” në shumën 5,791,607 lekë përbëhet nga shpenzime për dieta dhe bileta për udhëtime per ekspedita. Shpenzimet për dietat të kontabilizuara në këtë llogari janë të keqklasifikuara. Kontabilizimi i drejtë do te ishte në llogarinë 6009 “Shpenzime te tjera për personelin” sipas UMF nr.8, datë 09.03.2018 “*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme*” si dhe “*NOMENKLATURA E LLOGARIVE TE PLANIT KONTABEL PUBLIK*”

**Observacion i subjektit mbi Projekt Raportin e Auditimit, vënë në dispozicion grupit të auditimit në datë 27.03.2025 me nr.1101/11 prot.**

**Pretendimi i subjektit:** Shpenzimet e dietave janë kontabilizuar në 6024 pasi në kuptimin e VKM-ve përkatëse për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës dhe për trajtimin financiar të punonjesve që dergohen me shërbim jashtë vendit, dietat janë rimbursim i shpenzimeve shtesë që punonjësi ka kur lëviz jashtë qendrës së punës ose jashtë vendit.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Përsa i përket observimeve të paraqitura lidhur me shpenzimet e dietave që janë kontabilizuar në 6024. Në zbatim të UMF nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme” si dhe “Nomeklatura e Llogarive të Planit Kontabel Publik” kontabilizimi i drejtë do te ishte në llogarinë 6009 “Shpenzime te tjera për personelin”.

**Përsa më sipër observacioni juaj nuk merret në konsiderate.**

- f) Llogaria 6025 “Shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme” në shumën 21,025,252 lekë. Nga auditimi i llogarisë analitike konstatohet se ne këtë llogari janë kontabilizuar tre urdhër shpenzime te cilat sipas procedurave te prokurimit dhe preventivave përfaqësojnë rikonstruksione te objekteve . Kontabilizimi ne këtë llogari është keqklasifikim, klasifikimi i sakte do te ishte ne llogarinë 212 “Ndërtesa e konstruksione”
- g) Llogaria 6027 “Shpenzime për detyrime për kompensime legale” në shumën 402,000 lekë përfaqësojnë “Shpenzime për ekzekutim te vendimeve gjyqësore për detyrime te palikuiduara” Nga auditimi konstatohet se ky shpenzim është ekzekutim vendim gjyqi për likuidimin e një fature të lëshuar nga shoqëria tregtare “R. SH” shpk në vitin 2022.
- h) Llogaria 6029 “Shpenzime të tjera operative” ne shumën 29,511,588 lekë. Nga auditimi i llogarisë analitike konstatohet se totali i llogarisë analitike nuk kuadron me totalin sintetik te kësaj llogarie. Mosrakordimi është 2,181,359 lekë në kundërshtim me UMF nr.8, datë 09.03.2018 “*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme*”.

**Observacion i subjektit mbi Projekt Raportin e Auditimit, vënë në dispozicion grupit të auditimit në datë 27.03.2025 me nr.1101/11 prot.**

**Pretendimi i subjektit:** Diferenca për vitin 2023 tek shpenzimet operative në vlerën 2,181,359 lekë vjen nga fakti që kthimi i Fondit i Projektit MARED nuk është konsideruar shpenzim por pakësim I të ardhurave.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Përsa i përket observimeve të paraqitura lidhur diferencën në llogarinë 6029, theksojmë se mosrakordimi i të dhënave është në kundërshtim me UMF nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njëjësive të Qeverisjes së Përgjithshme”.

**Përsa më sipër observacioni juaj nuk merret në konsideratë.**

Nga analizi i veprimeve të dritarit konstatohet se shpenzimet për vitin 2023 në total pasqyrohen në shumën 769,752,976 lekë ndërsa në pasqyrën e performancës dhe pasqyrën e pozicionit financiar pasqyrohen në shumën 771,934,335 leke. Konstatohet një diferencë prej 2,181,359 leke e cila është e njëjtë me diferencën e konstatuar në llogarinë 6029 “Shpenzime të tjera operative”.

- IV. Llogaria 6061 “*Transferta të paguara nga Inst. Tjera e Org.Pusht.Vendor*” në shumën prej 50,436,430 përfaqëson shpenzime për bursat akorduar studenteve në shumën 49,654,000 leke si dhe shpenzime për ndihma të menjëhershme dhe shpërblime pensioni për punonjësit e institucioneve.
- V. Llogaria 63 “Ndryshimi i gjendjes së inventarit” nuk është element që ndikon në rezultat, por nëpërmjet operacioneve të transferimit ndikon sipas rastit në shtesë apo pakësim të fondeve bazë të institucioneve. Nga veprimet kontabël të bëra nga institucioni dhe të pasqyruar në pasqyrën e performancës financiare ndryshimi i gjendjes është pasqyruar drejtë në shumën prej 1,814,023 lekë.

Nga auditimi i rakordimit të “Situacion shpenzimesh Janar-Dhjetor 2023” i degës së Thesarit me pasqyrën e performancës kemi mospërputhje vlerash, diferencë është 2,181,359 leke. Shpenzimet korrente sipas pasqyrës performancës pasqyrohen në vlerën 1,214,118,448 lekë kurse sipas aktit rakordimit me degën e thesarit vlera e tyre është 1,197,949,619 lekë si dhe shpenzimeve të kryera nga të ardhurat dytësore në bankat e nivelit të dytë, paraqitur sipas tabelës 10 aneksi 1:

Mosrakordimi i të dhënave dhe veprimet e tjera të mësipërme janë në kundërshtim me UMF nr 31 dt. 13.12.2023 “*Per Proçedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2023*” pika 34 dhe 41.

### **Situata e detyrimeve të prapambetura në Universitetin “Luigj Gurakuqi” Shkodër.**

Nga auditimi mbi vendimet e proceseve gjyqësore, njohjen në kontabilitet dhe likuidimin e tyre konstatohet vetëm një vendim gjyqësor. Ky vendim gjyqësor ka marrë formë të prerë në vitin 2022 në shumën prej 402,000 lekë dhe është likuiduar në vitin 2023.

Me vendimin nr 929(5431) dt. 28.12.2022 si dhe Urdhrin “Për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit” gjykata rrethit gjyqësor Shkodër me palë paditëse shoqëria tregtare “R” shpk, me person të interesuar universitetin “Luigj Gurakuqi” Shkodër me objekt “Lëshim urdhër ekzekutimi për faturën tatimore të shitjes nr 27 nr serial b559cb10-a01a-47da-8d5d-f40007d1fe427 dt. 08.04.2022 .....” ka vendosur për ekzekutimin e objektit të kërkesë-padisë në favor të shoqërisë tregtare “R” shpk në shumën 370,800 lekë.

Ky vendim gjyqësor nuk është njohur në kontabilitet si detyrim, rrjedhimisht llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” nuk pasqyron vlerën e saktë në pasqyrat financiare të vitit 2022. Në këtë zë nuk janë reflektuar detyrimet sa i takon shpenzimeve të periudhave të ardhshme për vendimet gjyqësore, të cilat kanë marrë formën e prerë përpara mbylljes së pasqyrave

financiare të vitit ushtrimor. Gjithashtu shpenzimet për vendimet gjyqësore të formës së prerë, nuk janë njohur në kontabilitet sipas parimit të të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, duke mos u njohur si shpenzime periudhe në momentin e marrjes së formës së prerë të Vendimit të Gjykatës, por janë njohur në momentin e likuidimit, në kundërshtim me nenin 61, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar, si dhe Udhëzimit e MF me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Procedurat në përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 34 dhe 42.

Nga auditimi i detyrimeve të prapambetura konstatohet vetëm një detyrim në shumën 2,520,000 lekë. Subjekti ka inicuar urdhër-shpenzimin (detyrim i prapambetur) nr 01 date 29.12.2023 me shumë 2,520,000 lekë me përshkrim “Shlyerja e faturës 3443/2021 të P”. Sipas dokumentacionit bashkëlidhur fatura me nr 3443/2021 date 04.10.2021 me NIVF: d8124bce-d99f-4b5b-933c-8c1c05c7e4c6 lëshuar nga P. shpk me Nipt L.....A ka ne artikuj te faturës “P” ne sasi 50 cope me vlere totale te saj 2,520,000 leke. Ne zbatim te UMF nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njërive të Qeverisjes së Përgjithshme” kapitulli 2 “Parimet e kontabilitetit ne sektorin publik” pika 5 “Pasqyrat financiare sigurojnë transparencën përmes të dhënave të plota dhe paraqesin, me vërtetësi, të dhënat e nevojshme për vendimmarrje. Ato përgatiten bazuar në një kontabilitet ushtrimor dhe në vijueshmërinë e veprimtarisë së njësisë së qeverisjes së përgjithshme, për një të ardhme të parashikueshme”. Pika 42 “Të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme duhet të evidentojnë veçmas në pasqyrat financiare vjetore dhe zërin e detyrimeve të prapambetura të tyre ndaj të tretëve, për shpenzime, shërbime apo investime të kryera e të pafinancuara, për shkak të mungesës së fondeve. Për të evidentuar këto detyrime, do të përdoren llogari specifike të kontabilitetit të llogarisë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”, në varësi të natyrës së tyre”. Kapitulli 3.3 Trajtimi kontabël dhe funksioni i llogarive të të tretëve (klasa 4) “Klasa 4 përfaqëson në përgjithësi ngjarjet apo fenomenet që kanë ndodhur dhe duhet të trajtohen kontabilisht, sipas parimit të të drejtave e detyrimeve të konstatuara.”

### **3. Pasqyra e ndryshimeve ne aktivet neto/ fondet neto F4**

Nga auditimi i “Pasqyrës së ndryshimeve në aktivet neto/ fondet neto” konstatohet se të dhënat e kësaj pasqyre rakordojnë me të dhënat në pasqyrën e pozicionit financiar në rubrikën C.

Aktivt neto rakordojnë me fondet neto, por për disa zëra nuk ka informacion sesi sektori i financës ka arritur në rezultatet e pasqyruara.

Në pasqyrën e ndryshimeve të aktiveve neto nuk janë plotësuar të gjithë zërat që përfaqësojnë ndryshimet e ndodhura në burimet e brendshme.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me Udhëzimi i MF nr.5, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në Udhëzimin e MF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”.

**Observacion i subjektit mbi Projekt Raportin e Auditimit, vënë në dispozicion grupit të auditimit në datë 27.03.2025 me nr.1101/11 prot.**

**Pretendimi i subjektit:** Pasqyra e Fondeve Neto është bërë në formën e paraqitur bazuar në udhëzimet verbal te specialistes së Degës së thesarit Shkodër e cila po ashtu e miratoi në këtë formë por do të sistemohet.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Përsa i përket observimeve të paraqitura lidhur pasqyrën e ndryshimeve në aktivet neto/ fondet neto sic është cituar më sipër janë në kundërshtim me udhëzimin e MF nr. 8 datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar.

**Inventarizimi i pronës shtetërore, nxjerrja e rezultateve të inventarizimit dhe sistemimi i diferencave në përputhje me rregullat kontabël**

Auditimi u fokusua në rregullshmërinë e kryerjes së procesit të inventarizimit sipas Udhëzimit nr. 30 të MF, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”. Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i praktikave të dokumentuara të vëna në dispozicion të grupit të auditimit, ka rezultuar sa më poshtë vijon:

Nga auditimi u konstatua se Universiteti i Shkodrës ka të dhëna mbi gjendjen fizike dhe vlerën kontabël të pronave të cilat rakordojnë në përputhje me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”, neni 26 ku citohet: “*Çdo njësi publike duhet të krijojë dhe të përditësoj një regjistër kontabël të të gjitha aktiveve që zotëron apo ka në administrim, përfshi dhe pronat publike që siguron të ardhur ...*”

Nisur nga rëndësia, materialiteti sasior dhe në natyrë i aspekteve të menaxhimit material dhe mundësisë për veprime të pajustificuara, është audituar periudha objekt auditimi.

Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i praktikave të dokumentuara, të vëna në dispozicion të grupit të auditimit, ka rezultuar se, për periudhën objekt auditimi, është inicuar procesi i inventarizimit sipas parashikimeve të Paragrafit nr. 74, i Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*” i ndryshuar që sanksionin se: “*Çdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dokumentacionit mbështetës*” .

Regjistrimi i aktiveve është kryer konform Kreut III, "Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre", të Udhëzimit të Ministrisë Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik".

Hyrja e aktiveve *përgjithësisht* është dokumentuar me fletë hyrjen përkatëse, të hartuar sipas gjendjes fizike të tyre, konform pikës 37, të Udhëzimit të Ministrisë Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik". Dalja e aktiveve *në përgjithësi* është realizuar konform pikës 38, të Udhëzimit të Ministrisë Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik".

**Inventarizimi i vitit 2022:**

Me Urdhrin e Administratorit nr. 26 prot datë 06.01.2023 është urdhëruar “Krijimi i komisioneve për inventarizimin, e aktiveve të Universitetit të Shkodrës Luigj Gurakuqi”. Komisioni i parë me përbërje znj. S. A, z. A. B dhe z. V. B. do të inventarizojë Rektoratin, FSHE (Fakulteti i Shkencave të Edukimit), FSHSH (Fakulteti i Shkencave Shoqërore) dhe FGJH (Fakulteti i Gjuhëve të Huaja). Komisioni i dytë me përbërje znj. R. M, znj. I. S dhe z. N. R do të inventarizojë Fakultetin e Drejtësisë, Fakultetin Ekonomik, Fakultetin e Shkencave të Natyrës dhe Bibliotekën. Procesit i inventarizimit duhet të kryhet në periudhën 09 Janar deri me datë 28 Shkurt 2023. Për zbatimin e urdhrin ngarkohen Drejtorja Ekonomike, Komisionet e ngritura si dhe personat përgjegjës material të aktiveve.

Me Urdhrin e Administratorit nr. 26/1 prot datë 30.01.2023 është urdhëruar zëvendësimi i anëtarit të komisionit të inventarizimit znj. R. M me znj. M. P.

Me Raportin nr 26/2 prot dt. 28.02 2023 drejtuar Nëpunësit Zbatues z. I. B është raportuar lidhur me procesin e inventarizimit vetëm në Fakultetin Ekonomik dhe Bibliotekën e Universitetit nga komisioni i përberë nga M. P, I. S dhe N. R.

Procedura e ndjekur nga komisionet respektive është si vijon:

Me datën 28.02.2023 është hartuar raporti mbi inventarizimin e aktiveve për vitin 2022 per Fakultetin Ekonomik dhe Bibliotekën e Universitetit drejtuar Nëpunësit Zbatues.

Sipas këtij raporti nga komisioni i ngritur për këtë detyre raportohet se: *“Inventarizimi i aseteve është kryer ne sasi, çmim dhe ne vlere dhe komisioni ka përpiluar flete inventarizimet përkatëse per Fakultetin Ekonomik dhe Bibliotekën e Universitetit Luigj Gurakuqi pasi per dy fakultetet tjera na është thënë nga Administratori, se do te krijohet komision i veçantë”*

Konstatohet se nuk ekzistojnë urdhra të tjerë të cilët amendojnë Urdhrin e Administratorit nr. 26 prot datë 06.01.2023 per “Krijimi i komisioneve për inventarizimin, e aktiveve të Universitetit të Shkodrës Luigj Gurakuqi”.

Në vijim është bërë verifikimi i sasisë dhe gjëndjes fizike të aseteve. Nisur nga kartelat e personave përgjegjës për asetet konstatohet se ekzistojnë asete jashtë përdorimit nisur nga gjykimi i komisionit te inventarizimit. Ne Bibliotekën e Universitetit është bere inventarizimi i mjeteve kryesore pa përfshirë librat. Sipas takimit te datës 16.02.2023 me pjesëmarrjen e Administratorit te Universitetit te Shkodrës, Drejtoreshës së Prokurimeve dhe Shërbimeve dhe komisionit te inventarizimit është vendosur qe per librat si asete dhe mjete kryesore te behet regjistrimi nga ana e punonjësve te Bibliotekës.

Konstatohet se nuk është ngritur një grup inventarizimi për adresimin e problematikes se diskutuar në mbledhjen e datës te datës 16.02.2023 me pjesëmarrjen e Administratorit te Universitetit te Shkodrës, Drejtoreshës se Prokurimeve dhe Shërbimeve dhe komisionit te inventarizimit

Ne vijim te raportit është bashkëlidhur edhe procesverbali i mbajtur me date 27.02.2023 lidhur me asete te cilat figurojnë fizikisht 99 karrige ne Bibliotekën e Universitetit por jo ne inventarin kontabel te kësaj Biblioteke.

Sa me sipër konstatohet se për procedurën e inventarizimit të aktiveve për vitin 2022 nuk janë kryer veprime te mëtejshme në kundërshtim me Udhëzimin Nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar me Udhëzimin nr.24, datë 07.12.2016, nr.11 datë 06.05.2016 dhe nr. 20 datë 17.11.2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Konkretisht:

- Regjistri i aktiveve i nuk është i plotësuar në formën e kërkuar nga pika nr 30 i udhëzimit Nr. 30 datë 27.12.2011 *“Formati i rregjistrimit të aktiveve hartohet në vartësi të llojit të tyre afatgjatë apo afatshkurtër si dhe grupit përkatës brenda llojit. Kërkesat minimale që duhet të përmbajë rregjistri i aktiveve në vartësi të llojit, përfshijnë: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.*
- Nuk janë kryer veprime ne zbatim te pikës 73 *“Inventarizimi i aktiveve është një element i rëndësishëm kontrolli në kuadrin e menaxhimit të aktiveve të njësisë, i cili kryhet për të vërtetuar saktësinë, cilësinë e gjendjes fizike të aktiveve në një kohë të caktuar si dhe përdorimin në mënyrën e duhur dhe më eficientë të tyre. Inventarizimi kryhet nën përgjegjësinë dhe sipas procedurave të miratuara me këtë udhëzim dhe me urdhëra /udhëzime nga titullari i njësi publike”*
- Nuk janë kryer veprime ne zbatim te pikës 74 *“Çdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dokumentacionit mbështetës”*
- Nuk janë kryer veprime ne zbatim te pikës 85 *“Komisioni i inventarizimit ka përgjegjësinë për: a. Verifikimin fizik dhe cilësor të gjendjes së aktiveve në ngarkim/përdorim të personelit të*

*njësisë publike dhe pasqyrimin e të dhënave të inventarizimit në procesverbalin përkatës, i cili ruhet gjatë periudhës së inventarizimit..*

- b. Të bëjë krahasimin e gjendjes konkrete të aktiveve me të dhënat përkatëse të librave që mbahen nga punonjësit me përgjegjësi materiale e që janë të përputhura me sektorin e financës, të llogaritë kompensimet e lejueshme, duke marrë edhe mendimin e specialistëve përkatës dhe, për diferencat që mund të dalin pas kompensimeve, të hartojë procesverbalet.*
- c. Të përpilojë një raport lidhur me inventarizimin fizik të aktiveve, vlerësimin paraprak lidhur me cilësinë dhe kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike dhe vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave e dëmtimeve të konstatuara, për shkaqet e tyre dhe personat përgjegjës, së bashku me gjithë dokumentacionin e inventarizimit, t'ia dorëzojë për veprime të mëtejshme Nëpunësit Autorizues.”*
- Nuk janë kryer veprime ne zbatim te pikës 86 “Personat e ngarkuar për kryerjen e inventarizimeve mbajnë sipas rastit përgjegjësi disiplinore, materiale a penale për moskryerjen me saktësi të inventarit.”

Në vijim me urdhrin nr 2 date 06.01.2023 “Per ngritjen e komisionit te inventarizimit te vlerave materiale te magazinës se USH-se” është urdhëruar fillimi I procesit per evidentimin e gjendjes se mallrave ne magazinën e USH-se me komision znj. N. F kryetare, z. A. C anëtar dhe z. I. S anëtar. Me relacionin nr 17/2 Prot date 18.01.2023 komisioni ka dërguar informacion drejtuar Administratorit lidhur me rezultatin e inventarizimit te kryer nga i cili rezulton se: “Është bere verifikimi fizik dhe cilësor i gjendjes se aktiveve dhe te materialeve te konsumit ne magazine .... nuk u evidentuan diferenca ne sasi....komisioni zbardhi gjendjen fizike te artikujve..... te cilat përputhen me gjendjen kontabel 31.12.2022 te konfirmuar nga financa”.

### **Inventarizimi i vitit 2023:**

Me Urdhrin e Administratorit nr. 3144 prot datë 12.10.2023 është nxjerre Urdhër i Brendshëm “Per krijimin e komisionit të inventarizimit, dhe vlerësimit te aktiveve ne USH” me anë të të cilit urdhërohet:

- 1- Krijimi i komisionit te inventarizimit dhe vlerësimit fizik te aktiveve me përbërje
  - a- I. B – Kryetar
  - b- A. C – Anetar
  - c- E. I – Anetar
  - d- X. Z – Anetar
  - e- S. I – Anetar
- 2- Ky komision do te përfundoje inventarizimin dhe vlerësimin deri me date 17.11.2023

Me datën 13 Tetor 2023 ka dale Urdhër i brendshëm i Administratorit nr. 3144/1 prot datë 13.10.2023 “Per krijimin e komisionit të inventarizimit, dhe vlerësimit te aktiveve ne USH” me anë të të cilit urdhërohet:

- 1- Krijimi i komisionit te inventarizimit dhe vlerësimit fizik te aktiveve me përbërje
    - a- I. B. – Kryetar
    - b- A. C – Anetar
    - c- N. R – Anetar
    - d- A. N – Anetar
    - e- S. I – Anetar
  - 2- Ky komision do te përfundoje inventarizimin dhe vlerësimin deri me date 17.11.2023
- Konstatohet se procedura e inventarizimit nuk është finalizuar

Sa me sipër konstatohet se per procedurën e inventarizimit te aktiveve per vitin 2022 nuk janë kryer veprime të mëtejshme në kundërshtim me Udhëzimin Nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar me udhëzimin nr.24, datë 07.12.2016, nr.11 datë 06.05.2016 dhe nr. 20 datë 17.11.2014 “për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Konkretisht:

- Regjistri i aktiveve i nuk është i plotësuar ne formën e kërkuar nga pika nr 30 i udhëzimit Nr. 30 datë 27.12.2011 “*Formati i rregjistrimit të aktiveve hartohet në vartësi të llojit të tyre afatgjatë apo afatshkurtër si dhe grupit përkatës brenda llojit. Kërkesat minimale që duhet të përmbajë rregjistri i aktiveve në vartësi të llojit, përfshijnë: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.*
- Nuk janë kryer veprime ne zbatim te pikës 73 “*Inventarizimi i aktiveve është një element i rëndësishëm kontrolli në kuadrin e menaxhimit të aktiveve të njësisë, i cili kryhet për të vërtetuar saktësinë, cilësinë e gjendjes fizike të aktiveve në një kohë të caktuar si dhe përdorimin në mënyrën e duhur dhe më eficientë të tyre. Inventarizimi kryhet nën përgjegjësinë dhe sipas procedurave të miratuara me këtë udhëzim dhe me urdhëra /udhëzime nga titullari i njësi publike*”
- Nuk janë kryer veprime ne zbatim te pikës 74 “*Çdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dokumentacionit mbështetës*”
- Nuk janë kryer veprime ne zbatim te pikës 85 “*Komisioni i inventarizimit ka përgjegjësinë për: a. Verifikimin fizik dhe cilësor të gjendjes së aktiveve në ngarkim/përdorim të personelit të njësisë publike dhe pasqyrimin e të dhënave të inventarizimit në procesverbalin përkatës, i cili ruhet gjatë periudhës së inventarizimit.*
- b. *Të bëjë krahasimin e gjendjes konkrete të aktiveve me të dhënat përkatëse të librave që mbahen nga punonjësit me përgjegjësi materiale e që janë të përputhura me sektorin e financës, të llogaritë kompensimet e lejueshme, duke marrë edhe mendimin e specialistëve përkatës dhe, për diferencat që mund të dalin pas kompensimeve, të hartojë procesverbalet.*
- c. *Të përpilojë një raport lidhur me inventarizimin fizik të aktiveve, vlerësimin paraprak lidhur me cilësinë dhe kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike dhe vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave e dëmtimeve të konstatuara, për shkaqet e tyre dhe personat përgjegjës, së bashku me gjithë dokumentacionin e inventarizimit, t’ia dorëzojë për veprime të mëtejshme Nëpunësit Autorizues.*”
- Nuk janë kryer veprime ne zbatim te pikës 86 “*Personat e ngarkuar për kryerjen e inventarizimeve mbajnë sipas rastit përgjegjësi disiplinore, materiale a penale për moskryerjen me saktësi të inventarit.*”

Në vijim me urdhrin e administratorit nr, 1 date 09.01.2024 “Per ngritjen e komisionit te inventarizimit te vlerave materiale te magazinës se USH-se” është urdhëruar fillimi i procesit per evidentimin e gjendjes se mallrave ne magazinën e USH-se me komision z. I. B kryetar, znj. S. C anëtare dhe z. X. Z anëtar. Me procesverbalin nr 17/4 Prot date 22.01.2024 komisioni ka dërguar informacion lidhur me rezultatin e inventarizimit te kryer nga I cili rezulton se:

“Është bere verifikimi fizik dhe cilësor i gjendjes se aktiveve dhe te materialeve te konsumit ne magazine .... nuk u evidentuan diferenca ne sasi...”

### Komisioni i inventarizimit

U konstatua se për vitin 2023, Kryetari i komisionit të inventarizimit është përgjegjësi i Sektorit të Financës dhe anëtarë janë specialistët e Sektorit të Financës, veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30 të MF, datë 27.12.2011, i ndryshuar pika 82 ku citohet se “Komisioni nuk duhet te jete më pak se 3 punonjës. Anëtarët e komisionit nuk duhet te kenë konflikt interesi. Në komision nuk merr pjesë punonjësi që ka ne ngarkim/ përdorim aktivin, por ai duhet të jetë I pranishëm kur bëhet inventarizimi ...” si dhe ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar me ligjin 110/2015, datë 15.10.2015 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 22 “veprimtaria e kontrollit” pika 3. b “ndarjen e detyrave në fushën e dhënies së autorizimit në atë formë, në mënyrë që i njëjti punonjës të mos jetë përgjegjës në të njëjtën kohë për propozimin, miratimin, zbatimin, kontabilitetin dhe kontrollin.

Nga auditimi i magazinës u konstatua se:

1-Procesi i hyrje-daljeve nga magazina mbahet me libër magazine manualisht;

2-Dalja e inventarit nga magazina bëhet në fund të muajit, dhe jo për çdo kërkesë për tërheqje malli;

3-Çdo vit bëhet mbartje e gjendjes së vitit paraardhës të inventarit qarkullues, duke hapur një libër të ri magazine, dhe rrjedhimisht sjell vështirësi në identifikimin e vjetërsisë së artikullit në magazinë, me qëllim menaxhimin më efektiv të magazinës;

4- Artikuj të njëjtë të inventarit janë mbajtur në kartela të ndryshme, duke sjellë vështirësi në menaxhimin me efektivitet të magazinës.

5- Rakordimi dhe dërgimi i flete daljeve dërgohet një here ne muaj ne departamentin e financës. Kjo parregullsi sjell mospasqyrim te sakte mes gjendjes kontabel dhe asaj fizike.

Nga verifikimi i datës 16.12.2024, FH dhe FD e fundit janë: FH nr.22 datë 21.11.2024 dhe FD nr.170 datë 11.12.2024. Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30 të MF, date 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik”, i ndryshuar, pika 39 ku citohet: “ Çdo hyrje-dalje në magazinë dokumentohet menjëherë. Aktivët që hyjnë pjesë-pjesë për në vendmbërritje, pasqyrohen me dokumente të përkohshme, por fletëhyrja ose fletëdalja për gjithë sasinë plotësohet me mbritjen e gjithë sasisë së aktivitetit, duke u bashkëlidhur edhe dokumentet e përkohshme”, trajtuar në aneksin nr. 8 bashkëlidhur Raporti Përfundimtar.

## **2.5 PROKURIMET E FONDEVE PUBLIKE.**

Në zbatim të pikës nr. 5 së Programit të Auditimit nr. 1101/1 prot., datë 19.09.2024, “Mbi prokurimin e fondeve publike”, zbatimi i legjisllacionit për realizimin e procedurave të prokurimit publik, lidhje dhe zbatimi i kontratave deri në marrjen në dorëzim të mallrave/punëve dhe shërbimeve. Bazuar në Ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, VKM 285, Datë 19.05.2021 ‘Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik’, ndryshuar, si dhe çdo akt juridik që është në fuqi në lidhje mbi prokurimet publike

- *Rregjistrat e parashikimeve*
- *Rregjistrat e Realizimeve*
- *Urdhrat e ngritjes së komisioneve*
- *Praktika me zgjedhje blerjesh në fushën e Teknologjisë së Informacionit*

Referuar të dhënave të regjistratit të prokurimeve për vitin 2022 janë realizuar procedura si me poshtë vijon:

Mbi 1,000,000 lekë janë realizuar 5 procedura me vlerë kontrate 27,080,671 lekë pa TVSH.

Blerje me vlerë të vogël nga 100,000 lekë deri 1,000,000 lekë, janë realizuar 4 procedura me vlerë kontratë 2,149,220 lekë.

Procedura nen 100,000 lekë janë realizuar 4 me vlerë kontratë 400,000 lekë.

Për vitin 2023 janë realizuar procedura si me poshtë vijon:

Mbi 1,000,000 lekë janë realizuar 11 procedura me vlerë kontrate 90,574,132 lekë pa TVSH.

Blerje me vlerë të vogël nga 100,000 lekë deri 1,000,000 lekë, janë realizuar 14 procedura me vlerë kontratë 6,038,555 lekë pa TVSh.

Procedura nen 100,000 lekë janë realizuar 9 me vlerë kontratë 678,846 lekë.

Për vitin 2024 janë realizuar procedura si me poshtë vijon:

Mbi 1,000,000 lekë është realizuar 1 procedura me vlerë kontrate 1,055,750 lekë pa TVSH.

Blerje me vlerë të vogël nga 100,000 lekë deri 1,000,000 lekë, janë realizuar 14 procedura me vlerë kontratë 6,038,555 lekë pa TVSh.

Procedura nen 100,000 lekë janë realizuar 9 me vlerë kontratë 678,846 lekë.

Nga grupi i auditimit për vitin 2022 janë përzgjedhur 5 procedura mbi 1,000,000 lekë me fond te realizuar ne vlerën 27,080,671 lekë, si dhe 2 procedura blerje me vlerë te vogël me vlerë kontratë 818,220 lekë.

- Për vitin 2023 janë përzgjedhur 11 procedura mbi 1,000,000 lekë me fond te realizuar ne vlerën 90,574,132 lekë, si dhe 5 procedura me vlere te vogël me vlerë kontratë 2,079,229 lekë.

- Për vitin 2024 është përzgjedhur 1 procedura mbi 1,000,000 lekë me fond te realizuar ne vlerën 1,055,750 lekë, si dhe 3 procedura me vlere te vogël me vlerë kontratë 1,100,754 lekë.

**Nga auditimi i procedurave të prokurimit te audituara janë konstatua mangësitë si me poshtë.**

**1. Procedura e prokurimit “Shërbime të printimit dhe publikimit (për ceremoninë e 65 vjetorit të USH-së.)”, me fond limit 2,332,497 pa TVSH,**

<b>Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Shërbime të printimit dhe publikimit (për ceremoninë e 65 vjetorit të USH-së.)” viti 2022,</b>		
<b>1. Lloji i Procedurës së Prokurimit</b> “Procedurë e hapur, e thjeshtuar, REF:43038-09-22-2022	<b>2. Grupi i hartimit i specifikimeve teknike dhe fondit limit:</b> Urdhri nr. 2500/1 prot, datë 03.08.2022 E. S E. D M. P	<b>3. Njësia e Prokurimit</b> Urdhri nr. 2797/1 prot, datë 21.09.2022 S. B J. T A. B
<b>4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b> Urdhri nr. 2797/3 prot, datë 21.09.2022 E. Ç M. K X. Z	<b>5. Fondi Limit (pa TVSh)</b> 2,332,497 lekë	<b>6. Oferta fituese (pa TVSh)</b> 2,332,000 lekë
<b>7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh)</b> 497 lekë	<b>8/1 Data e publikimit të tenderit</b> 05.10.2022	<b>9. Burimi Financimit</b> Fondet e Buxheti i Shtetit
<b>10. Operoret Ekonomike</b> a) Pjesëmarrës në tender 1 BOE; Fitues BOE “T”sh.p.k me NUIS M & “A” sh.p.k me NUIS L,	<b>8/2 Kohëzgjatja e kontratës</b> Nga data e nënshkrimit të kontratës deri me datë 31.10.2022.	<b>11. Përgjigje Ankesës AK</b>
<b>12. Ankimim</b> Jo	<b>13. Përgjigje Ankesës AK</b>	<b>14. Përgjigje Ankesës nga KKP</b>
<b>b. Zbatimi i Kontratës Prokurimit</b>		
<b>15. Lidhja e kontratës</b> Kontrata me nr, 279717 prot datë 26.10.2022 dhe afati për	<b>Zbatimi i kontratës:</b> Me urdhër nr, 2797/14 datë 25.10.2022 është ngritur komisioni për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës.	

shërbimit është deri me datë  
31.10.2022.

**-Auditimi i hartimit të fondit limit, vendosjen e specifikimeve teknike dhe hartimi i kriterëve të DST.**

Me Urdhrin e Titullarit të AK nr, 2500/1 prot, datë 03.08.2022 është ngritur grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe përlogaritjen e fondit limit, si më poshtë:

**Hartimi i specifikimeve teknike dhe përlogaritja e fondit limit:**

- E. S
- E. D
- M. P

Me proces-verbal me nr, 2797 prot datë 21.09.2022, Komisioni për hartimin e specifikimeve teknike dhe përlogaritjes së fondit limit ka paraqitur studimin e tregut për përcaktimin e fondit limit, i cili është 2,332,497 lekë pa TVSh dhe ka hartuar specifiket teknike, disa nga specifikimet teknike si me poshtë vijon:

- 1, Libër per ceremoninë e 65 vjetorit të USH-së 500 cope
- 2, Libër me portrete te spikatura te Prof te USH-së 500 cope
- 3, Fletëpalosje 500 cope
- 4, Poster 70x50 cm 50 cope
- 5, Spila 800 cope

**-Mbi auditimin e realizimit të procedurës në bazë të DT dhe përzgjedhja e operatorit ekonomik fitues.**

Urdhri nr. 2797/3 prot, datë 21.09.2022, Titullari i AK , ka ngritur Komisionin e Vlerësimit të Ofertave (KVO), të përbërë nga:

- Z. E. Ç., Kryetar
- Znj. M. K., Anëtare
- Z. Xh. Z., Anëtare

Me procesverbal me nr, 2797/9 datë 17.10.2022 u be hapja e oferta te dorëzuara për procedurën e prokurimit ku morën pjese 1 BOE.

Nr	Operatori ekonomi	Oferta lekë pa TVSh	Kualifikuar/S'kualifikua
1	"T" sh.p.k me NUIS M & "A" sh.p.k me NUIS L,	2,332,000	Kualifikuar dhe shpallur fitues

Sa më sipër, oferta e shpallur fituese me shkresë nr 2797/12 datë 24.10.2022 është e BOE "T" sh.p.k me & "A" sh.p.k, me ofertën ekonomike në vlerën 2,332,000 lekë pa TVSh ose 2,798,400 me TVSh, KVO citon se brenda 2 ditësh duhet të dorëzohet sigurimi i kontratës.

**Grupi i auditimi konstatoi mangësitë si me poshtë vijon:**

**1:** Dokumentet e dorëzuara nga operatorët ekonomik fitues në përmbushje të kërkesave të vendosura në DT nuk protokollohen në zyrën e arkiv protokollit nga OE. Dokumentacioni merret në dorëzim nga komisioni i vlerësimit të oferta i cili mban dhe një procesverbal me dokumentet e mare në dorëzim dhe me pas protokollat pranë AK sipas proces verbal nr. 2797/14 datë 25.12.2022. *Veprime në kundërshtim me Referuar nenit 18 te Normave tekniko-profesionale te shërbimit arkivor ne Republikën e Shqipërisë, ne mbështetje te Ligjit nr. 9154 datë 06.11.2003 "Për arkivat", procesverbalet e mbledhjeve kanë të gjitha elementët e dokumenteve të brendshme dhe*

duhet te protokollohen. Referuar nenit 19 te po ketij akti, te gjitha dokumentet qe krijohen nga subjekti shtetëror apo jo shtetëror si dhe ato qe vijne nga subjekte te tjera, evidencohen ne regjistrin e korrespondencës. Dokumentet qe formojne një praktikë dhe qe kanë lidhje organike ndërmjet tyre marrin ne regjistrin e korrespondencës një numër rendor të veçantë. Dokumenti i parë qe krijohet nga vetë organi apo qe vjen ne adresë te tij, merr numër rendor të plotë, ndërsa dokumentet e tjera qe kanë lidhje me të evidencohen me të njëjtin numër e progresivisht me fraksion deri ne mbylljen e praktikës.

**2:** BOE fitues "T" sh.p.k & "A" sh.p.k nuk kanë paraqitur vërtetim për kriteret si me poshtë vijon:

**1. Kriteret e përgjithshme për kualifikimit,**

c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;

- Oe Alb-Korrekt nuk ka dorëzuar vërtetim për pagesën e energjisë elektrike.
- Oe Tetea nuk ka dorëzuar vërtetim për pagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore,

**Veprimet në kundërshtim me LPP nr. 162 dt. 23.12.2020, "Për prokurimin publik" Neni 76 Kriteret detyruese për skualifikim, VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 neni 88 citon Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit.**

**2. Kriteret e Veçanta për kualifikim-Kapaciteti Teknik.**

- Pika 2.4.1, OE T. ka paraqitur ISO 9001:2015, por certifikata është për prodhimin e paletës (*Pelet Production, Manufacturing*) dhe nuk ka te beje me objektin e prokurimit i cili është Shërbime të printimit dhe publikimit (për ceremoninë e 65 vjetorit të USH-së).
- Tek DT Shtojca nr, 7 **Termet e Referencës** është kërkuar që OE të ketë staf profesional dhe të kualifikuar **me regjisor, skenarist, operatorë e montazheri video e audio.**

Për plotësimin e kriterit të mësipërm OE ekonomik Tetea ka paraqitur liste pagës ku deklaron 1 punonjës të punësuar i cili është në rolin e administratorit.

Ndërsa OE A ka 4 punonjës të deklaruar gjate 3 muajve të fundit, me rolet: 1 administratori, dy punonjës Punëtor shërbimi në shtëpi dhe 1 punonjës Bojaxhi për ndërtesa.

**Për sa me sipër KVO** nuk ka respektuar kërkesat e vendosura në DT nga Komisioni i specifikimeve teknike. **Veprimet në kundërshtim me LPP nr. 162 dt. 23.12.2020, "Për prokurimin publik" Neni 92** Shqyrtimi i ofertave pika 3 citon: *Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji, dhe VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 Neni 82 Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave pika 2 citon: Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme.*

**Mbajnë përgjegjësi për veprimet dhe mos veprimet e tyre:** z, E. Ç znj, M. K dhe z, X. Z

**-Lidhja e kontratës.**

Kontrata midis AK dhe OE është me nr, 279717 prot datë 26.10.2022 dhe afati për shërbimit është deri me datë 31.10.2022.

**-Zbatimi i kontratës.**

Me urdhër nr, 2797/14 datë 25.10.2022 është ngritur komisioni për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës me përbërje si me poshtë:

Z, I. H.

Znj, D. L.

Znj, H. D.

Znj, E. B.

Znj, A. B.

Komisioni i zbatimit të kontratës ka mbajtur proces-verbal me nr, 2797/20 prot datë 31.10.2022 komisioni për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës shprehet se malli dhe shërbimi janë konform specifikimeve të përcaktuara në kontratë.

Fatura tatimore është paraqitur nga OE me nr, 36/2022, datë 31.10.2022 ndërsa likuidimi i faturës është kryer me urdhër shpenzim nr, 449 datë 15.12.2022 në vlerën 2,798,400 lekë.

Me fletë hyrje nr, 15 datë 31.10.2022 është bërë hyrje në magazinë malli si me poshtë vijon:

1. Libra për ceremoninë 65 vjetori USH
2. Libra me portrete të profileve të USH
3. Fletë palosje.
4. Poster 70x50
5. Tabelë ndriçimi (me logo).
6. Spila.

**Grupi i auditimit konstatoi** se komisioni i zbatimit të kontratës pas përfundimit të aktivitetit nuk ka bërë hyrje në magazine.

1. Realizim Dokumentari 65 vjetorit i USH i cili është në vlerën 999,403 lekë.

2. Shërbim Fotografije dhe regjistrim video e audio me CD të 65 vjetorit të USH i cili është në vlerën 180,000 lekë.

Grupi i auditimit verifikoi se artikulli nr.1 “Realizim Dokumentari 65 vjetorit i USH” gjenden në ambientet e USH.

Ndërkohë për sa i përket Artikullit nr.2 “Shërbim Fotografije dhe regjistrim video e audio me CD të 65 vjetorit të USH i cili është në vlerën 180,000 lekë” fotografit janë venë në dispozicion të grupit të auditimit por nuk janë sipas specifikimeve të kërkuar në DT i cili citon “ Shërbim video/ foto të organizuara sipas kërkesave të USH, regjistrim audio, editim, finalizim, dorëzim pamjeve bruto për arkivë. **I gjithë eventi do regjistrohet dhe në fund të tij do dorëzohet materiali bruto dhe i përpunuar në formën e një dokumentari për gjithë eventin, Regji, kamera HD , duhet të jete në dispozicion të aktivitetit për një mbulim optimal. Sipas nevojës duhet të krijohen lidhje direkte brenda eventit**”

Veprime në kundërshtim me *UDHËZIM Nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pika 42, 43, 44 dhe 122.*

**Mbajnë përgjegjësi për veprimet dhe mos veprimet e tyre:** Z, I. H, znj, D. L, znj, H. D, znj, E. B dhe znj, A. B.

## 2. Procedura e prokurimit “Blerje Gazoil”, me fond limit 1,000,000 pa TVSH,

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje Gazoil”. Viti 2022.			
<b>1. Lloji i Procedurës së Prokurimit</b> “Procedurë e hapur, : E hapur, e thjeshtuar, REF : 49862-11-14-2022	<b>2. Grupi i hartimit i specifikimeve teknike dhe fondit limit:</b>	<b>3. Njësia e Prokurimit</b> Urdhri nr. 3474 prot, datë 10.11.2022 R. B S. B S. L	<b>4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b> Urdhri nr. 3474/1 prot, datë 10.11.2022 A. C A. D N. R
<b>5. Fondi Limit (pa TVSh) 1,000,000 lekë</b>	<b>6. Oferta fituese (pa TVSh)</b> 8 lek marzhi i fitimit lekë		<b>7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh)</b>
<b>8/1 Data e publikimit të tenderit</b> 14.11.2022	<b>9. Burimi Financimit</b> Fondet e Buxheti i Shtetit		<b>10. Operatorët Ekonomike</b> a) Pjesëmarrës në tender <b>2 OE;</b> <b>1: Kualifikuar 2 OE</b> <b>2. Fitues OE “R – E” me</b>
<b>8/2 Kohëzgjatja e kontratës</b> Nga data e nënshkrimit të			

kontratës deri me datë 31.12.2022.		marzh fitimi 8 lek.
<b>12. Ankimim Jo</b>	<b>13. Përgjigje Ankesës AK</b>	<b>14. Përgjigje Ankesës nga KKP</b>
<b>b. Zbatimi i Kontratës Prokurimit</b>		
<b>15. Lidhja e kontratës</b> Kontrata me nr, 3474/10 prot datë 22.12.2022 me afat deri me datë 31.12.2022.	<b>Zbatimi i kontratës:</b> Me urdhër nr, 3474/14 datë 28.12.2022 është ngritur komisioni për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës.	

***-Auditimi i hartimit të fondit limit, vendosjen e specifikimeve teknike dhe hartimi i kriterëve të DST.***

Me Urdhrin e Titullarit të AK nr, 3474 prot, datë 10.11.2022 është ngritur Njësia e prokurimit si më poshtë:

**Njësia e prokurimit:**

- R. B.
- S. B.
- S. L.

Me proces-verbal me pa nr prot dhe pa datë, Njësia e prokurimit ka hartuar specifiket teknike dhe me shkresë 3474/5 datë 18.11.2022 ka modifikuar kriteret sipas rekomandimit dhe asistencës së APP, disa nga specifikimet teknike si me poshtë vijon:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme me një vlere jo me te vogël se 40% e vlerës që prokurohet, të kryera gjatë tri viteve të fundit.

**Grupi i Auditimit konstatoi** se në procedurën e prokurimit nuk është ngritur komisioni për hartimin e fondit limit në kundërshtim me VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 neni 76 “Mënyrat për përlllogaritjen e vlerës së prokurimit”.

Gjithashtu njësia e prokurimit për përvojat e mëperpashme ka kërkuar që OE të paraqis dëshmi për një vlerë prej 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës por në kundërshtim me VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 neni 55 pika 4 shkronja b citon: *Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.*

**Mbajnë përgjegjësi për veprimet dhe mos veprimet:** Administratori i USH Znj, S. A. dhe njësia e prokurimit z, R. B, znj, S. B, znj, S. L.

***-Mbi auditimin e realizimit të procedurës në bazë të DT dhe përzgjedhja e operatorit ekonomik fitues.***

Urdhri nr. 3474/1 prot, datë 10.11.2022, Administratori i USH , ka ngritur Komisionin e Vlerësimit të Ofertave (KVO), të përbërë nga:

- Z. A. C.
- Znj. A. D.
- Znj. N. R.

Me procesverbal me nr, 3474/6 datë 12.12.2022 u be hapja e oferta te dorëzuara për procedurën e prokurimit ku morën pjese 2 OE.

Nr	Operatori ekonomi	Oferta lekë pa TVSh	Kualifikuar/S'Kualifikuar
4	OE "R – E	8 leke marzhi fitimit.	Kualifikuar dhe shpallur fitues.
5	2. OE A	14.8 lekë marzhi fitimi.	Kualifikuar.

Sa më sipër, oferta e shpallur fituese me proces verbal nr. 3474/7 datë 14.12.2022 është e OE "R – E me marzh fitimi 8 leke per litër.

Formulari i njoftimit të fituesit është me shkresë nr. 3474/8 datë 14.12.2022.

Me proces verbal nr. 3474/9 datë 21.12.2022 KVO mori ne dorëzim dokumentacioni e OE fitues.

### **Grupi i auditimit konstatoi mangësitë si me poshtë vijon:**

**1:** Lidhja e kontratës është nënshkruar me date 22.12.2022 ndërsa në SPE është publikuar me date 09.02.2023.

Shtesa e kontratës është hartuar me date 31.12.2022 ndërsa në SPE është publikuar me date 09.02.2023. Veprime e mësipërme janë kundërshtim me VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 i ndryshuar, Neni 2 Dokumentimi i procesit 1. Autoriteti/enti kontraktor duhet të administrojë të gjithë dokumentacionin për procedurën e prokurimit, duke filluar nga planifikimi i saj deri te zbatimi i kontratës. Për këtë qëllim, autoriteti/enti kontraktor duhet të mbajë procesverbale dhe dokumentacion të plotë për procedurat e kryera, Neni 86 Publikimi i njoftimit të lidhjes së kontratës Pas nënshkrimit të kontratës, **brenda 5 (pesë) ditëve**, autoriteti/enti kontraktor dërgon për publikim në sistemin e prokurimit elektronik dhe/ose Buletinin e Njoftimeve Publike njoftimin e kontratës së nënshkruar

**2:** Dokumentet e dorëzuara nga operatorët ekonomik fitues në përmbushje të kërkesave të vendosura në DT nuk protokollohen në zyrën e arkiv protokollit nga OE. Dokumentacioni merret në dorëzim nga komisioni i vlerësimit të oferta i cili mban dhe një procesverbal me dokumentet e mare në dorëzim dhe me pas protokollat pranë AK sipas proces verbal nr. 3474/9 datë 21.12.2022. Veprime në kundërshtim Referuar nenit 18 te Normave tekniko-profesionale te shërbimit arkivor ne Republikën e Shqipërisë, ne mbështetje te Ligjit nr. 9154 datë 06.11.2003 "Për arkivat", procesverbalet e mbledhjeve kanë të gjitha elementët e dokumenteve të brendshme dhe duhet te protokollohen. Referuar nenit 19 te po këtij akti, të gjitha dokumentet që krijohen nga subjekti shtetëror apo jo shtetëror si dhe ato që vijnë nga subjekte të tjera, evidencohen në regjistrin e korrespondencës. Dokumentet që formojnë një praktikë dhe që kanë lidhje organike ndërmjet tyre marrin në regjistrin e korrespondencës një numër rendor të veçantë. Dokumenti i parë që krijohet nga vetë organi apo që vjen në adresë të tij, merr numër rendor të plotë, ndërsa dokumentet e tjera që kanë lidhje me të evidencohen me të njëjtin numër e progresivisht me fraksion deri në mbylljen e praktikës.

**3:** AK ka mbyllur procesin e vlerësimit te ofertave ne SPE me datë 14.12.2022 dhe ka shpallur fitues OE Resuli me shkresë nr, 3474/8 prot, datë 14.12.2022. AK ka publikuar njoftimin e fituesit pa respektuar afatet e sjelljes së dokumentacionit të plotë fizik dhe rrjedhimisht pa kryer verifikimin e dokumentacionit të OE të shpallur fitues. Veprime në kundërshtim me VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 i ndryshuar Neni 26 Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit pika 6 citon: "përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i" dhe "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

**Mbajnë përgjegjësi për veprimet dhe mos veprimet:** z, A. C, znj, A. D, z, N. R, Administratori z, A. U dhe personi përgjegjës për prokurimin znj, S. B.

***-Lidhja e kontratës.***

Kontrata midis AK dhe OE është me nr, 3471/10 prot datë 22.12.2022 dhe afati për shërbimit është deri me datë 31.12.2022.

Me datë 31.12.2022, nr 3474/16 prot është hartuar shtesë kontrate me afat deri me datë 01.04.2023, me arsyetimin “Pamundësi ne depozitimim ne USH të sasisë së parashikuar ne kontratë.

***-Zbatimi i kontratës.***

Me urdhër nr, 3474/14 datë 28.12.2022 është ngritur komisioni për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës me përbërje si me poshtë:

Znj, E. V

Z, S. I

Znj, A. B.

Z, H. S.

Z, G. T.

Z, B. H.

**3. Procedura e prokurimit “Shpenzime Pritje përcjellje”, me fond limit 620,000 pa TVSH,**

<b>Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Shpenzime Pritje përcjellje” viti 2022</b>			
<b>1. Lloji i Procedurës së Prokurimit</b> “Procedurë e hapur, : E hapur, e thjeshtuar, <b>REF-44345-10-04-2022</b>	<b>2. Grupi i hartimit i specifikimeve teknike dhe fondit limit:</b> Urdhër nr, 2500 prot, datë 02.08.2022 S. L E. D M. L	<b>3. Njësia e Prokurimit</b> Urdhri nr. 2889/1 prot, datë 30.09.2022 R. B S. B J. T	<b>4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b> Urdhri nr. 2889/3 prot, datë 03.10.2022 E. V D. K S. I
<b>5. Fondi Limit (pa TVSh)</b> 620,000 lekë	<b>6. Oferta fituese (pa TVSh)</b> 610,000 lekë		<b>7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh)</b> 10,000 lekë
<b>8/1 Data e publikimit të tenderit</b> 05.10.2022	<b>9. Burimi Financimit</b> Fondet e Buxheti i Shtetit		<b>10. Operatorët Ekonomike</b> a) Pjesëmarrës në tender <b>1 OE;</b> <b>1.</b> OE “G” i shpallur fitues
<b>8/2 Kohëzgjatja e kontratës</b> Kontrata do të realizohet me datat 27-28.10.2022			
<b>12. Ankimim</b> Jo	<b>13. Përgjigje Ankesës AK</b>	<b>14. Përgjigje Ankesës nga KKP</b>	
<b>b. Zbatimi i Kontratës Prokurimit</b>			
<b>15. Lidhja e kontratës</b> Kontrata me nr, 2889/13 prot datë 26.10.2022	<b>Zbatimi i kontratës:</b> Me urdhër 2889/10 datë 26.10.2022 është ngritur komisioni për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës.		

***-Auditimi i hartimit të fondit limit, vendosjen e specifikimeve teknike dhe hartimi i kriterëve të DST.***

Me proces-verbal me nr, 2889 prot datë 29.09.2022, Komisioni për hartimin e specifikimeve teknike dhe përlllogaritjes së fondit limit ka paraqitur studimin e tregut për përcaktimin e fondit limit, i cili është 620,000 lekë pa TVSh.

***-Mbi auditimin e realizimit të procedurës në bazë të DT dhe përzgjedhja e operatorit ekonomik fitues.***

Urdhri nr. 2889/3 prot, datë 03.10.2022, Titullari i AK , ka ngritur Komisionin e Vlerësimit të Ofertave (KVO), të përbërë nga:

Znj. E. V, Kryetar

Znj. D. K, Anëtar

Z. S. I, Anëtar

Me procesverbal me nr, 2889/5 datë 17.10.2022 u be hapja e oferta te dorëzuara për procedurën e prokurimit ku mori pjese 1 OE.

Nr	Operatori ekonomi	Oferta lekë pa TVSh	Kualifikuar/S'Kualifikuar
1	OE "G" shpk	610,000 lekë.	Kualifikuar dhe shpallur fitues.

Sa më sipër, oferta e shpallur fituese me shkresë "Formulari i njoftimit të fituesit" nr 2889/7 datë 18.10.2022 është e OE "G. G." sh.p.k, me ofertën ekonomike në vlerën 610,000 lekë pa TVSh ose 732,000 me TVSh.

Me shkresë nr 2889/8 datë 25.10.2022 KVO njofton OE se pas mbarimit te afateve të ankimimit duhet te paraqit për te lidhur kontratën brenda 2 ditëve nga ky njoftim.

**Grupi i auditimi konstatoi mangësitë si me poshtë vijon:**

**1:** Dokumentet e dorëzuara nga operatorët ekonomik fitues në përmbushje të kërkesave të vendosura në DT nuk protokollohen në zyrën e arkiv protokollit nga OE. Dokumentacioni merret ne dorëzim nga komisioni i vlerësimit të oferta i cili mban dhe një procesverbal me dokumentet e mare në dorëzim dhe me pas protokollat pranë AK sipas proces verbal nr. 2889/9 datë 25.10.2022. *Veprime në kundërshtim me Referuar nenit 18 te Normave tekniko-profesionale te shërbimit arkivor ne Republikën e Shqipërisë, ne mbështetje te Ligjit nr. 9154 datë 06.11.2003 "Për arkivat", procesverbalet e mbledhjeve kanë të gjitha elementët e dokumenteve të brendshme dhe duhet te protokollohen. Referuar nenit 19 te po këtij akti, të gjitha dokumentet që krijohen nga subjekti shtetëror apo jo shtetëror si dhe ato që vijnë nga subjekte të tjera, evidencohen në regjistrin e korrespondencës. Dokumentet që formojnë një praktikë dhe që kanë lidhje organike ndërmjet tyre marrin në regjistrin e korrespondencës një numër rendor të veçantë. Dokumenti i parë që krijohet nga vetë organi apo që vjen në adresë të tij, merr numër rendor të plotë, ndërsa dokumentet e tjera që kanë lidhje me të evidencohen me të njëjtin numër e progresivisht me fraksion deri në mbylljen e praktikës.*

**2:** KVO ka mbyllur procesin e vlerësimit të ofertave ne SPE dhe ka mbajtur proces verbal me nr, 2889/6 datë 17.10.2022. AK ka publikuar njoftimin e fituesit me shkresë nr. 2889/7 datë 18.10.2022 por pa respektuar afatet e sjelljes së dokumentacionit të plotë fizik dhe rrjedhimisht pa kryer verifikimin e dokumentacionit të OE të shpallur fitues. *Veprime në kundërshtim me VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 i ndryshuar Neni 26 Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit pika 6 citon: "Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i" dhe "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.*

**Mbajnë përgjegjësi për veprimet dhe mos veprimet e tyre:** znj, E. V, znj, D. K dhe z, S. I dhe Administratori i komanduar znj, S. A.

**-Lidhja e kontratës.**

Kontrata midis AK dhe OE është me nr, 2889/13 prot datë 26.10.2022 dhe afati për shërbimit është data 27-28.10.2022.

**-Zbatimi i kontratës.**

Me urdhër nr, 2984/20 datë 26.12.2023 është ngritur komisioni për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës i përberë nga:

Znj. O. S

Znj. S. Z

Znj. E. G

Komisioni i zbatimit të kontratës ka mbajtur proces-verbale me nr 2889/16 datë 31.10.2022 ku shprehet se komisioni verifikoj dhe konstatoi se shërbimi u mor konform specifikimeve të kontratës. Fatura tatimore është lëshuar me nr22/2022 datë 31.10.2022 dhe likujdimi është kryer me USH nr, 459 date 29.12.2022 në vlerën 610,000 lekë.

**4. Procedura e prokurimit “Blerje për Laboratorin e Analizave të Ushqimeve”, me fond limit 12,335,000 pa TVSH,**

<b>Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje për Laboratorin e Analizave të Ushqimeve viti 2022”</b>		
<b>1. Lloji i Procedurës së Prokurimit</b> “Procedurë e hapur, <b>REF-39230-08-18-2022</b> ”	<b>2. Grupi i hartimit i specifikimeve teknike dhe fondit limit:</b> Urdhri nr. 2526 prot, datë 15.08.2022 J. P S. L E. S	<b>3. Njësia e Prokurimit</b> Urdhri nr. 2526/2 prot, datë 15.08.2022 S. B A. M D. K
		<b>4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b> Urdhri nr. 2526/4 prot, datë 15.08.2022 D. U E. D S. I
<b>5. Fondi Limit (pa TVSh)</b> 12,335,000 lekë	<b>6. Oferta fituese (pa TVSh)</b> 12,056,800 lekë	<b>7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh)</b> 278,200 lekë
<b>8/1 Data e publikimit të tenderit</b> 22.08.2022	<b>9. Burimi Financimit</b> Fondet e Buxheti i Shtetit	<b>10. Operatorët Ekonomike</b> a) Pjesëmarrës në tender <b>2 OE;</b> <b>1.</b> Kualifikuar 2 OE <b>2 .</b> Fitues I shpk
<b>8/2 Kohëzgjatja e kontratës</b> 60 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës.		
<b>12. Ankimim</b> Jo	<b>13. Përgjigje Ankesës AK</b>	<b>14. Përgjigje Ankesës nga KKP</b>
<b>b. Zbatimi i Kontratës Prokurimit</b>		
<b>15. Lidhja e kontratës</b> Kontrata me nr, 2526/14 prot datë 06.10.2022	<b>Zbatimi i kontratës:</b> Me urdhër nr, 2526/16 datë 13.10.2022 është ngritur komisioni për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës.	

**-Auditimi i hartimit të fondit limit, vendosjen e specifikimeve teknike dhe hartimi i kritereve të DST.**

Me Urdhrin e Titullarit të AK nr. 68 prot, datë 15.08.2022 është ngritur grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe përlllogaritjen e fondit limit, si më poshtë:

**-Hartimi i specifikimeve teknike dhe përlllogaritja e fondit limit:**

J. P.

S. L.

E. S.

Me proces-verbal me nr, 2526/1 prot datë 15.08.2022, Komisioni për hartimin e specifikimeve teknike dhe përlllogaritjes së fondit limit ka paraqitur studimin e tregut për përcaktimin e fondit limit, i cili është **12,335,000** lekë pa TVSh dhe ka hartuar specifiket teknike, për 30 pajisjet laboratorike.

**Grupi i Auditimit konstatoi se nuk janë argumentuar specifikimet teknike të kërkuara për pajisjet laboratorike. Veprime në kundërshtim me LPP nr. 162 dt. 23.12.2020 Neni 36 si dhe VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 neni 78 pika 2, . Hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret për shpalljen e ofertës fituese (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit. Në varësi të objektit të prokurimit, nëse nuk është vlerësuar e nevojshme caktimi i një specialisti fushe, hartimi i kërkesave si më sipër bëhet nga njësia e prokurimit. Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërish, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit.**

**Mbajnë përgjegjësi për veprimet dhe mos veprimet: z. J. P. znj. S. L dhe z. E. S.**

**-Mbi auditimin e realizimit të procedurës në bazë të DT dhe përzgjedhja e operatorit ekonomik fitues.**

Urdhri nr. 2526/4 prot, datë 15.08.2022, Titullari i AK , ka ngritur Komisionin e Vlerësimit të Ofertave (KVO), të përbërë nga:

Z. D. U, Kryetar

Z. S. I, Anëtare

Znj. E. D, Anetar

Me procesverbal me nr, 2526/6 datë 06.09.2022 u be hapja e oferta te dorëzuara për procedurën e prokurimit ku morën pjesë 2 OE si me poshtë:

Nr	Operatori ekonomi	Oferta lekë pa TVSh	Kualifikuar/S'Kualifikuar
1	OE "I" shpk	12,056,800 lekë.	Kualifikuar dhe shpallur fitues.
2	OE "K" Shpk	12,231,000 lekë	Kualifikuar.

Sa më sipër, oferta e shpallur fituese me shkresë "Formulari i njoftimit të Fituesit" nr, 2526/8 datë 12.09.2022 është e OE "I" shpk, me ofertën ekonomike në vlerën 12,056,800 lekë pa TVSh ose 14,468,160 me TVSh.

**Grupi i auditimit konstatoi mangësitë si me poshtë vijon:**

**1.** Dokumentet e dorëzuara nga operatorët ekonomik fitues në përmbushje të kërkesave të vendosura në DT nuk protokollohen në zyrën e arkiv protokollit nga OE. Dokumentacioni merret ne dorëzim nga komisioni i vlerësimit të oferta i cili mban dhe një procesverbal me dokumentet e mare në dorëzim dhe me pas protokollat pranë AK sipas proces verbal nr. 2526/11 datë 27.09.2022. Veprime në kundërshtim Referuar nenit 18 te Normave tekniko-profesionale te shërbimit arkivor ne Republikën e Shqipërisë, ne mbështetje te Ligjit nr. 9154 datë 06.11.2003 "Për arkivat", procesverbalet e mbledhjeve kanë të gjitha elementët e dokumenteve të brendshme dhe duhet te protokollohen. Referuar nenit 19 te po këtij akti, të gjitha dokumentet që krijohen nga subjekti shtetëror apo jo shtetëror si dhe ato që vijnë nga subjekte të tjera, evidencohen në regjistrin e korrespondencës. Dokumentet që formojnë një praktikë dhe që kanë lidhje organike ndërmjet tyre marrin në regjistrin e korrespondencës një numër rendor të veçantë. Dokumenti i parë që krijohet nga vetë organi apo që vjen në adresë të tij, merr numër rendor të plotë, ndërsa dokumentet e tjera që kanë lidhje me të evidencohen me të njëjtin numër e progresivisht me fraksion deri në mbylljen e praktikës.

**2:** KVO ka mbyllur procesin e vlerësimit të ofertave ne SPE dhe ka mbajtur proces verbal me nr, 2526/7 datë 12.09.2022. AK ka publikuar njoftimin e fituesit me shkresë nr. 2526/8 datë

12.09.2022. por pa respektuar afatet e sjelljes së dokumentacionit të plotë fizik dhe rrjedhimisht pa kryer verifikimin e dokumentacionit të OE të shpallur fitues. Veprime në kundërshtim me VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 i ndryshuar Neni 26 Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit pika 6 citon: "Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i" dhe "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

**Mbajnë përgjegjësi për veprimet dhe mos veprimet:** z. D. U, znj. E. D, z. S. I dhe administratori i komanduar znj. S. A.

#### **-Lidhja e kontratës.**

Kontrata midis AK dhe OE është me nr, 2526/14 prot datë 06.10.2022 dhe afati për shërbimit është 60 dite nga nënshkrimi i kontratës.

Me shkresë 2526/19 datë 06.12.2022 OE ka paraqitur kërkesë për shtyrje afati të kontratës me arsyetim "vonesa ne disa artikuj për shkak të mungesës së lëndës se parë ne Kine dhe Euroje".

AK me nr 2526/21 date 06.12.2022 ka lidhur shtese kontratë deri me datë 31.12.2022.

**Grupi i auditimi konstatoi** se kontrata e parë është nënshkruar me datë 06.10.2022 dhe përfundon brenda 60 ditëve nga nënshkrimi i saj ose me datë 05.12.2022.

Ndërkohe që shtesa e kontratës është lidhur me datë 06.12.2022 kur ka përfunduar kontrata e pare, por çdo ndryshim kontrate mund te behet vetëm gjate kohëzgjatjes se tyre. Veprime në kundërshtim me LPP nr. 162 dt. 23.12.2020 neni 127 Modifikimi i kontratave gjatë afatit të tyre si dhe VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 i ndryshuar Neni 23 Njoftimi i modifikimit të kontratës gjatë kohëzgjatjes së saj

**Mbajnë përgjegjësi për veprimet dhe mos veprimet:** Administratori i USHLG z. A. U.

#### **-Zbatimi i kontratës.**

Me urdhër nr, 2526/16 datë 13.10.2022 është ngritur komisioni për marrjen në dorëzim si me poshtë:

Znj. M. N.

Znj. Z. T.

Znj. A. B.

Komisioni për marrjen në dorëzim ka mbajtur disa proces-verbal si me poshtë vijon:

**1:** Proces verbal me nr, 2526/18 prot datë 17.11.2022 komisioni shprehet se malli u mor konform specifikimeve të përcaktuara në kontratë me vlerë 8,111,400 lekë pa TVSh dhe 9,733,680 lekë me TVSh.

Fatura tatimore është paraqitur nga OE me nr, 89/2022, datë 17.11.2022 ndërsa likuidimi i faturës është kryer me urdhër shpenzim nr, 435 datë 05.12.2022 në vlerën 9,733,680 lekë.

Me fletë hyrje nr, 15 datë 17.11.2022 është bërë hyrje në magazinë.

**2:** Proces verbal me nr, 2526/20 prot datë 06.12.2022 komisioni shprehet se malli u mor konform specifikimeve të përcaktuara në kontratë me vlerë 204,000 lekë pa TVSh dhe 244,800 lekë me TVSh.

Fatura tatimore është paraqitur nga OE me nr, 97/2022, datë 06.12.2022 ndërsa likuidimi i faturës është kryer me urdhër shpenzim nr, 462 datë 22.12.2022 në vlerën 244,800 lekë.

Me fletë hyrje nr, 16 datë 06.12.2022 është bërë hyrje në magazinë.

**3:** Proces verbal me nr, 2526/22 prot datë 30.12.2022 komisioni shprehet se malli u mor konform specifikimeve të përcaktuara në kontratë me vlerë 3,741,400 lekë pa TVSh dhe 4,489,680 lekë me TVSh.

Fatura tatimore është paraqitur nga OE me nr, 123/2022, datë 30.12.2022 ndërsa likuidimi i faturës është kryer me urdhër shpenzim nr, 490 datë 30.12.2022 në vlerën 4,489,680 lekë.  
Me fletë hyrje nr, 19 datë 30.12.2022 është bërë hyrje në magazinë.

**Grupi i auditimi konstatoi** se kohëzgjatja e kontratës me nr, 2526/14 prot, datë 06.10.2022 është 60 ditë dhe mbaron me datë 05.12.2022.

Ndërkohë me date 06.12.2022 janë mare në dorëzim pajisjet (procesverbali nr,2) ose 1 ditë me vonesë.

Diferenca midis vlerës totale dhe shumës së marre ne dorëzim është 4,734,480 lekë me TVSh (14,468,160 vlera totale e kontratës - 9,733,680 mare ne dorëzim brenda afatit = 4,734,480 lek).

$4/1000 \times 4,734,480 = 18,938$  lekë me TVSh penaliteti ditor.

18,938 lekë me TVSh x 1 ditë = **18,938** lekë me TVSh i cili është penaliteti për 1 ditë vonesë.

Me datë 30.12.2022 është marë në dorëzim pjesa e mbetur e pajisjeve ose 24 ditë me vonesë.

Diferenca midis vlerës totale dhe shumës së marre ne dorëzim është 4,489,680 lekë me TVSh (14,468,160 vlera totale e kontratës - 9,978,480 mare ne dorëzim = 4,489,680 lek).

$4/1000 \times 4,489,680 = 17,959$  lekë me TVSh penaliteti ditor.

17,959 lekë me TVSh x 24 ditë = **431,009** lekë me TVSh i cili është penaliteti për 24 ditë vonesë.

Në total penaliteti është 18,938 lekë + 431,009 lekë = **449,947** lekë me TVSh.

**Mbajnë përgjegjësi për veprimet dhe mos veprimet e tyre:** Administratori i USHLG z, A. U.

### 5. Procedura e prokurimit “Blerje Kancelari”, me fond limit 3,208,327 pa TVSH,

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje Kancelari” viti 2022			
<b>1. Lloji i Procedurës së Prokurimit</b> “Procedurë e hapur, e thjeshtuar, <b>REF: 45689-10-13-2022</b> ”	<b>2. Grupi i hartimit i specifikimeve teknike dhe fondit limit:</b> Urdhri nr. 2500 prot, datë 02.08.2022 M. P L. L S. I	<b>3. Njësia e Prokurimit</b> Urdhri nr. 2953/1 prot datë 10.10.2022 R. B S. B E. S	<b>4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b> Urdhri nr. 2953/3 prot, datë 13.10.2022 E. V X. Z R. M
<b>5. Fondi Limit (pa TVSh)</b> 3,208,327 lekë	<b>6. Oferta fituese (pa TVSh)</b> 2,081,871 lekë		<b>7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh)</b> 1,126,456 lekë
<b>8/1 Data e publikimit të tenderit</b> 24.10.2022	<b>9. Burimi Financimit</b> Fondet e Buxheti i Shtetit		<b>10. Operatoret Ekonomike</b> a) Pjesëmarrës në tender <b>5 OE;</b> 1. Kualifikuar 5 OE. 2. Fitues M 2,081,871 lekë.
<b>8/2 Kohëzgjatja e kontratës</b> Deri me date 19.12.2022 nga data e nënshkrimit të kontratës.			
<b>12. Ankimim</b> Jo	<b>13. Përgjigje Ankesës AK</b>		<b>14. Përgjigje Ankesës nga KKP</b>
<b>b. Zbatimi i Kontratës Prokurimit</b>			
<b>15. Lidhja e kontratës</b> Kontrata me nr, 2953/14 prot datë 12.12.2022	<b>Zbatimi i kontratës:</b> Me urdhër 2953/12 datë 02.12.2022 është ngritur komisioni për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës.		

**-Auditimi i hartimit të fondit limit, vendosjen e specifikimeve teknike dhe hartimi i kritereve të DST.**

Me Urdhrin e Titullarit të AK nr. 2500 prot, datë 02.08.2022 është ngritur grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe përlllogaritjen e fondit limit, si më poshtë:

**-Hartimi i specifikimeve teknike dhe përlllogaritja e fondit limit:**

M. P.

L. L.

S. I.

Me proces-verbal me nr, 2953 prot datë 05.10.2022, Komisioni për hartimin e specifikimeve teknike dhe përlllogaritjes së fondit limit ka paraqitur studimin e tregut për përcaktimin e fondit limit, i cili është **3,208,327** lekë pa TVSh dhe ka hartuar specifiket teknike si me poshtë vijon.

*Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme me një vlerë jo me te vogël se 40% e vlerës që prokurohet ne masën 1.283.331 (një milion e dyqind e tetëdhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) Lekë , të kryera gjatë tri viteve të fundit.*

**Grupi i Auditimit konstatoi** se njësia e prokurimit për përvojat e më përparshme ka kërkuar që OE të paraqis dëshmi për një vlerë prej 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës por në kundërshtim me VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 neni 55 pika 4 shkronja b citon: *Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.*

**Mbajnë përgjegjësi për veprimet dhe mos veprimet:** Njësia e prokurimit z. R. B, znj. S. B, z. E S.

***-Mbi auditimin e realizimit të procedurës në bazë të DT dhe përzgjedhja e operatorit ekonomik fitues.***

Urdhri nr. 2953/3 prot, datë 13.10.2022, Titullari i AK , ka ngritur Komisionin e Vlerësimit të Ofertave (KVO), të përbërë nga:

Znj. E. V.

Znj. X. Z.

Znj. R. M.

Me procesverbal me nr, 2953/4 datë 24.10.2022 u be hapja e oferta te dorëzuara për procedurën e prokurimit ku morën pjesë 5 OE si me poshtë:

Nr	Operatori ekonomi	Oferta lekë pa TVSh	Kualifikuar/S'Kualifikuar
1	A	2,389,000	Kualifikuar
2	E	2,818,980	Kualifikuar
3	I	2,661,571.3	Kualifikuar
4	L	3,207,434	Kualifikuar
5	M	2,081,871	Kualifikuar dhe shpallur fitues.

Sa më sipër, oferta e shpallur fituese me shkresë nr, 2953 prot, datë 28.10.2022 është e OE “M” shpk, me ofertën ekonomike në vlerën 2,081,871 lekë pa TVSh ose 2,498,245.2 lekë me TVSh.

KVO ka kërkuar sqarime ndaj OE fitues për ofertën e tij pasi është ofertë anomalisht e ulët.

Me shkresë nr, 2953/6 prot datë 01.11.2022 OE ka paraqitur pranë AK sqarimet për ofertën e tij:

a) anën ekonomike të procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara ose të metodës së

ndërtimit;

b) zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve ose për kryerjen e punës;

c) origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi;

ç) pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës;

d) mundësinë e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore.

Me shkresë nr, 2953/7 datë 02.11.2022 KVO shqyrtoj dokumentacionin e dërguar nga OE dhe vlerësoi për ta shpallur fitues.

Me shkresë nr, 2953/8 datë 02.11.2022 është publikuar formulari i njoftimit të fituesit.

Me shkresë 2953/9 datë 14.11.2022 KVO pas përfundimit të afatit të ankimit ka shpallur fitues OE “M & D” shpk.

Me shkresë nr, 2953/10 datë 21.11.2022 KVO ka mbajtur proces verbalin mbi marrjen në dorëzim dhe shqyrtim e dokumentacionit të OE fitues.

**Grupi i auditimit konstatoi** mangësitë si me poshtë vijon:

**1:** Dokumentet e dorëzuara nga operatorët ekonomik fitues në përmbushje të kërkesave të vendosura në DT nuk janë protokolluar në zyrën e arkiv protokollit nga OE. Dokumentacioni merret në dorëzim nga komisioni i vlerësimit të oferta të cilin mban dhe një procesverbal me dokumentet e mare në dorëzim dhe me pas protokollat pranë AK sipas proces verbal nr, 2953/10 datë 21.11.2022 Veprime në kundërshtim Referuar nenit 18 të Normave tekniko-profesionale të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, në mbështetje të Ligjit nr. 9154 datë 06.11.2003 “Për arkivat”, procesverbalet e mbledhjeve kanë të gjitha elementët e dokumenteve të brendshme dhe duhet të protokollohen. Referuar nenit 19 të këtij akti, të gjitha dokumentet që krijohen nga subjekti shtetëror apo jo shtetëror si dhe ato që vijnë nga subjekte të tjera, evidencohen në regjistrin e korrespondencës. Dokumentet që formojnë një praktikë dhe që kanë lidhje organike ndërmjet tyre marrin në regjistrin e korrespondencës një numër rendor të veçantë. Dokumenti i parë që krijohet nga vetë organi apo që vjen në adresë të tij, merr numër rendor të plotë, ndërsa dokumentet e tjera që kanë lidhje me të evidencohen me të njëjtin numër e progresivisht me fraksion deri në mbylljen e praktikës.

**2:** KVO ka mbyllur procesin e vlerësimit të ofertave në SPE dhe ka mbajtur proces verbal me nr, shkresë 2953/7 datë 02.11.2022. AK ka publikuar njoftimin e fituesit me shkresë nr. 2953/8 prot, datë 02.11.2022, por pa respektuar afatet e sjelljes së dokumentacionit të plotë fizik dhe rrjedhimisht pa kryer verifikimin e dokumentacionit të OE të shpallur fitues. Veprime në kundërshtim me VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 i ndryshuar Neni 26 Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit pika 6 citon: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

**Mbajnë përgjegjësi për veprimet dhe mos veprimet:** znj, E. V, znj, X. Z znj, R. M dhe administratori i komanduar znj, S. A.

**-Lidhja e kontratës.**

Kontrata midis AK dhe OE është lidhur me nr, 2953/14 prot datë 12.12.2022 dhe afati për shërbimit deri me datë 19.12.2022 nga nënshkrimi i kontratës.

### ***-Zbatimi i kontratës.***

Me urdhër nr, 2953/12 datë 02.12.2022 është ngritur komisioni për marrjen në dorëzim si me poshtë:

Znj. N. F

Z. A. C

Znj. A. B.

Komisioni për marrjen në dorëzim ka mbajtur disa proces-verbal si me poshtë vijon:

**1:** Proces verbal me nr, 2953/18 prot datë 19.12.2022 komisioni shprehet se malli u mor konform specifikimeve të përcaktuara në kontratë me vlerë 591,279.6 lekë me TVSh.

Fatura tatimore është paraqitur nga OE me nr, 12221/2022, datë 19.12.2022 ndërsa likuidimi i faturës është kryer me urdhër shpenzim nr, 469 datë 30.12.2022 në vlerën 591,280 lekë.

Me fletë hyrje nr, 16 datë 19.12.2022 është bërë hyrje në magazinë.

**2:** Proces verbal pa nr prot datë 11.01.2023 komisioni shprehet se malli u mor konform specifikimeve të përcaktuara në kontratë me vlerë 638,173. lekë me TVSh.

Fatura tatimore është paraqitur nga OE me nr, 340/2023, datë 11.01.2023 ndërsa likuidimi i faturës është kryer me urdhër shpenzim nr, 44 datë 10.03.2023 në vlerën 462,732 pasi 175,441 lekë janë penalitete për 23 dite vonesë lekë.

Me fletë hyrje nr, 03 datë 11.01.2023 është bërë hyrje në magazinë.

**3:** Proces verbal pa nr, prot datë 11.01.2023 komisioni shprehet se malli u mor konform specifikimeve të përcaktuara në kontratë me vlerë 1,208,432.40 lekë me TVSh.

Fatura tatimore është paraqitur nga OE me nr, 341, datë 11.01.2023 ndërsa likuidimi i faturës është kryer me urdhër shpenzim nr, 45 datë 09.03.2023 në vlerën 1,208,432 lekë.

Me fletë hyrje nr, 04 datë 11.01.2023 është bërë hyrje në magazinë.

### **Blerjet me vlerë të vogël.**

**1.** Nga auditimi i procedura me blerje te vogël grupi i auditimi konstatoi se në 3 procedura në vitin 2022, në 5 procedura në vitin 2023 dhe në 3 procedura ne vitin 2024, dokumentet e dorëzuara nga operatorët ekonomik fitues në përmbushje të kërkesave të vendosura në ftesën për oferte nuk protokollohen në zyrën e arkiv protokollit nga OE. Dokumentacioni merret ne dorëzim nga komisioni i vlerësimit të oferta me vlerë te vogël i cili mban dhe një procesverbal me dokumentet e mare në dorëzim dhe me pas protokollet pranë AK. *Veprime në kundërshtim Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësite e sektorit publik”, i ndryshuar, pika 122, udhëzimin nr.5 datë 25.06.2021 “Mbi Përdorimin e procedurës së prokurimit me vlere te vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike, pika 17. Referuar nenit 18 te Normave tekniko-profesionale te shërbimit arkivor ne Republikën e Shqipërisë, ne mbështetje te Ligjit nr. 9154 datë 06.11.2003 “Për arkivat”, procesverbalet e mbledhjeve kanë të gjitha elementët e dokumenteve të brendshme dhe duhet te protokollohen. Referuar nenit 19 te po këtij akti, të gjitha dokumentet që krijohen nga subjekti shtetëror apo jo shtetëror si dhe ato që vijnë nga subjekte të tjera, evidencohen në regjistrin e korrespondencës. Dokumentet që formojnë një praktikë dhe që kanë lidhje organike ndërmjet tyre marrin në regjistrin e korrespondencës një numër rendor të veçantë. Dokumenti i parë që krijohet nga vetë organi apo që vjen në adresë të tij, merr numër rendor të plotë, ndërsa dokumentet e tjera që kanë lidhje me të evidencohen me të njëjtin numër e progresivisht me fraksion deri në mbylljen e praktikës.*

**Mbajnë përgjegjësi për veprimet dhe mosveprimet e tyre:** Komisioni i blerjeve me vlerë të vogël për vitin 2022 i përbërë nga z, R. B, znj, S. B dhe znj, A. M, komisioni i vitit 2023 dhe 2024 i përbërë nga znj, S. B, znj, M. K dhe znj, S. M.

**Observacion i subjektit mbi Projektin e Auditimit, vënë në dispozicion grupit të auditimit në datë 27.03.2025 me nr.1101/11 prot.**

**Pretendimi i subjektit:** Si pjesë e komisionit të blerjeve të vogla, sqarojmë se sipas rregullave të sektorit të protokollit të institucionit tonë, hyrja dhe protokollimi i shkresave/dokumenteve në institucion nga të tretë kryhet ekskluzivisht përmes postës. Meqënëse kjo mënyrë e dorëzimit mund të shkaktojë vonesa sepse minimumi i mbërritjes të postës është 24 orë sjell mosrespektim të afateve të përcaktuara për procedurat e blerjeve të vogla sipas ligjit të prokurimit publik duke qenë se afati kohor është vetëm 24 orë. Për të adresuar këtë çështje mes gjithë palëve, si dhe në zbatim të pikës 17 të "Udhëzimit nr. 05 datë 25.06.2021 Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike", dokumentacioni i kërkuar në ftesën për Ofertë është dorëzuar nga operatori ekonomik në zyrën e protokollit nëpërmjet një procesverbal të mbajtur nga komisioni i blerjeve të vogla (dhe operatorit me objekt: "Procesverbal marrje në dorëzim dokumentacioni". Nisur nga fakti që çdo operator ekonomik i kualifikuar i pari, sipas ftesës për ofertë, ka patur 24 orë/brenda ditës së nesërme të punës të sjellë dokumentacionin dhe gjithashtu procesverbali mban datën e nesërme, kjo e bën procedurën legjitime, pa cënuar në asnjë moment qëllimet e Ligjit nr 162/2020 "Për Prokurimin Publik", si: eficienta dhe efikasiteti, nxitja e konkurrencës, trajtimi i barabartë dhe jodiskriminues i të gjithë operatorëve ekonomikë etj. Procesverbali vepron si një dokument vërtetues i pranimit dhe dorëzimit të dokumentacionit kërkuar, në përputhje me ftesën për ofertë dhe brenda afateve të përcaktuara, që përfshin transparencën mes gjithë palëve, operatorit ekonomik për dokumentacion që dorëzon, komisionin e blerjeve të vogla që e merr dhe protokollit që ndjek linjën e procedurës progresivisht me fraksion deri në mbylljen e praktikës, si dëshmi e përmbushjes së procedurës së dorëzimit dhe garantimit të transparencës dhe ligjshmërisë në prokurim Dëshirojmë të theksojmë zbatueshmërinë e qëllimit të ligjit të prokurimeve publike edhe në lidhje me duke qenë se në gjitha procedurat dokumentacioni i firmës përveç se ka qenë plotësisht i rregullt nga ana ligjore sipas ftesës për ofertë që janë krejt bazike që nxit pjesëmarrjen dhe konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë dhe ndihmon të gjitha llojet e biznesit dhe po ashtu gjithë operatorët ekonomikë fitues janë në vendin e parë ose të dytë, pa cënuar në asnjë moment qëllimet e Ligjit nr 162/2020 "Për Prokurimin Publik", si: eficienta dhe efikasiteti, nxitja e konkurrencës, trajtimi i barabartë dhe jodiskriminues i të gjithë operatorëve ekonomikë etj.

Në përfundim, kjo është një praktikë që e kemi gjetur të aplikuar në institucion që Gjithmonë dhe duke qenë se nuk është lënë asnjë rekomandim për ndryshim të saj qoftë nga Audituesit e mëparshëm të KLSH, Auditit të brendshëm apo nga struktura të tjera, nuk ka lindur nevoja të ndryshohet sepse nuk na janë diktuar rekomandime. Nisur nga konstatimi juaj, do të zbatojmë rekomandim për marrjen e dokumentacionit të OE.

**Qëndrimi i Grupit të Auditimit:** Referuar observacioneve të ardhura me prot 1101/14 datë 27.03.2025, nuk u sollën arsye të apo dokumenta shtesë vërtetues për pasojë **observacioni nuk merret në konsideratë.**

**1. Procedura e prokurimit “Shpenzime Pritje përcjellje”, me fond limit 2,232,000 pa TVSH,**

**Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Shpenzime Pritje përcjellje” viti 2023**

1. Lloji i Procedurës së Prokurimit	2. Grupi i hartimit i specifikimeve teknike dhe fondit limit:	3. Njësia e Prokurimit	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave
“Procedurë e hapur, E hapur, e thjeshtuar, <b>REF-82867-10-09-2023</b> ”	Urdhri nr. 2984 prot, datë 04.10.2023 M. P E. L I. K	Urdhri nr. 2984/2 prot, datë 09.10.2023 M. K S. M S. B	Urdhri nr. 2984/4 prot, datë 09.10.2023 E. S S. I N. R

<b>5. Fondi Limit (pa TVSh)</b> 2,232,000 lekë	<b>6. Oferta fituese (pa TVSh)</b> 1,924,422 lekë	<b>7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh)</b> 307,578 lekë
<b>8/1 Data e publikimit të tenderit</b> 09.10.2023	<b>9. Burimi Financimit</b> Fondet e Buxheti i Shtetit	<b>10. Operatoret Ekonomike</b> a) Pjesëmarrës në tender <b>2 OE</b> ; 1. OE "O" i shpallur fitues 2. OE "B".
<b>8/2 Kohëzgjatja e kontratës</b> Nga data e nënshkrimit të kontratës deri me datë 31.12.2023.		
<b>12. Ankimim</b> Jo	<b>13. Përgjigje Ankesës AK</b>	<b>14. Përgjigje Ankesës nga KKP</b>
<b>b. Zbatimi i Kontratës Prokurimit</b>		
<b>15. Lidhja e kontratës</b> Kontrata me nr, 2984/15 prot datë 11.12.2023 dhe afati për shërbimit është deri me datë 31.10.2022.	<b>Zbatimi i kontratës:</b> Me urdhër 2984/20 datë 26.12.2023 është ngritur komisioni për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës.	

***-Auditimi i hartimit të fondit limit, vendosjen e specifikimeve teknike dhe hartimi i kritereve të DST.***

Me Urdhrin e Titullari i AK me nr, 2984 prot, datë 04.10.2023 është ngritur grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe përlllogaritjen e fondit limit, si më poshtë:

***Hartimi i specifikimeve teknike dhe përlllogaritja e fondit limit:***

M. P.

E. L.

I. K.

Me proces-verbal me nr, 2984/1 prot datë 09.10.2023, Komisioni për hartimin e specifikimeve teknike dhe përlllogaritjes së fondit limit ka hartuar për llogaritjet ku për fondin limit është bazuar ne kontratat e mëparshme dhe është 2,232,000 lekë pa TVSh dhe ka hartuar specifiket teknike. Disa nga kriteret si me poshtë vijon:

**2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

**2.3.3. Operatori ekonomik duhet të operojë duke plotësuar standartet në fuqi për sigurinë ushqimore. Për këtë, ai duhet të paraqesë vetdeklarim, ku të deklarojë se nga kontrolli i fundit ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore". , OE duhet të dorëzojnë vetdeklarim me qëllim plotësimin e këtij kriteri, ku të deklarojë se nga kontrolli i fundit ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore dhe në rast se shpallen fitues përpara lidhjes së kontratës ka detyrim të paraqesë dokumentacionin provues për të.**

***-Mbi auditimin e realizimit të procedurës në bazë të DT dhe përzgjedhja e operatorit ekonomik fitues.***

Urdhri nr. 2984/4 prot, datë 09.10.2023, Titullari i AK , ka ngritur Komisionin e Vlerësimit të Ofertave (KVO), të përbërë nga:

Z. E. S, Kryetar

Z. S. I, Anëtar

Z. N. R, Anëtar

Me procesverbal me nr, 2984/6 datë 23.10.2023 u be hapja e oferta te dorëzuara për procedurën e prokurimit ku morën pjese 2 OE.

Nr	Operatori ekonomi	Oferta lekë pa TVSh	Kualifikuar/S'Kualifikuar
1	OE "O" shpk	1,924,422 lekë.	<b>Kualifikuar dhe shpallur fitues.</b>
2	2. OE "B"	2,192,000 lekë	<b>Kualifikuar.</b>

Sa më sipër, oferta e shpallur fituese me shkresë nr 2984/10 datë 10.11.2023 është e OE "O" sh.p.k, me ofertën ekonomike në vlerën 1,924,422 lekë pa TVSh ose 2,309,306 me TVSh.

**Grupi i auditimi konstatoi** se OE fitues "O" sh.p.k nuk plotësojnë kriteret si me poshtë vijon:

- OE "O" Shpk sipas QKB nuk ka në fushën e veprimtarisë së tij objektin e prokurimit i cili është Pritje përcjellje "shërbim catering".
- Tek DST pika 2.16. Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera është shënuar **JO**. Ndërkohe që OE fitues "O" shpk ka paraqitur vërtetim për subjekti "M" për plotësimin e kriterit 2.3.3 i ushtruar nga AKU.

**Për sa me sipër KVO** nuk ka respektuar kërkesat e vendosura në DT nga Komisioni i specifikimeve teknike. *Veprimet në kundërshtim me LPP nr. 162 dt. 23.12.2020, "Për prokurimin publik" Neni 92 Shqyrtimi i ofertave pika 3 citon: Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji, dhe VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 Neni 82 Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave pika 2 citon: Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme.*

**Mbajnë përgjegjësi për veprimet dhe mos veprimet e tyre:** Komisioni i vlerësimit të ofertave: z, E. S, z, S. I dhe z, N. R.

#### ***-Lidhja e kontratës.***

Kontrata midis AK dhe OE është me nr, 2984/15 prot datë 11.12.2023 dhe afati për shërbimit është deri me datë 31.12.2022.

Plani i Zbatimi të kontratës është të kontratës është lidhur me nr. 2984/16 datë 11.12.2023 dhe është si me poshtë vijon:

*Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi" do organizojë gjatë periudhës tetor-dhjetor 2023 aktivitetet si më poshtë:*

*Kokteji pritje "Praktikat ne terren gjate viteve" 20 tetor 2023*

*Kokteji pritje "Lufta e Shkodrës faqe e lavdishme historike" nentor 2023*

*Koktej për konferencën shkencore "30 Vjetori i Fakultetit Ekonomik" 8 nentor 2023*

*Kokteji i konferencës "Zhvillimi Rural" nentor 2023*

*Kokteji konferences QSA Leonardo de Martini nentor 2023*

*Kokteji Projekti "Praktikat ne terren gjate viteve" dhjetor 2023*

*Kokteji Projekti "320 vjetori I kuvendit te Arberit" dhjetor 2023*

*Kokteji Projekti "Trashegimia jone kulturore-mbrojme te kaluaren për te ardhmen" tetor, dhjetor 2023*

*Kokteji Projekt Vlersimi I situates ekologjike te ujrave ne Rajonin e Shkodrës, edukimi ne terren nentor 2023*

*Kokteji Aktiviteti "Udhetim nder breza" nentor 2023*

*Kokteji Aktiviteti Shkencetaret ne mesin tone" nentor 2023*

**-Zbatimi i kontratës.**

Me urdhër nr, 2984/20 datë 26.12.2023 është ngritur komisioni për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës:

Komisioni i zbatimit të kontratës ka mbajtur disa proces-verbale për aktivitetet që janë zhvilluar si me poshtë vijon:

**1.** Me proces-verbal me nr, 2984/23 prot datë 27.12.2023 komisioni për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës për aktivitetin “*Shkenctaret në mesin tonë*” konstatoi se shërbimi është konform specifikimeve të përcaktuara dhe është ne vlerën 200,772 lekë me TVSh.

Fatura tatimore është paraqitur nga OE me nr, 170/2023, datë 27.12.2023 ndërsa likuidimi i faturës është kryer me urdhër shpenzim nr, 566 datë 29.12.2023 në vlerën **200,772 lekë**.

Tek shënimet e faturës tatimore citohet se aktiviteti Shkenctaret ne mesin tone datë 22.12.2023 Aktiviteti është zhvilluar ne datë 22.12.2023 dhe është i publikuar dhe në faqen e USH <https://USHLG.edu.al/aktivitete/aktiviteti-i-plote/departamenti-biologji-kimi-organizoi-aktivitetin-shkencetaret-mes-nesh>

**2.** Me proces-verbal me nr, 2984/27 prot datë 28.12.2023 komisioni për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës për aktivitetin “*Vlersimi I situates ekologjike te ujrave ne Rajonin e Shkodrës, edukimi ne terren nentor 2023*” konstatoi se shërbimi është konform specifikimeve të përcaktuara dhe është në vlerën 36,288 me TVSh.

Fatura tatimore është paraqitur nga OE me nr, 173/2023, datë 28.12.2023 ndërsa likuidimi i faturës është kryer me urdhër shpenzim nr, 567 datë 29.12.2023 në vlerën **36,288 lekë**.

Aktiviteti është zhvilluar ne datë 21.12.2023 dhe është publikuar dhe në faqen e USH <https://USHLG.edu.al/aktivitete/aktiviteti-i-plote/konferenca-studentore-njohim-ruajme-dhe-menaxhojme-ne-menyre-te-qendrueshme-burimet-natyrore>

**3.** Me proces-verbal me nr, 2984/24 prot datë 27.12.2023 komisioni për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës për aktivitetin “*Trashëgimia jone kulturore-mbrojme te kaluaren për te ardhmen*” konstatoi se shërbimi është konform specifikimeve të përcaktuara dhe është ne vlerën 20,160 lekë me TVSh.

Fatura tatimore është paraqitur nga OE me nr, 165/2023, datë 27.12.2023 ndërsa likuidimi i faturës është kryer me urdhër shpenzim nr, 570 datë 29.12.2023 në vlerën **20,160 lekë**.

Aktiviteti është zhvilluar me datë 20.12.2023 dhe është i publikuar dhe në faqen e USH <https://USHLG.edu.al/aktivitete/aktiviteti-i-plote/takimi-studentor-trashegimia-jone-kulturore-mbrojme-te-kaluaren-per-te-ardhmen-xhubleta-ne-unesco>

**4.** Me proces-verbal me nr, 2984/22 prot datë 27.12.2023 komisioni për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës për aktivitetin “*Leonardo de Martini*” konstatoi se shërbimi është konform specifikimeve të përcaktuara dhe është ne vlerën 65,772 lekë me TVSh.

Fatura tatimore është paraqitur nga OE me nr, 164/2023, datë 27.12.2023 ndërsa likuidimi i faturës është kryer me urdhër shpenzim nr, 571 datë 29.12.2023 në vlerën **65,722 lekë**.

Tek shënimet e faturës tatimore citohet se aktiviteti *Leonardo de Martini* datë 15.12.2023 Aktiviteti është i publikuar dhe në faqen e USH <https://USHLG.edu.al/aktivitete/aktiviteti-i-plote/konferenca-shkencore-nderuniversitare-arbereshi-shkodran-leonardo-de-martino>

**5.** Me proces-verbal me nr, 2984/21 prot datë 27.12.2023 komisioni për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës për aktivitetin “*Praktikat në terren gjatë viteve*” konstatoi se shërbimi është konform specifikimeve të përcaktuara dhe është ne vlerën 20,160 lekë me TVSh.

Fatura tatimore është paraqitur nga OE me nr, 172/2023, datë 27.12.2023 ndërsa likuidimi i faturës është kryer me urdhër shpenzim nr, 572 datë 29.12.2023 në vlerën **20,160 lekë**.

Aktiviteti është zhvilluar me datë **22.12.2023** dhe është i publikuar dhe në faqen e USH <s://USHLG.edu.al/aktivitete/aktiviteti-i-plote/aktivitet-me-titull-ekspeditat-mesimore-gjate-viteve>

**6.** Me proces-verbal me nr, 2984/25 prot datë 27.12.2023 komisioni për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës për aktivitetin “Udhëtimi ndër breza” konstatoi se shërbimi është konform specifikimeve të përcaktuara dhe është në vlerën 398,160 lekë me TVSh.

Fatura tatimore është paraqitur nga OE me nr, 169/2023, datë 27.12.2023 ndërsa likuidimi i faturës është kryer me urdhër shpenzim nr, 569 datë 29.12.2023 në vlerën 398,160 lekë.

Aktiviteti nuk është i publikuar në faqen e USH.

Tek shënimet e faturës tatimore citohet se aktiviteti *Udhëtimi ndër breza* datë 18.12.2023.

**7.** Me proces-verbal me nr, 2984/26 prot datë 27.12.2023 komisioni për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës për aktivitetin “zhvillimi Rural” konstatoi se shërbimi është konform specifikimeve të përcaktuara dhe është në vlerën 398,160 me TVSh.

Fatura tatimore është paraqitur nga OE me nr, 171/2023, datë 27.12.2023 ndërsa likuidimi i faturës është kryer me urdhër shpenzim nr, 568 datë 29.12.2023 në vlerën 398,160 lekë.

Aktiviteti nuk është i publikuar në faqen e USH.

**Grupi i auditimit konstatoi** se në gjashtë aktivitet (si me poshtë) me vlerë totale **741,262** lekë komisioni i zbatimit të kontratës ka mbajtur proces verbale me date 27-28.12.2023 mbi kryerjen e aktiviteteve, por aktivitet janë kryer përpara proces verbaleve të mbajtura nga komisioni si dhe përpara ngritjes së urdhrin për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës.

1. “Shkencaret në mesin tonë”,

2. “Vlersimi I situates ekologjike te ujrave ne Rajonin e Shkodrës, edukimi ne terren nentor 2023”,

3. “Trashëgimia jone kulturore-mbrojme te kaluaren për te ardhmen”,

4. “Leonardo de Martini”,

5. “Praktikat në terren gjatë viteve”,

6. “Udhëtimi ndër breza”

Ndërkohë në aktivitetin “Zhvillimi Rural” proces verbali është mbajtur me datë 27.12.2023, por nuk ka gjurmë se kur është mbajtur aktiviteti pasi nuk është publikuar në ËEB e USH si dhe tek fatura e OE nuk ka shënime.

**Mbajnë përgjegjësi për veprimet dhe mos veprimet e tyre:** Administratori i USHLG z, A. U si dhe grupi i marrjes në dorëzim.

**2. Procedura e prokurimit “Blerje paisje për projektin Edukimi është çelësi zhvillimit”, me fond limit 6,296,889 pa TVSH,**

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje paisje për projektin Edukimi është çelësi zhvillimit”			
<b>1. Lloji i Procedurës së Prokurimit</b> “Procedurë e hapur, e thjeshtuar, <b>REF-83724-10-13-2023</b> ”	<b>2. Grupi i hartimit i specifikimeve teknike dhe fondit limit:</b> Urdhri nr. 2983 prot, datë 04.10.2023 I. H N. L A. C	<b>3. Njësia e Prokurimit</b> Urdhri nr. 3016/8 prot, datë 13.10.2023 M. K S. M S. B	<b>4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b> Urdhri nr. 3016/10 prot, datë 13.10.2023 N. R S. I E. S
<b>5. Fondi Limit (pa TVSh)</b> 6,296,889 lekë	<b>6. Oferta fituese (pa TVSh)</b> 5,670,200 lekë		<b>7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh)</b> 626,689 lekë

<b>8/1 Data e publikimit të tenderit</b> 16.10.2023	<b>9. Burimi Financimit</b> Fondet e Buxheti i Shtetit	<b>10. Operatorët Ekonomike</b> a) Pjesëmarrës në tender <b>2 OE</b> ; 1. Fitues A shpk me vlerë 5,670,200. 2. R shpk me vlerë 6,026,000
<b>8/2 Kohëzgjatja e kontratës</b> 60 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës.		
<b>12. Ankimim</b> Jo	<b>13. Përgjigje Ankesës AK</b>	<b>14. Përgjigje Ankesës nga KKP</b>
<b>b. Zbatimi i Kontratës Prokurimit</b>		
<b>15. Lidhja e kontratës</b> Kontrata me nr, 3688/6 prot datë 21.12.2023, Kontratë me nr 993 prot datë 13.03.2024.	<b>Zbatimi i kontratës:</b> Me urdhër nr, 993/2 datë 19.03.2024 është ngritur komisioni për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës.	

***-Auditimi i hartimit të fondit limit, vendosjen e specifikimeve teknike dhe hartimi i kriterëve të DST.***

Me Urdhrin e Titullarit të AK nr. 2983 prot, datë 04.10.2023 është ngritur grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe përlogaritjen e fondit limit, si më poshtë:

**-Hartimi i specifikimeve teknike dhe përlogaritja e fondit limit:**

I. H.

N. L.

A. C.

Me proces-verbal me nr, 3016/5 dhe 3016/7 prot datë 13.10.2023, Komisioni për hartimin e specifikimeve teknike dhe përlogaritjes së fondit limit ka paraqitur studimin e tregut për përcaktimin e fondit limit, i cili është 6,296,889 lekë pa TVSh dhe ka hartuar specifiket teknike të cilat të dhënat i ka marrë nga AKSHI.

***-Mbi auditimin e realizimit të procedurës në bazë të DT dhe përzgjedhja e operatorit ekonomik fitues.***

Urdhri nr. 3016/4 prot, datë 11.10.2023, Titullari i AK , ka ngritur Komisionin e Vlerësimit të Ofertave (KVO), të përbërë nga:

Z. N. R, Kryetar

Z. S. I, Anëtare

Z. E. S, Anetar

Me procesverbal me nr, 3016/12 datë 13.11.2023 u bë hapja e oferta të dorëzuara për procedurën e prokurimit ku morën pjesë 2 OE si më poshtë:

Nr	Operatori ekonomi	Oferta lekë pa TVSh	Kualifikuar/S'Kualifikuar
1	OE "A" shpk	5,670,200 lekë.	<b>Kualifikuar dhe shpallur fitues.</b>
2	OE "R"	6,026,000 lekë	<b>Kualifikuar.</b>

Sa më sipër, oferta e shpallur fituese me shkresë "Formulari i njoftimit të Fituesit" nr, 3688//4 datë 13.12.2023 është e OE "ATOM" shpk, me ofertën ekonomike në vlerën 5,670,200 lekë pa TVSh ose 7,231,200 me TVSh.

***-Vlerësimi i procedurës:***

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të OE të skualifikuar/ dhe kualifikuar në dosjen e procedurës dhe sistemin SPE, konstatohet se vlerësimi i bërë nga KVO është i saktë dhe në përputhje me dispozitat

e LPP.

***-Lidhja e kontratës.***

Kontrata midis AK dhe OE është me nr, 3688/6 prot datë 21.12.2023 dhe afati për shërbimit është 60 dite nga nënshkrimi i kontratës.

AK ka lidhur kontrate të re me OE është me nr, 993 prot datë 13.03.2024 dhe afati për shërbimit është 60 dite nga nënshkrimi i kontratës.

Me shkresë nr, 993/1 prot datë 13.03.2024 hartuar plani i zbatimit të kontratës.

Me shkresë nr, 993/4 prot datë 20.03.2024 është hartuar formulari i njoftimit të kontratës së nënshkruar bazuar ne kontratën e lidhur me 13.03.2024.

***-Zbatimi i kontratës.***

Me urdhër nr, 993/2 datë 19.03.2024 është ngritur komisioni për marrjen në dorëzim si me poshtë:

Z, I. H.

Z, X. Z

Znj, A. B.

Komisioni për marrjen në dorëzim ka mbajtur proces-verbal me nr, 993/5 prot datë 28.03.2024 ku shprehet se malli u mor konform specifikimeve të përcaktuara në kontratë me vlerë 5,670,200 lekë pa TVSh dhe 6,804,240 lekë me TVSh.

Fatura tatimore është paraqitur nga OE me nr, 197/2024, datë 28.03.2024 ndërsa likuidimi i faturës është kryer me urdhër shpenzim nr, 101 datë 08.04.2024 në vlerën 6,804,240 lekë.

Me fletë hyrje nr, 9 datë 28.03.2024 është bërë hyrje në magazinë.

**Grupi i auditimi konstatoi** se urdhri i prokurimit është hartuar me datë 11.10.2023 dhe sipas procedurave dhe afateve të LPP kontrata me OE fitues detyrimisht do të lidhej mbas datës 15 tetor, *Veprime kundërshtim me ligjin e buxhetit nr 9936 dt 26.6.2008, neni 51, si dhe Udhëzimi nr. 9 date 20.03.2018 Për Procedurat Standarte te Zbatimit te Buxhetit pika 83 citon: Nëpunësi autorizues i njësisë së qeverisjes së përgjithshme mund të ndër marrë angazhime të reja gjatë vitit buxhetor, por jo më vonë se data 15 tetor e çdo viti buxhetor.*

Ndërkohë janë hartuar dhe firmosur **2 kontrata** me të njëjtin OE, objekt prokurimi, numër reference, vlerë kontratë etj, por me datë të ndryshme dhe numri protokolli të ndryshëm.

Kontrata e parë e firmosur ndërmjet AK dhe OE në datën 21.12.2023 nuk mundej të regjistrohej në sistemin e thesarit dhe është refuzuar regjistrimi i saj për veprime ne kundërshtim me *ligjin e buxhetit nr 9936 datë 26.06.2008.*

Kontrata e dyte është firmosur ndërmjet AK dhe OE me nr, 993 prot datë 13.03.2024 por pa u bere me parë një anulim/revokim apo ndryshimi të kontratës se pare se firmosur me nr, 3688/6 prot datë 21.12.2023. *Në kundërshtim me kontratën e parë nr, 3688/6 prot datë 21.12.2023 neni 30 "Negociatat dhe amendamentet" pika 30.2 citon: Asnjë amendament ose variacion tjetër i kontratës nuk do të jetë i vlefshëm pa qenë me shkrim, me datë, ti referohet shprehimisht kontratës dhe nënshkruhet nga një nga përfaqësues i autorizuar i Kontraktuesit dhe Autoritetit Kontraktor.*

Afati për marrjen në dorëzim te mallit nga komisioni i marrjes në dorëzim është kryer referuar kontratës se dytë dhe urdhër shpenzimi i është referuar po kontratës se dyte e lidhur me 13.03.2024. Gjithashtu publikimi i njoftimit të lidhjes së kontratës nuk është berë brenda 5 diteve *në kundërshtim me VKM nr. 285 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" neni 86 :Pas nënshkrimit të kontratës, brenda 5 (pesë) ditëve, autoriteti/enti kontraktor dërgon për publikim në sistemin e prokurimit elektronik dhe/ose Buletinin e Njoftimeve Publike njoftimin e kontratës së nënshkruar.*

**Mbajnë përgjegjësi për veprimet dhe mos veprimet e tyre:** Administratori i USHLG, z, A. U dhe Personi përgjegjës për prokurimin znj, M. K.

**Observacion i subjektit mbi Projektin e Auditimit, vënë në dispozicion grupit të auditimit në datë 27.03.2025 me nr.1101/11 prot.**

**Pretendimi i subjektit 1:** Për sa me sipër, në cilesinë e personit përgjegjës për vitin 2024, caktuar me Urdhër nr. 10 datë 09.02.2024 të Administratorit me nr. 456 prot. dt. 09.02.2024 po ju sqaroj se detyrat e mia si person përgjegjës për prokurimin nuk konsistojnë në konceptimin apo hartimin e kontratave apo ndonjë procesverbali gjatë procesit të prokurimit, në zbatim të nenit 74 pika 3, të VKM nr. 285 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik"

Në çdo rast në zbatim të detyrave të mia funksionale si dhe ato të parashikuara me ligj, unë kam administruar vetëm dokumentacionin për përgatitjen e procesit të prokurimit, dokumentet e tenderit, procedurat e përcaktimit të fituesit.

Në përputhje me dispozitat e ligjit dhe rregullave të prokurimit, nuk është detyrë dhe përgjegjësi ime si person përgjegjës për prokurimin të përfshihem në hartimin dhe konceptimin e kontratave. Kjo është detyrë që i takon autoritetit kontraktor ose, në disa raste, strukturave të tjera të specializuara brenda institucionit, të cilat kanë kompetencat dhe mandatin për të përgatitur dhe nënshkruar kontratat përkatëse.

Kontrata e parë e firmosur ndërmjet AK dhe OE me nr.2982/20 prot datë 21.12.2023 është refuzuar në sistemin AFMIS nga Drejtorja Rajonale e Thesarit Shkodër, me justifikimin: "Afati i kontratës në kundërshtim me ligjin nr. 9939 dt 26.06.2008, i ndryshuar, neni 50, 51 dhe udhëzimin Plotësues nr. 2 dt, 19.01.2023 pika 38, email MFE dt, 21.12.2023. objekti në UB.

**Pretendimi i subjektit 2:** Në lidhje me Urdhërin e prokurimit, i cili është hartuar me dt.11.10.2023 sqaroj se ky projekt ka ardhur si kërkesë nga Fakulteti i Shkencave Shoqërore, Departamenti i Historisë me dt. 25.09.2023 me nr. 2784 prot, pasi është projekt i fituar në kuadër të thirrjes për ndërkombëtarizim nga MAS, miratuar me Vendim të Bordit të Administrimit nr. 206 datë 18.09.2023 rrjedhimisht nuk mund të hartohet më herët ky urdhër.

Përsa i përket çështjes së krijimit të dy kontratave për të njëjtën procedurë, theksojmë se ky vendim ka qenë rezultat i një situatë objektive dhe të justifikuar nga mungesa e fondeve në Drejtorinë Rajonale të Thesarit sipas përcaktimeve në nenin 85 pika 2 të VKM nr. 285 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Për sa më sipër ju bëj me dije se kontrata nr. 3688/6 prot. dt. 21.12.2023 sipas nenit 4 të saj, kishte afat realizimi 60 ditë pra do përfundonte me dt. 20.02.2024 rrjedhimisht çdo amendim i kontratës duhej të bëhej pa përfunduar afati i realizimit të saj. Në rast se amendimi i saj të bëhej para datës 20.02.2024 (data e përfundimit të kontratës nr.3688/6 prot,dt. 21.12.2023) do ishim në kushtet e nënshkrimit të një kontrate përsëri të pavlefshme sipas përcaktimeve në nenin 85 pika 2 të VKM nr. 285 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i cili citon: "Lidhja e kontratës do të bëhet në përputhje me afatet e përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, dhe vetëm pasi fondi do të jetë në dispozicion (në llogarinë përkatëse) të autoritetit/entit kontraktor."

**Qëndrimi i Grupit të Auditimit:** Referuar observacioneve të ardhura me prot 1101/14 datë 27.03.2025, nuk u sollën arsyetime apo dokumenta shtesë vërtetues për pasojë **observacioni nuk merret në konsideratë.**

**3. Procedura e prokurimit "Blerje pajisje për laboratorin klinik - biokimik", me fond limit 6,500,000 pa TVSH,**

<b>Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Blerje pajisje për laboratorin klinik - biokimik"</b>			
<b>1. Lloji i Procedurës së Prokurimit</b> "Procedurë e hapur, e hapur, e thjeshtuar, <b>REF-83723-10-13-2023</b>	<b>2. Grupi i hartimit i specifikimeve teknike dhe fondit limit:</b> Urdhri nr. 2725 prot, datë 19.09.2023 L. D	<b>3. Njësia e Prokurimit</b> Urdhri nr. 2725/2 prot, datë 11.10.2023 M. K S. M S. B	<b>4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b> Urdhri nr. 2725/3 prot, datë 11.10.2023 N. R S. I

	A. S N. M		E. S
<b>5. Fondi Limit (pa TVSh)</b> 6,500,000 lekë	<b>6. Oferta fituese (pa TVSh)</b> 6,363,000 lekë	<b>7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh)</b> 137,000 lekë	
<b>8/1 Data e publikimit të tenderit</b> 16.10.2023	<b>9. Burimi Financimit</b> Fondet e Buxheti i Shtetit	<b>10. Operatorët Ekonomike</b> a) Pjesëmarrës në tender 2 OE; 1. Fitues I SHPK me vlerë 6,363,000. 2. A shpk ska paraqitur ofertë.	
<b>8/2 Kohëzgjatja e kontratës</b> 30 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës.			
<b>12. Ankimim</b> Jo	<b>13. Përgjigje Ankesës AK</b>	<b>14. Përgjigje Ankesës nga KKP</b>	
<b>b. Zbatimi i Kontratës Prokurimit</b>			
<b>15. Lidhja e kontratës</b> Kontrata me nr, 2725/15 prot datë 27,12,2023, Kontratë me nr, 916 prot datë 06.03.2024.	<b>Zbatimi i kontratës:</b> Me urdhër nr, 916/2 datë 12.03.2024 është ngritur komisioni për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës.		

***-Auditimi i hartimit të fondit limit, vendosjen e specifikimeve teknike dhe hartimi i kritereve të DST.***

Me Urdhrin e Titullarit të AK nr. 2725 prot, datë 19.09.2023 është ngritur grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe përlllogaritjen e fondit limit, si më poshtë:

**-Hartimi i specifikimeve teknike dhe përlllogaritja e fondit limit:**

L. D.

A. S.

N. M.

Me proces-verbal me nr, 2725/1 prot datë 11.10.2023, Komisioni për hartimin e specifikimeve teknike dhe përlllogaritjes së fondit limit ka paraqitur studimin e tregut për përcaktimin e fondit limit, i cili është 6,500,000 lekë pa TVSh dhe ka hartuar specifiket teknike, disa nga specifikimet teknike si me poshtë vijon:

**Autoanalizator për gjak komplet**

*Specifikimet Teknike: Diferencimi 3-pjesësh i ËBC; 20 parametra + 3 histograme*

*Mënyrat e numërimit: Gjak i plotë, i paraholluar dhe periferik*

*Parametrat: ËBC, LYM#, MON#, GRA#, LYM%, MON%, GRA%, RBC, HCG,*

*MCHC, MCH, MCV, RDË-CV, RDË-SD, HCT, PLT, MPV, PDË, PCT, P-LCR,*

*Histogramet për ËBC, RBC, PLT.*

*Performanca: 60 mostra në orë*

*Parimet: Rezistenca elektrike për numërimin e ËBC, RBC dhe PLT*

*Vëllimi i kampionit: Gjak i plotë 9.8 µl, i paraholluar 20 µl*

*Diametri i hapjes: ËBC 80 µm, RBC 50 µm*

*Transportues: ËBC/RBC/HGB<0,5%, PLT<1,0%*

*Ruajtja e të dhënave: Deri në 50.000 rezultate të mostrave (përfshirë histogramet)*

*Menyja: Testi, Rezultatet, Informacioni i Sistemit, Kontrolli i Cilësisë, Kalibrimi, Shërbimi,*

*Cilësimet*

*Softueri: Anglisht, Spanjisht, Frëngjisht*

*Ekrani: Ekran me prekje LCD me ngjyra 10,4 TFT*

*Hyrja/Dalja: RS232, USB, LAN, ndërfaqja e tastierës dhe mausit*

*Printimi: Printer termik, letër me gjerësi 55 mm, formate të shumta printimi,*

*printer i jashtëm (opsionale)*

*Mjedisi i funksionimit: Temperatura: 15°C~35°C, Lagështia: 10%~90%*

*Kërkesa për energji: AC 100-240V, 50/60 ±1Hz*

*Përmasat: 436 mm (H) x 363 mm (Ë) x 367 mm (D)*

Pesha: 18 kg. Reagentet e pershfire për procesin e validimi , bashkeshoqeruese :Diluent 20L  
Liser 0,5L, Pastrues 1L, Extra Cleaner 100mL  
Kontrolli i hematologjis reagent kalibrues

### **Autoanalizator biokimik**

150 teste fotometrike në orë, deri në 250 teste në orë me modul ise të integruar.  
Moduli opsional Ise i integruar për: Na+, K+, Li+, Cl-in serum, plazma dhe urinë e holluar.  
Deri në 20 parametra në linjë.  
Metoda e reagentëve mono, të dyfishtë, të trefishtë.  
15 pozicione të mostrës.  
Tuba primare (Ø12÷13mm 75/100mm), kupa mostrash (3 ml).  
9 pozicione të kalibratorit me kalibrim linear/jolinear  
kurbë deri në 8 pikë e holluar automatikisht (regresion linear,  
lineare sipas pjesës, vijë kub, polinom).  
3 pozicione kontrolli me komplot Levy-Jennings.  
Lexues bar-kodi i integruar për mostrat dhe reagentët.  
Krahu i pajisur me detektor të nivelit të lëngut (kapacitiv),  
sensor goditjeje, sistem parangrohës.  
Pompë mikromatëse me precizion të lartë për të shpërndarë reagentët dhe mostrat (pa shiringë).  
Vëllimi i reagentit: 180÷400 mikrolitra.  
Vëllimi i kampionit: 1÷100 mikrolitra.  
Vëllimi tipik i reagimit 200 mikrolitra.  
Gjatësia e valës në bord: 8 nga 340 nm në 700 nm plus një pozicion i lirë.  
Burimi i dritës: Llambë halogjene me jetë të gjatë (2000 orë).  
Lineariteti fotometrik: 0÷3.0 OD.  
Kuveta e leximit: 80 e ri-larë në bord të prodhuara në Bionex™.  
Larja e kuvetës: stacion larjeje automatike.  
Konsumi i ujit: 2 litra në orë.  
Ftohësi i reagentit: 14°C nën temperaturën e ambientit.  
L.I.S.: Lidhje dydrejtimëshe.  
Sistemi operativ: Ëindoës™

### **Autoanalizator hormonal**

Metodologjia Elektro-kimilumineshencë imunoanalizuese (eCLIA).  
Rezultati 9 min.  
Sistemi i reagentëve 10 pozicione; Ftohje në bord 4-15°C  
Pozicioni kampion 30 pozicione; Ngarkimi i vazhdueshëm  
Vëllimi i mostrës 5-100uL  
Lloji i mostrës Serumi dhe plazma  
Sistemi i Inkubacionit 100 pozicione; 37±0,3°C inkubacion  
Probe System Zbulimi i nivelit të lëngshëm; Zbulimi i mpiksjes; Veprim argëtues kundër përplasjes  
Sistemi operativ Ëindoës 10, Ekrani me prekje, i pajtueshëm me LIS  
Funksioni opsional Zbërthimi automatik  
Përmasat 650 mm x 620 mm x 650 mm ( H x P x D)  
Pesha 100 kg  
Performanca 86 T/h  
Metoda e testimit Deri në 24 teste/orë, 15-30 minuta për 6 mostra

### **Centrifuge**

Strukture e jashtme e përberë nga metal anti acid.  
Mbyllje e sigurt.  
Temperatura e paraselektuar në 65°C , sipas metodes Gerber.  
Koha e paraxehjes max 20 min  
Shpërndarje perfekte e temperaturës brenda dhomes force centrifugale 350 g ±50 g sipas metodes Gerber.  
Dimensionet 49x40x23 cm Pesha 18 kg Ushqyesi 230 V ose 115 V, 50 ose 60 Hz  
Konsumi elektrikiteti 470Ë

### **Perzieres gjaku**

Përzjerës me rrotullim dhe anim me 7 rula, me veprim të dyfishtë, rrotullon butësisht tubat ndërsa tunden,  
prodhon një lëvizje sinusoidale, duke siguruar homogjenizim të shkëlqyer të mostrës.  
Rekomandohet për pezullime të lëngjeve biologjike dhe hematologjike.

### **Koagulometer**

4 kanale (4 detektorë LED me jetëgjatësi deri në parametra të ndryshëm)  
QC dhe programi i kalibrimit të inkorporuar  
Rezultati i shumëfishtë duke përfshirë raportin gjithëpërfshirës të pacientit.  
Funksioni i kontrollit automatik të ndezjes  
Pipetë e lidhur në mënyrë elektronike  
Parimi: Drita e shpërndarë me analizë përqindjeje  
Kanali i testimit: 4 kanale  
Burimi i dritës: Dedektor i qëndrueshëm LED (470 nm)

Koha e provës: Normalisht 20-60 sekonda, koha maksimale deri në 600 sekonda

Pozicioni i mostrës: 24 pozicione

Pozicioni i reagentit: 6 pozicione (1 përzierës magnetik i përfshirë)

Min.Konsumimi i reagentit: 25 ul për FIB,PT,APTT

Kujtesa: Deri në 10,000 rezultate të testit

Ndërfaqja: RS232, PSTN (opsionale)

Ekrani: LCD 6 inç

Hyrja: Paneli me prekje ose mouse

Dalja: Printer i jashtëm (opsionale)

Pesha neto: 8 kg

Dimensionet LXËxH ( mm ) : 410 \* 310 \* 160

Furnizimi me energji elektrike: AC 110 V -220 V; +/- 10 % 50-60 Hz

Reagentët e koagulimit

- PT-HS 10 x 5 ml

-APTT (Acidi Ellagic) 10 x 4 ml

-Fibrinogjen 5 x 2 ml

-Klorur kalciumi 0,020 M 3 X 16 ml

-Plasma Control Niveli 1 - 10 X 1 ml

-Plasma Control Niveli 2 - 10 x 1 ml

### **Mikroskop digjital me tablet dhe kamera te integruar**

Me njësi ndriçimi profesional Koehler me një diafragmë të rregullueshme në terren si dhe një kondensator 1,25 Abbe të rregullueshëm në lartësi, i cili mund të përqendrohet dhe ka një diafragmë të rregullueshme të hapjes.Sistemi optik Infinity

Njësi rrotulluese e lenteve 5-fish

E pjerrët siedentopf, e rrotullueshme 360°

Kompensimi i dioptrës (të dyja palët)

Dimensionet e përgjithshme ËxDxH 390 x 200 x 400 mm

Pesha neto përafërsisht. 8983 kg

Okulare: HËF 10x20 mm

Cilësia objektive: Infinity E-Plan

Objektivat: 4x/10x/20x/40x/100x

Ndriçimi : 3Ë LED (drita e transmetuar). Sensor CMOS 1/2,5", sistem operues ; Ëin XP Ëin Vista Ëin 7 Ëin

8 Ëin 10. Kendi i tubave 30 grade , trinokulare . Nderlidhja : USB 3.0 (14,2 - 101,2 FPS).HËF 10x Ø 20.0 mm

4 x / 10 x / 20 x / 40 x / 100 x

#### **Specifikime teknike te tabletit**

ekran LCD me prekje 9.7".

· Rezolucioni i ekranit: 2048x1536 piksele

· CPU: Quad Core Cortex-A17; 1,8 GHz

· Dimensionet e përgjithshme ËxDxH 238x51x206 mm

· Pesha neto përafërsisht. 0,65 kg. transferim i drejtpërdrejtë i imazhit në Tabela Android, kamera e integruar 5 MP do të thotë gjithashtu se imazhet dhe videot mund të jenë krijuar për dokumentacionin.

· Funkzione të thjeshta matëse si p.sh., për shembull, funksionet për matjen e distancës, sipërfaqet dhe këndet si dhe një manual funksionet e numërimit janë gjithashtu të disponueshme

· Balancë automatike e bardhë dhe automatike mund të kryhet rregullimi i kontrastit shpejt dhe lehtë, gjë që mundëson efikasitetet procedurat e punës

· Ofrohen një sërë funksionesh shtesë përmes ndërfaqeve të integruara, si p.sh.

- Ruajtja e të dhënave në një kartë USB ose SD

- Lidhja me një maus USB

- Transferimi i imazhit të drejtpërdrejtë në një të jashtëm ekran duke përdorur HDMI

- Transferimi i të dhënave të ruajtura në të jashtme marrës duke përdorur ËiFi

· Dërgesa përfshin kamerën e tabletit me softuer të parainstaluar si dhe përshtatës elektrik

#### **Specifikime teknike te kameras**

5,1 MP USB 2.0 6,8 – 55 CMOS 1/2,5" Ëin XP, Vista, 7, 8, 10

#### **Hemocitometer**

Dhoma e numërimit të hemocitometrit është formuar nga një copë xhami e vetme termike dhe rezistente ndaj goditjeve. Çdo dhomë vjen me dy gota mbuluese të përfshira. Një hendek në formë H formon dy zona numërimi, ose pllaja. Çdo pllajë përmban një rrjet ose rregullim të gdhendur.

Sipërfaqja e rregulluar është 0,1 mm nën xhamin e mbulesës, duke kufizuar vëllimin e 1 mm katror gjak ose lëng mbi një mm katror në 0,1 kub. mm. Kontakti i sipërfaqeve të sheshta, të lëmuara të xhamit të mbulimit me mbështetëset e xhamit të mbulimit prodhon një vëllim të saktë lëngu mbi zonën e numërimit.

Lloji: 2-qeliza e metalizuar

Thellesia: 0.1 mm

**Grupi i Auditimit konstatoi se nga verifikimi i specifikimeve teknike të sipër cituara komisioni ka hartuar parametrat teknik pa dhënë asnjë argument teknik.**

**Gjithashtu konstatohet se specifikimet teknike të vendosura nga komisioni për 8 paisje laboratorike janë të njëjtat me parametrat teknik sipas katalogëve të paraqitur nga OE i shpallur fitues në këtë procedure më Firmat prodhuese si me poshtë vijon:**

1. Autoanalizator për gjak komplet – Kompania prodhuese **LINEAR Chemical S.L.U**

2. Autoanalizator biokimik - Kompania prodhuese **LINEAR Chemical S.L.U**

3. Autoanalizator hormonal- Kompania prodhuese **LINEAR Chemical S.L.U**

4. Centrifuge - Kompania prodhuese **FUNKE-GERBER**
5. Perzieres gjaku - Kompania prodhuese **J.P SELCTA**
6. Koagulometer - Kompania prodhuese **LINEAR Chemical S.L.U**
7. Mikroskop digjital me tablet dhe kamera te integruar - Kompania prodhuese **Kern&Sohn**
8. Hemocitometer - Kompania prodhuese **HERENZ&HEINZ**

Në rastin konkret komisioni duhet të përgatiste specifikime teknike të cilat do të krijojnë kushte për konkurrim të hapur ndërmjet të gjithë OE të duke mundësuar trajtim të barabartë, në mënyrë që të mos shërbejnë pengesa ne procedurën e prokurimit publik.

Veprime ne kundërshtim me LPP nr. 162 dt. 23.12.2020 Neni 36 Specifikimet teknike, pika 4, Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve, dhe VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 neni 78 pika 2, Hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret për shpalljen e ofertës fituese (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit. Në varësi të objektit të prokurimit, nëse nuk është vlerësuar e nevojshme caktimi i një specialisti fushe, hartimi i kërkesave si më sipër bëhet nga njësia e prokurimit. Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit.

**Mbajnë përgjegjësi për veprimet dhe mos veprimet:** znj, L. D, znj, A. S dhe znj, N. M.

**-Mbi auditimin e realizimit të procedurës në bazë të DT dhe përzgjedhja e operatorit ekonomik fitues.**

Urdhri nr. 2725/4 prot, datë 11.10.2023, Titullari i AK , ka ngritur Komisionin e Vlerësimit të Ofertave (KVO), të përbërë nga:

Z. N. R, Kryetar

Z. S. I, Anëtar

Z. E. S, Anetar

Me procesverbal me nr, 2725/6 datë 17.11.2023 u be hapja e oferta te dorëzuara për procedurën e prokurimit ku morën pjesë 2 OE si me poshtë:

Nr	Operatori ekonomi	Oferta lekë pa TVSh	Kualifikuar/S'Kualifikuar
1	OE "I"	6,363,000 lekë.	<b>Kualifikuar dhe shpallur fitues.</b>
2	OE "A"	Nuk ka paraqitur ofertë	<b>S Kualifikuar për arsyet si me poshtë</b> Në SPE ka ngarkuar vetëm 3 dokumente sic janë, 1. Deklarat, 2, sigurim oferte dhe 3, ekstrakt QKB.

Sa më sipër, oferta e shpallur fituese me shkresë "Vlerësimi përfundimtar" nr, 2725/10 datë 07.12.2023 është e OE "I" shpk, me ofertën ekonomike në vlerën 6,363,000 lekë pa TVSh ose 7,635,600 me TVSh.

**Grupi i auditimi konstatoi** se OE I shpk nuk ka dorëzuar vërtetimin për pagimin e taksave dhe tatimeve por ka paraqitur vetëm vërtetim për pagimin e kontributeve të sigurimeve shoqërore.  
**Për sa me sipër KVO** nuk ka respektuar kërkesat e vendosura në DT sic janë Kriteret detyruese,

*Veprimet në kundërshtim me LPP nr. 162 dt. 23.12.2020, "Për prokurimin publik" Neni 76 Kriteret detyruese për skualifikim pika 2 citon: Një operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në një procedurë prokurimi kur operatori ekonomik ka shkelur detyrimet e tij në lidhje me pagesën e taksave ose kontributeve të sigurimeve shoqërore, Neni 92 Shqyrtimi i ofertave pika 3 citon: Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji, dhe VKM Nr. 285, datë 19.5.2021*

*Neni 26 Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit pika 2 gërma dh citon: operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së dhe Neni 82 Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave pika 2 citon: Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme.*

**Mbajnë përgjegjësi për veprimet dhe mos veprimet e tyre:** z, N. R, z, S. I dhe z, E. S

### **-Lidhja e kontratës.**

Kontrata midis AK dhe OE është me nr, 2725/15 prot datë 27.12.2023 dhe afati për dorëzimin e mallit është 30 dite pune nga nënshkrimi i kontratës.

Plani i zbatimi të kontratës është me nr 2725/16 prot, datë 27.12.2023.

AK ka lidhur kontrate të re me OE është me nr, 916 prot datë 06.03.2024 dhe afati për dorëzimin e mallit është 30 dite pune nga nënshkrimi i kontratës.

Me shkresë nr, 916/1 prot datë 06.03.2024 është hartuar plani i zbatimit të kontratës së dytë.

Me shkresë nr, 916/4 prot datë 12.03.2024 është hartuar formulari i njoftimit të kontratës së nënshkruar bazuar ne kontratën e lidhur me 06.03.2024.

OE ka dërguar shkresë me nr, 916/7 prot datë 04.04.2024 pranë AK ku kërkon të shtyhet afati i dorëzimi me 2 jave për 4 paisje të mbetura pa u dorëzuar pasi kompania prodhuese Spanjolle Linear Chemical ka qen e mbyllur për një jave nga festat zyrtare(pashkët katolike) ne Spanjë.

AK me nr, 916/8 datë 05.04.2024 ka nënshkruar kontratë shtesë me OE ku është shtyrë afati i saj me 14 ditë.

### **Grupi i auditimi konstatoi si me poshtë vijon:**

**1:** Urdhri i prokurimit është hartuar me datë 11.10.2023 dhe sipas procedurave dhe afateve të LPP kontrata me OE detyrimisht do të lidhej mbas datës 15 tetor, *Veprime kundërshtim me ligjin e buxhetit nr 9936 dt 26.6.2008, neni 51, si dhe Udhëzimi nr. 9 date 20.03.2018 Për Procedurat Standarte te Zbatimit te Buxhetit pika 83 citon: Nëpunësi autorizues i njësisë së qeverisjes së përgjithshme mund të ndërmarrë angazhime të reja gjatë vitit buxhetor, por jo më vonë se data 15 tetor e çdo viti buxhetor.*

**2:** AK ka hartuar dhe firmosur 2 kontrata me të njëjtin objekt prokurimi, numër reference, vlerë kontratë etj. Por me datë te ndryshme dhe numri protokolli të ndryshëm.

**a)** Kontrata e parë e firmosur ndërmjet AK dhe OE me nr, 2725/15 prot datë 27.12.2023 nuk mundej të regjistrohej në sistemin e thesarit dhe është refuzuar regjistrimi i saj për veprime ne kundërshtim me *ligjin e buxhetit nr 9936 datë 26.06.2008.*

**b)** Kontrata e dyte është firmosur ndërmjet AK dhe OE me nr, 916 prot datë 06.03.2024 por pa u bere me pare një anulim/revokim apo ndryshim në kontratën e parë.

Afati për marrjen ne dorëzim te mallit nga komisioni i marrjes në dorëzim është kryer referuar kontratës se të lidhur me nr, 916 prot datë 06.03.2024.

*Në kundërshtim me kontratën e parë nr, 2725/15 prot datë 27.12.2023 neni 30 "Negociatat dhe amendamentet" pika 30.2 citon: Asnjë amendament ose variacion tjetër i kontratës nuk do të*

**jetë i vlefshëm pa qenë me shkrim, me datë, ti referohet shprehimisht kontratës dhe nënshkruhet nga një nga përfaqësues i autorizuar i Kontraktuesit dhe Autoritetit Kontraktor.**

**3:** Tek neni 3 i kontratës "Afati i kontratës" citohet: *kontrata do të realizohet për 30 ditë pune nga nënshkrimi i saj nga palët.* Përcaktimi i afatit 30 dite **pune** është në kundërshtim me LPP nr. 162 dt. 23.12.2020 neni 56 pika 5 citon: *Afatet kohore në këtë ligj jepen në ditë kalendarike, me përjashtim të rasteve kur ka specifikime të tjera, si dhe VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 neni 7 pika 10 citon: Afatet, kur nuk përcaktohen ndryshe në LPP dhe në këto rregulla, janë në dit kalendarike, dhe përllogariten sipas përcaktimit në Kodin e Procedurave Administrative,* Gjithashtu publikimi i njoftimit të lidhjes së kontratës nuk është bërë brenda 5 diteve në kundërshtim me VKM nr. 285 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" neni 86 :*Pas nënshkrimit të kontratës, brenda 5 (pesë) ditëve, autoriteti/enti kontraktor dërgon për publikim në sistemin e prokurimit elektronik dhe/ose Buletinën e Njoftimeve Publike njoftimin e kontratës së nënshkruar.* **Mbajnë përgjegjësi për veprimet dhe mos veprimet e tyre:** Administratori i USHLG, z, A. U dhe Personi përgjegjës për prokurimin znj, M. K.

#### **-Zbatimi i kontratës.**

Me urdhër nr, 916/2 datë 12.03.2024 është ngritur komisioni për marrjen në dorëzim si me poshtë:

Znj, L. D

Znj, A. B

Znj, I. S

**1:** Komisioni për marrjen në dorëzim ka mbajtur proces-verbal (i pjesshëm) me nr, 916/6 prot datë 13.03.2024 ku shprehet se malli u mor konform specifikimeve të përcaktuara në kontratë me vlerë 1,425,000 lekë pa TVSh dhe 1,710,000 lekë me TVSh.

Fatura tatimore është paraqitur nga OE me nr, 8/2024, datë 13.03.2024 ndërsa likuidimi i faturës është kryer me urdhër shpenzim nr, 97 datë në vlerën 1,710,000 lekë.

Me fletë hyrje nr, 4 datë 13.03.2024 është bërë hyrje në magazinë.

**2:** Komisioni për marrjen në dorëzim ka mbajtur proces-verbal me nr, 916/13 prot datë 25.04.2024 ku shprehet se malli u mor konform specifikimeve të përcaktuara në kontratë me vlerë 4,938,000 lekë pa TVSh dhe 5,925,600 lekë me TVSh.

Fatura tatimore është paraqitur nga OE me nr, 29/2024, datë 25.04.2024 ndërsa likuidimi i faturës është kryer me urdhër shpenzim nr, 172 datë në vlerë 5,925,600 lekë.

Me fletë hyrje nr, 13 datë 25.04.2024 është bërë hyrje në magazinë.

**Grupi i auditimit konstatoi** si kohëzgjatja e kontratës sipas përcaktimeve të sipër cituar me dite kalendarike është deri me datë 19.04.2024.

Ndërkohë që me date 25.04.2024 janë marrë në dorëzim pajisjet ose 5 ditë me vonesë.

Diferenca midis vlerës totale dhe shumës së marre në dorëzim është 5,925,600 lekë me TVSh (7,635,600 vlera totale e kontratës - 1,710,000 marrë në dorëzim = 5,925,600 lekë).

$4/1000 \times 5,925,600 = 23,702$  lekë me TVSh penaliteti ditor.

$23,702$  lekë me TVSh x 5 ditë = **118,512 lekë me TVSh** i cili është penaliteti për 5 ditë vonesë.

**Mbajnë përgjegjësi për veprimet dhe mos veprimet e tyre:** Administratori i USHLG, z, A. U. Gjithashtu nga inspektimi i magazinës konstatohet se pajisjet e laboratorit ndodhen të pa hapura në kuti në ambientet e magazine. Garancia pajisjeve është 1 vite dhe me datë 25.04.2025 mbaron garancia për pajisjet e fundit të dorëzuar pranë AK.

**Observacion i subjektit mbi Projekt Raportin e Auditimit, vënë në dispozicion grupit të auditimit në datë 27.03.2025 me nr.1101/11 prot.**

**Pretendimi i subjektit 1:** Për sa me sipër, në cilesinë e personit përgjegjës për vitin 2024,

caktuar me Urdhër nr. 10 date 09.02.2024 të Administratorit me nr. 456 prot. dt. 09.02.2024 po ju sqaroj se kontrata e parë e firmosur ndërmjet AK dhe OE me nr.2725/15 prot datë 27.12.2023 është refuzuar në sistemin AFMIS nga Drejtoria Rajonale e Thesarit Shkodër, me justifikimin: "Afati i kontratës në kundërshtim me ligjin nr. 9939 dt 26.06.2008, i ndryshuar, neni 50, 51 dhe udhëzimin Plotësues nr. 2 dt, 19.01.2023 pika 38.

Në përfundim ju citoni se përsonei përgjegjës për nënshkrimi e kontratave është Titullari i Institucioni.

**Pretendimi i subjektit 2:** Nisur dhe nga fakti që kontrata shtesë nuk ka ndryshuar asnjë detyrim tjetër të parashikuar në kontratën nr. 916 datë 06.03.2024 përveçse afatin, e gjykoj të drejtë arsyetimin tuaj që nëpunësi zbatues duhet të likuidonte dëmet për vonesa në zbatim për arsye se mallrat janë dorëzuar jashtë periudhës së zbatimit të specifikuar në kontratë. (referuar legjislacionit në fuqi).

Në këtë kontekst, është e drejtë të kërkohet likuidimi i dëmeve për vonesat e mundshme të shkaktuara nga dorëzimi i mallrave jashtë periudhës së zbatimit të specifikuar në kontratë, siç parashikohet në nenin 63 të Ligjit për Prokurimin Publik. Ky nen mbështet kërkesën për likuidimin e dëmeve për vonesat në zbatim, duke siguruar që çdo shkelje e afateve të realizimit të adresohen dhe të kompensohen në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

**Qëndrimi i Grupit të Auditimit:** Referuar observacioneve të ardhura me prot 1101/14 datë 27.03.2025, nuk u sollën arsyeime apo dokumenta shtesë vërtetues për pasojë **observacioni nuk merret në konsideratë.**

#### 4. Procedura e prokurimit “Pajisje Laboratori i Analizave Ushqimore”, me fond limit 9,920,665 pa TVSH,

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Pajisje Laboratori i Analizave Ushqimore” viti 2023			
<b>1. Lloji i Procedurës së Prokurimit</b> “Procedurë e hapur, <b>REF-80585-09-20-2023</b>	<b>2. Grupi i hartimit i specifikimeve teknike dhe fondit limit:</b> Urdhri nr. 2300 prot, datë 18.07.2023 J. P I. S D. K	<b>3. Njësia e Prokurimit</b> Urdhri nr. 2724 prot, 19.09.2023 M. K S. M S. B	<b>4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b> Urdhri nr. 2724/2 prot datë 19.09.2023 S. I X. Z N. R
<b>5. Fondi Limit (pa TVSh)</b> 9,920,665 lekë	<b>6. Oferta fituese (pa TVSh)</b> 8,800,000 lekë		<b>7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh)</b> 1,120,665 lekë
<b>8/1 Data e publikimit të tenderit</b> 26.02.2024	<b>9. Burimi Financimit</b> Fondet e Buxheti i Shtetit		<b>10. Operatorët Ekonomike</b> a) Pjesëmarrës në tender <b>5 OE;</b> 1. Kualifikuar 7 OE. 2. Skualifikuar 5 OE.
<b>8/2 Kohëzgjatja e kontratës</b> <b>60 ditë</b> nga data e nënshkrimit të kontratës.			
<b>12. Ankimim</b> Po	<b>13. Përgjigje Ankesës AK</b> po		<b>14. Përgjigje Ankesës nga KKP</b> Po
<b>b. Zbatimi i Kontratës Prokurimit</b>			
<b>15. Lidhja e kontratës</b> Kontrata me nr, 42/33 prot datë 11.06.2024	<b>Zbatimi i kontratës:</b> Me urdhër nr, 42/35 datë 25.06.2024 është ngritur komisioni për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës.		

**-Auditimi i hartimit të fondit limit, vendosjen e specifikimeve teknike dhe hartimi i kritereve të DST.**

Me Urdhrin e Titullarit të AK nr. 2300 prot, datë 18.07.2023 është ngritur grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe përlllogaritjen e fondit limit, si më poshtë:

**-Hartimi i specifikimeve teknike dhe përlllogaritja e fondit limit:**

J. P.

I. S.

D. K.

Me proces-verbal me nr, 2300/1 prot datë 06.09.2023, Komisioni për hartimin e specifikimeve teknike dhe përlllogaritjes së fondit limit ka paraqitur studimin e tregut për përcaktimin e fondit limit, i cili është **9,920,665** lekë pa TVSh dhe ka hartuar specifiket teknike.

Me shkresë nr, 2724/4 prot datë 27.09.2023 AK pa pezulluar procedurën pasi paraqitjes se ankesë nga OE "A" për specifikimet teknike te hartuara nga AK.

Me shkresë 2724/6 datë 03.10.2023 AK ka dërguar pranë Komisionit të Prokurimeve Publike përgjigjen mbi ankesë e paraqitur nga OE.

Me shkresë 2367/5 datë 16.10.2023 prot pranë AK me nr, 2724/7 datë 19.10.2023 KPP dërguar vendimin nr, 1041/2023, i cili vendosi si me poshtë:

**1: Te mbyll çështjen për pjesën e ankesës se OE.**

**2: Të pranojë pjesërisht ankesën e OE për procedurën e sipërpërmendur.**

**3: AK të kryej modifikimet përkatëse në përputhje me arsyetimet dhe konstatimet të KPP si dhe të publikoj të gjithë ndryshimet ne SPE.**

**4: AK brenda 5 ditëve, të vërë në dizeni KPP për zbatimin e këtij vendimi.**

Me shkresë nr, 2357/7 prot, datë 23.10.2023, prot pranë AK me nr, 2724/9 datë 26.10.2023, KKP kërkon AK që të zbatoj vendimin nr, 1041/2023.

KPP ka ridërguar me shkresë nr, 2367/9 prot, datë 20.12.2023, prot pranë AK me nr, 2724/10 datë 26.12.2023, KKP kërkon AK që të zbatoj vendimin nr, 1041/2023.

AK me shkresë nr, 2724/12 prot, datë 29.12.2023 ka dërguar pranë KPP ndryshimet e kryera sipas vendimit të saj.

Me shkresë nr, 2367/14 prot, datë 05.01.2024, prot pranë AK me nr, 42 datë 11.01.2024 ka dërguar vendimin nr 12/2024 i cili vendosi si me poshtë:

1: Të mos lejoj AK për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës se sipërpërmendur.

2: AK të publikojë shtojcën ne zbatim të vendimit nr. 1041/2023 datë 16.10.2023 të KPP.

Me shkresë nr, 42/3 prot, datë 16.01.2024 AK ka dërguar shtojcën e DST pranë KPP.

Me shkresë nr, 2367/18 prot datë 24.01.2024, prot pranë AK me nr, 42/5 prot, datë 01.02.2024 ka dërguar vendimin nr, 81/2024 i cili vendosi si me poshtë:

1: Të mos lejoj AK Për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës se sipërpërmendur.

2: AK të publikojë shtojcën ne zbatim të vendimit nr. 1041/2023 datë 16.10.2023 të KPP.

Me shkresë nr, 42/5 prot, datë 05.02.2024 AK ka dërguar shtojcën e DST pranë KPP.

Me shkresë nr, 294/3 prot, datë 14.02.2024, prot pranë AK me nr, 42/8 datë 14.02.2024 ka dërguar vendimin nr 179/2024 i cili vendosi si me poshtë:

1: Të lejojë AK Për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës se sipërpërmendur.

Me shkresë nr, 42/9 prot, datë 19.02.2024 është ngarkuar në sistem e SPE ndryshimet e kryera sipas vendimit te **KPP**.

**Grupi i Auditimit konstatoi se AK ka zbatuar vendimin e KPP mbas 122 ditësh ndërkohë që në vendim e KPP citohet se brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni KPP për zbatimin e këtij vendimi veprime ne kundërshtim me *LIGJIN Nr. 162/2020 “PËR PROKURIMIN PUBLIK” neni 24 pika 1. Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit dhe kryen çdo detyrë tjetër që i ngarkohet me këtë ligj dhe akte të tjera ligjore brenda fushës së kompetencave të tij. 3. Komisioni i Prokurimit Publik merr vendime për ankesat e paraqitura para tij dhe nxjerr interpretim për rregullat ose parimet ligjore, që duhet të zbatohen për objektin e ankesës, të cilat zbatohen për sa janë të vlefshme në vendimmarrjet e ardhshme. Në marrjen e vendimeve mban parasysh, përveç parimeve të përgjithshme të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, edhe parimet e mëposhtme: paanshmërinë në shqyrtimin e ankesave, qëndrueshmërinë në vendimmarrje, ligjshmërinë, shpejtësinë dhe efikasitetin, aksesin, karakterin publik, si edhe parimin e kontradiktoritetit. Neni 30 pika 2. Vendimet e marra nga Komisioni janë administrativisht përfundimtare. Këto vendime mund të ankimohen në Gjykatën Administrative të Apelit, në përputhje me nenin 121 të këtij ligji, pika 3. Në përfundim të shqyrtimit, vendimi i marrë nga Komisioni, përveç palëve në proces u bëhet i njohur edhe subjekteve të tjera që preken nga ky vendim, si edhe publikohet në faqen e internetit të këtij institucioni brenda 2 ditëve nga dalja e tij.***

**Mbajnë përgjegjësi për veprimet dhe mos veprimet:** Administratori i USHLG, z. A. U, dhe njësia e prokurimit znj, M. K, znj, S. M dhe S. B.

**Observacion i subjektit mbi Projektin Raportin e Auditimit, vënë në dispozicion grupit të auditimit në datë 27.03.2025 me nr.1101/11 prot.**

**Pretendimi i subjektit 1:** Pas këtij vendimi, Komisioni i Specifikimeve Teknike u përball me nevojën për të rishikuar në detaje specifikimet teknike, përfshirë përcaktimin e diapazoneve, përmasave dhe karakteristikave teknike të artikujve të përmendur në ankesë, që kryesisht adresonte problematikën se orientonim artikujt e tenderuar jo për masën e gjërë të tregut. Ky proces kërkonte kohë shtesë për t'u realizuar me kujdes dhe për të shmangur çdo pasaktësi që mund të ndikonte në transparencën dhe ligjshmërinë e procedurës që të mos ishte më objekt refuzimi. Duke pasur parasysh rrethanat e përmendura, mbetem në mirëkuptimin tuaj për vonesën e krijuar si pasojë e problematikave të sjella nga ankesa dhe vendimet e mëtejshme të kërkuara për specifikimet teknike të artikujve tepër të veçantë.

**Pretendimi i subjektit 2:** Si pjesë e njësisë së prokurimit sqarojme se vendimi i KPP-së nr 2724/7 prot dt 19/10/2023 pranon ankesën e bërë nga A. në lidhje me specifikimet teknike të procedurës që janë bërë nga specialistët e fushës sipas urdhrat të prot nr 2300 dt 18/07/2023, por nuk vendos specifikimet definitive teknike të paisjeve të ankimuar, duke sjellë si pasojë që komisionet në vijim të ngarkuara për specifikimet teknike të arrijnë në konkluzionet finale për t'i dërguar përsëri në KPP për miratim në se janë plotësuar apo jo specifikimet përfshirë ndryshimet e diapazoneve, përmasat apo parametra të tjerë specifikë.

Në shkresën 2724/8 është dorëzuar pranë KPP-së shkresa që komisioni i specifikimeve teknike ka nevojë për kohë, sic janë shprehur edhe vetë për kohën e konsiderueshme që kanë marrë për kthim përgjigje në shkresën prot nr.2724/11 dt 29/12/2024 duke qenë se paisjet janë për hulumtim shkencor dhe vetë ligji parashikon që në rastet ku komisioni i specifikimeve teknike ka specialist fushe dhe hartimi i specifikimeve teknike bëhet nga ky komision, njësia e prokurimit nuk përfshihet kur janë hartuar nga struktura të posaçme specifike, por mban përgjegjësi për hartimin e dokumentave standarde të tenderit, dhe në rast se ka ankesa, krijohen komisionet e shqyrtimit të ankesave që merr sqarime nga komisioni i specifikimeve etj, dhe njësia e prokurimit mbetet thjesht përgjegjëse për dokumentat e tenderit dhe dokumentat e tjera, por pa fuqi vendimarrëse në lidhje me çështjet në KPP sipas nenit 101 "Hapat për shqyrtimin e

ankesave në autoritetin/entin kontraktor" VKM nr,285 dt "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" dhe Neni 74 "Personi përgjegjës për prokurimin dhe njësia e prokurimit" njëjtën VKM.

**Qëndrimi i Grupit të Auditimit:** Referuar observacioneve të ardhura me prot 1101/14 datë 27.03.2025, nuk u sollën arsyetime apo dokumenta shtesë vërtetues për pasojë **observacioni nuk merret në konsideratë.**

**-Mbi auditimin e realizimit të procedurës në bazë të DT dhe përzgjedhja e operatorit ekonomik fitues.**

Urdhri nr. 2724/2 prot, datë 19.09.2023, Titullari i AK , ka ngritur Komisionin e Vlerësimit të Ofertave (KVO), të përbërë nga:

Znj. S. I

Znj. X. Z

Z. N. R

Me procesverbal me nr, 42/10 datë 26.02.2024 u be hapja e oferta te dorëzuara për procedurën e prokurimit ku morën pjesë 7 OE si me poshtë:

Nr	Operatori ekonomi	Oferta lekë pa TVSh	Kualifikuar/S'Kualifikuar
1.	M	6,860,120	Skualifikuar
2.	A	8,800,000	Kualifikuar dhe shpallur fitues.
3.	A	Pa ofertë	Skualifikuar
4.	F	9,181,000	Skualifikuar
5.	K	Pa ofertë	Skualifikuar
6.	I	7,249,160	Kualifikuar
7.	D	7,900,000	Skualifikuar

Me proces verbal me nr 42/11 datë 08.03.2024 KVO ka vlerësuar oferta si me poshtë vijon:

- OE **M** me NUIS **J s'kualifikohet** pasi **Zëri 1 faqe 55 kat 2 Konsumi maksimal i energjisë elektrike është 3KË I kërkuar ndërsa tek katalogu është 7 KË.**

**Zëri 4 është përkthyer pjesërisht katalogu ku tabela technical data është përkthyer vetëm emërtimi I tabelës dhe jo përmbajtja, Zëri 5 katalogu pjesërisht i përkthyer ndërsa tek temperature e matjes është kërkuar -75 deri ne 195 dhe ne katalog është -75 -deri ne 175**

**Zëri 17 kat 2 faqja 28 ka vetëm faturën e blerjes nuk ka informacione mbi specifikimet teknike**

**Zëri 23 faqja 66 pj 1 Nuk ka përkthim, Zëri 29 katalog 4 faqe 1, Ekranin kërkuar është 5.7 inch ndërsa tek katalogu është 4.3.**

- OE **F** me NUIS **K s'kualifikohet pasi në dokumentacion mungon tek: Zëri 5 mungon temperatura e matjes se kërkuar ne specifikime teknike 75°C -195°C. Zëri 10 mungon shkalla e ramp rate. Zëri 14 raftet duhen te kenë kapacitet jo me pak se 48kg ndërsa ne specifikime teknike sipas OE është 30kg**

- OE **D** NUIS **L s'kualifikohet** pasi në dokumentacion mungon: **Zëri 1 faqe 55 kat 2, Zëri 1 kërkohej diapazoni temperaturës 10-40 ku ne specifikime teknike mungon, Zëri 9 kërkuar saktësia e kripërave dhe densiteti ku mungojnë secila, Zëri 16 saktësia e kërkuar ne diapazonin e**

matjes është 0.025 ndërsa ne specifike teknike është 0.125, Zëri 17 mungojnë specififikimet teknike të acidometrit, Zëri 18 specifikime teknike kërkuar për produktin ngjyra e bardhe ndërsa është paraqitur ngjyra inox.

- OE A M s'kualifikohet ska paraqitur ofertë ekonomike.
- OE K K s'kualifikohet ska paraqitur ofertë ekonomike.
- OE A K Kualifikohet
- OE I L Kualifikohet.

Me shkresë nr, 42/12 prot, datë 08.03.2024 OE "I" me ofertë më të ulët i është bërë kërkesë për të paraqitur dokumentet pranë AK.

Me shkresë nr 42/15 datë 21.03.2024 KVO ka vlerësuar dokumentacioni e paraqitur nga OE dhe ka vendosur ta s'kualifikoj pasi mungon vërtetimi i detyrimit për pagimin e taksave dhe tatimeve, si dhe nuk ka paraqitur vërtetim për mos përjashtim nga APP. Kriteri i cili është detyrues sipas LPP nr. 162 dt. 23.12.2020, "Për prokurimin publik" Neni 76 Kriteret detyruese për skualifikim pika 2 citon: *Një operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në një procedurë prokurimi kur operatori ekonomik ka shkelur detyrimet e tij në lidhje me pagesën e taksave ose kontributeve të sigurimeve shoqërore.*

Me shkresë nr, 42/17 prot datë 21.03.2024 KVO kaloi tek OE i radhës me ofertë më të ulët "A" dhe i bën kërkesë për të paraqitur dokumentet pranë AK.

Me proces verbal nr 42/20 datë 16.04.2024 KVO ka shpallur fitues OE A më ofertë 8,800,000 lekë pa TVSh.

Me shkresë nr, 42/22 prot datë 16.04.2024 është publikuar formulari i njoftimit paraprak.

Me shkresë nr, 42/23 prot datë 24.04.2024 është pezulluar procedura pas paraqitjes së ankesës nga OE "M".

Me shkresë nr. 42/25 prot, datë 30.04.2024 AK i ka kthyer përgjigje KPP mbi ankesën e paraqitur nga OE.

Me shkresë nr, 981 prot datë 27.05.2024, prot pranë AK me nr 42/30, datë 03.06.2024 KPP me vendim nr, **572/2024** ka vendosur të mos pranojë ankesën e OE.

#### ***-Lidhja e kontratës.***

Kontrata midis AK dhe OE është lidhur me nr, 42/33 prot datë 11.06.2024 dhe afati për shërbimit 60 ditë nga nënshkrimi i kontratës.

#### ***-Zbatimi i kontratës.***

Me urdhër nr, 42/35 datë 25.06.2024 është ngritur komisioni për marrjen në dorëzim si me poshtë:

Z, J. P.

Znj, A. B.

Znj, A. A.

### **5. Procedura e prokurimit "Paisje për Inventar Ekonomik", me fond limit 4,119,033 pa TVSH,**

<b>Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Paisje për Inventar Ekonomik" viti 2023</b>
---

<b>1. Lloji i Procedurës së Prokurimit</b> “Procedurë e hapur, E hapur, e thjeshtuar, <b>REF-83539-10-12-2023</b> ”	<b>2. Grupi i hartimit i specifikimeve teknike dhe fondit limit:</b> Urdhri nr. 2982 prot, datë 04.10.2023 I. S I. K D. R	<b>3. Njësia e Prokurimit</b> Urdhri nr. 2982/2 prot, datë 09.10.2023 M. K S. M S. B	<b>4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b> Urdhri nr. 2982/5, datë 12.10.2023 N. R S. I E. S
<b>5. Fondi Limit (pa TVSh)</b> 4,119,033 lekë	<b>6. Oferta fituese (pa TVSh)</b> 3,775,300 lekë		<b>7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh)</b> 343,733lekë
<b>8/1 Data e publikimit të tenderit</b> 13.10.2023	<b>9. Burimi Financimit</b> Fondet e Buxheti i Shtetit	<b>10. Operoret Ekonomike</b> a) Pjesëmarrës në tender <b>3 OE;</b> <b>1.</b> Fitues M SHPK me vlerë 3,775,300 lekë.	
<b>8/2 Kohëzgjatja e kontratës</b> 1 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës.			
<b>12. Ankimim</b> Jo	<b>13. Përgjigje Ankesës AK</b>	<b>14. Përgjigje Ankesës nga KKP</b>	
<b>b. Zbatimi i Kontratës Prokurimit</b>			
<b>15. Lidhja e kontratës</b> Kontrata me 2982/20 prot datë 21.12.2023, Kontratë me nr, 669 prot datë 26.02.2024.	<b>Zbatimi i kontratës:</b> Me urdhër nr, nr, 669/5 datë 04.03.2024 është ngritur komisioni për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës.		

***-Auditimi i hartimit të fondit limit, vendosjen e specifikimeve teknike dhe hartimi i kritereve të DST.***

Me Urdhrin e Titullarit të AK nr. 2982/1 prot, datë 04.10.2023 është ngritur grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe përlllogaritjen e fondit limit, si më poshtë:

**-Hartimi i specifikimeve teknike dhe përlllogaritja e fondit limit:**

I. S.

I. K.

D. R.

Me proces-verbal me nr, 2982/1 prot datë 09.10.2023, Komisioni për hartimin e specifikimeve teknike dhe përlllogaritjes së fondit limit ka paraqitur studimin e tregut për përcaktimin e fondit limit, i cili është 4,119,033 lekë pa TVSh dhe ka hartuar specifiket teknike, disa nga specifikimet teknike si me poshtë vijon:

***-Mbi auditimin e realizimit të procedurës në bazë të DT dhe përzgjedhja e operatorit ekonomik fitues.***

Urdhri nr. 2982/5, datë 12.10.2023, Titullari i AK , ka ngritur Komisionin e Vlerësimit të Ofertave (KVO), të përbërë nga:

N. R, Kryetar

S. I, Anëtar

E. S, Anëtar

Me procesverbal me nr, 2982/6 datë 23.10.2023 u be hapja e oferta te dorëzuara për procedurën e prokurimit ku morën pjesë 3 OE si me poshtë:

Nr	Operatori ekonomi	Oferta lekë pa TVSh	Kualifikuar/S'Kualifikuar
----	-------------------	---------------------	---------------------------

1.	M	3,775,300	Kualifikuar dhe shpallur fitues
2.	E	4,035,700	Kualifikuar dhe shpallur fitues.
3.	E	3,875,900	Skualifikuar

Sa më sipër, oferta e shpallur fituese me shkresë “Vlerësimi përfundimtar” nr, 2982/10 datë 10.11.2023 është e OE “M” shpk, me ofertën ekonomike në vlerën 3,775,300 lekë pa TVSh ose 4,506,300 me TVSh.

**-Lidhja e kontratës.**

Kontrata midis AK dhe OE është me nr, 2982/20 prot datë 21.12.2023 dhe afati për dorëzimin e mallit është 1 muaj nga nënshkrimi i kontratës.

Plani i zbatimi të kontratës është me nr, 2982/21 prot, datë 21.12.2023.

AK ka lidhur kontrate të re me OE është me nr, 669 prot datë 26.02.2024 dhe afati për dorëzimin e mallit është 1 muaj nga nënshkrimi i kontratës.

Me shkresë nr, 669/1 prot, datë 26.02.2024 është hartuar plani i zbatimit të kontratës së dytë.

Me shkresë nr, 669/2 prot, datë 26.02.2024 është hartuar formulari i njoftimit të kontratës së nënshkruar bazuar ne kontratën e lidhur me datë 26.02.2024.

**Grupi i auditimi konstatoi si me poshtë vijon:**

**1:** Urdhri i prokurimit është hartuar me datë 09.10.2023 dhe sipas procedurave dhe afateve të LPP kontrata me OE detyrimisht do të lidhej mbas datës 15 tetor, *Veprime kundërshtim me ligjin e buxhetit nr 9936 dt 26.6.2008, neni 51, si dhe Udhëzimi nr. 9 date 20.03.2018 Për Procedurat Standarte te Zbatimit te Buxhetit pika 83 citon: Nëpunësi autorizues i njësisë së qeverisjes së përgjithshme mund të ndërmarrë angazhime të reja gjatë vitit buxhetor, por jo më vonë se data 15 tetor e çdo viti buxhetor.*

**2:** AK ka hartuar dhe firmosur 2 kontrata me të njëjtin objekt prokurimi, numër reference, vlerë kontratë etj. Por me datë te ndryshme dhe numri protokollit të ndryshëm.

**a)** Kontrata e parë e firmosur ndërmjet AK dhe OE me 2982/20 prot datë 21.12.2023 nuk mundej të regjistrohej në sistemin e thesarit dhe është refuzuar regjistrimi i saj për veprime ne kundërshtim me *ligjin e buxhetit nr 9936 datë 26.06.2008.*

**b)** Kontrata e dyte është firmosur ndërmjet AK dhe OE me nr, 669 prot datë 26.02.2024 por pa u bere me pare një anulim/revokim apo ndryshim në kontratën e parë.

Afati për marrjen ne dorëzim te mallit nga komisioni i marrjes në dorëzim është kryer referuar kontratës se të lidhur me nr, 669 prot datë 26.02.2024.

*Në kundërshtim me kontratën e parë nr, 2982/20 prot datë 21.12.2023 neni 30 “Negociatat dhe amendamentet” pika 30.2 citon: Asnjë amendament ose variacion tjetër i kontratës nuk do të jetë i vlefshëm pa qenë me shkrim, me datë, ti referohet shprehimisht kontratës dhe nënshkruhet nga një nga përfaqësues i autorizuar i Kontraktuesit dhe Autoritetit Kontraktor.*

**Mbajnë përgjegjësi për veprimet dhe mos veprimet e tyre:** Administratori i USHLG, z, A. U dhe Personi përgjegjës për prokurimin znj, M. K.

**-Zbatimi i kontratës.**

Me urdhër nr, 669/5 datë 04.03.2024 është ngritur komisioni për marrjen në dorëzim si me poshtë:

Znj, A. A

Z, B. H

Znj, A. B

Z, E. K

Z, G. T

**1:** Komisioni për marrjen në dorëzim ka mbajtur proces-verbal me nr, 669/7 prot datë 25.03.2024 ku shprehet se malli u mor konform specifikimeve të përcaktuara në kontratë me vlerë 3,755,300 lekë pa TVSh dhe 4,506,360 lekë me TVSh.

Fatura tatimore është paraqitur nga OE me nr, 8/2024, datë 25.03.2024 ndërsa likuidimi i faturës është kryer me urdhër shpenzim nr, 98 datë në vlerën 4,506,360 lekë.

Me fletë hyrje nr, 8 datë 25.03.2024 është bërë hyrje në magazinë.

## **6. Procedura e prokurimit “Rikonstruksion Catia FSHE”, me fond limit 11,666,666 pa TVSH,**

<b>Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Rikonstruksion Catia FSHE” viti 2023</b>			
<b>1. Lloji i Procedurës së Prokurimit</b> “Procedurë e hapur, : E hapur, e thjeshtuar, <b>REF-85758-10-30-2023</b>	<b>2. Grupi i hartimit i specifikimeve teknike dhe fondit limit:</b>	<b>3. Njësia e Prokurimit</b> Urdhri nr. 3047/5 datë 12.10.2023 M. K S. M S. B	<b>4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b> Urdhri nr. 3047/7 datë 12.10.2023 N. R S. I E. S
<b>5. Fondi Limit (pa TVSh) 11,666,666 lekë</b>	<b>6. Oferta fituese (pa TVSh) 9,634,688 lekë</b>		<b>7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 2,031,978 lekë</b>
<b>8/1 Data e publikimit të tenderit</b> 31.10.2023	<b>9. Burimi Financimit</b> Fondet e Buxheti i Shtetit		<b>10. Operatorët Ekonomike</b> a) Pjesëmarrës në tender <b>7 OE;</b> <b>1. Kualifikuar 6 OE</b> <b>2. Skualifikuar 1 OE</b> <b>3. Fitues L SHPK me vlerë 9,634,688 lekë.</b>
<b>8/2 Kohëzgjatja e kontratës</b> 4 muaj nga data që kontraktorit i jepet leja për të hyrë në kantier.			
<b>12. Ankimim</b> Jo	<b>13. Përgjigje Ankesës AK</b>	<b>14. Përgjigje Ankesës nga KKP</b>	
<b>b. Zbatimi i Kontratës Prokurimit</b>			
<b>15. Lidhja e kontratës</b> Kontrata me nr, 1030 prot datë 19.03.2024, Kontratë me nr, 1030/2 prot datë 25.03.2024.			

### **-Auditimi i hartimit të fondit limit, vendosjen e specifikimeve teknike dhe hartimi i kriterëve të DST.**

Preventivi i Catis është realizuar nga OE L SHPK dhe fondi i përlogaritur është 11,666,666 lekë pa TVSh.

AK ka kërkuar asistencë për procedurën e prokurimit dhe APP ka rekomanduar specifikimet e Procedurës.

Njësia e prokurimit është ngritur me urdhër nr, 3047/5 prot datë 12.10.2023 të përberë nga;

M. K,

S. M

S. B

**-Mbi auditimin e realizimit të procedurës në bazë të DT dhe përzgjedhja e operatorit ekonomik fitues.**

Urdhri nr. 3047/7, datë 12.10.2023, Titullari i AK , ka ngritur Komisionin e Vlerësimit të Ofertave (KVO), të përbërë nga:

E. S, Kryetar

S. I, Anëtar

N. R, Anëtar

Me procesverbal me nr, 3047/12 datë 20.11.2023 u be hapja e oferta te dorëzuara për procedurën e prokurimit ku morën pjesë 7 OE si me poshtë:

Nr	Operatori ekonomi	Oferta lekë pa TVSh	Kualifikuar/S'Kualifikuar
1.	L	9,634,688	Kualifikuar dhe shpallur fitues.
2.	A	9,643,494	Kualifikuar
3.	N	10,506,796	Kualifikuar
4.	S	10,713,523	Skualifikuar
5.	T	10,784,851	Kualifikuar
6.	K	11,510,231	Kualifikuar
7.	B	11,355,810	Kualifikuar

Sa më sipër, oferta e shpallur fituese me shkresë “Vlerësimi përfundimtar” nr, 3047/16 datë 18.12.2023 është e OE “L” shpk, me ofertën ekonomike në vlerën 9,634,688 lekë pa TVSh ose 11,418,326 me TVSh.

**Grupi i auditimi konstatoi** se tek DST pika 2.16. Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera është shënuar **JO**.

Ndërkohe që OE fitues Liqeni VII ka marë mbështetje nga OE ONI shpk për 1 . Elektricist dhe 1. Teknik IT, nga OE S 1. Elektricist, dhe nga S 1 . Auto Vinc.

Gjithashtu dhe OE fitues L nuk ka dorëzuar vërtetimin për pagimin e taksave dhe tatimeve por ka paraqitur vetëm vërtetim për pagimin e kontributeve të sigurimeve shoqërore.

**Për sa me sipër KVO** nuk ka respektuar kërkesat e vendosura në DST pika 2.16. Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera është shënuar **JO**. *Veprimet në kundërshtim me LPP nr. 162 dt. 23.12.2020, "Për prokurimin publik" Neni 76 Kriteret detyruese për skualifikim pika 2 citon: Një operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në një procedurë prokurimi kur operatori ekonomik ka shkelur detyrimet e tij në lidhje me pagesën e taksave ose kontributeve të sigurimeve shoqërore, Neni 92 Shqyrtimi i ofertave pika 3 citon: Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji, dhe VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 Neni 26 Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit pika 2 germa dh citon: operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së dhe Neni 82 Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave pika 2 citon: Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin*

*kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme.*

**Mbajnë përgjegjësi për veprimet dhe mos veprimet e tyre:** z, N. R, z, S. I dhe z, E. S.

**-Lidhja e kontratës.**

Kontrata midis AK dhe OE është me nr, 1030 prot, datë 19.03.2024 dhe afati për realizimin e punimeve është 4 muaj nga data që kontraktorit i jepet leja për të hyrë ne kantier.

Plani i zbatimi të kontratës është me nr, 1030/1 prot, datë 19.03.2024.

AK ka lidhur kontrate të re me OE është me nr, 1030/2 prot datë 25.03.2024 dhe afati për realizimin e punimeve është 4 muaj nga data që kontraktorit i jepet leja për të hyrë ne kantier. Me shkresë nr, 1030/3 prot datë 25.03.2024 është hartuar plani i zbatimit të kontratës së dytë. Me shkresë nr, 1030/9 prot datë 28.03.2024 është hartuar formulari i njoftimit të kontratës së nënshkruar bazuar ne kontratën e lidhur me datë 26.02.2024.

**Grupi i auditimi konstatoi si me poshtë vijon:**

**1:** Përfundimi i afateve te ankimit është më datë me shkresë nr, 3047/19 prot datë 31.12.2023 ndërsa kontratat është lidhur datë 19.03.2024 dhe është lidhur 79 ditë mbas përfundimit të afateve të ankimit. Në kundërshtim me VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar neni 85 Lidhja e kontratës pika 1 citon:*

*Autoriteti/enti kontraktor do të ftojë operatorin ekonomik të shpallur fitues, që të lidhë kontratën menjëherë pas përfundimit të afateve të ankimit ose dhënies së një vendimi përfundimtar për ankesën, por, në çdo rast, jo më vonë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga kjo datë.*

**2:** AK ka hartuar dhe firmosur 2 kontrata me të njëjtin objekt prokurimi, pasi ne kontratën e parë nuk është vendosur sigurimi i kontratës 5% sigurimit qe do të deri ne përmbushje e detyrimeve te garancisë e cila është 24 muaj.

**a)** Kontrata e parë e firmosur ndërmjet AK dhe OE me 1030 prot datë 19.03.2024.

**b)** Kontrata e dyte është firmosur ndërmjet AK dhe OE me 1030/2 prot datë 25.03.2024 por pa u bere me pare një anulim/revokim apo ndryshim në kontratën e parë.

*Në kundërshtim me kontratën e parë nr, 1030 prot datë 19.03.2024 neni 44 “Negociatat dhe amendamentet” pika 44.2 citon: Asnjë amendament ose variacion tjetër i kontratës nuk do të jetë i vlefshëm pa qenë me shkrim, me datë, ti referohet shprehimisht kontratës dhe nënshkruhet nga një nga përfaqësues i autorizuar i Kontraktuesit dhe Autoritetit Kontraktor.*

**Mbajnë përgjegjësi për veprimet dhe mos veprimet e tyre:** Administratori i USHLG, z, A. U dhe personi përgjegjës për prokurimin znj, M. K

**Pika 2.5.1 e programit: Lidhja dhe zbatimi i kontratave deri në marrjen në dorëzim të mallrave /punëve dhe shërbimeve.**

**1.** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për zbatimin e kontratës me objekt: *“Investim për ndriçim të objekteve dhe tabelave emërtuese të ndërtesave”* rezultoi se:

- Objekti i kontratës është *“Investim për ndriçim të objekteve dhe tabelave emërtuese të ndërtesave”* me nr.2436/28 prot., datë 26.11.2023, lidhur midis Universitetit Luigj Gurakuqi, Shkodër dhe Operatorit Ekonomik OE “N” Shpk. Vlera e kontratës është 11,367,261.6 lekë me Tvsh. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 60 ditë nga data e të fillimit të punimeve. Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, është lidhur kontrata përkatëse me nr.2657/8 prot., datë 15.12.2024 midis AK Universitetit Luigj Gurakuqi, Shkodër dhe mbikëqyrësit “S-A” Shpk, me licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 4146/3.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezultoi se dorëzimi i sheshit të ndërtimit dhe njoftimi i fillimit të punimeve është kryer më datë 19.01.2024. Procesverbali i fillimit të punimeve dhe akti i piketimit janë realizuar më datë 19.01.2024. Afati fillestar i parashikuar në kontratë ishte 60 ditë nga data e lirimt të sheshit të ndërtimit. Punimet në këtë objekt janë pezulluar për shkak të provimeve dhe pranisë së studentëve nëpër klasa; për këtë arsye është kryer zgjatje e afatit fillestar të punimeve me 6 ditë. Është mbajtur amendament kontrate me nr.56/24 datë 09.05.2024, po në këtë datë është kryer njoftimi i rifillimi të punimeve dhe procesverbali i rifillimit të punimeve. Janë kryer ndryshime në preventivin fillestar të punimeve. Këto ndryshime konsistojnë në volume punimesh që shtohen dhe zbriten, por në total janë brenda vlerës së kontratës. Njoftimi i përfundimit të punimeve është kryer nga Kontraktori më datë 15.05.2024. Në dosjen teknike administrohej librezat e masave përfundimtare, e cila korrespondonte me situacionin përfundimtar.

-Për këtë objekt në vitin 2021 është prokuruar një projekt: *“Ndricim të objekteve dhe tabelave emërtuese të ndërtesave të Universitetit “Luigj Gurakuqi”* në vlerën 213,456 lekë me TVSh. Pas dy vitesh me anë të një urdhëri për prokurim me vlerë të vogël me nr.16 më datë 16.06.2023 është kërkuar rishikim i projektit ekzistues dhe është realizuar një projekt i ri: *“Rishikim për efekt aktualizimi i pjesës që lidhet me ndricimin e jashtëm në projektin “ Ndricim të objekteve dhe tabelave emërtuese të ndërtesave të Universitetit “Luigj Gurakuqi”*. (Shtojcë) në vlerën 118,200 lekë me TVSh. Ky ndryshim i projektit fillestar është propozuar nga Senati i Universitetit Shkodrës dhe miratuar bordi i administrimit me vendimin me nr.83 datë 28.03.2023, dhe futur me një zë të veçantë në buxhet *“Rishikim i projektit për ndricimin e ndërtesave të Universitetit “Luigj Gurakuqi; ndërkohë që nuk argumentohet nevoja për ndryshimin e projektit fillestar. Gjithashtu personat që kanë miratuar këtë ndryshim nuk kanë arsimin dhe kualifikimin përkatës.*

Më pas ky projekt është tenderuar për zbatimin e punimeve. Ky veprim ka sjellë shpërdorimin e fondeve të Universitetit Luigj Gurakuqi Shkodër pasi janë realizuar dy projekte për të njëjtin qëllim, duke vepruar në kundërshtim me ligjin për prokurim publik nr.162 datë 23.12.2020 dhe Ligji Nr. 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", Ligji Nr. 10431 "Për Mbrojtjen e Mjedisit", Vendimet dhe udhëzimet e Këshillit të Ministrave dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë. Vlera **93,456 lekë me TVSh** (213,456 lekë -120,000 lekë) përben dëm ekonomik. Për veprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi bordi i administrimit dhe senati i Universitetit Luigj Gurakuqi, Shkodër.

- Nga verifikimi i dokumentacionit tekniko-ligjor në dosjen zbatimit, u vu re se mungojnë disa dokumente teknik, ndër më kryesorët mund të përmendim: certifikatat dhe skeda teknike për materialet e përdorura, miratimi i tyre, prova teknike e sistemit të ndriçimit me ngarkesë, skica dhe vizatime teknike për librezat e masave.

-Nga verifikimi në terren u konstatua se kemi një sërë zërash pune të cilët janë gjendur në sasi më të vogël sesa janë raportuar në situacionin përfundimtar. Pra ka një diferencë midis punimeve faktike dhe ato të raportuara në situacionin përfundimtar në vlerën **1,677,708 lekë pa TVSh**, të cilat do të konsiderohen si dëm ekonomik nëse punimet e gjendura në mangësi nuk do të korrigjohen dhe realizohen gjatë hartimit të aktit të kolaudimit.

-Përveç këtyre në objekt u konstatua në fakultetin e Shkencave të Natyrës dhe të Drejtësisë një pjesë e ndriçimit të jashtëm ishte djegur dhe fasada nuk është e ndriçuar. Konkretisht për këto zëra: Fasada (1) kemi 8 shirita led të djegur

8 copë Shirita led 7Ë/ml x 18.1 ml = 144.8 ml x 250 lekë/ml = 36,200 lekë

Fasada (4) kemi 5 shirita led te djegur

5 copë Shirita led 7Ë/ml x 18.1 ml = 90.5 ml x 250 lekë/ml = 22,625 lekë

Pra do të kemi vlerën **58,825 lekë pa TVSh**( 36,200 lekë+22,625 lekë) për punime faktike të raportuara në situacionin përfundimtar, por të realizuara pa cilësi me difekte dhe ende të pariparuara nga ana e Kontraktorit.

**Vlera totale 1,736,533 lekë pa TVSh (1,677,708 lekë + 58,825 lekë)** do të konsiderohen si dëm ekonomik nëse punimet e gjendura në mangësi dhe pacilësi nuk do të korrigjohen dhe realizohen gjatë hartimit të aktit të kolaudimit.

-Gjithashtu aktualisht nga ana e Fondit Shqiptar të Zhvillimit si investitor me përftues Bashkia Shkodër, po kryhen disa punime paralele për termoizolimimin e fasadave të godinave të qytetit Shkodër. Këto punime kanë sjellë mbivendosje të punimeve të ndriçimit për objektin: *“Investim për ndriçim të objekteve dhe tabelave emërtuese të ndërtesave”*, konkretisht për nënobjektin e kontratës së mësipërme *“Rektorati”* i Universitetit Luigj Gurakuqi.

Aktualisht punimet për këtë objekt nuk janë marr ende në dorëzim të përhershëm nga ana e AK, objekti është ende në periudhën e garancisë së punimeve e cila përfundon në datën 15.05.2026 dhe kemi mbivendosje punimesh për zërat:

*“Shirit LED7 Ë/ml, IP 68”* në sasinë 580 ml x 250 lekë/ml= 145,000 lekë

*“Kanaline me difuzor per shirit LED 7 Ë/ml,IP 68”* në sasinë 580 ml x700 lekë/ml=406,000 lekë

*“Adaptor (spine) per shirit LED 7Ë/ml”* në sasinë 26 copë x 500 lekë/copë =13,000 lekë

Pra **564,000 lekë pa TVSh** janë shpenzuar në mënyrë jo efektive, pa efikasitet dhe pa ekonomikitet. Për sa më sipër, mbikqyrësi i punimeve OE “S” Shpk”, nuk ka zbatuar rigorozisht përcaktimet ligjore dhe kontraktuale të bëra në Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998, *“Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”* i ndryshuar, Kreu III, neni 7, dhe udhëzimin nr.2 datë 13.5.2005 *“Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”* dhe nr.3 datë 15.2.2001 *“Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”*

**2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për zbatimin e kontratës me objekt: *“Shpenzime për mirëmbajtjen e objekteve ndërtimore”* rezultoi se:**

- Objekti i kontratës është *“Shpenzime për mirëmbajtjen e objekteve ndërtimore”*, me nr.1840/16 prot., datë 09.08.2023, lidhur midis Universitetit Luigj Gurakuqi, Shkodër dhe Operatorit Ekonomik BOE “B” Shpk dhe “N” Shpk. Vlera e kontratës është 23,316,485 lekë me Tvsh. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 3 (tre) muaj nga data e të fillimit të punimeve.

-Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se dorëzimi i sheshit të ndërtimit dhe njoftimi i fillimit të punimeve është kryer më datë 30.08.2023. Procesverbali i fillimit të punimeve dhe akti i piketimit janë realizuar më datë 30.08.2023. Afati fillestar i parashikuar në kontratë ishte 3 muaj. Punimet në këtë objekt janë pezulluar për shkak të kushteve atmosferike; për këtë arsye është kryer zgjatje e afatit fillestar të punimeve me 26 ditë. Është mbajtur amendament kontrate me nr. 1840/38 datë 20.12.2023, po në këtë datë është kryer njoftimi i rifillimit të punimeve dhe procesverbali i rifillimit të punimeve. Janë kryer ndryshime në preventivin fillestar të punimeve si dhe kemi futjen e disa zërave të rinj. Këto ndryshime konsistojnë në volume punimesh që shtohen

dhe zbriten, por në total janë brenda vlerës së kontratës. Njoftimi i përfundimit të punimeve është kryer nga kontraktori më datë 26.12.2023. Në dosjen teknike administrohet librezat e masave përfundimtare, e cila korrespondon me situacionin përfundimtar.

-Nuk është kryer procedura e mbikëqyrjes së punimeve sipas procesit të tenderimit publik dhe nuk është caktuar një mbikëqyrës për mbikëqyrjen e punimeve. Me anë të një urdhëri nga titullari i Universitetit Luigj Gurakuqi është caktuar inxhinieri V. B si ndjekës i kësaj kontrate i cili nuk disponon licencën përkatëse për mbikëqyrje dhe kolaudim punimesh ndërtimore. Në këtë urdhër është caktuar dhe grupi i marrjes në dorëzim të punimeve, i përbërë nga inxhinier V. B, dhe M. P, V. B, G. T, A. N persona të cilët nuk janë inxhiniera në profesion. Ky grup ka firmosur situacionet pjesore dhe atë përfundimtar të punimeve, megjithatë, asnjëri nga personat e sipërcituar nuk disponon licencën përkatëse për mbikëqyrje dhe kolaudim punimesh ndërtimore. Ky veprim është në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998, "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit" nenet 7, 2, 5, 8 etj.

-Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, nuk është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi midis AK Universitetin Luigj Gurakuqi, Shkodër kjo në kundërshtim me:

*Udhëzim Nr.2, Datë 13.5.2005 Për Zbatimin E Punimeve Të Ndërtimit , Kreu II, - neni 8.2*

*Udhëzim Nr.3, Datë 15.2.2001 Për Mbikëqyrjen Dhe Kolaudimin E Punimeve Të Ndërtimit - neni22 dhe neni 25 Per Kolaudimin E Punimeve.*

-Për këtë objekt me anë të një shkrese me nr.1565 prot., më datë 09.05.2023 është lëshuar nga titullari i (AK) urdhri për të ngritjen e grupit për hartimin e specifikimeve teknike dhe përlllogaritjen e fondit limit. Sipas urdhërit Komisioni i specifikimeve teknike dhe përlllogaritjes të fondit limit përbëhej nga: S. M kryetare, X. Z anëtarë, I. K anëtar. Ky grup me anë të një relacioni me nr.1791 prot., më datë 29.05.2023 ka kryer përlllogaritjen e fondit limit; por nuk është shprehur nëse do të jenë punime mirëmbajtje apo rikonstruksioni. Me anë të një shkrese me nr.1840 prot., më datë 01.06.2023 është lëshuar nga titullari i (AK) urdhri për të ngritjen e grupit për prokurimin e fondit 19,717,234 lekë pa TVSh. Njësia e prokurimit përbëhet nga: S. B kryetare ekonomiste, M. K anëtare juriste, S. M anëtare ekonomiste. Njësia e prokurimit nuk ka kryer klasifikimin e duhur të punimeve të objektit si mirëmbajtje apo rikonstruksion. Por nëse shohim preventivin e punimeve vihet re se kemi të bëjmë me punime të mirëfillta rikonstruksioni dhe kemi të bëjmë me zëra pune si: *zëvendësim dyer/dritare te reja, lyerje fasade të jashtëme, punime hidrosanitare, mure të rinj ndarës, punime elektrike etj.* Gjithashtu afati për realizimin e kësaj kontrate shërbim mirëmbajtje është caktuar mjaft i shkurtër 3 muaj. Kjo në kundërshtim me Ligjin Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik" dhe akteve nënligjore të nxjerra nga Agjencia e Prokurimit Publik (APP); neni 19 dhe 20.Ky klasifikim i gabuar si kontratë shërbimi dhe jo kontratë rikonstruksioni ka sjellë si pasojë mosaktimin e një mbikëqyrësi për mbikëqyrjen e punimeve dhe një kolaudatori për kolaudimin e tyre.

Nga verifikimi i dokumentacionit tekniko-ligjor të vënë në dispozicion grupit të auditimit si dhe verifikimit të punimeve në terren për objektin "Shpenzime për mirëmbajtjen e objekteve ndërtimore" u konstatuan disa pasaktësi si më poshtë:

-Në dosjen e zbatimit, u vu re se mungojnë disa dokumente teknik, ndër më kryesorët mund të përmendim: certifikatat dhe skeda teknike për materialet e përdorura, miratimi i tyre, prova teknike me ujë për rrjedhje të taracës, skica dhe vizatime teknike për librezat e masave, si dhe mungon projekti faktik i zbatuar.

-Nga verifikimi në terren mund të themi se punimet përgjithësitë janë kryer me cilësi, sipas preventivit të rishikuar, dhe çmimeve të dakortësuara. Në dosjen teknike administrohet vetëm librezja e masave përfundimtare e cila korrespondon me situacionin përfundimtar.

-Aktualisht nga ana e Fondit Shqiptar të Zhvillimit si investitor dhe përftues Bashkia Shkodër, po kryhen disa punime paralele për termoizolimimin e fasadave të godinave të qytetit.

Këto punime kanë sjellë mbivendosje të punimeve të ndriçimit për objektin: “Shpenzime për mirëmbajtjen e objekteve ndërtimore” në Universitetin Luigj Gurakuqi konkretisht për Rektoratën. Punimet për këtë nënobjekt nuk janë marr ende në dorëzim të përhershëm punimet nga ana e AK dhe objekti është ende në periudhën e garancisë së punimeve e cila përfundon në datë 26.12.2025. Pra kemi mbivendosje punimesh për zërat:

Nr.2.404/1 “Lyerje fasada me boje plastike” -  $(1783.9 \text{ m}^2 \times 350 \text{ lekë/m}^2 = 624,365 \text{ lekë})$

Nr.2.431 “Skelë metalike me tubo fasade  $H > 12 \text{ m}$ ” -  $(1783.9 \text{ m}^2 \times 300 \text{ lekë/m}^2 = 535,170 \text{ lekë})$

Pra do kemi në total vlerën **1,159,535 lekë pa TVSh** (624,365 lekë + 535,170 lekë) të shpenzuara në mënyrë jo efektive, pa efikasitet dhe pa efektivitet.

Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: Administratori i Universitetit Luigj Gurakuqi z. A. U për ngritjen e një urdhëri ku në përbërje të grupit nuk ka persona me licensë përkatëse për mbikqyrje kolaudim punimesh.

**Observacion i subjektit mbi Projekt Raportin e Auditimit, vënë në dispozicion grupit të auditimit në datë 27.03.2025 me nr.1101/14 prot.**

**Pretendimi i subjektit:** Në lidhje me procedurën e "Shpenzimeve për mirëmbajtjen e objekteve ndërtimore", sqarohet si më poshtë:

Ne fillim të vitit ushtrimor hartohet dhe përcaktohet buxheti i Universitetit të Shkodrës, me ndarjet përkatëse të zërave sipas klasifikimeve: punë, shpenzime dhe mallra.

Buxheti kalon për miratim pranë organeve kolegjiale Bordi dhe Senati.

Gjatë vitit ushtrimor sipas nevojave fillon zbatimi i zërave të miratuar në buxhet dhe sipas klasifikimeve të tyre, pasi kanë kaluar fazën e miratimit në gjithë hallkat e Institucionit, Drejtorise Rajonale të Thesarit dhe APP.

Kështu për rrjedhojë:

- krijimet e komisioneve përkatëse për secilën fazë,
- zhvillimi i procedurës,
- lidhja e kontaktit,
- zbatimi/ndjekja dhe marrja në dorëzim e tyre

janë bërë duke respektuar ndarjet e miratuar të zërave të buxhetit të USH-së, sipas llogarive përkatëse për rrjedhojë edhe në regjistrin e parashikimeve ku është bërë përzgjedhja e llojit të procedurës në bazë të klasifikimit të llogarive kontabël të zërave të buxhetit, në këtë rast llogaria 6025 "Shërbime". Gjithashtu theksohet se kjo procedure "Shpenzimeve për mirëmbajtjen e objekteve ndërtimore", ka vijuar të trajtohet në përputhje me praktikën dhe procedurat e kaluara, duke pasur parasysh klasifikimin dhe natyrën e shpenzimeve. Gjatë gjithë viteve që kjo procedure është bërë në Institucion, është trajtuar gjithmonë si shërbim dhe është regjistruar në llogarinë 6025 të buxhetit, e cila është specifike për shërbimet që lidhen me mirëmbajtjen e objekteve

ndërtimore. Referuar viteve dhe praktikave të audituara më perpara nga auditues të jashtëm dhe të & brendshëm të USH-së, mirëmbajtja e objekteve ndërtimore nuk ka qenë e pëfshirë në karakterin e investimit kapital, siç janë projektet e rikonstruksioneve ose ndërtimit të ri, të cilat klasifikohen në llogarinë 212 "Ndërtesa dhe Konstruksione". Për më tepër, ndarja e llogarive buxhetore është një praktikë e njohur, ku shpenzimet për mirëmbajtje janë trajtuar gjithmonë si shërbime dhe jo si projekte investimi, duke i dhënë kështu një trajtim të drejtë dhe të përshtatshëm për natyrën e punimeve. Në këtë kontekst, llogaria 212, që lidhet me projekte të mëdha investimi (si rikonstruksioni i godinave), përfshin një gamë të gjerë fazash si projektimi, zbatimi, mbikeqyrja dhe kolaudimi. Ky proces kërkon kalimin në fazën të ndryshme dhe regjistrimit të ketyre punimeve si investim, që nis që nga hartimi i buxhetit e më tej duke konkluduar në procedurë prokurimi. Në përputhje me këtë logjikë, urdhri për hartimin e specifikimeve dhe fondit limit, i datës 09.05.2023 (prot. nr. 1565), ka përcaktuar gjithashtu që procedura të trajtohet si shërbim pasi ka kaluar fazën e miratimit në gjithë hallkat e Institucionit, Thesar dhe APP (zë i miratuar në regjistrin e parashikimeve ku është bërë perzgjedhja e llojit të procedurës në bazë të

klasifikimit të llogarive kontabël të zërave të buxhetit, në këtë rast llogaria 6025 "Shërbime"). Gjithashtu inxhinieri i fushës, bazuar në pervojën e tij, ka llogaritur se punimet e parashikuara do të realizohen brenda një periudhe 3-mujore, dhe kjo periudhe është marrë parasysh për përgatitjen e dokumenteve të nevojshme për procedurën e prokurimit. Ky informacion është përcjelle nga vetë Komisioni i Specifikimeve teknike si me afate kohore, kritere teknike inxhinierike dhe preventivin etj, tek Njësia e Prokurimit, e cila ka formuluar dokumentacionin përfundimtar dhe ka siguruar të gjithë informacionin e nevojshëm për zhvillimin e procedurës së prokurimit në përputhje me rregullat dhe praktikën e përcaktuara.

Për pasojë, edhe grupi i marrjes në dorëzim ka vazhduar të ndjekë këtë logjikë të konsoliduar për Institucionin, pa e trajtuar procedurën si një procedurë kolaudimi, duke e mbajtur atë në kuadër të shërbimeve dhe duke siguruar një klasifikim të sakte ekonomik. Ky trajtim ka vijuar pa ndonjë ndryshim, në përputhje me praktikën e miratuar nga vitet e kaluara, pa e parë të nevojshme kalimin e procedurës nga llogaria 6025 "Shërbime" në 212 "Ndërtesa dhe Rikonstruksione". Në përfundim, mund të theksoj se trajtimi i kësaj procedurë si shërbim është i plotë, ka qenë i justifikuar dhe i miratuar nga praktikën e mëparshme dhe klasifikimi buxhetor në rolin e Autoritetit Kontraktor sepse nuk ka patur asnjë rekomandim nga audituesit e brendshëm apo të jashtëm, për kalimin në llogarinë 212 për ndërtimin dhe rikonstruksionin e objekteve. Kjo ka mundur vazhdimin e procedurës në përputhje me rregullat e buxhetit dhe procedurave të prokurimit. Në vijim në vitin 2025 kjo procedurë do rregullohet sipas akt konstatimit tuaj.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Referuar argumentimeve dhe komenteve, sqarojmë se:

Nga ana e përfaqësuesve të Universitetit "Luigj Gurakuqi" Shkodër, konstatimet e lëna nga Grupi Auditimit, janë marrë në konsideratë dhe nuk kanë paraqitur kundërshtime në obsevacion.

**3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për zbatimin e kontratës me objekt: "Rikonstruksion çatia FSHE", rezultoi se:**

- Objekti i kontratës është "Rikonstruksion çatia FSHE", me nr.1030/2 prot., datë 25.03.2024, lidhur midis Universitetit Luigj Gurakuqi, Shkodër dhe Operatorit Ekonomik OE "L" Shpk. Vlera

e kontratës është 11,418,326 lekë me Tvsh. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 4 (katër) muaj nga data e të fillimit të punimeve. Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, është lidhur kontrata përkatëse me nr. 2345/7 prot., datë 26.08.2024, midis AK Universitetit Luigj Gurakuqi, Shkodër dhe mbikëqyrësit “M” Shpk dhe pf. B. Y, me licencë për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 3877. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezultoi se dorëzimi i sheshit të ndërtimit dhe njoftimi i fillimit të punimeve është kryer më datë 26.03.2024. Njoftimi i fillimit të punimeve nga mbikëqyrësi, procesverbali i fillimit të punimeve dhe akti i piketimit, janë realizuar më datë 26.03.2024. Afati i kontratës në muaj është parashikuar dhe punimet janë realizuar në 4 muaj. Njoftimi i përfundimit të punimeve është kryer nga kontraktori dhe mbikëqyrësi më datë 25.07.2024. Në dosjen teknike administrohej librezë e masave përfundimtare e cila përgjithësisht korrespondonte me situacionin përfundimtar.

-Nga verifikimet e dokumentacionit teknik në dosjen e zbatimit, rezultoi se mungojnë disa dokumente teknike, ndër më kryesorët mund të përmendim: certifikatat dhe skeda teknike për materialet e përdorura, miratimi i tyre, skica dhe vizatime teknike për çdo zë pune në librezat e masave etj. Nga verifikimi i pagesës në situacionin përfundimtar, librezës së masave dhe verifikimit në terren, u konstatuan disa parregullësi dhe mangësi si më poshtë vijon:

-Zëri punës me nr. analize 2.209/b “Ulluk vertikal me baker Ø120mm” është i raportuar në situacionin përfundimtar 80 ml ndërsa në terren u gjet se ky zë nuk ishte realizuar me bakër sipas preventivit por ulluqet ishin realizuar me llamarinë të lyer me ngjyrë të ngjashme me bakrin. Vendosija e ulluqeve prej llamarine do të ulte jetëgjatësinë e tyre për shkak të ndryshkjes së llamarinës nga faktorët e jashtëm atmosferik, rrjedhimisht mosvënia e ulluqeve të bakrit përbën shkelje kundrejt projektit të zbatimit dhe preventivit me efekt financiar **520,000 lekë pa TVSh.**

-Zëri punës me nr. analize 2.431 “Skela metalike me standarte sigurie ne pune, per punimet ne fasade, riparime suvatimi, bojatisje, ulluqe, etj per një periudhe 2 muaj” i raportuar në situacionin përfundimtar 1,292 m<sup>2</sup> ndërsa sipas projekt preventivit fillestar kjo sasi ishte e parashikuar nga ana e projektuesit në sasinë 640 m<sup>2</sup>. Rritja e kësaj sasive me dyfishin e sasisë fillestare është e pajustificuar, sepse projektuesi e ka parashikuar vendosjen e skelës në një faqe të objektit pastaj pasi të mbarohen punimet në një tërësi faqe do kalohej me instalimin e skelës në faqet e tjera të objektit, gjithashtu nuk ka fakte dhe prova shtesë për pretendimet e sjella në observacion. Diferenca prej 1,292 m<sup>2</sup> – 640 m<sup>2</sup>= 652 m<sup>2</sup> x 300 lekë/m<sup>2</sup>=195,600 lekë; përbën shkelje dhe ka efektin financiar **195,600 lekë pa TVSh.**

-Zëri punës me nr. analize 2.196-An “Heqje karton katrama tek ulluqet horizontale ne cati, pjesa qe riparohet dhe largim mbeturinash” është i raportuar në situacionin përfundimtar 454 m<sup>2</sup>, ndërsa nëse shohim llogaritjet e paraqitura në librezën e masave për këtë zë pune, vihet re se në këtë zë pune është përfshirë gabimisht edhe heqja e karton katramasë sipër shtresës së dërrasës në kundërshtim me përmbajtjen e zërit të mësipërm në sasinë 320 m<sup>2</sup>. Diferenca prej 320 m<sup>2</sup> x 100 lekë/m<sup>2</sup> = 32,000 lekë; përbën shkelje dhe ka efektin financiar **32,000 lekë pa TVSh.**

-Zëri punës me nr. analize 2.37/5b “Transport material ndërtimi deri 10 km” i raportuar në situacionin përfundimtar 85 m<sup>3</sup> ndërsa nëse shohim librezën e masave disa zëra e kanë të përfshirë transportin. Diferenca prej sasisë së raportuar në situacionin përfundimtar dhe sasisë së llogaritur në mënyrë korrekte: 85 m<sup>3</sup>-48.52 m<sup>3</sup> = 36.74 m<sup>3</sup> x 700 lekë/m<sup>3</sup> ka efektin **25,718 lekë pa TVSh.**

-Zëri punës me nr. analize 2.297/a “F.V. Tavan i sheshte me KNAUF-Gips me konstruksion metalik me pllaka te bardhe, përfshihen pllake gipsi tip A13-GKB 12.5mm dhe te gjithë aksesoret e tjerë, sipas detajit te fletës se projektit, ose detajit te miratuar gjate zbatimit. Referenca e produkteve sipas KNAUF, ose e ngjashme ne specifikime teknike me te” i raportuar në situacionin përfundimtar 293 m<sup>2</sup> ndërsa sipas librezave të masave kësaj sipërfaqe duhej ti ishin zbritur 36 copë ndriçues plafonier me përmasa 60x60cm, diferenca prej 12.96 m<sup>2</sup> x 1,800 lekë/m<sup>2</sup> dhe ka efektin financiar **23,328 lekë pa TVSh.**

-Zëri punës me nr. analize 2.490/h “F.V Kasetë plastike KE me 54 module (vende)” i raportuar në situacionin përfundimtar 1 copë ndërsa në terren u gjet kuti e cila ishte vendosur më e vogël 36 module (vende); kuti e cila nuk mund të mbaj sasinë e automateve të parashikuar në preventivit, diferenca prej 1 copë do të ketë efektin financiar **5,000 lekë pa TVSh.**

-Zëri punës me nr. analize 1. “Furnizim ndriçues plafonier/hermetik 60x60 led/40ë 4000K” i raportuar në situacionin përfundimtar 43 copë ndërsa në terren u gjetën në sasi më të vogël 36 copë, diferenca prej 7 copë x 2500 lekë/copë do të ketë efektin financiar **17,500 lekë pa TVSh.**

-Zëri punës me nr. analize 2.a-73 “F.V Elektroda tokezimi 5x5x0.5 L=150” i raportuar në situacionin përfundimtar 16 copë ndërsa në terren u gjetën në sasi më të vogël 4 copë, diferenca prej 12 copë x 1000 lekë/copë do të ketë efektin financiar **12,000 lekë pa TVSh.**

-Zëri punës me nr. analize An.60(P) “F.V Shtize e rrufepritësit ne cati L=100 D=160 mm i raportuar në situacionin përfundimtar 13 copë ndërsa në terren u gjetën me gjatësi më të vogël se 1 m; diferenca prej 13 copë x 700 lekë/copë do të ketë efektin financiar **9,100 lekë pa TVSh.**

-Zëri punës me nr. analize 2.a-73 “F.V. Automat 2P/2M-20A/6-C magnetik termik” i raportuar në situacionin përfundimtar 9 copë ndërsa në terren u gjetën në sasi më të vogël 4 copë, diferenca prej 5 copë x 2000 lekë/copë do të ketë efektin financiar **10,000 lekë pa TVSh.**

-Zëri punës me nr. analize 2.a-73 “F.V. Automat IP+N-10A/6-C magnetik termik” i raportuar në situacionin përfundimtar 9 copë ndërsa në terren u gjetën në sasi më të vogël 4 copë, diferenca prej 5 copë x 650 lekë/copë do të ketë efektin financiar **3,250 lekë pa TVSh.**

-Zëri punës me nr. analize An 53(p) “F.V Sensor tymi ZEOS-C-S + baze ZEOS-D/konvencional” i raportuar në situacionin përfundimtar 16 copë ndërsa në terren u gjetën në sasi më të vogël 15 copë, diferenca prej 1 copë x 3,060 lekë/copë do të ketë efektin financiar **3,060 lekë pa TVSh.**

-Zëri punës me nr. analize An 57 (P) “F.V Ndricues evakuim EXIT me llamp led 1x11ë IP40” i raportuar në situacionin përfundimtar 6 copë ndërsa në terren u gjetën në sasi më të vogël 5 copë, diferenca prej 1 copë x 2000 lekë/copë do të ketë efektin financiar **2,000 lekë pa TVSh.**

Vlera totale **866,056 lekë pa TVSh** do të konsiderohet si dëm ekonomik për shkak të llogaritjeve të gabuara, punimeve të pakryera dhe të pajustificuara teknikisht dhe jo sipas punimeve faktike.

Për sa më sipër, mbikqyrësi i punimeve OE “M” Shpk dhe p.f B. Y; me përfaqësues të palëve z. B. Y. në kundërshtim me kontratën e zbatimit të punimeve nuk ka zbatuar rigorozisht përcaktimet ligjore dhe kontraktuale të bëra në Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”.

## **2.6. Vlerësimi i funksionimit të sistemit të brëndshëm dhe menaxhimit financiar dhe vlerësimi i Auditimit të Brendshëm.**

Auditimit, u fokusua kryesisht në këto çështje:

- ☞ Vlerësimi i Mjedisit të Kontrollit
- ☞ Menaxhimi i riskut
- ☞ Veprimtaritë e kontrollit
- ☞ Informim komunikimi
- ☞ Monitorimi

Ky auditim u krye për të vlerësuar nëse sistemi i drejtimit, politikat, procedurat, veprimtaritë dhe kontrollet, kanë ndikuar që planifikimi dhe përdorimi i burimeve financiare, kanë bërë të mundur ofrimin me efikasitet dhe efektshmëri të shërbimeve publike, si dhe ka ndikuar në adresimin e risqeve, për të dhënë garanci të mjaftueshme se objektivat e njësisë publike do të arrihen nëpërmjet:

- pajtueshmërisë me legjislacionin dhe me aktet e brendshme e kontratat;
- informacioneve operative e financiare të besueshme e të plota;
- mbrojtjes së informacionit e të aktiveve.

### ***Mbi vlerësimin e funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit.***

Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në Universitetin e Shkodrës u realizua bazuar në ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Manualin për MFK-në, miratuar me Urdhrin e Ministrisë të Financave nr. 108, datë 17.11.2016, si dhe urdhrat dhe udhëzimet e dala në zbatim të tij. Në kuptimin e ligjit të lartpërmendur, menaxhimi financiar dhe kontrolli përcaktojnë përgjegjshmërinë menaxheriale për planifikimin, zbatimin dhe kontrollin e buxhetit, kontabilitetin dhe raportimin, duke respektuar parimet e transparencës dhe të ligjshmërisë për të arritur objektivat dhe për të shmangur shpërdorimin, keqpërdorimin dhe vjedhjen e pasurisë.

Caktimi i nëpunësit autorizues dhe zbatues është kryer sipas vendimmarrjeve të mëposhtme.

Universiteti i Shkodrës ka caktuar si Nëpunës Autorizues ka z. A. U i cili është emëruar administrator I Universitetit të Shkodrës me vendimin e Bordit të Administrimit nr 233 dt. 15.11.2022 “Për emerimin e Administratorit të USHLG” nr, 3548 Prot dt. 15.11.2022.

Si Nëpunës Zbatues është vendosur z. I. B me urdhrin e administratorit nr, 231 datë 13.08.2020.

Sa më sipër, në përmbushje të kërkesave të pikës të nenit 18/1, nenit 19, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, “Nëpunësi autorizues i çdo njësie të qeverisjes së përgjithshme, në bazë të vetëvlerësimit depoziton te titullari i njësisë publike dhe nëpunësi i parë autorizues deklaratën dhe raportin përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm të njësisë publike që mbulon, për vitin e mëparshëm, jo më vonë se fundi i muajit shkurt aktual”

Universiteti i Shkodrës, në bazë të nenit 19 të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar me ligjin nr.110/2015, ka hartuar dhe dërguar pyetësorin vjetor të vetëvlerësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm për vitin 2022 me shkresën nr, 123/1 prot. datë 30.01.2023 në Ministrinë e Arsimit.

Konstatohet se për vitin 2023 nuk është hartuar dhe dërguar pyetësori vjetor i vetëvlerësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm.

Me anë të shkresës së cituar Universiteti i Shkodrës ka dërguar deklaratën për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe raportet për funksionimin e kontrollit të brendshëm në Ministrinë e Arsimit. Struktura e raportimit respekton përcaktimet e Udhëzimit nr. 28, datë 15.12.2011 “Mbi paraqitjen e Deklaratës dhe Raportit Vjetor për cilësinë e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm në Njësitë Publike”

Mangësitë e konstatuara në plotësimin e kërkesave që kërkojnë komponentët e kontrollit të brendshëm në drejtim të funksionimit me përgjegjshmëri, realizimit të objektivave të institucionit

dhe përdorimit me efektivitet të fondeve të tij me qëllim zgjidhjen e mangësive të zbuluara gjatë përgatitjes së raporteve vjetore mbi funksionimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit janë si më poshtë:

Nga auditimi u konstatua se Universiteti i Shkodrës nuk ka ngritur Ekipin e Menaxhimit të Programit në zbatim të udhëzimit nr.7, datë 28.02.2018 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarde të përgatitjes së PBA-së” paragrafi 2.5 pika 1

Sipas Manualit të MFK, në kreun III, “Komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollit”, neni 19 citohet: *Titullarët e njësive të sektorit publik, zbatojnë menaxhimin financiar dhe kontrollin nëpërmjet komponentëve të ndërlidhur me njëri-tjetrin:*

1. *Mjedisi i kontrollit.*
2. *Menaxhimi i riskut.*
3. *Veprimtaritë e kontrollit.*
4. *Informacioni dhe komunikimi.*
5. *Monitorimi.*

## **1. Mjedisi i kontrollit**

Mjedisi i kontrollit është baza e menaxhimit të fondeve buxhetore dhe përbën themelin, ku ngrihen të gjithë komponentët e tjerë të kontrollit të brendshëm. Mjedisi i kontrollit përmban: Integritetin personal dhe etikën profesionale të nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të njësisë publike; politikat menaxheriale dhe stilin e punës; strukturën organizative, garantimin e ndarjes së detyrës, hierarkinë dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit; Politikat dhe praktikatat e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe aftësitë profesionale të punonjësve.

**a.** *Integriteti personal dhe etika profesionale e nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të kësaj njësie publike.*

Në referencë të ligjit nr. 9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”, si dhe ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, nevojitet që punonjësit të respektojnë normat etike dhe profesionale të bashkëpunimit e të ndihmës së ndërsjellë, mbështetur në krijimin e një Kodi të Brendshëm Etik. Nga auditimi u konstatua se, institucioni ka hartuar dhe zbaton një kod etike i cili është miratuar ne 11.1 2009. Konstatohet se ky kod nuk është ndryshuar dhe përshtatur.

**b.** *Struktura organizative, garantimi i ndarjes së detyrave, rregullat e qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit.*

Universiteti i Shkodrës funksionon në bazë të strukturës së miratuar me Vendimin nr 95 date 26.04.2022 te Bordit te Administrimit, “Për miratimin e strukturës organizative te USH-se per vitin 2022”.

Universiteti i Shkodrës ushtron veprimtarinë e vet mbi bazën e Rregullores, miratuar me Vendimin nr 132 date 27.04.2023 te Senatit te Universitetit “Për miratimin e rregullores së administratës te rektoratit te USH-se.”

Nga ana e Grupit të Auditimit konstatohet se në rregullore mungojnë përcaktimet e përgjegjësisë për kryerjen e raportimeve, për aksesimin dhe përdorimin e sistemeve dhe platformave qeveritare si “E-filing”, “Platforma qendrore e faturave e administratës tatimore”, “AFMIS”, “PITAGORA”.

**c.** *Stili i të vepruarit dhe filozofia e menaxhimit.*

Nga ana e Grupit të Auditimit është konstatuar se në Universiteti i Shkodrës nuk ka një rregullore të brendshme të përditësuar ku të jenë evidentuar delegimi i detyrave dhe mënyra e dokumentimit të tyre veprime këto në kundërshtim me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, neni 15 “Rregulla të përgjithshme për delegimin e detyrave”, si dhe Kapitulli III “Delegimi i detyrave”, të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin,

**d.** *Politikat dhe praktikatat e menaxhimit të burimeve njerëzore.*

Në Universitetin e Shkodrës, burimet njerëzore menaxhohen nga Drejtoria Juridike Burimeve Njerëzore dhe protokoll/Arkives, në varësi të së cilës është Sektori i Burimeve Njerëzore. Nga auditimi u konstatua se për periudhën objekt auditimi nuk janë kryer vlerësimet e punonjësve për vitet 2022-2023.

e. *Për ruajtjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale të punonjësve* gjatë viteve objekt auditimi, konstatohet se nga Sektori i Burimeve Njerëzore në Universitetin e Shkodrës nuk janë paraqitur programe specifike për trajnimin e punonjësve të administratës, veprime në kundërshtim me Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kap. III, pika 3.1 “Mjedisi i kontrollit të brendshëm”, paragrafët “Politikat dhe praktikat që lidhen me burimet njerëzore” dhe “Profesionalizmi i stafit”.

## **2. Menaxhimi i riskut**

Risku dhe menaxhimi i riskut përcaktohet në Nenin 21 të Ligjit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Risku zakonisht përcaktohet si pasiguria e rezultatit, qoftë kjo mundësi pozitive apo negative i veprimeve dhe ngjarjeve. Kjo është mundësia që një ngjarje e caktuar, e cila do të ketë ndikim në arritjen e objektivave të njësisë, mund të ndodhë. Risku matet me efektin e tij dhe shkallën e mundësisë së ndodhjes. Menaxhimi i riskut përfshin identifikimin, vlerësimin, kontrollin dhe monitorimin e këtyre ngjarjeve të mundshme apo situatave që mund të kenë një efekt negativ në arritjen e objektivave të njësisë dhe është projektuar për të dhënë siguri të arsyeshme se objektivat do të arrihen.

Nga auditimi u konstatua se nuk janë kryer takime me stafin menaxherial mbi çështjet e menaxhimit të riskut, diskutimin e problematikave dhe dokumentimin e veprimtarisë së përditshme të menaxhimit të riskut. Universiteti i Shkodrës nuk ka hartuar strategjinë për menaxhimin e riskut, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, pika 2, neni 21 “Menaxhimi i Riskut”, ku citohet:...*“Titullari i njësisë publike miraton një strategji, e cila përditësohet çdo tre vjet ose sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të risku. Nëpunësi autorizues analizon dhe përditëson kontrollat që synojnë minimizimin e riskut, të paktën një herë në vit.”*, si dhe me udhëzimin e MFE nr. 16, datë 20.07.2016, “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”, pika 3.2.1 ku citohet:... *“Titullari i njësisë publike është përgjegjës për përcaktimin e objektivave dhe strategjisë. Kjo përfshin: Menaxhimin efektiv të riskut”*.3.2.2 *“Nëpunësi autorizues/koordinatori i riskut ka përgjegjësi për: Ngritjen dhe funksionimin e sistemit të MR, përcaktimin e nivelit të oreksit të riskut; Vlerësimin e sistemit të MR (...).”*

Mbështetur në nenin 18, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, me shkresën nr. 123/1 prot., datë 30.01.2023, Nëpunësi Autorizues ka hartuar, Deklaratën për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm, Raportin për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm të Universitetit të Shkodrës, i cili është përmbledhje e raportit vjetor për menaxhimin financiar dhe kontrollin, Pyetësorin e vetëvlerësimit për komponentët e MFK-së nëpërmjet të cilit synohet ndërgjegjësim i mëtejshëm mbi rëndësinë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm për vitin 2022. Per Vitin 2023

**Nga auditimi** u konstatua se për vitin 2022 dhe 2023 nuk janë përgatitur dhe dërguar te NA, regjistri i riskut nga secila drejtori përkatëse, veprim ky në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar pika neni 11, ku citohet:...*“Menaxherët e tjerë të strukturave të të gjitha niveleve të njësisë publike janë përgjegjës dhe raportojnë dhe i japin llogari eprorit, sipas shkallës hierarkike, për:*

*2. Identifikimin dhe krijimin e regjistrit të riskut, vlerësimin, kontrollin e risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive të strukturave që ata drejtojnë”*.

Nga ana e Grupit të Auditimit konstatohet se për vitin 2022 dhe 2023, Universiteti nuk ka ngritur Grupin e Menaxhimit Strategjik.

Nga auditimi i funksionimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm për vitin 2022 dhe 2023 **konstatohet** se Universiteti i Shkodrës nuk ka takime të dokumentuara të veprimtarisë së GMS-së, i cili duhet të mbledhet të paktën 4 herë në vit, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, pika nr. 1, e nenit 27 “Takimet periodike ndërmjet menaxherëve të njësisë publike”, si dhe me Udhëzimin nr. 16 të MFE, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike” pika nr. 3, paragrafi 2.2.4 “Roli i GMS në sistemin e MFK”, së, e cila përcakton se: “GMS duhet të mbledhet të paktën katër herë në vit. Vendimet duhet të jenë objektive dhe të merren si grup, (...). Vendimet e GMS duhet të regjistrohen nga sekretari dhe vihen në dispozicion të drejtimit të njësisë publike.”

Gjithashtu, **konstatohet** se GMS nuk ka realizuar përgjegjësinë e rishikimit jo më pak se dy herë në vit të regjistrit të riskut, veprim ky në kundërshtim me Udhëzimin nr. 16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”, ku përcakton se “GMS është përgjegjës të sigurojë se regjistri i riskut për programe/objektiva specifik rishikohet jo më pak se dy herë në vit”.

### 3. Aktivitetet e kontrollit

Nga auditimi u konstatua se Universiteti i Shkodrës ka të miratuar një rregullore të përditësuar me ndryshimet ligjore në fuqi, duke përfshirë dhe ndryshimet në organikën e institucionit, duke përcaktuar detyrat.

**Konstatohet** se nuk ka miratuar Gjurmën e Auditimit, si një dokument të unifikuar për të gjitha proceset, në kundërshtim me përcaktimet e pikave nr. 2 dhe 3, të nenit 16, “Detyrimi për përgatitjen dhe dokumentimin e gjurmës së auditimit”, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, ku citohet... “2. Titullarët e njësive publike miratojnë gjurmët e auditimit për procedura që lidhen me veprimtari kryesore të njësisë dhe sigurojnë që të gjitha operacionet e njësive publike dokumentohen në atë formë, që u mundëson audituesve të brendshëm, të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit. 3. Gjurma e auditimit arkivohet sipas dispozitave ligjore në fuqi”

**Konstatohet** se Universiteti i Shkodrës nuk disponon një regjistër kontabël të plotë aktiveve, veprim ky në kundërshtim me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, Kreu III “Regjistri i aktiveve të njësive të sektorit publik”, paragrafi 26, përcakton se: “Çdo njësi publike duhet të krijojë dhe të përditësojë një regjistër kontabël të të gjitha aktiveve që zotëron apo ka në administrim, përfshi dhe pronat publike nga të cilat siguron të ardhura. Regjistri mbahet në formën e kartelave ose në formë të sintetizuar”.

### 4. Informimi dhe komunikimi

Nga auditimi u konstatua se, përgjithësisht komunikimi me titullarin dhe nëpunësit e tjerë është bërë në formën dhe kohën e duhur, për ti ndihmuar ata në përmbushjen e detyrave dhe të përgjegjësiave. Punonjësit brenda institucionit komunikojnë me postë elektronike dhe në mënyrë verbale, ndërsa jashtë institucionit komunikohet kryesisht në formë shkresore zyrtare dhe ka korrespondencë të rregullt me subjektet e tjera, pa përjashtuar komunikimin elektronik dhe atë telefonik. Universiteti i Shkodrës ka faqen e tij zyrtare në internet dhe nëpërmjet kësaj të fundit të gjithë të interesuarit mund të informohen rreth veprimtarisë së institucionit.

### 5. Monitorimi

Nga auditimi **konstatohet** se në vijim të përcaktimit në pikën 23/1 të nenit 4 të ligjit nr. 10 296, datë 08.07.2010 i ndryshuar me Ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015 “Për menaxhimin financiar

*dhe kontrollin:* “Nëpunës autorizues i nivelit të dytë”, dhe /ose të niveleve të tjera, janë nëpunës të administratës publike në secilën nga njësitë e vartëse, me buxhet më vete të njësisë së qeverisjes së përgjithshme, përgjegjës për përgatitjen, zbatimin, kontrollin e brendshëm financiar, monitorimin, raportimin, kontabilitetin dhe auditimin e brendshëm të buxhetit të tyre, që përgjigjet përpara nëpunësit autorizues...”, për periudhën objekt auditimi nuk janë hartuar raportet e monitorimit 4-8 mujore të buxhetit për vitin 2022 dhe 2023. Është hartuar vetëm raporti 12 mujor në formë tabelare për të dyja vitet dërguar Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, veprime në kundërshtim me pikën 42 kapitulli III të 41.2 kapitulli III, të Udhëzimit nr. 22, datë 17.11.2016, “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e Qeverisjes Qendrore”.

## **6.2 Mbi vlerësimin e Auditimit të Brendshëm.**

Për këtë u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- ✓ Plani Auditimit dhe realizimit për vitin 2022-2023-2024.
- ✓ Plani strategjik i auditimit dhe ai vjetor 2022-2023-2024.
- ✓ Raportimi vjetor në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditit të Brendshëm për vitet 2022-2023 së bashku me pasqyrat shoqëruese;
- ✓ Dosjet e auditimit të njësive publike, (koherente);
- ✓ Dosjet e përhershme të subjekteve të audituar;
- ✓ Raport mbi zbatimin e masave të rekomanduara nga Njësia e Auditit të Brendshëm;

### **1. Organizimi i Njesisë së Auditimit të Brendshëm**

Spektori i Auditimit të Brendshëm është pjesë e strukturës administrative të Rektoratit të në USHLG por është funksionalisht i pavarur dhe raporton në mënyrë të drejtpërdrejtë tek Bordi i Administrimit të Universitetit. Në USHLG ka qenë në fuqi struktura organizative e Njesisë së Auditimit të Brendshëm në Rektoratin e USHLG sipas vendimit të Bordit të Administrimit të USH dhe është i pandryshuar deri në vitin raportues.

- **Organizimi i Njesisë së Auditimit të Brendshëm, niveli i kualifikimit.**

Auditimi i brendshëm në USHLG ka funksionuar në përputhje me Ligjin nr. 114/2015, datë 22.10.2015 "Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik", VKM nr.83 datë 03.02.2016 "Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësisë së Auditimit të Brendshëm në sektorin Publik, si dhe manualit të auditimit i miratuar me urdhër të MF- nr.100, datë 25.10.2016 "Për miratimin e manualit të auditimit të brendshëm në sektorin publik" ndryshime. Përveç këtyre akteve, në punën audituese, kanë shërbyer edhe ligje, udhëzime e manuale e metodika të tjera specifike për arsimin e lartë.

**Gjatë viteve objekt auditimi**, i gjithë stafi i NJAB ka ndjekur trajnimin e detyrueshëm të vijueshëm të edukimit të përditësuar të organizuar dhe zhvilluar nga NJQH/AB. Nga ana e stafit të cilët kanë qenë të certifikuar janë ndjekur trajnimet e detyrueshme 40 orë në vit të organizuara nga ana e Drejtorisë së Harmonizimit, këto trajnime janë ndjekur me interes nga audituesit e drejtorisë.

Struktura e miratuar është si vijon: Spektori i Auditimit të Brendshëm, 3 punonjës, nga ku: - Përgjegjës sektori, 1 (një); -Specialist audit i brendshëm, 2 (dy).

Nr.	Nga 01.01.2022 deri më 01.06.2024	Funksioni	Arsimimi	Vjetërsia në punë	Vjetërsia në auditim	Certifikimi	Trajnime të vijueshme	Datë fillimi dhe mbarimi
1	R. B	Përgjegjës Sektori	Financë-Kontabilitet-Drejtësi	15	6	2018	40	2018-
2	R. D	Specialist	Financë-Kontabilitet	13	4	2013	40	Larguar 01.06.2022
3	E. V	Specialist	Financë-Kontabilitet	17	1	E pacertifikuar	40	2023-
4	A. M	Specialist	Juriste	6	1	E pacertifikuar	40	2023-

### **-Analiza e Kapaciteteve të Audituesve.**

Në realizimin e misioneve të parashikuara, Njësia e Auditimit të Brendshëm është mbështetur në organizimin aktual të strukturës së njësisë së auditimit në nivel sektori në USH, i përbërë nga 2 (dy) auditues dhe 1 (një) përgjegjës sektori i kësaj njësie.

Në bazë të strukturës dhe numrit të punonjësve, nivelit të riskut për çdo sistem, është bërë edhe përcaktimi numrin të ditëve të punës të nevojshme për auditimin e sistemeve të identifikuar për këtë periudhë.

Për vitin 2022 objekt auditimi, konstatohet se Sektori i Auditimit të Brendshëm, nuk ka funksionuar me numër të plotë sipas organikes, pasi nuk është bërë plotësimi i vendeve vakante, përkatësisht me një auditues.

Nga ana tjetër, 2 specialistet e Auditimit të Brendshëm, nuk disponojnë certifikimin si auditues.

### **1. Vlerësim mbi veprimtarinë e njësisë së auditimit të brendshëm**

**Karta e Auditimit** është përgatitur nga Njësia e Auditimit të Brendshëm dhe miratuar nga Bordi i Administrimit, me vendimin nr. 138 datë 13.07.2022 dhe nr. 2292 Prot., datë 13.07.2022 dhe nuk ka pasur ndryshime për sa i përket viteve të objekt auditimit.

Ky veprim është në përputhje me kërkesat e nenit 4, pika 12, të Ligjit nr. 114/2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik” dhe në përputhje me kërkesat e pikës 2.6.1, Kapitulli II të Manualit të Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhrin nr.100 datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave.

**Programi i Sigurimit të Cilësisë të NJ.A.B në USH për vitet e program auditimit**, është hartuar nga NJAB dhe miratuar nga Bordi i Administrimit të USH me Vendim Nr. 23, nr. 337 prot., datë 28.01.2022 dhe i është dërguar Ministrisë së Financave nr. 337/1 Prot., datë 01.02.2022.

Njësia e auditimit mbikëqyr veprimtarinë e Universitet të Shkodrës dhe organeve të varësisë, duke hartuar plane strategjike dhe raporte vjetore të veprimtarisë së tyre.

Mbi veprimtarinë e Njësisë së Auditimit të Brendshëm, në USH, për periudhën nga data 01.01.2022 deri në 01.06.2024 është raportuar në mënyrë sistematike, referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti, si më poshtë:

- 1) **Plani strategjik dhe vjetor i veprimtarisë së Auditimit të brendshëm për periudhën 2022-2024**, është miratuar nga Bordi i Administrimit dhe me shkresën nr. 3254 prot., datë 13.10.2021 ka dërguar MFE planin strategjik për vitin 2022-2024 dhe vjetor 2022 të veprimtarisë së Njësisë së Auditimit të Brendshëm. Plani strategjik përgjithësisht është hartuar në përputhje me standardin e përcaktuar në Manualin e Auditimit të Brendshëm, Kapitulli III, pika 3.1.6 dhe pika 3.3. Plani vjetor për vitin 2022 i bashkangjitur me planin strategjik, është hartuar bazuar në Manualin e Auditimit të Brendshëm, Kapitulli III, pika

3.2 dhe 3.3., ku në përmbajtje të tij janë të përshkruara të gjitha pikat e strukturës së këtij plani.; Plani strategjik i veprimtarisë është bazuar në identifikimin dhe vlerësimin e risqeve për secilin subjekt.

- 2) **Plani strategjik dhe vjetor i veprimtarisë së Auditimit të brendshëm për periudhën 2023-2025**, është miratuar plani strategjik dhe ai vjetor në përputhje me afatet ligjore të përcaktuara në “Manualin e Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”. Me shkresën nr. 3026/1 prot., datë 17.10.2022 ka dërguar MFE planin strategjik për vitin 2023-2025 dhe vjetor 2023 të veprimtarisë së Njesisë së Auditimit të Brendshëm. Plani strategjik përgjithësisht është hartuar në përputhje me standardin e përcaktuar në Manualin e Auditimit të Brendshëm, Kapitulli III, pika 3.1.6 dhe pika 3.3. Plani vjetor për vitin 2023 i bashkëngjitur me planin strategjik, është hartuar bazuar në Manualin e Auditimit të Brendshëm, Kapitulli III, pika 3.2 dhe 3.3., ku në përmbajtje të tij janë të përshkruara të gjitha pikat e strukturës së këtij plani.; Plani strategjik i veprimtarisë është bazuar në identifikimin dhe vlerësimin e risqeve për secilin subjekt.
- 3) **Plani strategjik dhe vjetor i veprimtarisë së Auditimit të brendshëm për periudhën 2024-2026**, është miratuar plani strategjik dhe ai vjetor në përputhje me afatet ligjore të përcaktuara në “Manualin e Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”. Me shkresën nr. 2934/1 prot., datë 12.10.2023 ka dërguar MFE planin strategjik për vitin 2024-2026 dhe vjetor 2023 të veprimtarisë së Njesisë së Auditimit të Brendshëm. Plani strategjik përgjithësisht është hartuar në përputhje me standardin e përcaktuar në Manualin e Auditimit të Brendshëm, Kapitulli III, pika 3.1.6 dhe pika 3.3. Plani vjetor për vitin 2024 i bashkëngjitur me planin strategjik, është hartuar bazuar në Manualin e Auditimit të Brendshëm, Kapitulli III, pika 3.2 dhe 3.3., ku në përmbajtje të tij janë të përshkruara të gjitha pikat e strukturës së këtij plani.; Plani strategjik i veprimtarisë është bazuar në identifikimin dhe vlerësimin e risqeve për secilin subjekt.
- 4) **Raportimi vjetor i veprimtarisë së AB për vitin 2022**, është kryer me shkresën nr. 453/1 prot, datë 15.02.2023, bashkëngjitur dhe pasqyrat shoqëruese. Dokumentacioni është dërguar në afat, shoqëruar edhe me pjesën përshkruese të raportit, i përgatitur në përgjithësi sipas standardeve që përcakton Manuali i Auditimit të Brendshëm, Kapitulli IV, pika 4.3.
- 5) **Raportimi vjetor i veprimtarisë së AB për vitin 2023** është kryer me shkresën nr. 444/1 prot, datë 13.02.2024, bashkëngjitur dhe pasqyrat shoqëruese. Dokumentacioni është dërguar në afat, shoqëruar edhe me pjesën përshkruese të raportit, i përgatitur në përgjithësi sipas standardeve që përcakton Manuali i Auditimit të Brendshëm, Kapitulli IV, pika 4.3.

#### **- Përshkrimi i situatës mbi aktivitetin e NJAB.**

Bazuar në strukturën e USH, të gjitha subjektet që auditon NJAB janë të gjitha institucione arsimore dhe drejtori në varësi të USH, të cilat nuk kanë në përbërje të strukturës dhe organikës së tyre një njësi të auditimit të brendshëm dhe për këtë arsye janë identifikuar të gjitha institucionet e varësisë si subjekte auditimi, sepse shërbimi i auditimit të brendshëm kryhet nga struktura e NJAB në USH. Shpërndarja e subjekteve të identifikuara për auditim gjatë viteve objekt auditimi është bërë duke marrë në konsideratë nivelin e vlerësimit të riksut, përlllogaritjen e burimeve të auditimit si dhe frekuencën e auditimit.

Pasqyra e planifikimit dhe realizimit të auditimeve të brendshme sipas viteve objekt auditimi si dhe rekomandimet e dhëna.

Nr	PERIUDHA	TË DHËNA SIPAS RAPORTIMIT						
		Auditime të planifikuara	Auditime të realizuara	Nga të realizuarat, sipas llojit				
				Përputh	Financiar	Kombinuar	Performa	Tjera
1	Viti 2022	9	7	3	1	2	-	3
2	Viti 2023	8	7	3	-	5	-	-
3	Viti 2024	8	4	2	2	4	-	-

Nga auditimi i raportimeve vjetore hartuar nga NJAB mbi aktivitetin e saj për vitin objekt auditimi, të dhënat mbi gjetjet/rekomandimet dhe statusin e zbatimit të tyre, paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Nr	PERIUDHA	TË DHËNA SIPAS RAPORTIMIT							
		Rekomandime të shprehura në numër				Rekomandime të shprehura në vlerë (shpërblim dëmi)			
		Gjithsej në numër	Zbatuar	Në proces	Pazbatuar	Gjithsej në vlerë	Zbatuar	Në proces	Pazbatuar
1	Viti 2022	7	3	4	-	-	-	-	
2	Viti 2023	13	2	7	4	-	-	-	

### Vlerësimi i procedurave dhe standarteve të kryerjes së auditimit të brendshëm

Planifikimi i një angazhimi auditimi nga njësia e auditit të brendshëm në USH është realizuar duke respektuar kërkesat e Manualit të Auditimit të Brendshëm kapitulli IV, pika 4.1.1 “Planifikimi i një angazhimi”, duke ndërmarrë të gjitha hapat për fillimin e punës nga ana e grupit të auditimit, si : Autorizimi për fillimin e auditimit, njoftim paraprak për fillimin e angazhimit, takimi fillestar, deklarata e pavarësisë, ndarja e detyrave, vlerësimi i riskut për mjedisin e përgjithshëm të kontrollit dhe për sistemet/fushat e veçanta të llogarisë, përcaktimin e drejtimeve të auditimit, duke e shoqëruar me testet përkatëse, përcaktimi i kostos së veprimit, masat për sigurimin e cilësisë, etj.

Vlerësojmë se në mbështetje të Manualit të AB, miratuar me Urdhrin e MF nr.100, datë 25.10.2016 (i ndryshuar), programet e auditimit kanë përmbledhur orientimet kryesore të veprimit, në përputhje me risqet dhe problematikat e subjekteve dhe përmbajnë në mënyrë të qartë emërtimin e subjektit, llojin e auditimit, periudhën dhe afatin e misionit, drejtimet dhe grupin e punës.

### - Vlerësimi i procedurave të parashikuara për raportimin dhe komunikimin e auditimit si: hartimi i projekt-raportit të angazhimit, takimet me palën e audituar, hartimi i raportit final, trajtimi i observacioneve, përgatitja e memorandumit

Nga NJAB, në USH janë respektuar kërkesat e manualit të AB, lidhur me procedurat e hartimit të dokumenteve të auditimit, siç përcakton manuali i auditimit, pra janë respektuar hapat e një misioni angazhimi që nga procesi i planifikimit (përgatitja) e misionit të angazhimit, puna në terren, pasqyrimi i punës audituese, (dokumentimi) i saj. Kjo strukturë ka plotësuar pyetësorin mbi veprimtarinë e saj, duke dhënë opinionin mbi vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në subjektet që auditon, kjo sipas nivelit të riskut, veprim i reflektuar tek formati 7 kap. II të MAB. Në dosjet e auditimit ndodhen konfirmimet e raporteve të bëra nga subjektet e audituara, veprime të cilat përputhen me kërkesat e ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” dhe të kapitullit VI “Evidentimi dhe dokumentimi i punës audituese” të Manualit të Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhër të Ministrisë të Financave me nr. 100, datë 25.10.2016, (i ndryshuar). Nga auditimi i projekt - raporteve dhe raporteve përfundimtare, rezulton se nga audituesit e brendshëm në procesin e auditimit, janë zbatuar standardet e përcaktuara në MAB, në përmbajtje dhe formë. Gjithashtu referencat ligjore të vëna në programet e auditimit reflektojnë kuadrin ligjor në fuqi.

Praktikat e përzgjedhura për shqyrtim dhe vlerësim janë të plota në dokumentacion dhe përmbajnë auditime të kryera gjatë periudhës 2022-2023-30.06.2024, në subjektet, si më poshtë:

- Mbi auditimin e detyrimeve financiare të prapambetura të krijuara për vitin 2021 në USH (viti 2022, auditim për periudhën 01.01.2021-31.12.2021)
- Auditimi i të ardhurave nga tarifa e shkollimit dhe përjashtimit nga tarifa e shkollimit për vitin akademik 2020/2021 dhe 2021-2022 (viti 2023, auditim për periudhën viti akademik 2020-2021 dhe viti akademik 2021-2022)
- Mbi auditimin e detyrimeve financiare të prapambetura të krijuara për vitin 2022 në USH (viti 2023, auditim për periudhën 01.01.2022-31.12.2022)
- Mbi menaxhimin e fondeve të akorduara nga Bashkimi Europian apo donatorë të tjerë në USH (viti 2023, auditim për periudhën 01.06.2021-31.12.2022)
- Mbi auditimin e detyrimeve financiare të prapambetura të krijuara për vitin 2023 në USH (viti 2024, auditim për periudhën 01.01.2023-31.12.2023)
- Sistemin e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (viti 2024, auditim i periudhës 01.01.2020-31.12.2023)

**Raporti Vjetor i ndjekjes dhe zbatimit të rekomandimeve për vitin 2022**, është hartuar dhe është dërguar në MFE me shkresën nr. 636/2 Prot., datë 20.03.2023. Bashkëngjitur tij dhe raporti përfundimtar mbi zbatimin e rekomandimeve për secilin subjekt i auditimit si dhe ju është përcjellë dhe subjekteve përkatëse. Dosja është e plotë dhe përmban të gjithë dokumentet përkatëse në përputhje me Ligjin nr. 114/2015, për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik dhe Manualin e Auditimit të Brendshëm.

**Raporti Vjetor i ndjekjes dhe zbatimit të rekomandimeve për vitin 2023**, është hartuar dhe është dërguar në MFE me shkresën nr. 367/3 Prot., datë 08.03.2024. Bashkëngjitur tij dhe raporti përfundimtar mbi zbatimin e rekomandimeve për secilin subjekt i auditimit si dhe ju është përcjellë dhe subjekteve përkatëse. Dosja është e plotë dhe përmban të gjithë dokumentet përkatëse në përputhje me Ligjin nr. 114/2015, për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik dhe Manualin e Auditimit të Brendshëm.

**Dosja e përhershme** shërben që audituesit e brendshëm të njohin mirë njësinë publike, veprimtaritë operacionale dhe sistemin financiar me qëllim që të sigurojnë se puna e tyre do të jetë e përshtatshme për organizatën vlerësimin e sistemeve, proceseve të cilat janë pjesë e aktiviteteve të përditshme të njësisë që auditohet.

Njësia e Auditimit të Brendshëm në USHLLG mban një dosje të përhershme për çdo njësi publike ku kryen angazhim auditimi, dosje të cilës i referohet për auditimin pasardhës që do të kryhet, veprim ky në përputhje me kërkesat e Manualit të Auditimit të Brendshëm, Kapitulli nr. VI, pika 6.3.

#### **Baza Ligjore:**

- Ligji nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”;
- Urdhri nr.4, datë 10.01.2020 të Ministrit të Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë “Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në manualin e auditimit të brendshëm, miratuar me urdhrin nr.100, datë 25.10.2016”;
- Manuali i Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr.100, datë 25.10.2016, i ndryshuar.

#### **2.7 Probleme të ndryshme që mund të dalin gjatë auditimit.**

Në zbatim të pikës 7 të programit të auditimit Nr. 1101/1, datë 19.09.2024 (I ndryshuar) “*Probleme të ndryshme që mund të dalin gjatë auditimit*”, si dhe ankesës së ardhur në KLSH protokolluar me

*Nr.1494, datë 13.12.2024 për mos nënshkrimin e kontratave për pedagogët e jashtëm në FE për vitin akademik 2022-2023.*

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të kërkuar dhe vënë në dispozicion të grupit të auditimit rezultoi:

Referuar Vendimit të Ministrit të MAS nr. 377, datë 07.07.2022, viti akademik 2022-2023 në Institucionet e Arsimit të Lartë fillon me datë 17 Tetor të vitit 2022.

Me datë 06.10.2022, përmes e-mailit dërguar dekanëve të fakulteteve të USHLG, Rektori sjell në vëmendje të tyre se:

*“Në prag të fillimit të vitit akademik dhe pasi keni bërë nëpër departamente shpërndarjen e ngarkesës mësimore, sjell ne vëmendjen tuaj se për aplikimet e pedagogeve të jashtëm duhet të ndiqet neni 17 i Rregullores së punësimit.*

*Përjashtohet nga aplikimi online personeli akademik me kohe të pjesshme i angazhuar vitet e mëparshme dhe që kërkon me shkrim vazhdimin angazhimit në mësimdhënie pasi departamenti ka bere vlerësimin pozitiv të performaces.*

*1. Aplikimi duhet bere brenda afateve të përcaktuara ne shpalljen e vendosur ne faqen zyrtare të USH-së për njoftimin e vendit të lire të punës.*

*2. Aplikantët duhet të dorëzojnë dokumentacionin e kërkuar pranë Sektorit të Burimeve njerëzore të USH-se ose me Poste, brenda afateve të caktuara ne njoftimin e publikuar.*

*3. Aplikanti i cili nuk ka aplikuar on-line dhe nuk ka dorëzuar dosjen me dokumentacionin e kërkuar brenda afateve të përcaktuara ne njoftimin zyrtar nuk mund të konkurojë për vendin e shpallur të punës.*

*Do t'ju lutesha, ne rast nevojë të paraqisni menjëherë kërkesat”.*

Me shkresë nr. 1432 prot, datë 20.10.2022 pranë Fakultetit Ekonomik (FE, Departamenti Administrim Biznesit (DAB) është ngritur komisioni adhoc për vlerësimin e angazhimit e aplikantëve për asistent pedagogë të jashtëm të DPA i përberë nga:

Znj. Y. K

Znj. A. B

Znj. E. B

Me shkresë nr. 1434 prot, datë 20.10.2022 pranë FE, Departamenti Turizmit (DT) është ngritur komisioni adhoc për vlerësimin e kandidatëve aplikues për personel akademik me kontrate për vitin akademik 2022-2023 i përberë nga:

Znj. M. D

Znj. A. T

Znj. B. B

Me shkresë nr. 1412 prot, datë 20.10.2022 pranë FE, Departamenti Financë Kontabilitet (DFK) është ngritur komisioni adhoc për vlerësimin e asistent pedagogëve të jashtëm të DFK i përberë nga:

Znj. E. B

Znj. A. K

Znj. K. H

Me shkresë (vendim) nr. 1584 prot, datë 10.11.2022 komisioni adhoc i DT ka bërë vlerësimin e kandidatëve me sistem pikësh ku ka propozuar 10 kandidatë të riangazhohen në mësimdhënie.

Me shkresë nr, 1590 prot, datë 10.11.2022, përgjegjësja e DT i ka dërguar dekanit të FE vendimin e komisionit adhoc i cili me shkresë (nr, 3477 prot, datë 10.11.2022 pranë USH) nr, 1591 prot, datë 10.11.2022 i ka dërguar rektorit të USH kërkesën për angazhim të pedagogëve të jashtëm për vitin akademik 2022-2023.

Me shkresë nr, 3477/1 prot, datë 25.11.2022 Rektori i ka kthyer përgjigje FE ku shprehët se kërkesa e znj, A. Z nuk miratohet. (pa dhënë arsyet e mos miratimit)

Me shkresë (vendim) nr, 1502 prot, datë 31.10.2022 komisioni adhoc i DAB ka bërë vlerësimin e kandidatëve ku ka propozuar 15 kandidatë të riangazhohen ne mësimdhënie.

Me shkresë (vendim) nr, 1461 prot, datë 26.10.2022 komisioni adhoc i DAB ka bërë vlerësimin e kandidatëve ku ka propozuar 2 kandidatë të riangazhohen në mësimdhënie të cilët janë të angazhuar në administratën e USHLG dhe me shkresë nr, 1462 prot, datë 26.10.2022 ka kryer vlerësimin si dhe ka propozuar 13 kandidatë të riangazhohen ne mësimdhënie.

Me shkresë (nr, 3369 prot, datë 01.11.2022 pranë USHLG) nr, 1515 prot, datë 01.11.2022 Dekani i FE i ka dërguar vendimet e komisionit adhoc Rektorit të USHLG.

Me shkresë nr, 3369/1 prot, datë 04.11.2022 Rektori i ka kthyer përgjigje FE ku shprehët se 2 pedagoget e jashtëm të cilët angazhon dhe ne administratë nuk miratohet.(pa dhënë arsyet e mos miratimit)

Me shkresë (vendim) nr, 118 prot, datë 12.01.2023 Rektori i USHLG ka aktivizuar 23 pedagoge e jashtëm si staf akademik me kohë të pjesshme për vitin akademik 2022-2023.

Me shkresë (vendim) nr, 680 prot, datë 27.02.2023 Rektori i USHLG ka aktivizuar 2 pedagoget e jashtëm si staf akademik me kohë të pjesshme për semestrin e dytë të vitin akademik 2022-2023.

Me shkresë (vendim) nr, 1402 prot, datë 25.04.2023 Rektori i USHLG ka aktivizuar 2 pedagoget e jashtëm si staf akademik (A. Z, S. H) me kohë të pjesshme për semestrin e dytë të vitin akademik 2022-2023.

Kontratat me pedagoget e jashtëm janë firmos duke filluar nga muajin dhjetor 2022 deri në prill të vitit 2023.

Komisioneri për mbrojtjen nga diskriminim, me Vendimin Nr.130, datë 13.05.2024 ka vendosur *“Konstatimin e diskriminimit të ankueses S.S, për shkak të shtatzënisë, në të drejtën për punësim, nga ana e Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”*.

Grupi i auditimit konstatoi si me poshtë vijon:

**1.** Miratimi përfundimtar i listës me pedagogët e jashtëm fitues është nxjerr me vendim të Rektorit me datat 12.01.2023, 27.02.2023 dhe me 25.04.2023, por kontratat (*sipas listës në aneks 6*), me disa pedagogë janë lidhur përpara daljes se urdhërit për miratimin përfundimtar me fituesit. *Veprime këto ne kundërshtim me vendimin Nr, 146 datë 14.07.2022 “Për miratimin e disa ndryshimeve në rregulloren e punësimit në USH” neni 19 pika 2 ku shprehet se “Pas renditjes se konkurrenteve, komisioni adhoc harton vendimin me fituesit dhe e përcjell për miratim paraprak te Dekani përkatës, i cili e përcjell te Rektori për miratim përfundimtar.*

**2.** Rektori me shkresë nr, 3369/1 prot, datë 04.11.2022 dhe me shkresë nr, 3477/1 prot, datë 25.11.2022 ka refuzuar 3 punonjës të cilët janë punonjës të administratës së USHLG, të angazhohen si pedagogë të jashtëm pavarësisht se punonjësit kanë pasur miratim e eprorit për tu angazhuar ne procesin e mësimdhënies si pedagogë të jashtëm, si dhe pasi janë vlerësuar si fitues nga komisioni adhoc i ngritur ne Departament e FE, veprime ne kundërshtim VKM nr. 568, datë 6.10.2021 *“Për miratimin e rregullave për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit, orët shtesë dhe kompensimin e tyre në institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore” dhe vendimin Nr, 146 datë 14.07.2022 “Për miratimin e disa*

*ndryshimeve në rregulloren e punësimit në USH” neni 19 pika 2 ku shprehet se “Pas renditjes së konkurrenteve, komisioni adhoc harton vendimin me fituesit dhe e përcjell për miratim paraprak te Dekani përkatës, i cili e përcjell te Rektori për miratim përfundimtar.*

Gjithashtu konstatohet se nga USHLG/Rektori ka vepruar me dy standarde pasi pavarësisht se me shkresë nr. 3477/1 prot, datë 25.11.2022 ka refuzuar angazhim e znj, A. Z si pedagogë të jashtme, me vendim nr, 1402 prot, datë 25.04.2023 e ka angazhuar përsëri. Por nga auditimi i listë pagesave rezulton se për vitin akademik 2022-2023 pranë fakulteteve të USHLG si pedagogë të jashtëm janë angazhuar 6 punonjës të cilët janë pjesë e administratës së USHLG.

Ndërkohë që 2 punonjës (znj, S. Ç dhe znj, D. D) nuk janë angazhuar si pedagogë të jashtëm.

**3.** Rektori i USH nuk ka lidhur kontratat me disa pedagogë të jashtëm pavarësisht se ato janë shpallur fitues nga komisioni adhoc si me poshtë:

a) Për Departamentin e Financë Kontabilitet nuk ka lidhur kontratat me 2 pedagogë te jashtëm znj, S. K dhe znj, S. L.

b) Për Departamentin e Administrim Biznesit nuk ka lidhur kontratat me 7 pedagogët e jashtëm znj, D. L, z, J. M, znj, A. S, znj, G. B, znj, A. B, znj, V. M dhe znj, V. H.

c) Për Departamentin e Turizmit nuk ka lidhur kontratat me 4 pedagogët e jashtëm znj, A. G, znj, E. M, z, F. M dhe z, F. J.

Veprime ne kundërshtim me Ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në republikën e Shqipërisë” neni 39 pika 5, *Ligjin Nr.7961, datë 12.7.1995 “Kodi i punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, neni 21 pika 4 si dhe vendimin nr, 146 datë 14.07.2022 “Për miratimin e disa ndryshimeve në rregulloren e punësimit në USH” neni 18, 19, 20, 21 dhe 22.*

**4.** Mos firmosja e kontratave në kohe me pedagoget e jashtëm, ka ndikuar në procesin e mësimdhënies pasi, sipas urdhërit të Ministrit te MAS nr, 377 datë 07.07.2022, viti akademik 2022-2023 fillon me datë 17 tetorë të vitit 2022.

**5.** Mos nënshkrimi i kontratës me ankuesin është trajtuar nga Komisioneri për mbrojtjen nga diskriminim, me Vendimin Nr.130, datë 13.05.2024 si “*diskriminim për shkak të shtatzënisë, në të drejtën për punësim, nga ana e Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”.*

**Për sa sipër mban përgjegjësi:** ish Rektori i Ush znj, S. G.

Në zbatim të pikës 7 të programit të auditimit Nr. 1101/1, datë 19.09.2024 (I ndryshuar) “*Probleme të ndryshme që mund të dalin gjatë auditimit”, si dhe ankesës së ardhur në e-mail e KLSH me datë 23.01.2025 kerkese per interpretim te VKM Nr.997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”*

Z, D. U punonjës pranë USHLG me detyre staf ndihmës akademik me karakter mësimor (laborant) pranë Departamentit të Biologjisë e Kimisë, Laboratori i Zoologjisë ka paraqitur ankesën për pikat si me posht vijon:

1. Një problem të lindur për shkak të heqjes së dietave nga ana e Universitetit të Shkodrës në muajin shkurt të 2014.

Në vitin 2014 me një vendim të brendshëm Nr. 5 “Ndalesë në pagë” administruar në rektorat me shkresën me nr. 21 Prot. datë 08.01.2014 më janë ndaluar në pagë, shuma e përfituar në zërin “dieta”, që sipas vendimit, kam përfituar me pa të drejtë dhe me këtë shkresë jam ngarkuar me detyrimin e kthimit.

Jam vënë në dijeni të heqjes së dietave nga Universiteti i Shkodrës pas marrjes së pagës mujore të muajit shkurt 2014. Pas shumë këmbënguljeve arrita të gjej vendimin nr. 21 prot, nr. 5, datë 08.01.2014, “Ndalesë në pagë”, ku është mbështetur rektori për të bërë ndalesën në pagë.

Menjëherë pasi mora dijeni për faktin, kam kontaktuar si me rektorin e kohës ashtu edhe me Auditin e Brendshëm, por pa asnjë rezultat duke i qëndruar me këmbëngulje vendimit të marrë.

Me datë 26.02.2018 dhe me 17.03.2022, i jam drejtuar Bordit të Administrimit të Universitetit të Shkodrës me një kërkesë për të shqyrtuar vendimin nr. prot. 21, nr. 5, datë 08.01.2014, “Ndalesë në pagë”. Por deri tani nuk kam pasur ndonjë përgjigje zyrtare për shqyrtimin apo jo të kërkesës time.

Meqenëse kanë kaluar kaq shumë kohë nga kërkesa ime ndaj Bordit të Administrimit, heshtja institucionale me detyron t’iu kërkoj sqarim për këtë çështje.

2. Në Vendim i Rektorit nr. prot. 21, nr. 5, datë 08.01.2014 “Ndalesë në pagë” jam përfshirë në kategorinë e personelit akademik dhe të trupës pedagogjike. Duke u mbështetur në ligjet në fuqi gjatë vitit 2014, për arsimin e lartë, arsimin parashkollor dhe në vendime të këshillit të Ministrave, ku jepet kategorizimi i personelit përkatës në secilin sistem të arsimit, personeli ndihmës-akademik qartazi nuk bën pjesë në stafin pedagogjik apo në personelin akademik. *VKM Nr.997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit” Paragrafi VII “Studentët dhe nxënësit, si dhe trupa shoqëruese pedagogjike, që kryejnë praktika mësimore, ekspozita apo veprimtari jashtë qendrës së institucionit arsimor publik, nuk përfitojnë dietë. Shpenzimet e udhëtimit dhe të fjetjes së tyre përballohen nga institucionet përkatëse të arsimit, sipas dokumenteve përkatëse tatimore”.*

Grupi i auditimit pasi mori në shqyrtim ankesën, arriti në konkluzion se në lidhje me ankesën e kryer nga z. D. U, USHLG ka të gjithë strukturat dhe mekanizmat për të qartësuar çështjen si dhe për ti kthyer përgjigje korrekte dhe në kohe z. D. U, pasi USHLG nuk ka kthyer një përgjegji për ankesës e kryer. *Në kundëstim me Ligji Nr. 119/2014 “PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT” neni 3 pika 1 dhe 2 citojn: “Çdo person gëzon të drejtën e njohjes me informacionin publik, pa u detyruar të shpjegojë motivet. 2. Autoriteti publik është i detyruar të informojë kërkuuesin nëse ka ose jo në zotërim informacionin e kërkuar”.*

Për sa me sipër grupi i auditimit do të lërë rekomandimin përkatës në seksioni IV. Gjetje dhe Rekomandime.

## **IV. GJETJE DHE REKOMANDIME:**

### **A. MASA ORGANIZATIVE**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga kryerja e auditimit mbi urdhër shpenzimet, rezultuan shkelje të disiplinës buxhetore sa i takon likuidimit të faturave, duke tejkalluar afatin ligjor. Konkretisht, janë likuiduar fatura mbi afatin e parashikuar 30 ditor duke shkelur disiplinën buxhetore që dikton Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar” si dhe neni 7 i Ligjit nr. 48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare” në 6 urdhër shpenzime në shumën totale prej 5,622,038 lekë, duke sjellë tejkallim të afateve dhe risku për krijimin e detyrimeve të reja të prapambetura. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 32-41, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**1.1 Rekomandimi:** Nëpunësi Zbatues i Universitetit “Luigj Gurakuqi” Shkodër të marrë masa të paraqesë në degën e thesarit dokumentacionin justifikues të shpenzimeve për rastet e pagesave ndaj operatorëve ekonomikë, brenda 30 ditëve nga data e faturës origjinale të OE, me qëllim respektimin e disiplinës buxhetore dhe shmangien e riskut për krijimin e detyrimeve të prapambetura.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi me përzgjedhje i kartelave të automjeteve si dokumenti

vërtetues për lëvizjet, kilometrazhin dhe shpenzimet e karburantit të automjeteve, rezultoi se të gjithë fletë udhëtimet e drejtuesve të mjeteve, janë të përshkruara lëvizjet me itinerarin e tyre përkatës, por nuk janë të firmosura nga nëpunësit udhëtues të kryerjes së shërbimit. Për automjetin që administron institucioni me targë A, në kartelat e shpenzimeve të karburantit, nuk është evidentuar kilometrazhi i tij në fillim dhe në fund të vitit, për të bërë ndjekjen e shpenzimeve periodike, të cilat nuk mund të përlllogariten pa pasqyruar elementin bazë (kilometrazhin), si dhe për përlllogaritjen dhe planifikimin e shpenzimeve për mirëmbajtje dhe shfrytëzimin e automjeteve. Veprimet në këndshmit me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 32-41, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**2.1 Rekomandimi:** Drejtoria e Fondit të Investimeve dhe Shërbimeve, të marrë masa që për çdo fletë-udhëtim të dorëzuar nga drejtuesit e mjeteve, në fund të muajit të jenë të plotësuara në mënyrë të saktë me të gjithë elementet e nevojshme. Në fund të fletë udhëtimeve të bëhet përmbledhja e kilometrave të përshkruara si dhe litrat e harxhuara.

### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**3. Gjetje nga auditimi:** Për periudhën objekt auditimi janë rimbursuar pagesa për tarifën e konferencave dhe kërkimit shkencor. Për vitin 2022 janë 3 përfitues personel akademik me vlerën totale prej 55,774 lekë, për vitin 2023 janë 79 përfitues personel akademik me vlerë totale 5,079,658 lekë dhe deri në 30.06.2024 janë 14 përfitues personel akademik me vlerë totale 856,833 lekë. Në total janë 96 përfitues personel akademik me vlerë totale prej 5,992,235 lekë. Grupi i auditimit konstatoi se për vitin 2022 dhe vitin 2023 nuk ka një relacion shpjegues dhe verifikues nga ana e strukturave përkatëse akademike. Ndërkohë, për vitin 2024 relacioni i hartuar nga struktura përkatëse është një përmbledhje narrative dhe nuk citohet mbështetja në objektivat strategjike të institucionit apo të prioritetëve të njësisë bazë kryesore të USHLG. Në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 32-41, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**3.1 Rekomandimi:** Administratori i Universitetit “Luigj Gurakuqi” Shkodër, në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse, të marrë masa që kërkimi shkencor dhe tarifën e konferencave, të planifikohen dhe të dokumentohen, me qellim garantimin e transparencës së plotë dhe menaxhim me efikasitet dhe efektivitet të fondeve publike.

### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**4. Gjetje nga auditimi:** Për periudhën objekt auditimi, 36 anëtarë të personelit akademik dhe ndihmës akademik me karakter administrativ janë punësuar pa iu nënshtruar më parë procesit të rekrutimit dhe kohëzgjatja e kontratave është deri në shpalljen e procedurës së konkurrimit. Kjo në kundërshtim me VKM-në nr. 176 datë 29.03.2006 “Për botimin e buletinit e njoftimeve publike”, pika 3, germa V, ku botohen të gjitha njoftimet publike të shkollave të larta publike, përfshi dhe shprehjet e interesit për rekrutim staf akademik apo personeli administrativ në këto institucione, si dhe vendim e BA nr, 146, datë 14.07.2022 “Për miratimin e disa ndryshimeve në rregulloren e punësimit në USH”, neni 4.

Gjithashtu, edhe ngritjet në detyrë të 12 punonjësve të personelit ndihmës akademik dhe administrativ, janë kryer pa procedurë dhe janë të pa bazuara në një vlerësim performance të stafit. Veprime këto në kundërshtim me Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar dhe manualin e MFK-së Kapitulli III “Komponentët e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit”; 3.1 “Mjedisi i

kontrollit të brendshëm. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 20-32, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**4.1 Rekomandimi:** Rektori dhe Administratori në bashkëpunim me Burimet Njerëzore në Universitetin “Luigj Gurakuqi” Shkodër, të marrin masa që në çdo rast të ndjekin të gjitha procedurat e parashikuara ligjore në publikimin e vendeve vakante.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**4.2 Rekomandimi:** Nga ana e Rektorit dhe Administratorit të Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër, të merren masat për rishikimin e rregullores së brendshme të punësimit, duke parashikuar rregulla të qarta në lidhje me rekrutimin e punonjësve, emërimet e përkohshme, si dhe procedurave të ngritjes në detyrë të stafit, me qëllim rritjen e transparencës dhe konkurrueshmërinë.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**4.3 Rekomandimi:** Nga ana e Rektorit dhe Administratorit të Universitetit “Luigj Gurakuqi” Shkodër, të merren masat për rishqyrtimin e 36 procedurave të emërimeve/komandimeve, që janë kryer pa iu nënshtruar me parë procedurave të konkursit me qëllim zbatimin e akte ligjore dhe nënligjore.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**5. Gjetje nga auditimi.** Nga auditimi rezultoi se në disa raste, kohëzgjatja e marrëdhënies së punës për personelin akademik, nga ana e rektorit të USHLG-së, është kryer në kundërshtim me kategoritë e përcaktuara. Konkretisht për vitin akademik 2021-2022 në një rast, për vitin akademik 2022-2023 në një rast dhe për vitin akademik 2023-2024 në pesë raste. Veprime në kundërshtim më Ligjin nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 65 dhe përcaktimet e statutit, neni 41, pika 3, pasi referuar sa më sipër kohëzgjatja e kontratës mund të bëhet vetëm për kategorinë me titullin “Profesor” dhe “Profesor i Asociuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 20-32, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**5.1. Rekomandimi:** Rektori i Universitetit 'Luigj Gurakuqi' Shkodër të marrë masa për të identifikuar dhe rishqyrtuar kontratat e zgjatura të marrëdhënies së punës, duke siguruar që të mos bëhet zgjatje e tyre për personelin akademik pa titull 'Profesor' dhe 'Profesor i Asociuar'.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**6. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se laboratorit i diagnostifikimit mikrobiologjik nuk është i akredituar dhe i kalibruar, e për rrjedhojë analizat që kryen ky laborator nuk japin garanci për rezultate të sakta dhe brenda standardeve organizative, ligjore dhe teknike. Gjithashtu moskryerja e kalibrimit në mënyre periodike (1 herë në vit) nuk siguron legjitimitetin e kualifikimit dhe verifikimit, duke përfshirë vërtetimin e sistemit kompjuterik. Aktivitetet e kalibrimit duhet të kryhen me instrumente të kualifikuara nga një laborator i akredituar, ku një ndër to është dhe Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë (organ shtetëror i akredituar).” Ligji Nr. 9024, datë 6.3.2003 “Për akreditimin e laboratoreve testues kalibrues, organizmave certifikues dhe inspektues në Republikën e Shqipërisë. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 32-41, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**6.1 Rekomandimi:** Administratori i Universitetit “Luigj Gurakuqi” Shkodër, të marrë masa të menjëhershme për ngritjen e një grupi pune, për të kryer procedurat për akreditimin dhe kalibrimin e pajisjeve të laboratorit të diagnostifikimit mikrobiologjik.

**Menjëherë**

**7. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se në Universitetin “Luigj Gurakuqi”, Shkodër, janë punësuar 35 punonjës si personel akademik me kohë të plotë apo asistent lektor, të cilët nuk kanë përfunduar studimet e doktoraturës dhe nuk kanë fituar gradën shkencore “Doktor”, dhe për të cilët nuk janë kryer procedurat e parashikuara për zgjidhjen e kontratës së punës. Veprime në kundërshtim me Ligjit 85/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe Statutin e Universitetit “Luigj Gurakuqi” Shkodër. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 20-32, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**7.1 Rekomandimi:** Nga Rektori i Universitetit “Luigj Gurakuqi” Shkodër, të merren masa për rishikimin e kontratave të punës për personelin akademik me kohë të plotë, i cili nuk ka mbaruar studimet e doktoratës brenda afatit ligjor.

#### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**8. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i evidencave të orëve të personelit akademik pranë Fakultetit të Drejtësisë, Fakultetit të Shkencave të Edukimit dhe Fakultetit të Shkencave të Natyrës, rezultoi se në formularin e planifikimit pasqyroheshin të dhënat e personelit akademik, programet e studimit, lëndët mësimore që parashikoheshin të zhvilloheshin sipas planeve të miratuara dhe orët e specifikuar. Por, në formularin e planifikimit pasqyrohej vetëm “veprimtaria mësimdhënëse” referuar kreut I, pika 3, germa a, e udhëzimit nr.29 datë 10.09.2018 “Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në Institucionet e Arsimit të Lartë” i ndryshuar, ndërsa veprimtaria “kërkimi shkencor” (pika 3/b), “kontributi institucional” (pika 3/c). “kontributi profesional” (pika 3/d) evidentohet në total, por jo të detajuara. Veprime në kundërshtim të udhëzimit nr. 29 datë 10.09.2018 “Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në Institucionet e Arsimit të Lartë” i ndryshuar, *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 20-32, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**8.1 Rekomandimi:** Strukturat përgjegjëse pranë fakulteteve të Universitetit “Luigj Gurakuqi” Shkodër, të marrin masa që evidencat e stafit akademik të plotësohen të detajuara, ku të përfshihet “kërkimi shkencor”, “kontributi institucional” dhe “kontributi profesional”.

#### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**9. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i listë- pagesave, konstatohet se nuk ka një sistem elektronik të automatizuar të sistemit të pagave, duke përfshirë të gjithë elementët e saj, për kontrollin e procesit të punës, dhe saktësinë në përlllogaritjen e pagës. Ndërkohë, për të gjithë muajt e periudhës së auditimit, elementet e tabelës së listë pagesave nuk janë plotësuar sipas formatit të caktuar. Konstatohet se për orët shtesë paguar për stafin akademik është përdorur kolona nr. 17 “Shtesë page për orët jashtë kohës normale të punës”, në kundërshtim me Udhëzimin i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 1, datë 21.05.2021 “Për formën, elementet dhe plotësimin e listë- pagesës mujore të pagave dhe të urdhër shpenzimit për pagat në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”. Kjo parregullsi nuk jep një pasqyrë të qarte të elementeve përbërës të pagave, si dhe efektin/peshën specifike të tyre në strukturën e pagave. Gjithashtu, konstatohet se për stafin akademik me kohë të pjesshme pagesat për shërbimin e ofruar nga ana e pedagogëve për periudhën e vitit akademik 2023-2024 për semestrin e parë janë ekzekutuar në fund të semestrit për të gjithë ngarkesën mësimore dhe jo sipas planit mësimor bashkëlidhur kontratës së punës mes pedagogëve dhe Rektoratit. Subjekti duhet ti kishte regjistruar në skemën e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore sipas planit mësimor bashkëlidhur kontratës, pasi këta punonjës e kanë ofruar shërbimin e tyre sipas muajve respektiv dhe duheshin paguar po sipas këtyre muajve. Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore dhe Shëndetësorë në RSh”, neni 6 dhe neni 8. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 20-32, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**9.1 Rekomandimi:** Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër, të marrë masa ku të realizojë deklaratimet e punonjësve me kohë të pjesshme me organet tatimore para fillimit të punës, si dhe të kryejë pagesat e orëve mësimore të realizuara prej tyre në kohë e në përputhje me kontratën e lidhur me personelin akademik me kohë të pjesshme.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**10. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i projekteve me financim nga Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI), si dhe e projekteve me financim nga BE rezultoi se: Rregullorja e brendshme e administratës së Rektoratit të USHLG-së, nuk parashikon përshkrimin e proceseve të punës, procedurat e ndjekura në zbatimin dhe monitorimin e projekteve që kryhen nga drejtoria në lidhje me përgatitjen e dokumentacionit për shfaqje interesi ndaj thirrjeve për aplikim të projekteve të publikuara nga AKKSHI si dhe menaxhimin e projekteve dhe administrimin e dokumentacionit në rastin e projekteve me financim nga BE, e cila sjell si pasojë parregullsi në administrimin e dokumentacionit të projekteve. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3.1, faqe 41-47, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**10.1 Rekomandimi:** Të merren masa nga Titullari Universitetit “Luigj Gurakuqi” Shkodër, për miratimin e shtesave në Rregulloren e Brendshme të Administratës së Rektoratit, me qëllim përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësi të Drejtorisë së Komunikimit, Kërkimit Shkencor, Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë, në lidhje me përgatitjen e dokumentacionit për shfaqje interesi ndaj thirrjeve për aplikim të projekteve të publikuara nga AKKSHI, menaxhimin e projekteve, si dhe administrimin e dokumentacionit në rastin e projekteve me financim nga BE.

**Menjëherë**

**11. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i projekteve me financim nga Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI) rezultoi se:

Në 1 rast, shuma e mbetur pa u shpenzuar nga financimi i projektit nuk është kthyer pas përfundimit të tij, kjo jo në përputhje me nenin 5, pika 3 të Kontratës.

Në 1 rast, Raporti Final është përcjellë me vonesë në Tetor 2024 ndërkohë që, procedura e prokurimit për blerje pajisje për laboratorin, ka përfunduar në 31 Dhjetor 2022, sipas Kontratës shtesë Nr.2526/21, datë 06.12.2022 ”Blerje për Laboratorin e Analizave Ushqimore”.

Në dosjet e audituara ku projektet rezultojnë të përfunduara, nuk administrohet si pjesë e dosjes relacioni përmbledhës për pranimin e projektit nga financuesi (AKKSHI), referuar nenit 3 të kontratës të lidhur.

Në 1 rast, në dosje nuk administrohet kontrata e lidhur mes MAS-it dhe USHLG për vlerën e financuar nga ajo, në kundërshtim me VKM-në Nr. 607, datë 31.08.2016 “Për krijimin, përbërjen, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI)”, pika 1, germa c. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3.1, faqe 41-47, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**11.1 Rekomandimi:** Drejtoria e Komunikimit, Kërkimit Shkencor, Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë, të marrë masa, për plotësimin e parregullsive dhe mangësive të konstatuara në administrimin e dokumentacionit të projekteve.

**Menjëherë**

**12. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi dhe shqyrtimi i kontratave të punës të lidhura për periudhën objekt auditimi për pedagogët e jashtëm, u konstatua se për 18 pedagogë/punonjës kontratat janë lidhur përpara datës së miratimit të Vendimit të Rektorit nr. 118 prot., datë 12.01.2023, veprime

këto në kundërshtim me vendimin Nr., 146, datë 14.07.2022 “Për miratimin e disa ndryshimeve në rregulloren e punësimit në USH”, neni 19 pika 2.

Rektori i USH nuk ka lidhur kontratat me disa pedagogë të jashtëm, pavarësisht se këta të fundit janë shpallur fitues nga komisioni ad-hoc. Konkretisht:

- a) Për Departamentin e Financë Kontabilitet nuk janë lidhur kontratat me 2 pedagogë të jashtëm.
- b) Për Departamentin e Administrim Biznesit nuk janë lidhur kontratat me 7 pedagogë të jashtëm
- c) Për Departamentin e Turizmit nuk janë lidhur kontratat me 4 pedagogë të jashtëm.

Gjithashtu u konstatua se me shkresat: nr. 3369/1 prot, datë 04.11.2022 dhe nr. 3477/1 prot, datë 25.11.2022, të Rektorit të Universitetit, është refuzuar lidhja e kontratave për 3 punonjës të cilët janë punonjës të administratës së USH për tu angazhuar si pedagogë të jashtëm, pa asnjë argument, veprime në kundërshtim me Vendimin nr. 1461 prot, datë 26.10.2022 dhe nr. 1584 prot, datë 10.11.2022 të Komisionit ad hoc i ngritur në Departamentet e FE. Ndërkohë, po për këtë vit akademik 2022-2023, rezultoi se janë angazhuar 6 punonjës të cilët janë pjesë e administratës së USHLG.

Mos firmosja e kontratave në kohë me pedagogët e jashtëm, si dhe mos zbatimi i Vendimeve të marra nga Komisioni ad-hoc, i cili vlerëson dosjet e kandidatëve aplikues nga Rektori i USH janë veprime në kundërshtim me Vendimin nr. 146 datë 14.07.2022 “Për miratimin e disa ndryshimeve në rregulloren e punësimit në USH” neni 19. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, faqe 125-128, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**12.1 Rekomandimi:** Rektori i Universitetit “Luigj Gurakuqi” Shkodër, në bashkëpunim me Dekanët e Fakulteteve, të marrë masa për të garantuar respektimin e vendimeve të komisioneve ad-hoc, në procesin e shqyrtimit dhe klasifikimit të pedagogëve të jashtëm për angazhimin në mësimdhënie, në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullativ në fuqi.

**Në vijimësi**

**13. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit mbi procedurat e prokurimit për periudhën objekt auditimi (01.01.2022 – 30.06.2024), rezultoi se janë realizuar 17 procedura me vlerë të fondit limit 118,710,553 lekë. Janë audituar të gjitha procedurat, nga ku u konstatua se:

- Në **3** procedura prokurimi, me vlerë totale të fondit limit 10,708,327 lekë pa TVSh, parregullsi në hartimin e fondit limit, të specifikimeve teknike dhe vendosjen e kriterëve jo në përputhje me objektin që prokurohet, në kundërshtim me Ligjin nr, 162/2022 “Për prokurimin publik” neni 77 dhe VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 “Miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” neni 76.

- Në **4** procedura prokurimi, me fond limit 22,731,163 lekë pa TVSh, OE të shpallura fitues, në dokumentacionin e paraqitur prej tyre kishin mangësi në plotësimin e kriterëve të vendosura në DST, veprime në kundërshtim me LPP nr. 162 datë, 23.12.2020 ”Për prokurimin publik” Neni 92.

- Në **4** procedura prokurimi, me fond limit 28,582,588 lekë pa TVSh, janë nënshkruar 2 kontrata me të njëjtin OE të shpallur fitues me të njëjtin objekt prokurimi dhe zbatimi i kontratës është bërë referuar kontratës së dytë.

- Në **5** procedura prokurimi, me fond limit 27,080,671 lekë pa TVSh, AK ka publikuar njoftimin e fituesit pa respektuar afatet e sjelljes së dokumentacionit të plotë fizik dhe rrjedhimisht pa kryer verifikimin e dokumentacionit të OE të shpallur fitues, veprime në kundërshtim VKM-së Nr. 285, datë 19.5.2021 “Miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” neni 26.

- Në **1** procedurë prokurimi, është kryer nënshkrimi i shtesës së kontratës jashtë afateve dhe konkretisht një ditë pasi kishte përfunduar afati i kontratës së parë, veprime në kundërshtim me LPP nr. 162 datë, 23.12.2020 neni 127 si dhe VKM-së Nr. 285, datë 19.5.2021 i ndryshuar, Neni 23.

- Në **1** procedurë prokurimi, me urdhër nr. 2984/20, datë 26.12.2023 është ngritur komisioni për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës. Komisioni i zbatimit të kontratës ka mbajtur proces verbale me

datë 27 - 28.12.2023 mbi kryerjen e aktiviteteve, por aktivitetet janë kryer përpara procesverbaleve të mbajtura nga komisioni, si dhe përpara ngritjes së urdhrat për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës, veprime në kundërshtim me Udhëzim nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 42 dhe 43.

Ndërkohë nuk kishte gjurmë auditimi në dosjen përkatëse për të vërtetuar dhe siguruar që aktivitetet janë kryer konform kriterëve të vendosura në kontratë.

- Në 1 procedurë prokurimi, vendimi i KPP nuk është zbatuar brenda 5 ditëve por është zbatuar 122 ditë me vonesë nga AK. Veprime në kundërshtim me vendimin e KPP nr, 1041/2023, si dhe Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” neni 24 si dhe 30 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 69-109, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**13.1 Rekomandimi:** Titullari i Autoritetit Kontraktor (Administratori) në bashkëpunim me grupin e punës ose komisionin përkatës, të marrë masat e nevojshme për hartimin e fondit limit, përgatitjen e specifikimeve teknike dhe përcaktimin e kriterëve të vlerësimit, në përputhje me objektin që prokurohet. Gjithashtu, gjatë vlerësimit të ofertave për procedurat që do të zhvillohen në vijimësi, duhet të sigurojë që veprimet të jenë në përputhje të plotë me aktet ligjore dhe nënligjore, si dhe me parimet e transparencës, barazisë dhe efektivitetit.

**Në vijimësi**

**14. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt “Shërbime të printimit dhe publikimit (për ceremoninë e 65 vjetorit të USH-së.)”, e realizuar në vitin 2022 rezultoi se, komisioni i zbatimit të kontratës pas përfundimit të aktivitetit nuk ka bërë hyrje në magazinë: 1. Realizim dokumentari 65 vjetorit i në vlerën 999,403 lekë dhe 2. Shërbim Fotografik dhe regjistrim video e audio me CD të 65 vjetorit të USH në vlerën 180,000 lekë.

Ndërkohë për sa i përket Artikullit nr.2 “Shërbim Fotografik dhe regjistrim video e audio me CD të 65 vjetorit të USH në vlerën 180,000 lekë”, fotografitë janë venë në dispozicion të grupit të auditimit, por nuk janë sipas specifikimeve të kërkuar në Veprime në kundërshtim me Udhëzimin MF Nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pika 42, 43, 44 dhe 122. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 69-109, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**14.1 Rekomandimi:** Strukturat përgjegjëse, në vazhdimësi të marrin masa që të dokumentojnë marrjen në dorëzim të mallrave me fletëhyrjen shoqëruese të magazinës.

**Në vijimësi**

**15. Gjetje nga auditimi:** Në 5 procedura prokurimi mbi kufirin e ulet të vitit 2022 me fond limit 27,080,671 lekë pa TVSh, si dhe 11 procedurave me blerje të vogël, nga të cilat 3 procedura në vitin 2022, 5 procedura në vitin 2023 dhe 3 procedura në vitin 2024, u konstatua se, dokumentet e dorëzuara nga operatorët ekonomik fitues në përmbushje të kërkesave të vendosura në DT/ ftesën për ofertë nuk protokollohen në zyrën e arkiv protokollit nga OE. Dokumentacioni merret në dorëzim nga komisioni i vlerësimit të ofertave, i cili mban dhe një procesverbal me dokumentet e marra në dorëzim dhe me pas protokollat pranë AK. Veprime në kundërshtim Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, pika 122, Udhëzimin nr.5, datë 25.06.2021 “Mbi Përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike, pika 17. Referuar neni 18 të Normave tekniko-profesionale të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, në mbështetje të Ligjit nr. 9154 datë 06.11.2003 “Për arkivat”. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 69-109, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**15.1 Rekomandimi:** Titullari i Institucionit të marrë masa në vijimësi, që për të siguruar gjurmën e auditimit, çdo dokument që krijohet nga subjekti shtetëror apo jo shtetëror, si dhe ato që vijnë nga subjekte të tjera, të evidentohen në regjistrin e protokollit të institucionit.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**16. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi planifikimin e buxhetit në USHLG u konstatua se:

- ka hartuar dokumentin e PBA 2023-2025, PBA 2024-2026 dhe PBA 2025-2027 për fazën teknike, ndërsa sa i takon fazës strategjike, nga ana e USHLG, nuk rezulton të jetë hartuar dokumenti i PBA-së, veprim i cili kufizon përcaktimin e prioritetëve afatgjata të institucionit, ndikon negativisht në shpërndarjen e burimeve financiare, vlerësimin e ndikimit të aktivitetëve në arritjen e objektivave strategjike dhe rrezikon qëndrueshmërinë financiare dhe përmbushjen e misionit të tij.

- Me shkresën nr. 1014 prot., datë 16.03.2022, të Administratorit drejtuar Rektoratit, Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit të USHLG, me lëndë “Relacion mbi realizimin e buxhetit vjetor 2021 dhe planin buxhetor vjetor 2022”, është dërguar plani i Buxhetit Vjetor, i hartuar në bazë të kërkesave të fakulteteve. Më pas, nga ana e Senatit Akademik nuk është vijuar me miratimin e buxhetit brenda afateve të përcaktuara, por rezultoi se plani i buxhetit vjetor është miratuar me anë të Vendimit nr. 158, datë 29.07.2022, dhe nga Bordi i Administrimit është miratuar me anë të Vendimit e BA nr. 159, datë 01.08.2022 “Për miratimin e buxhetit për vitin 2022”, jashtë të gjitha afateve të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore, duke shkelur disiplinën buxhetore.

Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me Ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligjit nr. 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, si dhe të Udhëzimit nr. 9, datë 20.3.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, neni 27, pika 1 dhe Udhëzimin nr. 16 të MFE, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”, paragrafi 2.2.4, pika 3. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 14-20, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**16.1. Rekomandimi:** Nga ana e Universitetit “Luigj Gurakuqi” Shkodër, të merren masat në vijimësi për hartimin e dokumentit të PBA-së për fazën strategjike, në mënyrë që të sigurohet një planifikim afatgjatë, efektiv dhe një shpërndarje e drejtë e burimeve financiare, duke shmangur ndikimet negative në përmbushjen e objektivave institucionale dhe garantimin e qëndrueshmërisë financiare.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**17. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi buxhetimin e investimeve u konstatua një mospërputhje e konsiderueshme ndërmjet planifikimit në Programin Buxhetor Afatmesëm (PBA), planit vjetor të buxhetit dhe realizimeve faktike të investimeve.

Në vitin 2022 konstatohet se vonesat e shkaktuara nga procesi i miratimit të planit buxhetor në Senatit Akademik dhe Bordin e Administrimit kanë ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në zbatimin e investimeve gjatë vitit 2022. Miratimi i buxhetit jashtë afateve ligjore ka shkaktuar vonesa të konsiderueshme në fillimin e projekteve të planifikuara, duke rezultuar në një realizim të ulët të investimeve, edhe pse nga ana e Administratorit është dërguar brenda afateve ligjore, nuk është shqyrtuar dhe miratuar brenda afateve ligjore, duke u vonuar deri në muajin gusht. Kjo vonesë ka rezultuar në dështimin për të filluar zbatimin e projekteve të planifikuara në kohë, duke ndikuar negativisht në përqindjen e realizimit të investimeve. Sipas të dhënave, nga 40 projekte të

planifikuara, janë realizuar vetëm 2(dy), çka tregon një realizim të pamjaftueshëm prej 12% të investimeve të buxhetit vjetor.

Në vitin 2023, sipas të dhënave, nga 28 projekte të planifikuara në PBA 2023-2025, realizimi i tyre ka qenë zero lekë. Për më tepër, nga 55 projekte të planifikuara në buxhetin vjetor me vlerë 195,224 mijë lekë, janë realizuar vetëm 9 projekte, me një vlerë prej 18,639 mijë lekë, që përfaqëson një realizim prej 10%. Këto rezultate tregojnë mungesë të efektivitetit në planifikimin dhe menaxhimin e investimeve nga strukturat përgjegjëse. Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me Ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 14-20, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**17.1. Rekomandimi:** Nga ana e Universitetit “Luigj Gurakuqi” Shkodër, të merren masat e nevojshme për të siguruar miratimin e planit buxhetor brenda afateve të përcaktuara ligjore, duke përmirësuar koordinimin ndërmjet Administratorit, Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit, me qëllim shmangien e vonesave që kanë ndikuar negativisht në ekzekutimin e investimeve.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**18. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se nga ana e Universitetit “Luigj Gurakuqi” Shkodër, si njësi shpenzuese, nuk janë hartuar raportet e monitorimit si dhe relacionet shpjeguese 4-8-12 mujore për të ndjekur realizimin e produkteve të buxhetit, për të garantuar përmirësimin e procesit të planifikimit dhe menaxhimit të buxhetit, ndjekjen dhe arritjen e qëllimit dhe objektivave të synuara, sipas deklaratës së politikës së programit, si dhe krahasimin e treguesve të planifikuar të performancës me treguesit faktik, veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr. 14/2023 dhe Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar të nenit 65. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 14-20, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**18.1 Rekomandimi:** Nga ana e Universitetit “Luigj Gurakuqi” Shkodër, të merren masat në vijimësi për hartimin dhe raportimin e rregullt të analizave financiare dhe raporteve të monitorimit 4-mujore, 8-mujore dhe 12-mujore, në përputhje me kuadrin ligjorë, me qëllim përmirësimin e planifikimit dhe monitorimit të buxhetit.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**19. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i llogarisë nr. 520 “Disponibilitete në Thesar” u konstatua se gjendja në datën e mbylljes së pasqyrave financiare duhet të ishte 539,058,275 lekë dhe jo 538,233,185 lekë, pra kemi një diferencë prej 827,113 lekë midis gjendjes së raportuar në datën 31 dhjetor 2023 dhe përlllogaritjeve analitike mes granteve dhe të ardhurave dytësore të trashëguara nga viti 2022 shtuar me grantin buxhetor dhe të ardhurat dytësore të vitit 2023 pakësuar me shpenzimet e periudhës shtuar me tepricën e mjeteve në ruajtje. Mungon akt-rakordimi me thesarin lidhur me llogarinë 520 “Disponibilitete në thesar”. Këto veprime janë në kundërshtim me pikën 36, 50 të Udhëzimit MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 47-69, Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**19.1 Rekomandimi:** Sektori i financës të marrë masa të menjëhershme për evidentimin dhe sistemimin e diferencë prej 827,113 lekë në llogarinë e duhur kontabël në pasqyrat financiare të vitit 2024.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**20. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi aktiveve afatgjata, analizës së llogarive të klasës 20 “Aktivet Afatgjata Jo materiale” u konstatuan parregullsitë si vijon:

- Norma e amortizimit e përdorur për përllogaritjen e amortizimit të grupit është bërë me normë 15%, si dhe me metodë amortizimi me “Vlerë të mbetur” çka ka sjellë një vlerë jo të saktë të zhvlerësimit nga amortizimi.

- Keqklasifikim në zërin “Likuidim TVSH pajisje elektronike projekti MARDS” në shumën 700,217 lekë. Ky zë nuk duhet të ishte kontabilizuar në këtë llogari por në llogaritë e klasës 2 “Aktivet Afatgjata Materiale” si pjesë e pajisjeve të financuara nga projekti.

- Në llogarinë 212 “Ndërtesa dhe Konstruksiione” konstatohet se janë kontabilizuar artikuj të cilët i përkasin llogarisë 218.

- Në llogarinë 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” konstatohet se amortizimi është përllogaritur me normën 20% për vlerën totale të kësaj llogarie dhe jo për secilin artikull me vete, gjithashtu konstatohen artikuj që nuk i përkasin këtij grupi të cilët duhet të ishin kontabilizuar në llogarinë 218.

-Në llogarinë 215 “Mjete transporti” konstatohet se amortizimi është përllogaritur me normën 20% ndërsa totali i llogarisë nuk rakordon me vlerën e kësaj llogarie e pasqyruar në datën e mbylljes së pasqyrave financiare të vitit 2023.

Në llogarinë 230 "Për aktive afatgjata jo materiale" janë konstatuar keqklasifikime të investimeve të mbetura në proces që prej vitit 2011, për të cilat institucioni nuk ka ndërmarrë masa për sistemimin e tyre në llogaritë përkatëse. Transaksionet per oponenca teknike, projekt ide, leje ndërtimi me vlerë totale 16,055,165 lekë, duhej t'i shtoheshin objekteve përkatëse dhe të kontabilizoheshin bashkë me amortizimet përkatëse sipas periudhave. Gjithashtu, në të njëjtën llogari është evidentuar vlera prej 2,348,420 lekë për "AKTI Pajisje", e cila përfaqëson mjete monetare të disbursuara nga Agjencia Kombëtare e Teknologjisë së Informacionit dhe që duhej të ishin regjistruar fillimisht në llogarinë 231 si investime në proces, për t'u transferuar më pas në llogaritë përkatëse të klasës 2.

- për transaksionet “Studim kabine elektrike”, “Studim salla e konferencave Fakulteti i Gjuhëve të Huaja” dhe “Studim projektim PMNZ” të cilat kapin vlerën e 570,880 lekë subjekti ka akt-marrje në dorëzim të realizimit të këtyre punimeve të cilat do të duhej të sistemoheshin në llogaritë përkatëse kontabël. Me akt-marrjen në dorëzim të punimeve do të duhej që vlerat respektive në llogarinë 230 do të duhej që të kapitalizoheshin në llogaritë e klasës 2 së bashku me vlerat e aktiveve afatgjata materialë. Paraqitja e këtyre transaksioneve në llogarinë 230 Investime në proces “Për aktive afatgjata jo materiale” është keqklasifikim me pasojë paraqitje jo të drejte të pozicionit financiar në datën e mbylljes së pasqyrave financiare. Mosparaqitja e tyre në llogaritë e klasës 2 i ka përjashtuar nga trajtimi kontabël lidhur me amortizimin. Mos marrja në konsideratë e amortizimit ndikon drejtpërsëdrejti në rezultatin e periudhës, në përcaktimin e jetës së aktivitetit dhe në vendimmarrjen e organeve drejtuese.

- në llogarinë 231 “Për aktive afatgjata materiale” konstatohen keq klasifikime transaksionesh në shumën 2,777,742 lekë të cilat duhet të ishin kontabilizuar dhe të klasifikoheshin në llogarinë 230 “Për aktive afatgjata jo materiale”. Konstatohen keq klasifikime transaksionesh në shumën 63,194,095 lekë të cilat duhet të kontabilizoheshin në llogaritë e klasës 212 pas procesit të marrjes në dorëzim të punimeve me qëllim kapitalizimin e tyre dhe në vijim përllogaritjen e amortizimit të tyre sipas periudhave.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me udhëzimin e MF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar. Mos sistemimi i këtyre transaksioneve pas akteve të marrjes në dorëzim në llogaritë e klasës 21, na jep një paraqitje jo të drejtë dhe të saktë të këtyre aktiveve pasi në përcaktimin e vlerës së drejtë të tyre ndikon amortizimi, i cili nuk është marrë në konsideratë që nga momenti i marrjes në dorëzim të punimeve duke ndikuar në rezultatet e

periudhave dhe pasqyrat financiare lidhur me saktësinë dhe rregullshmërinë e tyre. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 47-69, Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**20.1 Rekomandimi:** Sektori i financës të marrë masa të menjëhershme për riklasifikimin e asetëve sipas klasave përkatëse, të rillogariten vlerat e amortizimeve sipas normave të klasave përkatëse të konstatuara, të përdoret metoda e duhur e amortizimit, të përmirësohet regjistri i aktiveve. Rezultatet e përlllogaritjeve të mësipërme të pasqyrohen në pasqyrat financiare të vitit ushtrimor 2024, duke bërë që llogaritë e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale të paraqiten në vlera të drejta dhe të rakorduara sipas kërkesave të teknikave kontabël.

**Menjëherë**

**21. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i llogarisë 210 “Toka troje terrene” konstatohet se, nga përlllogaritjet e grupit të auditimit mbi sipërfaqen e tokës truall ku universiteti ushtron aktivitetin, sipas shkresës nr., 922/1 prot datë 13.03.2024 rezultojnë një sipërfaqe toke truall prej 13,536.64 metër katror. Vlera e tokës truall sipas shkresës së mësipërme në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 89, datë 3.2.2016 “Për Miratimin e Hartës së Vlerës së Tokës në Republikën e Shqipërisë” rezultojnë në vlerën 120,992,154.24 lekë, nga e cila vetëm 888,000 lekë është e kontabilizuar në llogaritë kontabël të pasqyrave financiare të Universitetit. Diferenca prej 120,104,154,24 lekë nuk është pasqyruar dhe kontabilizuar në llogaritë kontabël të pasqyrave financiare të Universitetit, duke sjellë një paraqitje jo të drejtë dhe të saktë të pozicionit financiar në datën e mbylljes së pasqyrave financiare për vitin 2022 dhe 2023. Veprimi i mësipërm është në kundërshtim me Udhëzimin të MF me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, “Parimet e kontabilitetit në sektorin publik”, pika 5. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 47-69, Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**21.1 Rekomandimi:** Administratori i Universitetit “Luigj Gurakuqi” Shkodrës të ngriejë një grup pune për vlerësimin financiar të truallit nën administrim të Universitetit. Për vlerësimin financiar të nxjerrë nga grupi i punës, sektori i financës të marrë masa të menjëhershme për kontabilizimin e vlerës së tokës truall nën administrim nga Universiteti duke bërë që llogaritë e aktiveve afatgjata materiale të paraqiten në vlerë të drejtë sipas kërkesave të teknikave kontabël.

**Menjëherë**

**22. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i aktiveve neto në llogarinë 105 “Teprica e granteve kapitale të brendshme” konstatohet se kjo llogari paraqitet me tepricë në mbyllje të periudhës ushtrimore e pandryshuar nga viti paraardhës, teprica e llogarisë 105 duhet të kapitalizohet brenda periudhës ushtrimore.

Nga auditimi i aktiveve neto në llogarinë 106 “Teprica e granteve kapitale të huaja” konstatohet se kjo llogari paraqitet me tepricë zero në mbyllje të periudhës ushtrimore ndërkohë që nga analizimi i llogarisë 512 “Mjete monetare në bankë” konstatohen teprica fondesh lidhur me projektet në proces.

Për sa më sipër këto veprime janë në kundërshtim me UMF nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësitë të qeverisjes së përgjithshme” aneksi 1, pika 1.1.2.c. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 47-69, Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**22.1 Rekomandimi:** Sektori i financës të marrë masa për të kryer sistemimet e nevojshme dhe regjistrimet në kontabilitet në bazë të klasifikimit ekonomik kontabël, për një pasqyrim më të drejtë të fondit neto.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**23. Gjetje nga auditimi** Nga auditimi seksionit të tretë të pasqyrës së Pozicionit Financiar F1 dhe pasqyrës së ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto F4 tepricat e llogarive nuk rakordojnë me njëra tjetrën. Gjithashtu, nga auditimi i pasqyrës së ndryshimeve në aktivet neto konstatohet se nuk është plotësuar sipas detajeve të tabelës duke mos ardhur qartë ndryshimet e ndodhura. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me Udhëzimi i MF nr.5, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në Udhëzimin e MF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 47-69, Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**23.1 Rekomandimi:** Sektori i financës të marrë masa të menjëhershme për të kryer sistemimet e nevojshme dhe regjistrimet e duhura me qëllim që pasqyrat e veçanta pjesë e pasqyrave financiare të rakordojnë me njëra tjetrën qofte në mënyrë analitike ashtu edhe sintetike dhe rezultati të pasqyrohet në pasqyrat financiare të vitit 2024.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**24. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i të ardhurave dytësore në Universitetin e Shkodrës u konstatua se, të ardhurat e Universitetit kontabilizohen në momentin e arkëtimit të tyre dhe kjo konkretisht për aktivitetin e Laboratorit të Diagnostifikimit Mikrobiologjik, i cili është pjesë e strukturës së Rektoratit dhe ka si funksion të tij: Kryerjen e analizave mikrobiologjike për individët dhe realizimin e të ardhurave në buxhetin e USH-së.

Arkëtimi i të ardhurave realizohet vetëm me ane të mandat arkëtimeve të cilat përpilohen nga punonjësit e laboratorit për shërbimin që kryejnë por që nuk kontabilizohen nga departamenti i financës. Totali i arkëtimeve ditore depozitohet nga bankat e nivelit të dytë në llogari të thesarit, dokument i cili kontabilizohet nga sektori i financës. Mos lëshimi dhe mungesa e faturës fiskale në momentin e furnizimit të mallrave ose shërbimeve, sjell mungesë të gjurmës së auditimit dhe është në kundërshtim me ligjin nr. 87/2019 “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit” neni 2 pika b). Mos lëshimi i dokumenteve fiskale sjell mos konstatimin e të ardhurave rrjedhimisht çon në mosnjohjen e këtyre të ardhurave në pasqyrat financiare, në kundërshtim me, Udhëzimin e MF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar pika 3, Mangësitë e konstatuara sipas kriterëve të mësipërme nuk përcaktojnë gjurmën e auditimit dhe sigurinë lidhur me dokumentimin e plotë të saktë dhe të drejtë të paraqitjes së tyre në pasqyrat financiare. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 49-75, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**24.1 Rekomandimi:** Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër/Sektori i financës të marrë masa të menjëhershme për tu pajisur me pajisje fiskale për lëshimin e faturave të fiskalizuara për të gjitha shërbimet e ofruara me qëllim konstatimin dhe pasqyrimin saktë të të ardhurave.

**Menjëherë**

**25. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i shpenzimeve për blerje mallra dhe shërbime konstatohet se në nënllogaritë e klasës 602, shpenzimet nuk janë kontabilizuar saktë duke denaturuar shpenzimin e kryer. Konkretisht në llogarinë 6021 “Materiale dhe shërbime speciale” konstatohen keq klasifikime shpenzimesh si “Likuidim Koktej për 7 Marsin”, në llogarinë 6020 “Materiale zyre dhe të përgjithshme”, konstatohen keq klasifikime si “Likuidim shërbime të tjera për aktivitetin e 7 Marsit”, ato duhet të kontabilizohen në llogarinë 6029 “Shpenzime të tjera operative”. Në llogarinë 6022 “Shërbime nga të tretë” konstatohen keq klasifikime shpenzimet për “Pagesa për komisionet zgjedhore”, “Pagesë tarife për doktoraturë”. Në llogarinë 6024 “Shpenzime udhëtimi” konstatohen shpenzime për dieta. Kontabilizimi i drejtë do të ishte në

llogarinë 6009 “Shpenzime të tjera për personelin”.Keq klasifikimet e konstatuara në nënlllogaritë e klasës 602 denatyrojnë shpenzimet e kryera dhe nuk na japin një pasqyrë të saktë dhe të drejtë të shpenzimeve të kryera. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 47-69, Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**25.1 Rekomandimi:** Sektori i financës të marrë masa në vijim për të kryer dhe pasqyruar saktë shpenzimet e kryera sipas rregullave kontabël, natyrës së shpenzimeve, klasifikimit të saktë të tyre me qëllim paraqitjen e drejtë në pasqyrat financiare.

#### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**26. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i llogarisë 6025 “Shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme” në shumën 21,025,252 lekë, konstatohet se në këtë llogari janë kontabilizuar tre urdhër shpenzime të cilat sipas procedurave të prokurimit dhe preventivave përfaqësojnë rikonstruksione të objekteve. Kontabilizimi në këtë llogari është keq klasifikim, klasifikimi i saktë do të ishte në llogarinë 212 “Ndërtesa e konstruksione”. Mos klasifikimi i duhur i këtyre transaksioneve i cili është investim sjell pasojën e mos llogaritjes së amortizimit dhe mosparaqitjes së saktë dhe të drejtë të pozicionit financiar, denatyrimit të shpenzimeve dhe aktiveve afatgjata. Nga auditimi i PBA këto shpenzime janë planifikuar si shpenzime mirëmbajtje te zakonshme. Nisur nga vlera dhe nga preventivi këto shpenzime përfaqësojnë rikonstruksion shtim vlere te aseteve. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me UMF nr 8 datë 09/03/2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësive e qeverisjes së përgjithshme. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 47-69, Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**26.1 Rekomandimi:** Sektori i financës të marrë masa të menjëhershme për të sistemuar dhe riklasifikuar saktë shumën e mësipërme sipas rregullave kontabel, dhe rezultati të pasqyrohet në pasqyrat financiare të vitit 2024.

#### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**27. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i detyrimeve të prapambetura konstatohet ne pasqyrat financiare te subjektit ato janë mbyllur me teprice zero, ndërkohë konstatohen detyrime te panjohura në shumën 2,890,800 lekë, shpenzime gjyqësore dhe shpenzime per blerje mallra. Shpenzimet për vendimet gjyqësore të formës së prerë, nuk janë njohur në kontabilitet sipas parimit të të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, duke mos u njohur si shpenzime periudhe në momentin e marrjes së formës së prerë të Vendimit të Gjykatës, por janë njohur në momentin e likuidimit ne shumen 370,800 lekë, vendim gjyqësor i cili ka marrë formë të prerë në datën 28.12.2022. Nga auditimi i urdhër-shpenzimeve, Subjekti ka inicuar urdhër-shpenzimin nr 01 date 29.12.2023 me shumë 2,520,000 lekë me përshkrim “Shlyerja e faturës 3443/2021 të PC S.”. Sipas dokumentacionit bashkëlidhur fatura me nr 3443/2021 date 04.10.2021 me NIVF: d8124bce-d99f-4b5b-933c-8c1c05c7e4c6 lëshuar nga PC S. shpk me Nipt L.....A ka ne artikuj te faturës “Printer B&Ë Advanc” ne sasi 50 cope cope me vlere totale te saj 2,520,000 leke.. Këto transaksione nuk janë të kontabilizuara dhe të njohura në momentin e konstatimit veprime në kundërshtim me UMF nr.5 datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e ministrit të financave dhe ekonomisë nr. 8 date 09/03/2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësive e qeverisjes së përgjithshme” pika 3. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 47-69, Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**27.1 Rekomandimi:** Sektori i financës të marrë masa për të njohur detyrimet për çështjet gjyqësore në momentin e marrjes formë të prerë të vendimit dhe jo në momentin e ekzekutimit të

vendimit. Gjithashtu të marrë masa për të njohur detyrimet që i lindin njësisë në momentin e lindjes së detyrimeve.

### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**28. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i inventarizimit të pronës shtetërore për vitin 2022 u konstatua se procesi i inventarizimit është bërë pjesor dhe nuk është përfunduar. Nga auditimi i inventarizimit të pronës shtetërore për vitin 2023 konstatohet se për procesin e inventarizimit ka dalë vetëm urdhri për “Krijimi i komisionit të inventarizimit dhe vlerësimit fizik të aktiveve”. Procesi i inventarizimit nuk është zhvilluar. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin Nr. 30 datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 47-69, Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**28.1 Rekomandimi:** Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodrës të marrë masa të menjëhershme për të kryer procesin e inventarizimit dhe rezultati të pasqyrohet në pasqyrat financiare të vitit 2024.

### **Menjëherë**

**29. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i Komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, mjedisit të kontrollit, konstatohet se në rregulloren e brendshme mungojnë përcaktimet e përgjegjësisë për kryerjen e raportimeve për aksesimin dhe përdorimin e sistemeve dhe platformave elektronike, nuk ka një rregullore të brendshme të përditësuar ku të jenë evidentuar delegimi i detyrave dhe mënyra e dokumentimit të tyre. Për periudhën objekt auditimi nuk janë kryer vlerësimet e punonjësve. Për vitin 2022 dhe 2023 nuk janë përgatitur dhe dërguar te NA, regjistri i riskut nga secila drejtori përkatëse.

Nga auditimi i funksionimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm për vitin 2022 dhe 2023 konstatohet se Universiteti i Shkodrës nuk ka takime të dokumentuara të veprimtarisë së GMS-së, i cili duhet të mbledhet të paktën 4 herë në vit. Konstatohet se GMS nuk ka realizuar përgjegjësinë e rishikimit jo më pak se dy herë në vit të regjistratit të riskut si dhe nuk ka të miratuar Gjurmë Auditimi, si një dokument të unifikuar për të gjitha proceset, në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 116-125, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**29.1 Rekomandimi:** Titullari i Universitetit “Luigj Gurakuqi” të marrë masa të menjëhershme për ndryshimin dhe përshtatjen e rregullores së brendshme sipas përcaktimeve dhe elementeve për kryerjen e detyrave dhe pozicioneve të punës; të bëhen vlerësimet periodike të punonjësve; të përditësohet regjistri i riskut dhe të dokumentohen regjistrat e riskut nga secila drejtori; të realizohen dhe dokumentohen mbledhjet e GMS si dhe gjurma e auditimit.

### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**30. Gjetje nga auditimi:** Grupit të auditimit gjatë fazës së përgatitjes së projekt raportit të auditimit iu paraqit ankesa “*kërkesë për interpretim*” të VKM Nr.997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit” ardhur në e-mail e KLSH me datë 23.01.2025.

Grupi i auditimit pasi mori në shqyrtim ankesën, arriti në konkluzion se në lidhje me ankesën e kryer nga z. D. U, Universiteti i Shkodrës i ka të gjithë strukturat dhe mekanizmat për të qartësuar çështjen, si dhe për ti kthyer përgjigje korrekte dhe në kohë z. D.U. Mos kthimi i përgjigjes për ankesën e kryer është në kundërshtim me Ligji Nr. 119/2014 “Për Të Drejtën e Informimit” neni 3 pika 1 dhe 2. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, faqe 125-128, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**30.1 Rekomandimi:** Administratori, Sektori i Financës dhe Njësia e Auditimit të Brendshëm të mare masa dhe të shqyrtojnë ankesën e z. D.U, duke siguruar një trajtim të plotë dhe të bazuar në ligj, për të garantuar transparencë dhe një përgjigje në kohë.

**Menjëherë**

## **B. MASA SHPËRBLIM DËMI**

Bazuar në ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15, geramat b) dhe c) “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së” dhe mbështetur në nenet 98-102 të ligjit nr. 44, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, pikën 93 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, nga ana e Titullarit të njësisë publike Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit, në mënyrë të menjëhershme për të shmangur tejkalimin e afateve dhe parashkrimin e të drejtës për të kërkuar shumën monetare gjyqësish, si dhe të ndiqet procesi, me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **4,450,893** lekë si më poshtë:

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi me përzgjedhje i dokumentacionit për shpenzimet mbi pagesat për orët jashtë orarit zyrtar për periudhën objekt auditimi, u konstatua se në janar të vitit 2024 janë paguar 13 punonjës në vlerën **830,299 lekë**. Urdhri i administratorit për pagesën për orët jashtë orarit zyrtar është mbas faktit, pasi dhe në shkresën me nr. 4005/1 datë 12.12.2023 nuk është cituar se grupi i punës do të punojë jashtë orarit zyrtar te punës.

Gjithashtu dhe tek listë prezenca e dhjetorit me nr. 9/5 prot., datë 10.01.2024 rezultoi se punonjësit nuk kanë punuar jashtë orarit zyrtarë të punës.

Për muajin mars të vitit 2024 janë paguar 5 punonjës me orë jashtë orarit zyrtar në vlerën **250,330 lekë**. Grupi i auditimit konstatoi se në shkresën me nr. 715 prot., datë 27.02.2024 për ngritjen e grupit të punës nuk është specifikuar se kur do të punojë jashtë orarit zyrtar grupi i punës. Ndërkohë tek listë- prezenca e muajt mars me nr. 1106/8 prot., datë 02.04.2024 rezulton se punonjësit nuk kanë punuar jashtë orarit zyrtar të punës pasi në ditët pushim zyrtar siç është e shtuna dhe e diela, prezenca është shënuar me (P) pushim.

Gjithashtu nuk ka një relacion ku të specifikohet numri i orëve dhe data në të cilën kanë punuar jashtë orarit zyrtar, por është vetëm urdhri për pagesë të orëve jashtë orarit dhe shumat totale pa i cilësuar sa orë ka punuar gjithsecili. Për muajin prill të vitit 2024 janë paguar 12 punonjës me orë jashtë orarit zyrtar në vlerën **105,760 lekë**.

Grupi i auditimit konstatoi se nuk ka kërkesë të eprorit të drejtpërdrejtë dhe miratim të titullarit të institucionit për punonjësit që kanë punuar orë shtesë, por urdhri i administratorit për pagesën për orët jashtë orarit zyrtar është mbas faktit. Veprime në kundërshtim me VKM nr. 568, datë 06.10.2021 “Për miratimin e rregullave për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit, orët shtesë dhe kompensimin e tyre në institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore” pika 7, pika 8, pika 11. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 32-41, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**1.1 Rekomandimi:** Nga Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër, të kërkohet në rrugë ligjore arkëtimi i vlerës prej **1,186,389 lekë** i përfituar padrejtësisht, për pagesat e orëve jashtë orarit zyrtar të punës, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit.

**Menjëherë**

**2. Gjetje nga auditimi:** Procedura e prokurimit me objekt “Blerje për Laboratorin e Analizave të Ushqimeve”. Kontrata midis AK dhe OE është lidhur me nr., 2526/14 prot, datë 06.10.2022 dhe afati për shërbimin është 60 ditë nga nënshkrimi i kontratës ose deri me datë 05.12.2022. AK ka lidhur shtesë kontratë me nr., 2526/21 datë 06.12.2022 me afat deri me datë 31.12.2022. Ndërkohë që shtesa e kontratës është lidhur me datë 06.12.2022 kur ka përfunduar kontrata e parë, por çdo ndryshim kontratë mund të bëhet vetëm gjatë kohëzgjatjes së tyre.

Me datë 06.12.2024 janë marrë në dorëzim pajisjet (procesverbali nr.,2) ose 1 ditë me vonesë dhe penaliteti është në vlerën **18,938** lekë me TVSh.

Me datë 30.12.2022 është marrë në dorëzim pjesa e mbetur e pajisjeve ose 24 ditë me vonesë dhe penaliteti është në vlerën **431,009** lekë me TVSh.

Në total penaliteti është 18,938 lekë + 431,009 lekë = **449,947** lekë me TVSh.

Veprime në kundërshtim me LPP nr. 162, datë 23.12.2020, i ndryshuar, si dhe VKM-së Nr. 285, datë 19.5.2021 i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 69-109, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**2.1 Rekomandimi:** Autoriteti Kontraktor Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjyqimit, arkëtimin e vlerës **449,947 lekë** nga OE “P” shpk si kamatëvonesa për tejkalim të afatit të dorëzimit të pajisjeve.

**Menjëherë**

**3. Gjetje nga auditimi:** Procedura e prokurimit me objekt “Blerje pajisje për laboratorin klinik - biokimik”, AK ka lidhur kontrate me nr. 916 prot., datë 06.03.2024 dhe afati për dorëzimin e mallit është 30 ditë pune nga nënshkrimi i kontratës. AK ka nënshkruar kontratë shtesë me nr., 916/8 datë 05.04.2024, ku është shtyrë afati i saj me 14 ditë. Tek neni 3 i kontratës “Afati i kontratës” citohet: kontrata do të realizohet për 30 ditë pune nga nënshkrimi i saj nga palët. Përcaktimi i afatit 30 dite pune është në kundërshtim me LPP nr. 162 dt. 23.12.2020 neni 56 pika 5 si dhe VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 neni 7. Grupi i auditimit konstatoi se kohëzgjatja e kontratës sipas përcaktimeve të sipër cituar me ditë kalendarike është deri me datë 19.04.2024. Gjithashtu konstatohet se kohëzgjatja e kontratës dhe e shtesës së saj me ditë **kalendarike** është deri me datë 19.04.2024. Ndërkohë që me datë 25.04.2024 janë marrë në dorëzim pajisjet, ose 5 ditë me vonesë. Diferenca midis vlerës totale dhe shumës së marrë në dorëzim është 5,925,600 lekë me TVSh (7,635,600 vlera totale e kontratës - 1,710,000 marrë në dorëzim = 5,925,600 lekë).  $4/1000 \times 5,925,600 = 23,702$  lekë me TVSh penaliteti ditor.  $23,702 \text{ lekë me TVSh} \times 5 \text{ ditë} = \mathbf{118,512 \text{ lekë me TVSh}}$  i cili është penaliteti për 5 ditë vonesë. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 69-109, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**3.1 Rekomandimi:** Drejtorja e Financës dhe Buxhetit, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjyqimit, arkëtimin e vlerës **118,512 lekë** nga Administratori z. A. U për lidhjen e kontratës me ditë pune dhe jo kalendarike duke shkaktuar kamatëvonesa për tejkalim të afatit të dorëzimit të pajisjeve.

**Menjëherë**

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga shqyrtimi i dokumentacionit për zbatimin e kontratës me objekt: “Investim për ndriçim të objekteve dhe tabelave emërtuese të ndërtesave” me nr.2436/28 prot., datë 26.11.2023, lidhur midis Universitetit “Luigj Gurakuqi”, Shkodër dhe OE “N” Shpk. rezultuan disa pasaktësi si më poshtë vijon:

-Për këtë objekt në vitin 2021 është prokuruar një projekt: “Ndriçim të objekteve dhe tabelave emërtuese të ndërtesave të Universitetit “Luigj Gurakuqi” në vlerën 213,456 lekë me TVSh. Pas dy vitesh me anë të një urdhri për prokurim me vlerë të vogël me nr.16 më datë 16.06.2023 është kërkuar rishikim i projektit ekzistues dhe është realizuar një projekt i ri: “Rishikim për efekt aktualizimi i pjesës që lidhet me ndriçimin e jashtëm në projektin “ndriçim të objekteve dhe tabelave emërtuese të ndërtesave të Universitetit “Luigj Gurakuqi”. (Shtojcë) në vlerën 118,200 lekë me TVSh. Ky ndryshim i projektit fillestar është propozuar nga Senati i Universitetit Shkodrës dhe miratuar nga bordi i administrimit, me vendimin me nr.83 datë 28.03.2023 dhe futur me një zë të veçantë në buxhet “Rishikim i projektit për ndriçimin e ndërtesave të Universitetit “Luigj Gurakuqi”, ndërkohë që nuk argumentohet nevoja për ndryshimin e projektit fillestar. Gjithashtu personat që kanë miratuar këtë ndryshim nuk kanë arsimin dhe kualifikimin përkatës.

Më pas ky projekt është tenderuar për zbatimin e punimeve. Ky veprim ka sjellë shpërdorimin e fondeve, pasi janë realizuar dy projekte për të njëjtin qëllim, duke vepruar në kundërshtim me ligjin për prokurim publik nr.162 datë 23.12.2020 dhe ligjin Nr. 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", ligjin Nr. 10431 "Për Mbrojtjen e Mjedisit", Vendimet dhe udhëzimet e Këshillit të Ministrave dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë. Vlera 93,456 lekë me TVSh (213,456 lekë -120,000 lekë) përben dëm ekonomik.

- Nga verifikimi i dokumentacionit tekniko-ligjor në dosjen zbatimit, u vu re se mungojnë disa dokumente teknike: certifikatat dhe skeda teknike për materialet e përdorura, miratimi i tyre, prova teknike e sistemit të ndriçimit me ngarkesë, skica dhe vizatime teknike për librezat e masave.

-Nga verifikimi në terren rezultoi se një sërë zërash pune janë gjendur në sasi më të vogël sesa janë raportuar në situacionin përfundimtar, duke krijuar diferencë midis punimeve faktike dhe ato të raportuara në situacionin përfundimtar në vlerën **1,677,708** lekë pa TVSh.

-Përveç këtyre në objekt u konstatua në fakultetin e Shkencave të Natyrës dhe të Drejtësisë një pjesë e ndriçimit të jashtëm ishte djegur dhe fasada nuk është e ndriçuar. Konkretisht për këto zëra: Fasada (1) kemi 8 shirita led te djegur

8 copë Shirita led 7Ë/ml x 18.1 ml = 144.8 ml x 250 lekë/ml = 36,200 lekë

Fasada (4) kemi 5 shirita led te djegur

5 copë Shirita led 7Ë/ml x 18.1 ml = 90.5 ml x 250 lekë/ml = 22,625 lekë

Vlera prej **58,825** lekë pa TVSh ( 36,200 lekë+22,625 lekë) përbën punime faktike të raportuara në situacionin përfundimtar, por të realizuara pa cilësi me difekte dhe ende të pariparuara nga ana e kontraktorit. Për sa më sipër, mbikqyrësi i punimeve OE “S” Shpk”, nuk ka zbatuar rigorozisht përcaktimet ligjore dhe kontraktuale të bëra në Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998, “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit” i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe udhëzimin nr.2 datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit” dhe nr.3 datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”.

-Nga kontrolli i dosjes tekniko ligjore rezulton se bazuar në kontratën e kolaudimit me nr., 1926/29 prot, datë 18.12.2024 me afat kolaudimi 10 ditë nga nënshkrimi i saj, nuk është bërë kolaudimi i objektit. nuk janë korrigjuar punimet me difekte si dhe nuk janë plotësuar sasisë e gjetura me mangësi.

Vlera totale **1,736,533** lekë pa TVSh (1,677,708 lekë + 58,825 lekë) përbën dëm në buxhetin e USHLG. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5.1, faqe 109-116, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**4.1 Rekomandimi:** Autoriteti Kontraktor Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër, të marrë masa që në likuidimin e situacionit përfundimtar të paraqitur nga OE “N” sh.p.k të zbres vlerën **1,736,533** lekë që përbën dëm, për punime të pa realizuara dhe të kryera me defekt.

**Menjëherë**

**4.2 Rekomandimi:** Titullari i Autoritetit Kontraktor Universitetit “Luigj Gurakuqi” Shkodër, të marrë masa për ngritjen e një grupi pune për të evidentuar shkaqet dhe personat përgjegjës, që kanë sjellë shkaktimin e dëmit ekonomik në vlerën **93,456 lekë me TVSh**. Autoriteti Kontraktor Universiteti i Shkodrës, Luigj Gurakuqi duhet të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, masa për arkëtimin e vlerës së mësipërme.

**Menjëherë**

**5. Gjetje nga auditimi:** Nga ana e grupit të auditimit u krye shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për zbatimin e kontratës me objekt: *“Rikonstruksion çatia FSHE”*, me nr.1030/2 prot., datë 25.03.2024, lidhur midis Universitetit “Luigj Gurakuqi”, Shkodër dhe Operatorit Ekonomik OE “L” Shpk. Vlera e kontratës është 11,418,326 lekë me TVSh. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 4 (katër) muaj nga data e fillimit të punimeve. Nga verifikimi i situacioneve të punimeve, librezës së masave dhe verifikimit të dokumentacionit tekniko-ligjor dhe kontrollit në terren, rezultuan disa pasaktësi si më poshtë vijon:

-Nga verifikimet e dokumentacionit teknik në dosjen e zbatimit, rezultoi se mungojnë disa dokumente teknike, ndër më kryesorët mund të përmendim: certifikatat dhe skeda teknike për materialet e përdorura, miratimi i tyre, skica dhe vizatime teknike për çdo zë pune në librezat e masave etj. Nga verifikimi i pagesës në situacionin përfundimtar, librezës së masave dhe verifikimit në terren, u konstatuan disa parregullsi dhe mangësi si më poshtë vijon:

-Zëri punës me nr. analize 2.209/b *“Ulluk vertikal me bakër Ø120mm”* është i raportuar në situacionin përfundimtar 80 ml, ndërsa në terren u gjet se ky zë nuk ishte realizuar me bakër sipas preventivit, por ulluqet ishin realizuar me llamarinë të lyer me ngjyrë të ngjashme me bakrin. Vendosija e ulluqeve prej llamarine do të ulte jetëgjatësinë e tyre për shkak të ndryshkjes së llamarinës nga faktorët e jashtëm atmosferik, rrjedhimisht mosvënia e ulluqeve të bakrit përbën shkelje kundrejt projektit të zbatimit dhe preventivit me efekt financiar 520,000 lekë pa TVSh.

-Zëri punës me nr. analize 2.431 *“Skela metalike me standarde sigurie ne pune, për punimet ne fasade, riparime suvatimi, bojatisje, ulluqe, etj. për një periudhe 2 muaj”* i raportuar në situacionin përfundimtar 1,292 m<sup>2</sup> ndërsa sipas projekt preventivit fillestar kjo sasi ishte e parashikuar nga ana e projektuesit në sasinë 640 m<sup>2</sup>. Rritja e kësaj sasive me dyfishin e sasisë fillestare është e pajustificuar, sepse projektuesi e ka parashikuar vendosjen e skelës në një faqe të objektit pastaj pasi të mbarohen punimet në njëërën faqe do kalohej me instalimin e skelës në faqet e tjera të objektit, gjithashtu nuk ka fakte dhe prova shtesë për pretendimet e sjella në observacion. Diferenca prej 1,292 m<sup>2</sup> – 640 m<sup>2</sup> = 652 m<sup>2</sup> x 300 lekë/m<sup>2</sup> = 195,600 lekë; përbën dem ekonomik në vlerën **195,600 lekë pa TVSh**.

-Zëri punës me nr. analize 2.196-An *“Heqje karton katrama tek ulluqet horizontale ne çati, pjesa qe riparohet dhe largim mbeturinash”* është i raportuar në situacionin përfundimtar 454 m<sup>2</sup>, ndërsa nëse shohim llogaritjet e paraqitura në librezën e masave për këtë zë pune, vihet re se në këtë zë pune është përfshirë gabimisht edhe heqja e karton katramasë sipër shtresës së dërrasës në kundërshtim me përmbajtjen e zërit të mësipërm në sasinë 320 m<sup>2</sup>. Diferenca prej 320 m<sup>2</sup> x 100 lekë/m<sup>2</sup> = 32,000 lekë; ; përbën dem ekonomik në vlerën **32,000 lekë pa TVSh**.

-Zëri punës me nr. analize 2.37/5b *“Transport material ndërtimi deri 10 km”* i raportuar në situacionin përfundimtar 85 m<sup>3</sup> ndërsa nëse shohim librezën e masave disa zëra e kanë të përfshirë transportin. Diferenca prej sasisë së raportuar në situacionit përfundimtar dhe sasisë së llogaritur në mënyrë korrekte: 85 m<sup>3</sup> - 48.52 m<sup>3</sup> = 36.74 m<sup>3</sup> x 700 lekë/m<sup>3</sup> ka efektin **25,718 lekë pa TVSh**.

-Zëri punës me nr. analize 2.297/a *“F .V. Tavan i sheshte me KNAUF-Gips me konstruksion metalik me pllaka te bardhe, përfshihen pllake gipsi tip A13-GKB 12.5mm dhe te gjithë aksesoret e tjerë, sipas detajit te fletës se projektit, ose detajit te miratuar gjatë zbatimit. Referenca e produkteve sipas KNAUF, ose e ngjashme ne specifikime teknike me te”* i raportuar në situacionin

përfundimtar 293 m<sup>2</sup> ndërsa sipas librezave të masave kësaj sipërfaqe duhej ti ishin zbritur 36 copë ndriçues plafonier me përmasa 60x60cm, diferenca prej 12.96 m<sup>2</sup> x 1,800 lekë/m<sup>2</sup> dhe ka efektin financiar 23,328 lekë pa TVSh.

-Zëri punës me nr. analize 2.490/h “F.V Kasetë plastike KE me 54 module (vende)” i raportuar në situacionin përfundimtar 1 copë ndërsa në terren u gjet kuti ishte vendosur më e vogël 36 module (vende); kuti e cila nuk mund të mbaj sasinë e automatëve të parashikuar në preventivit, diferenca prej 1 copë do të ketë efektin financiar 5,000 lekë pa TVSh.

-Zëri punës me nr. analize 1. “Furnizim ndriçues plafonier/hermetik 60x60 led/40ë 4000K” i raportuar në situacionin përfundimtar 43 copë ndërsa në terren u gjetën në sasi më të vogël 36 copë, diferenca prej 7 copë x 2500 lekë/copë do të ketë efektin financiar 17,500 lekë pa TVSh.

-Zëri punës me nr. analize 2.a-73 “F.V Elektroda tokëzimi 5x5x0.5 L=150” i raportuar në situacionin përfundimtar 16 copë ndërsa në terren u gjetën në sasi më të vogël 4 copë, diferenca prej 12 copë x 1000 lekë/copë do të ketë efektin financiar 12,000 lekë pa TVSh.

-Zëri punës me nr. analize An.60(P) “F.V Shtize e rrufepritësit ne çati L=100 D=160 mm i raportuar në situacionin përfundimtar 13 copë ndërsa në terren u gjetën me gjatësi më të vogël se 1 m; diferenca prej 13 copë x 700 lekë/copë do të ketë efektin financiar 9,100 lekë pa TVSh.

-Zëri punës me nr. analize 2.a-73 “F.V. Automat 2P/2M-20A/6-C magnetik termik” i raportuar në situacionin përfundimtar 9 copë ndërsa në terren u gjetën në sasi më të vogël 4 copë, diferenca prej 5 copë x 2000 lekë/copë do të ketë efektin financiar 10,000 lekë pa TVSh.

-Zëri punës me nr. analize 2.a-73 “F.V. Automat IP+N-10A/6-C magnetik termik” i raportuar në situacionin përfundimtar 9 copë ndërsa në terren u gjetën në sasi më të vogël 4 copë, diferenca prej 5 copë x 650 lekë/copë do të ketë efektin financiar 3,250 lekë pa TVSh.

-Zëri punës me nr. analize An 53(p) “F.V Sensor tymi ZEOS-C-S + baze ZEOS-D/konvencional” i raportuar në situacionin përfundimtar 16 copë ndërsa në terren u gjetën në sasi më të vogël 15 copë, diferenca prej 1 copë x 3,060 lekë/copë do të ketë efektin financiar 3,060 lekë pa TVSh.

-Zëri punës me nr. analize An 57 (P) “F.V Ndriçues evakuim EXIT me llamp led 1x11ë IP40” i raportuar në situacionin përfundimtar 6 copë ndërsa në terren u gjetën në sasi më të vogël 5 copë, diferenca prej 1 copë x 2000 lekë/copë do të ketë efektin financiar 2,000 lekë pa TVSh.

Vlera totale 866,056 lekë pa TVSh do të konsiderohet si dëm ekonomik për shkak të llogaritjeve të gabuara, punimeve të pakryera dhe të pajustificuara teknikisht dhe jo sipas punimeve faktike.

Për sa më sipër, mbikqyrësi i punimeve OE “M Ch” Shpk dhe p.f B. Y.; me përfaqësues të palëve z. B. Y. në kundërshtim me kontratën e zbatimit të punimeve nuk ka zbatuar rigorozisht përcaktimet ligjore dhe kontraktuale të bëra në Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5.1, faqe 109-116, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**5.1 Rekomandimi:** Autoriteti Kontraktor Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër, të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, masën për arkëtimin e vlerës prej **866,056 lekë pa TVSh**, nga operatori ekonomik i kontraktuar “L” sh.p.k, për punime të likuiduara, por të pa realizuara.

**Menjëherë**

## **C. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE**

**1. Gjetje nga auditimi:** Me vendimin nr. 83, datë 28.03.2023, të Bordit të Administrimit, është miratuar buxheti për vitin 2023, përfshirë zërin buxhetor “shërbime rrjeti RASH”. Pajesa për këtë

shërbim, në vlerën 3,119,760 lekë, është realizuar nga Administratori dhe nëpunësi zbatues me urdhër-shpenzimet nr. 16, datë 26.01.2024, për “shërbimin e rrjetit”. Kjo pagesë është kryer në kundërshtim me parashikimet ligjore, pasi është bërë pa një vendimmarrje nga organi kompetent, duke shkelur vendimin nr. 88, datë 14.02.2018, “Për krijimin e Qendrës Ndërinstitucionale të Rrjetit Akademik Shqiptar”, me të cilin është themeluar RASH dhe janë përcaktuar kompetencat e saj. Për më tepër, Bordi Drejtues i RASH, me vendimin nr. 49, datë 03.07.2020, ka miratuar në tejkallim të kompetencave të tij tarifën për shërbimin, çka bie ndesh me dispozitat e Akt-Marrëveshjes “Për krijimin e Qendrës Ndërinstitucionale të Rrjetit Akademik Shqiptar”. Konkretisht:

- Sipas nenit 8, pika 2, germa “d”, është Asambleja e Anëtarësisë ajo që miraton tarifën e përdorimit të shërbimeve të përbashkëta dhe kontributin vjetor të anëtarësisë.
- Ndërsa neni 10, pika 1, germa “h” i njeh Bordit Drejtues vetëm kompetencën për propozimin e tarifave, jo miratimin e tyre. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 32-41, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**1.1 Rekomandimi:** Administratori i Universitetit “Luigj Gurakuqi” Shkodër, në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse, të marrë masat për;

- Të ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme, që nga paraqitja e propozimeve për Asamblesë e RASH dhe rakordimin përfundimtar të detyrimeve me këtë Institucion, bazuar në vendimmarrjen e Asamblesë së RASH-it.
- Ngritjen e një grupi pune për të evidentuar vlerën e përdorimit pa eficiencë të buxhetit të shtetit për pagesën e likuiduar për RASH me urdhër shpenzimet në masën totale **3,119,760 lekë**, duke nxjerrë përgjegjësinë për personat përgjegjës.

#### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i 16 urdhër shpenzimeve, grupi i auditimit konstatoi se blerja e biletave të transportit ajror ndërkombëtar me vlerë **811,058** lekë, nuk është zhvilluar me procedurën e prokurimit publik, në kundërshtim me Ligjin nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” neni 54 pika 1, VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit Publik” neni 68, pika 9 dhe me udhëzimin nr. 03 datë 18.06.2021 “Mbi përdorimin e sistemit dinamik për blerjen e biletave të transport ajror ndërkombëtare dhe zhvillimin me mjete elektronike”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 32-41, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**2.1. Rekomandimi:** Administratori i Universitetit “Luigj Gurakuqi” Shkodër, të marrë masa për ngritjen e një grupi pune për të evidentuar shkaqet dhe personat përgjegjës, që kanë sjellë përdorimin pa eficiencë të buxhetit të shtetit në vlerë totale **811,058** lekë mbi pagesën e transportit ajror ndërkombëtar të zhvilluar pa procedurë prokurimi.

#### **Menjëherë**

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i kartelave të karburantit për periudhën objekt auditimit u konstatua se me autorizim të administratorit, punonjës të USHLG tërhiqnin karburant për arsye pune si dhe lëviznin me makinat e tyre personale, në vlerën 221,113 lekë.

Gjithashtu dhe tek dietat brenda vendit janë paguar shpenzime karburanti në vlerën 34,600 lekë, por pa dokument justifikues për shpenzimin e kryer (kuponët tatimor).

Vlera prej **255,713** lekë është përdorur pa ekonomikitet në kundërshtim me VKM nr. 977, datë 10.12.2010, “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit” i ndryshuar, në të cilën përcaktohet mënyra e rimbursimit të shpenzimeve të transportit sipas dokumentacionit tatimor (biletës së udhëtimit) sipas tarifave përkatëse dhe distancës kilometrike të linjave të miratuara me Vendimin nr. 146, datë 26.02.1998, “Për tarifën e

transportit të udhëtarëve”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 32-41, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**3.1. Rekomandimi:** Administratori i Universitetit “Luigj Gurakuqi”, Shkodër, të marrë masa për ngritjen e një grupi pune për të evidentuar shkaqet dhe personat përgjegjës, që kanë sjellë përdorimin pa ekonomikitet të buxhetit të institucionit në vlerën **255,713** lekë për konsumin e karburantit.

**Menjëherë**

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se duke filluar nga janari i vitit 2022 deri në mars të vitit 2023 pagesat e stafit me detyrë përgjegjës sektori në rektorat, janë realizuar në kundërshtim me parashikimet ligjore të VKM nr. 187 datë 08.03.2017 “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në Kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e Presidentit, Kuvendit, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Gjykatën e Lartë, Prokurorinë e Përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të Kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e Prefektit”, i ndryshuar, lidhja nr.7, e cila ka përcaktuar kategorinë IV-a “përgjegjës sektori në rektorat”, ndërsa vendimmarrja e Bordit ka përcaktuar kategorinë III-b me vendimin e BA-së nr.59 datë 12.01.2021. Vendimmarrja është në tejkalim të kompetencave pasi kategoria ishte shprehimisht e përcaktuar në VKM. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 20-32, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**4.1. Rekomandimi:** Administratori i Universitetit “Luigj Gurakuqi” Shkodër, të marrë masa për ngritjen e një grupi pune për të evidentuar shkaqet dhe personat përgjegjës, që kanë sjellë përdorimin pa ekonomikitetit të buxhetit të institucionit në vlerën **1,442,651** lekë në trajtimin me pagë për kategorinë “Përgjegjës Sektori në Rektorat”.

**Menjëherë**

**5. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi konstatohet se sekretare e Bordit të Administrimit është znj. S. B, pa qenë anëtare e tij, Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 8480 datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” neni 2, pika 1. Me vendimin nr. 16, datë 13.01.2023 “Për pagesën për sekretaren e Bordit të Administrimit të USH-së”, është vendosur miratimi i pagesës shtesë mbi pagën normale për detyrën si sekretare e BA me një vlerë prej 15,000 lekë në muaj. Në vendim shprehet se, ky vendim i shtrin efektet financiare që nga data e konsolidimit të BA datë 16.11.2021, edhe pse në këtë vendim nuk shprehet që sekretare për BA do të jetë znj. S. B. Në bazë të këtij vendimi nga ana USH është kryer pagesa për sekretaren e BA për çdo mbledhje që ajo ka qenë e pranishme. Kjo pagesë nuk duhet të ishte kryer për shkak se znj. B nuk është anëtare e BA siç edhe ligji e parashikon. Ky veprim ka sjellë një efekt financiar negativ për buxhetin e USH në masën 480,000 lekë.

Gjithashtu Bordi i Administrimit të Universitetit të Shkodrës me vendim nr.75 datë 10.03.2023 “Për miratimin e trajtimit të veçantë financiar të komisioneve të veçanta të USH-së” ka miratuar shpërblime për anëtarët e këshillit të etikës me 10,000 lekë për çdo mbledhje deri në 6 mbledhje në vit dhe për anëtarët e komisionit të përhershëm për garantimin e standardeve dhe cilësisë së USH-së me 10,000 lekë për çdo mbledhje deri në 4 mbledhje në vit. Nga grupi i auditimit është konstatuar se ka një mospërputhje ligjore me përcaktimet e VKM-së nr.656 datë 31.10.2018 “Për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave, bordeve ose komisioneve të përhershme të njëjësive të qeverisjes qendrore” i ndryshuar, (me VKM nr. 559 datë 31.07.2019 e VKM nr.612 datë 29.07.2020), pika 5 ku specifikohet vetëm pagesa e Senatit Akademik dhe Bordit

të Administrimit “Kufiri maksimal i shpërblimit të anëtarëve në Senatën Akademik dhe Bordin e Administrimit në IAL është 25,000 (njëzet e pesë mijë) lekë në muaj”.

Nga auditimi u konstatua se me anë të një shkrese nga ana e anëtarëve të komisionit të etikës me nr. 123 Prot., datë 12.04.2023 drejtuar administratorit dhe drejtorisë së financës, me anë të një relacioni të përgatitur prej tyre, ju kërkohet që të marrin pagesën edhe për mbledhjet që janë zhvilluar më përpara se të merrej vendimi i BA, kur në vendimin e BA nuk shprehet se ky vendim ka dhe fuqi prapavepruese. Ky veprim ka sjellë një efekt financiar negativ për buxhetin e USH në vlerën 650,000 lekë.

Nga auditimi u konstatua se referuar të dhënave të ardhura nga financa e USH LG, komisioni i përhershëm për garantimin e standardeve dhe cilësisë në USH është paguar në kundërshtim me VKM, veprim ky që ka sjellë një efekt financiar negativ për buxhetin e USH në vlerën 220,000 lekë (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 20-32, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**5.1 Rekomandimi:** Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër, të marrë masa për ngritjen e një grupi pune për të evidentuar shkaqet dhe personat përgjegjës, që kanë sjellë përdorimin pa eficiencë në buxhetin e institucionit, në vlerën **1,350,000** lekë, për pagesat e përfituar nga sekretarja e Bordit të Administrimit, komisioni i etikës dhe komisioni i përhershëm për garantimin e standardeve dhe cilësisë, në kundërshtim me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

**Menjëherë**

**6. Gjetje nga auditimi:** Procedura e prokurimit me objekt “Shpenzime Pritje përcjellje”.

Me urdhër nr., 2984/20 datë 26.12.2023 është ngritur komisioni për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës.

**1.** Me procesverbal me nr., 2984/23 prot., datë 27.12.2023 komisioni për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës për aktivitetin “Shkencëtarët në mesin tonë” konstatoi se shërbimi është konform specifikimeve të përcaktuara dhe është në vlerën 200,772 me TVSh. Tek shënimet e faturës tatimore citohet: “Aktiviteti Shkencëtarët në mesin tonë datë 22.12.2023”

**2.** Me procesverbal me nr., 2984/27 prot., datë 28.12.2023 komisioni për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës për aktivitetin “Vlerësimi i situatës ekologjike të ujërave në rajonin e Shkodrës, edukimi në terren nëntor 2023” konstatoi se shërbimi është konform specifikimeve të përcaktuara dhe është në vlerën 36,288 me TVSh. Aktiviteti është zhvilluar në datë 21.12.2023 dhe është publikuar dhe në faqen e USH.

**3.** Me proces-verbal me nr., 2984/24 prot., datë 27.12.2023 komisioni për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës për aktivitetin “Trashëgimia jone kulturore-mbrojmë të kaluarën për të ardhmen” konstatoi se shërbimi është konform specifikimeve të përcaktuara dhe është në vlerën 20,160 me TVSh. Aktiviteti është zhvilluar me datë 20.12.2023 dhe është i publikuar dhe në faqen e USH.

**4.** Me procesverbal me nr., 2984/22 prot datë 27.12.2023 komisioni për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës për aktivitetin “Leonardo de Martini” konstatoi se shërbimi është konform specifikimeve të përcaktuara dhe është në vlerën 65,772 me TVSh.

Fatura tatimore është paraqitur nga OE me nr., 164/2023, datë 27.12.2023 ndërsa likuidimi i faturës është kryer me urdhër shpenzim nr., 571 datë 29.12.2023 në vlerën **65,722 lekë**.

Tek shënimet e faturës tatimore citohet : “Aktiviteti Leonardo de Martini datë 15.12.2023”.

**5.** Me procesverbal me nr., 2984/21 prot datë 27.12.2023 komisioni për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës për aktivitetin “Praktikat në terren gjatë viteve” konstatoi se shërbimi është konform specifikimeve të përcaktuara dhe është në vlerën 20,160 me TVSh.

Aktiviteti është zhvilluar me datë 22.12.2023 dhe është i publikuar dhe në faqen e USH.

**6.** Me procesverbal me nr., 2984/25 prot datë 27.12.2023 komisioni për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës për aktivitetin “Udhëtimi ndër breza” konstatoi se shërbimi është konform specifikimeve të përcaktuara dhe është në vlerën 398,160 me TVSh.

Tek shënimet e faturës tatimore citohet: “aktiviteti Udhëtimi ndër breza datë 18.12.2023”.

7. Me procesverbal me nr., 2984/26 prot., datë 27.12.2023 komisioni për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës për aktivitetin “zhvillimi Rural” konstatoi se shërbimi është konform specifikimeve të përcaktuara dhe është në vlerën 398,160 me TVSh. Aktiviteti nuk është i publikuar në faqen e USH.

Komisioni i zbatimit të kontratës ka mbajtur procesverbale me datë 27 - 28.12.2023 mbi kryerjen e aktiviteteve, por aktivitet janë kryer përpara procesverbaleve të mbajtura nga komisioni si dhe përpara ngritjes së urdhrimit për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës. Gjithashtu nuk kishte gjurmë auditimi në dosjen përkatëse për të vërtetuar dhe siguruar AK që aktivitetet janë kryer konform kriterëve të vendosura në kontratë. Veprime në kundërshtim me udhëzim nr. 30 datë 27.12.2011 “për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik pika 42 dhe 43. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 69-109, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**6.1. Rekomandimi:** Administratori i Universitetit “Luigj Gurakuqi” Shkodër, të marrë masa për ngritjen e një grupi pune për të evidentuar shkaqet dhe personat përgjegjës, që kanë sjellë përdorimin pa efikasitet të buxhetit të USHLG në vlerën **741,262** lekë, për ngritjen e komisionit të zbatimit të kontratës si dhe mbajtjen e procesverbaleve nga komisioni mbas zhvillimit të aktiviteteve.

**Menjëherë**

**7. Gjetje nga auditimi:** Nga grupit të auditimit u krye shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për zbatimin e kontratës me objekt: “Investim për ndriçim të objekteve dhe tabelave emërtuese të ndërtesave” me nr.2436/28 prot., datë 26.11.2023, lidhur midis Universitetit Luigj Gurakuqi, Shkodër dhe Operatorit Ekonomik OE “N” Shpk. Vlera e kontratës është 11,367,261.6 lekë me TVSh. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 60 ditë nga data e të fillimit të punimeve. Nga verifikimi i situacioneve të punimeve, librezës së masave dhe verifikimit në terren, rezultuan disa pasaktësi si më poshtë vijon: Nga ana e Fondit Shqiptar të Zhvillimit si investitor me përfutës Bashkia Shkodër, po kryhen disa punime paralele për termoizolim dhe fasadave të godinave të qytetit Shkodër. Këto punime kanë sjellë mbivendosje të punimeve të ndriçimit për objektin: “Investim për ndriçim të objekteve dhe tabelave emërtuese të ndërtesave”, konkretisht për nën objektin e kontratës së mësipërme “Rektorati” i Universitetit Luigj Gurakuqi. Aktualisht punimet për këtë objekt nuk janë marrë ende në dorëzim të përhershëm nga ana e AK, objekti është ende në periudhën e garancisë së punimeve, e cila përfundon në datën 15.05.2026 dhe kemi mbivendosje punimesh për zërat:

“Shirit LED7 Ë/ml, IP 68” në sasinë 580 ml x 250 lekë/ml= 145,000 lekë

“Kanaline me difuzor për shirit LED 7 Ë/ml,IP 68” 580mlx700 lekë/ml=406,000 lekë

“Adaptor (spine) për shirit LED 7Ë/ml” në sasinë 26 copë x 500 lekë/copë =13,000 lekë

Pra, në total **564,000 lekë pa TVSh** janë shpenzuar në mënyrë jo efektive, pa efikasitet dhe pa ekonomikitet. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5.1, faqe 109-116, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**7.1 Rekomandimi:** Titullari i Autoritetit Kontraktor Universitetit “Luigj Gurakuqi” Shkodër, të marrë masa për ngritjen e një grupi pune për të evidentuar shkaqet dhe personat përgjegjës, që kanë sjellë përdorimin pa efikasitet të buxhetit të Autoritetit Kontraktor në vlerën **564,000 lekë pa TVSh** mbi pagesat e kryera për punime të mbivendosura në objektin “Investim për ndriçim të objekteve dhe tabelave emërtuese të ndërtesave”.

**Menjëherë**

**8. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u krye shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për zbatimin e kontratës me objekt: “Shpenzime për mirëmbajtjen e objekteve ndërtimore” me nr.1840/16 prot., datë 09.08.2023, lidhur midis Universitetit ”Luigj Gurakuqi” Shkodër dhe Operatorit Ekonomik BOE “B” Shpk dhe “N“ Shpk. Vlera e kontratës është 23,316,485 lekë me TVSh. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 3 (tre) muaj nga data e të fillimit të punimeve.

Nga verifikimi i situacioneve të punimeve, librezës së masave dhe verifikimit në terren, rezultuan disa pasaktësi si më poshtë vijon:

Nga ana e Fondit Shqiptar të Zhvillimit si investitor me përfitues Bashkia Shkodër, po kryhen disa punime paralele për termoizolim të fasadave të godinave të qytetit, ndër godinat të cilat janë pjesë e projektit të mësipërm është dhe godina e Rektoratit të USHLG.

Për shkak të natyrës së këtyre punimeve që janë termoizolim i fasadave të godinave, këto lloj punimesh sjellin mbivendosje me punimet e kryera nga ana e Kontraktorit; disa zëra pune që kanë mbivendosje janë lyerja e fasadës dhe zëri fv skela metalike.

Këto punime kanë sjellë mbivendosje të punimeve të ndriçimit për objektin: “Shpenzime për mirëmbajtjen e objekteve ndërtimore” në Universitetin Luigj Gurakuqi konkretisht për Rektoratin. Punimet për këtë nën objekt nuk janë marrë ende në dorëzim të përhershëm punimet nga ana e AK dhe objekti është ende në periudhën e garancisë së punimeve e cila përfundon në datë 26.12.2025. Pra, kemi mbivendosje punimesh për zërat:

Nr.2.404/1 “Lyerje fasada me bojë plastike” -  $(1783.9 \text{ m}^2 \times 350 \text{ lekë/m}^2 = 624,365 \text{ lekë})$

Nr.2.431 “Skelë metalike me tubo fasade  $H > 12 \text{ m}$ ” -  $(1783.9 \text{ m}^2 \times 300 \text{ lekë/m}^2 = 535,170 \text{ lekë})$ .

Pra do kemi në total vlerën 1,159,535 lekë pa TVSh (624,365 lekë + 535,170 lekë) të shpenzuara në mënyrë jo efektive, pa eficiencë dhe pa efektivitet. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5.1, faqe 109-116, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**8.1 Rekomandimi:** Titullari i Autoritetit Kontraktor Universitetit “Luigj Gurakuqi” Shkodër, të marrë masa për ngritjen e një grupi pune për të evidentuar shkaqet dhe personat përgjegjës, që kanë sjellë përdorimin pa eficiencë të buxhetit të Autoritetit Kontraktor në vlerën **1,159,535 lekë pa TVSh** mbi pagesat e kryera për punime të mbivendosura në objektin e mësipërm.

**Menjëherë**

## **D. TË ARDHURAT E MUNGUARA.**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i aktiveve afatshkurtra (qarkulluese) në pasqyrat financiare të vitit 2023, u konstatua se llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm”, e cila përfaqëson detyrimet e personave të tretë ndaj Universitetit, rezultoi e mbyllur me tepricë zero. Kjo vlerë është në mospërputhje të plotë me të dhënat e platformës së sekretarisë online “Pitagora”, nga ku rezultoi se janë 614 studentë debitorë, me detyrime të akumuluar që prej vitit akademik 2013, në vlerën totale prej 14,386,000 lekë. Këto të ardhura të munguar nuk janë reflektuar në regjistrat financiarë të universitetit. Ndër këta studentë, 167 janë me status “Diplomuar”, me një vlerë detyrimi prej 4,330,000 lekë ndaj universitetit. Mungesa e kontabilizimit të këtyre detyrimeve në kontabilitet evidentohet si një dobësi në sistemin e brendshëm të kontrollit financiar dhe administrimit të të ardhurave, duke rritur ndjeshëm riskun e mosarkëtimit të tyre. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 47-69, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**1.1 Rekomandimi:** Administratori dhe Sektori i Financës të marrin masa të menjëhershme për evidentimin dhe kontabilizimin e detyrimeve në vlerën 14,386,000 lekë, që studentet e regjistruar prej vitit 2013 e në vijim, kanë ndaj Universitetit të Shkodrës në pasqyrat financiare të vitit 2024.

**Menjëherë**

**1.2 Rekomandimi:** Administratori dhe Sektori i Financës të marrë masa dhe veprime të menjëhershme që studentët me status “Diplomuar” të mbyllin detyrimet ndaj Universitetit në vlerën 4,330,000 lekë.

**Brenda vitit 2025**

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i të ardhurave dytësore në Universitetin “Luigj Gurakuqi” Shkodrës, u konstatua se, të ardhurat që realizohen nga Laboratori i Diagnostifikimit Mikrobiologjik, i cili është pjesë e strukturës së Rektoratit dhe ka si funksion të tij: Kryerjen e analizave mikrobiologjike për individët dhe realizimin e të ardhurave në buxhetin e USHLG-së, arkëtohen pranë qendrës ku ofrohet shërbimi. Arkëtimi i të ardhurave realizohet vetëm me anë të mandat arkëtimeve të cilat përpilohen nga punonjësit e laboratorit për shërbimin që kryejnë por që nuk kontabilizohen nga departamenti i financës. Totali i arkëtimeve ditore depozitohet nga bankat e nivelit të dytë në llogari të thesarit, dokument i cili kontabilizohet nga sektori i financës. Nga ana e sektorit të financës nuk behet asnjë kontroll i mandat arkëtimeve të lëshuara nga kjo njësi. Rezulton se ky laborator ka kryer shpenzime pa ekonomikitet, referuar qarkullimit të të ardhurave dhe shpenzimeve për vitet respektive, ku ka rezultuar me humbje për 3 vite të njëpasnjëshëm në një vlerë totale 1,341,980 lekë (tabela në vijim).

	Viti 2022	Viti 2023	Janar - Qershor 2024	Totali
Të ardhurat e laboratorit	1,177,100.00	945,900.00	583,500.00	2,706,500.00
Shpenzime për paga 2 punonjës	1,300,120.00	1,782,840.00	965,520.00	4,048,480.00
<b>Rezultati fitim/humbje</b>	<b>(123,020.00)</b>	<b>(836,940.00)</b>	<b>(382,020.00)</b>	<b>(1,341,980.00)</b>

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 47-69, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**2.1 Rekomandimi:** Titullari i Universitetit “Luigj Gurakuqi” Shkodër, të marrë masa për ngritjen e një grupi pune për të evidentuar shkaqet dhe personat përgjegjës, që kanë sjellë humbje në aktivitetin financiar të Laboratorit të Diagnostifikimit Mikrobiologjik në vlerën 1,341,980 lekë, të ardhura këto të munguara në buxhetin e Universitetit Luigj Gurakuqi, Shkodër.

**Menjëherë**

## **E. MASA DISIPLINORE**

**a.** Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15 gjerat “b”, “c” dhe “e”, për punonjësit trajtuar me përgjegjësi në Raportin Përfundimtar të Auditimit, **i rekomandojmë Rektorit dhe Administratorit të Universitetit “Luigj Gurakuqi” Shkodër në bashkëpunim me Bordin e Administrimit të USHLG**, që bazuar në performancën e secilit punonjës dhe shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo nëpunës të adresuar dhe të sigurojë marrjen e masave disiplinore përkatëse në referim të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Kreu IV, neni 11, shkronja “c” dhe “e” dhe neni 37, si dhe të kontratën individuale të punës.

1. **I. B**, me detyrë Drejtor i sektorit të financës dhe realizimit të buxhetit.
2. **S. B**, me detyrë Drejtor drejtorja e fondit të investimeve dhe shërbimeve.
3. **E. S**, me detyrë përgjegjës sektori i teknologjisë dhe informacionit.
4. **M. K**, me detyrë përgjegjës sektori prokurimeve dhe investimeve.
5. **A. S**, me detyrë përgjegjës departamenti Biologji Kimi.

6. **E. Ç**, me detyrë përgjegjës sektori marrëdhënive me jashtë.
7. **X. Z**, me detyrë specialiste sektorit të financës dhe realizimit të buxhetit.
8. **S. A**, me detyrë specialiste sektorit të financës dhe realizimit të buxhetit.
9. **N. R**, me detyrë specialist qendra SURSH.
10. **E. V**, me detyrë specialiste sektorit të financës dhe realizimit të buxhetit.
11. **S. I**, me detyrë specialiste sektorit të IT.
12. **J. P**, me detyrë specialist qendra SURSH.
13. **L. D**, me detyrë lektore qendra SURSH.
14. **N. M**, me detyrë lektore departamenti Biologji Kimi.
15. **S. M**, me detyrë specialiste sektori prokurimeve dhe investimeve.
16. **S. G**, me detyrë profesor departamenti Biologji Kimi.
17. **R. K**, me detyrë profesor departamenti i Gjuhës Angleze.

**b. Bordin i Administrimit i USHLG** të marre masa të menjëhershme, në reference të *Ligjit nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimin të Lartë në Republikën e Shqipërisë."* neni 49 dhe *Statutit të Universitetit "Luigj Gurakuqi" Shkodër, neni 28*, që bazuar në performancën e Administratorit Z, A. U dhe shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, të vlerësojë shkallën e përgjegjësi dhe të sigurojë dhënien e masës disiplinore përkatëse në referim të *Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 "Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë"*, i ndryshuar, Kreu IV, neni 11, shkronja "c" dhe "e" dhe neni 37, si dhe të kontratën individuale të punës.

c. Për të gjithë punonjësit e tjerë të trajtuar me përgjegjësi në Raportin Përfundimtar të Auditimit, për të cilët nga KLSH-ja nuk është rekomanduar dhënia e masës disiplinore konkrete, pasi shkeljet e konstatuara dhe të evidentuara janë nën materialitetin e përcaktuar nga grupi i të auditimit, lihet në kompetencë të **Rektorit** dhe **Administratorit të USHLG në bashkëpunim me Bordin e Administrimit**, fillimin ose jo të procedurave disiplinore në referim të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 "*Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar, Kreu IV, neni 11, shkronja "c" dhe "e" dhe neni 37, si dhe të kontratën individuale të punës.

## **F. PËR AGJENCINË E PROKURIMIT PUBLIK**

Referuar parregullsi dhe shkeljeve të konstatuara në procedurat e prokurimit; 1. "Blerje Gazoil", viti 2022; 2. "Shpenzime Pritje përcjellje", viti 2022; 3. "Blerje për Laboratorin e Analizave të Ushqimeve", viti 2022; 4. "Blerje Kancelari", viti 2022; 5. "Shpenzime Pritje përcjellje", viti 2023; 6. "Blerje pajisje për projektin Edukimi është çelësi zhvillimit", viti 2023; 7. "Blerje pajisje për laboratorin klinik - biokimik", viti 2023; 8. "Pajisje Laboratori i Analizave Ushqimore", viti 2023; 9. "Pajisje për Inventar Ekonomik", viti 2023 dhe 10. "Rikonstruksion Çatia FSHE", viti 2023, të pasqyruar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, bazuar në nenin 23 pika "e" dhe neni 132 të Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe bazuar në nenin 15 shkronjat (c dhe ç) dhe nenin 30 të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014, "Për Organizim in dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", i rekomandohet Agjencisë së Prokurimit Publik të marrë masa disiplinore për anëtarët e njësisë së prokurimit dhe Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar neni 129, "Procedura e hetimit administrativ" pika 1, germa "a".

## **G. MASA ADMINISTRATIVE**

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e ndërtimit, përcaktuar në nenet 7/1 dhe 12, Kreu III, dhe nenet 15 e 16 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 "*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*" i ndryshuar dhe UKM nr. 3 datë 15.02.2001 "*Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e*

*punimeve të ndërtimit*" i ndryshuar, Kreu II, Pika 3 (si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në pjesët takuese të Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe komentet e subjektit të ndryshuar, me nenin 12 të ligjit nr. 183/2014 datë 01.04.2014 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme", bazuar në nenin 15 dhe nenin 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "*Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*", për shkelje të ligjshmërisë në mbikëqyrjen e zbatimit të punimeve të ndërtimit", **i rekomandojmë**, Administratorit të Universitetit të Shkodrës, Luigj Gurakuqi z. A. U t'i kërkojë **Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, Shkodër**, sipas kontratave respektive, të vlerësojë shkeljet e konstatuara dhe të nxjerrë vendime për marrjen e masave dhe sanksioneve administrative për:

**1.** Subjekti "M" Shpk. dhe pf B.Y përfaqësuar nga z. B. Y, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve për shkeljet e konstatuara si vijon:

- Në kontratën me nr.1030/2 prot., datë 25.03.2024 me objekt: "Rikonstruksion çatia FSHE" me Kontraktor punimesh OE "L" Shpk., si rrjedhojë e diferencave në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt, me pasojë dëm ekonomik në vlerën 866,056 lekë pa TVSh.

**2.** Subjekti "S" Shpk përfaqësuar nga z. S. Ç, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve për shkeljet e konstatuara si vijon:

- Në kontratën me nr.2436/28 prot., datë 26.11.2023, me objekt: "Investim për ndriçim të objekteve dhe tabelave emërtuese të ndërtesave" me Kontraktor punimesh OE "N" Shpk, si rrjedhojë e diferencave në volume pune të likuiduara, por të pakryera në fakt, me pasojë dëm ekonomik në vlerën 1,736,533 lekë pa TVSh.

**Për sa sipër mbahet ky Raport Përfundimtar Auditimi.**

## **KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**

